monumentet

DO NOT COPY



1/1988

DO NOT COPY

KOPERTINA E PARË: Manastiri i Ardenicës

KOMITETI I KULTURËS DHE I ARTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANE

DO NOT COPY

monumentet

1/1988 (35)

KOLEGJIUMI I REDAKSISE

EMIN RIZA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZV/KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, GJERAK KARAISKAJ, GJERGJ FRASHËRI, HASAN NALLBANI
NERITAN CEKA, PIRRO THOMO.

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Komitetit të Kulturës dhe Arteve

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7.

PASQYRA E LËNDËS

	ARTIKUJ	Faqe
Pirro THOMO	Vlerat urbanistike-arkitektonike të qytetit të Korçës dhe vënia në mbrojtje e tyre	5
Guri PANI	Arkitektura e dy tempujve në Butrint dhe punimet restauruese në to	23
Guntram KOCH	Sarkofagët e pikturës perandorake në Shqipëri	39
Halil MYRTO	Konsiderata mbi obeliskun e Apolonisë	81
Gjerak KARAISKAJ	Të dhëna për kalanë e Rodonit (Redoni)	87
Gjergj FRASHËRI *Sulejman DASHI*	Fillimet e artit islamik në qytetin e Beratit	97
Ylli DRISHTI	Piktura murore në kishën e Shën Venerandës – Pllanë.	133
Reshat GEGA	Arkitektura dhe restaurimet në manastirin «Fjetja e Shën Mërisë» në Ardenicë	141
Shpresa PRIFTI	Banesa e krahinës së Kelmendit	181
Faik ALIMEHMETI	Mbi ecurinë urbane të fshatrave të Tiranës	201
	BIBLIOGRAFI DHE INFORMACIONE	
Resul LLOGO	Disa gjurmë antike në luginën e Drinos	213
Moikom ZEQO	Një botim në Francë për monumentet e kërkimet arkeologjike në Shqipëri	215

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

ARTICLES

		Page
Pirro THOMO	Les valeurs urbanistiques et architectoniques de la ville de Korça ainsi que leur mise sous la protection de l'Etat	18
Guri PANI	L'architecture des deux temples à Butrint et leur restauration	25
Guntram KOCH	Kaiserzeitliche Sarkophage in Albanien	69
Halil MYRTO	Considérations sur un obélisque à Apollonie	86
Gjerak KARAISKAJ	Données sur la forteresse de Rodon	94
Gjergj FRASHËRI *Sulejman DASHI*	Les débuts de l'art islamique dans la ville de Berat.	129
Ylli DRISHTI	L'afresque de l'église de Sainte Vendredi	140
Reshat GEGA	L'architecture et la restauration du monastère «La Dormition de la Vierge» à Ardenice	177
Shpresa PRIFTI	L'habitation de la région de Kelmend	199
Faik ALIMEHMETI	Sur l'évolution urbaine des villages de Tirana	211
Resul LLOGO	Quelques traces de l'Antiquité dans la vallée de Drino.	214
Moikom ZEQO	Une édition en France sur les monuments et les recherches archéologiques en Albanie	217

DO NOT COPY

Pirro THOMO

DO NOT COPY

VLERAT URBANISTIKE — ARKITEKTONIKE TË QYTETIT TË KORÇËS DHE VËNIA NË MBROJTJE E TYRE

Realiteti i ri historik që u krijua në vendin tonë mbas vendosjes së Pushtetit Popullor, si për gjithë qytetet e tjera, hapi perspektiva të reja edhe për zhvillimin e qytetit të Korçës.

Në urbanistikë dhe në arkitekturë lindën dukuri të reja, të cilat për nga shtrirja dhe thellësia e tyre ishin të papara deri në atë kohë. Ndryshimi rrënjësor i strukturës ekonomike e shoqërore, krijimi i një industrie të re, shtimi i mëtejshëm i popullsisë, ndryshimi i mënyrës dhe i konceptit të të banuarit, rritja sasiore dhe cilësore e sistemit arsimor, kulturor e shëndetësor, përhapja e rrjetit tregtar dhe të shërbimeve etj., shtronin përpara urbanistëve dhe arkitektëve detyra të rëndësishme e të vështira për t'i zgjidhur. Këtyre detyrave u shtohej dhe kërkesa sesi do të ruhej e gjallë historia e qytetit, vlerat arkitektonike, artistike dhe mjedisore që u krijuan gjatë kësaj historie, sesi do të ndërfuteshin këto vlera në strukturën e re të qytetit, ç'vend dhe ç'rol do të lozninato në jetën e sotme.

VLERËSIMI DHE VËNIA NË MBROJTJE E MONUMENTEVE DHE ANSAMBLEVE

Qyteti i Korçës arriti deri në ditët tona me një fizionomi të formuar urbanistike dhe arkitektonike, në të cilën dallohen, nga njëra anë, arritje të suksesshme si rezultat i zhvillimit dhe përpunimit të vazhdueshëm të tipareve dhe elementeve të kësaj fizionomie, nga ana tjetër, mangësi të rrjedhura nga vetë kushtet dhe kufizimet e periudhave, gjatë të cilave u krye ky zhvillim. Prandaj studimet për vlerësimin dhe vënien në mbrojtje të monumenteve e ansambleve kishin si synim kryesor nxjerrjen në dukje të atyre banesave dhe zonave, të cilat bartnin në vetvete vlera të çmuara historike dhe arkitektonike, vlera të gjykuara jo vetëm si dëshmi të zhvillimit të një qyteti, por të ndërfutura në mbarë zhvillimin e arkitekturës dhe të urbanistikës shqiptare.

Shkallëimi në plotësimin e kësaj detyre, i përgjigjet shkallës së gjerësisë dhe thellësisë së studimeve të kryera si në plan kombëtar, ashtu dhe në atë lokal, për qytetin e Korçës. Kështu në studimin e parë, të vitit 1973, për zonifikimin e qytetit, qendrën historike e përbënin tri ansamble, nga të cilat dy zona-muze dhe një zonë e mbrojtur, si dhe 14 banesa të cilësuara «Monument kulture» për vlerat e tyre arkitektonike. Thellimi i studimit mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës solli si rezultat rishikimin e zonifikimit të parë, në drejtim të seleksionimit dhe shtimit të zonave dhe të monumenteve të shpallura. Zonifikimi i dytë i vitit 1984, i bërë në bazë të këtij studimi, e ka rritur qendrën historike në katër zona: dy zona-muze dhe dy të mbrojtura, ndërsa numri i banesave «Monument kulture» është shtuar në 23. Përfundimisht, në qendrën historike të qytetit të Korçës janë përfshirë: pjesa që ka mbetur nga pazari dhe një pjesë e ruajtur më mirë e Varoshit të vjetër (mbrapa monumentit të Luftëtarit Kombëtar), të cilësuara si «zona-muze», ndërsa të dy krahët e shëtitores «Republika» së bashku me katër rrugë paralele në krahun lindor të shëtitores të cilat hapen drejt kodrave, si dhe një pjesë e Lagjes së Re (Jenimahalla), janë cilësuar «zona të mbrojtura». Gjithashtu pjesa jugperëndimore e zonës-muze të pazarit qarkohet nga një zonë e mbrojtur (Tab. I). Në rastin e Korçës dallimi ndërmjet zonave-muze dhe atyre të mbrojtura nuk është bërë për të diferencuar vlerat që ato përmbajnë, por kryesisht për qëllime praktike, duke u nisur nga gjendja konkrete e

ndërtimeve, funksioni i tyre, gjë që do të përcaktonte shkallëzimin dhe karakterin e ndërhyrjeve restauruese në to.

Vlerësimi dhe vënia në mbrojtje e ndërtimeve dhe ansambleve me vlerë të qytetit të Korçës, janë mbështetur në kritere tashmë të njësuara dhe të përdorura dhe për gjini të tjera arkitekturore[1]). Ato bazohen në parimin e rëndësishëm, që e konsideron monumentin si bartës të vlerave të dyfishta: si dokument i prekshëm historik dhe si vepër me vlera arkitektonike e artistike. Natyrisht, brenda kritereve të përgjithshme, janë patur parasysh qoftë karakteristikat specifike të ndërtimeve popullore në krahasim me gjinitë e tjera, qoftë veçoritë e zgjidhjeve konkrete arkitektoniko-konstruktive të Korçës.

Për zbatimin e këtyre kritereve në zgjedhjen e ndërtimeve me vlerë të qytetit të Korçës, të para këto si pjesë e pandarë e zhvillimit të përgjithshëm të arkitekturës shqiptare, ishte e nevojshme të njihej dhe të përcaktohej, qoftë edhe në vija të përgjithshme, vendi dhe roli që luajti Korça në këtë zhvillim. Gjatë studimit të urbanistikës dhe të arkitekturës së qytetit të Korçës, kemi dalluar tri periudha kryesore të historisë së tij, secila me tiparet e saj të veçanta[2]).

Periudha e parë, e cila shtrihet në një hark të gjerë kohor, nga themelimi deri në mesin e shek. XIX, bart në vetvete një sërë procesesh dhe dukurish karakteristike të kësaj periudhe. Kjo periudhë karakterizohet nga formimi i qendrës së re administrative, fill mbas pushtimit osman të vendit dhe nga rruga e kalimit gradual të saj në një qendër prodhimi e shkëmbimi, dmth drejt forcimit gjithnjë e më të madh të tipareve qytetare. Gjatë këtij zhvillimi ndeshen procese të tilla, si krijimi i lagjes së re jashtë kalasë, Varoshi, i cili në etapën e parë, ruante ndarje më të vogla në mëhallë, në trajtën e aglomeracioneve të banuara nga familje me lidhje farefisnie, si dhe krijimi i një lagjeje të dytë, Kasabasë, rreth një institucioni kulti, siç ishte xhamia e Iliaz Mirahorit dhe institucionet e tjera që e shoqëronin, duke patur për bazë ose pranë një vendbanim të vjetër, fshatin-Peshkopi. Në strukturën urbanistike të kësaj periudhe vihet re një veçim i theksuar i anasambleve formuese të qytetit, si rrjedhim jo vetëm i rrugës së formimit të tyre, por dhe si pasqyrim i dallimeve shoqërore e fetare të popullsisë së tyre. Në formulimin urbanistiko-arkitektonik, Varoshi i Korçës, paraqet tiparet e veta dalluese në krahasim me qytetet e tjera të ndërtuara me terrene të rrafshta, siç është karakteri i mbledhur, rrjeti rrugor gjarpërues, por me prirje për krijimin e unazave të mbyllura, pjesëmarrja e banesave në formulimin e rrugicave etj.

Përsa i përket tipologjisë së banesës gjatë kësaj periudhe edhe në Korçë gjen përhapje banesa me çardak. Ndonëse ky tip banese nuk pati këtu ato arritje në planin kompozicional dhe arkitektoniko-dekorativ, për të cilat dallohen variantet e zhvilluara të Beratit apo të Shkodrës, ato hedhin dritë mbi kufijtë e shtrirjes së këtij tipi në vendin tonë dhe për tiparet specifike që ato fituan në qendra të ndryshme, në përputhje me kushtet konkrete të çdo qendre. Me numrin e paktë të mjediseve, përmasat e vogla të tyre, mungesën e një zbukurimi të pasur në dru dhe shfrytëzimin e kateve përdhese për banim, këto banesa dëshmojnë edhe për gjendjen ekonomike e shoqërore të përdoruesve të tyre.

Periudha e dytë, përmban hovin më të madh që pati zhvillimi i qytetit deri në atë kohë dhe kthesën vendimtare që kreu gjatë kalimit nga një qendër e vogël në një qendër të rëndësishme në jetën ekonomike e shoqërore të vendit, duke konkuruar qytete të tilla të zhvilluara si Janinën e Beratin. Në qoftë se gjatë periudhës së parë Korça me arritjet e saj arkitektonike nuk mundi të ngrihej në nivelin e qyteteve të tjera, si Gjirokastra, Berati apo Shkodra, hopi që kreu ajo gjatë kësaj periudhe e vuri Korçën në pozitën udhëheqëse në zbatimin e kritereve të reja e të përparuara për kohën dhe me një fuqi të madhe rrezatuese. Në shtrirjen e re që fitoi qyteti, duke zënë troje të lira pa ndërhyrë në strukturën e

1) P. Thomo, E. Riza, **Kritere dhe metoda për gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore në RPSSH;** «Monumentet», I, 1983, f. 5-12.

2) Për zhvillimin urbanistik e arkitektonik të qytetit të Korçës janë botuar një varg studimesh, prandaj në këtë artikull do të japim përmbledhtazi disa nga përfundimet e këtyre studimeve mbi vlerat urbanistiko-arkitektonike të qytetit. Shih: E. Riza, B. Strazimiri, **Vështrim arkitektonik mbi qytetin e Korçës,** «Monumentet» 3, 1972; P. Thomo, **Banesat e hapura të qytetit të Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre,** «Monumentet» I, 1982; P. Thomo, **Vështrim historiko-arkitektonik mbi pazarin e Korçës,** «Etnografia shqiptare», 13, 1983, P. Thomo, **Zhvillimi urbanistik e arkitektonik i qytetit të Korçës gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX – fillimi i shek. XX,** «Etnografia shqiptare», 15, 1986, P. Thomo, **Tiparet urbanistike e arkitektonike të qytetit të Korçës në vitet 1912-1944,** «Monumentet», 1, 1987, P. Thomo, **Qyteti i Korçës dhe arkitektura shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX,** «Kultura popullore», 1, 1987.

DOKTORATURA

vjetër, për herë të parë në vendin tonë, gjeti zbatim një sistem i rregullt urbanistik, i cili praktikisht i hapte perspektivë zgjerimit të planifikuar të qytetit. Krahas futjes së këtij sistemi përpunohet një tip i ri banese, i cili me vendosjen në lidhje në rrugën, me organizimin e oborrit, me zgjidhjen kompozicionale dhe funksionale, si dhe me përpunimin arkitektoniko-dekorativ, plotësonte më mirë kërkesat e reja në rritje të banorëve për një jetesë më të kulturuar qytetare, si dhe dëshmon për fuqinë ekonomike e kulturore të qytetit.

Gjatë kësaj periudhe u krye dhe rikonstruksioni tërësor i pazarit. Pazari ruajti edhe për një farë kohe, rolin që luante në jetën ekonomike të qytetit, duke përqëndruar pjesën më të madhe të veprimtarisë prodhuese e shkëmbyese, si dhe organizimin funksional mesjetar, të diktuar nga organizimi esnafor i prodhimit zejtar. Rikonstruksioni preku strukturën urbanistike, duke zbatuar edhe në këtë pjesë të qytetit skemat e rregullta gjeometrike, si dhe duke kryer një zonim ose një lidhje më funksionale të pjesëve përbërëse: shesheve të tregtimit, dyqaneve të prodhimit dhe haneve për bujtje. Por rikonstruksioni u ndje në mënyrë rrënjësore në ndërtimet e pazarit, duke zëvendësuar thuajse të gjitha dyqanet e vjetra, të ndërtuara me materiale të brishta dhe të paqëndrueshme ndaj zjarreve, me ndërtime të reja, në të cilat janë përdorur jo vetëm materiale të qëndrueshme, tulla, gurë e hekur, por edhe struktura të përparuara konstruktive të përshtatshme për t'i bërë ballë lëkundjeve sizmike dhe zjarreve. Përveç këtyre arritjeve, ndërtimet e reja të pazarit dallohen dhe nga përpunimi i pasur arkitektonik e dekorativ.

Fundi i kësaj periudhe lidhet dhe me procese të reja, të rëndësishme për jetën dhe fizionominë e ardhme të qytetit. Përparimi i marrëdhënieve të reja ekonomiko-shoqërore pati ndikime edhe në organizimin dhe funksionin e ansambleve formuese të qytetit. Kështu pazari, në këto kushte të reja, po e mbyllte rrugën e tij të gjatë shekullore. Shumë funksione, dikur vetëm të pazarit, tani plotësohen nga njësi të ngritura në lagjet e banuara, siç ishin njësitë e tregtimit e të shërbimit ose dhe jashtë tyre, siç ishin disa njësi prodhimi. Por kjo shpërbërje e rolit të pazarit, solli dhe krijimin e ansambleve ose arterieve rrugore të mbushura me ndërtime ekonomike dhe social-kulturore, të cilat dora-dorës u kthyen në qendra të rëndësishme të jetës ekonomike, shoqërore dhe kulturore të qytetit, duke përfshirë fluksin më të madh të lëvizjes së popullsisë.

Ndërmjet periudhës së parë dhe të dytë, kemi vënë në dukje dhe një etapë të ndërmjetme, përgatitore. Kjo etapë karakterizohet nga përpjekjet e një organizmi të vjetër për të ndjekur dhe për t'iu përgjigjur marrëdhënieve të reja ekonomiko-shoqërore, të cilat kërkonin domosdoshmërisht dhe ndryshime në mënyrën e të jetuarit. Përshtatja e tipologjisë ekzistuese në drejtim të përmirësimit të kushteve të banimit, zvogëlimi i oborreve si rezultat i kufizimit të veprimtarisë së ekonomisë shtëpiake, mbushja e hapësirave të lira me ndërtime, që solli një kompaktësim të mëtejshëm të strukturës urbanistike të lagjeve të vjetra, trajtimi i ri i pamjeve të jashtme dhe i mjediseve të brendshme, përpunimi i elementeve arkitektonike e dekorative dhe, së fundi, gjetja e formave të reja të banimit, ishin arritjet më kryesore të kësaj etape. Këto arritje patën një rëndësi të madhe, sepse konsumuan një pjesë të përpjekjeve për kërkimin e shprehjeve të reja më të përparuara arkitektonike, duke përpunuar një sërë tiparesh dhe kriteresh, të cilat gjetën formulimin më të plotë gjatë periudhës së dytë. Nga ana tjetër, këto tipare, shërbyen si një urë ndërlidhëse ndërmjet arkitekturës tradicionale dhe asaj më të re, duke e bërë më të rrjedhshëm kalimin ndërmjet periudhave dhe duke siguruar atë frymë vazhdueshmërie dhe uniteti që karakterizon arkitekturën e qytetit.

Periudha e tretë e zhvillimit të qytetit vitet (1912--1944), ndonëse nuk solli ndonjë të re thelbësore në krahasim me atë pararendëse, krijoi kushtet për lindjen e disa proceseve dhe dukurive të veçanta të cilat i dhanë urbanistikës dhe arkitekturës së qytetit një përmbajtje të re. Në këtë periudhë konsolidohen disa nga arritjet e mëparshme, të cilat, në planin urbanistik, shprehen në vazhdimin e skemës urbanistike ortogonale, ndërsa në planin arkitektonik në përmirësimin e zgjidhjes funksionale dhe kompozicionale të banesës; shtyhen më tej disa arritje të tjera: marrin formë më të plotë qendrat ekonomike, shoqërore e kulturore (arteriet kryesore të qytetit), arrin në një shkallë më të lartë përpunimi arkitektoniko-dekorativ i pamjeve dhe elementeve të veçanta të banesës; futen koncepte dhe elemente të reja, gjini ndërtimore të tilla si: banesa me dyqane në katet përdhe, ndërtime social-kulturore dhe administrative, ndjehet mendimi projektues i specialistëve të shkolluar në urbanistikë dhe arkitekturë etj. Ishin pikërisht këto faktorë dhe dukuri të kësaj periudhe, të cilat mundën ta korrigjojnë, ta plotësojnë dhe ta pasurojnë fizionominë urbanistiko-arkitektonike të Korçës dhe t'i japin atë koherencë dhe qartësi (sigurisht të gjykuar brenda kushteve të kohës) kaq karakteristike për këtë qytet.

Në varësi të këtyre vlerave është bërë përcaktimi i qendrës historike të qytetit dhe banesave të shpallura «Monument kulture». Theksi në këtë përcaktim

DOKUMENT

është vënë në periudhën e dytë, meqenëse vlera e saj i tejkalon ndijshëm caqet lokale, duke mbetur një shembull mjaft shprehës i karakterit të qytetit shqiptar dhe atij ballkanik, për një periudhë shumë të rëndësishme të historisë së tyre, që lidhet me lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste. Kështu, zona-muze, në pjesën më të vjetër të qytetit, pasqyron procesin e formimit të qendrave të reja, mënyrën e formimit të tyre dhe tiparet që ato kishin. Zona e mbrojtur, në ish Lagjen e Re (Jenimahalla) dëshmon për zgjerimin tashmë të planifikuar të qytetit, në bazë të një sistemi të caktuar urbanistik, ndërsa datimet e shumta të ruajtura në banesat e kësaj lagjeje dokumentojnë fillimet dhe ecurinë në kohë të zbatimit të këtij sistemi në Korçë. Zona-muze e pazarit hedh dritë mbi fuqinë prodhuese dhe tregtare të qytetit. Së fundi zona e mbrojtur në të dy krahët e shëtitores «Republika», sëbashku me katër rrugët që shkëputen nga ajo në drejtim të kodrave të qytetit, tregon për vazhdimin e këtij sistemi urbanistik në periudhën e tretë.

Relativisht më i lehtë ishte përcaktimi i objekteve që do të viheshin në mbrojtje. Studimet mbi tipologjinë e banesës qytetare dhe periodizimin e saj, si dhe gjurmimi e vënia në mbrojtje e ndërtimeve me vlerë të Beratit, Gjirokastrës, Shkodrës etj. kishin krijuar një bazë të mirë njohjeje për t'u orientuar drejt edhe përsa i përket ndërtimeve të Korçës. Kështu disa banesa, që i përkasin tipit me çardak, tregojnë për shtrirjen e këtij tipi në vendin tonë, disa të tjera përfaqësojnë etapën përgatitore me tiparet e saj të reja, si rezultat i përshtatjes së tipologjisë tradicionale, përpunimit të elementeve arkitektonike e dekorative dhe format e reja të banimit. Por fondin më të madh të monumenteve të qytetit të Korçës e zenë banesat e tipit të ri, duke dëshmuar për procesin e lindjes dhe për të gjitha hallkat e zhvillimit të këtij tipi, të përfaqësuara nga variantet e shumta që përmban. Veçimi i një fondi të tillë është i spjegueshëm, në qoftë se kihet parasysh fakti se Korça zinte një vend parësor ndërmjet qyteteve të tjera, përsa i përket përpunimit dhe përhapjes së tipit të ri të banesës qytetare.

Por, në qoftë se në binomin: dokument historik — vlerë arkitektonike e artistike që përmban nocioni «Monument kulture», premisat e mësipërme e kënaqin plotësisht faktorin e parë, faktori i dytë do të vinte në ndihmë për të përcaktuar konkretisht kufijtë e zonave muze ose të mbrojtura dhe objektet që do të përfaqësonin sa më mirë tiparet dhe zhvillimin e arkitekturës. Për këtë qëllim ishte e nevojshme të njihej jo vetëm rruga e zhvillimit tipologjik, por dhe niveli që arriti struktura urbanistike dhe përpunimi arkitektonik, konstruktiv e dekorativ, qoftë i kësaj tipologjie, qoftë dhe i elementeve të veçanta. Pra, me fjalë të tjera, në përcaktimin e qendrës historike dhe të monumenteve duhej të ndiqej një hierarki vlerash: mjedisore-urbanistike-arkitektonike-dekorative, me një gërshetim të natyrshëm dhe të drejtë të këtyre kategorive, d.m.th. elementi si pjesë përbërëse e ndërtesës ose ansamblit, ndërtesa si pjesë e ansamblit, ansambli në marrëdhënie me mjedisin rrethues.

Duke u nisur nga këto kritere, në Varoshin e vjetër u veçua një zonë, e cila u kishte shpëtuar më shumë ndërhyrjeve dhe ndryshimeve të mëvonshme, ruante rrjetin rrugor karakteristik të paprekur dhe një fond mjaft të madh ndërtimesh të vjetra, që me raportet ndërmjet njëri-tjetrit, shkallën, përmasat dhe trajtimin e tyre krijonin, ndonëse jo të plotë, atmosferën e jetës së asaj kohe (fig. 1).

Nga shtrirja e qytetit, gjatë periudhës së dytë, u veçua një pjesë e ish Lagjes së Re (Jenimahalla), në të cilën janë zbatuar më mirë karakteristikat kryesore të sistemit urbanistik ortogonal: lidhja me arteriet kryesore të qytetit dhe hapja e ansamblit ndaj tyre, rregullsia e rrjetit rrugor, kufijtë e luhatjes të madhësive të parcelave të ndërtimit, mënyra e vendosjes së ndërtimeve në parcelë, me prirjen për orientim sa më të favorshëm, uniformitetin e sipërfaqes së oborreve dhe elementeve formuese të tyre, tipizimin e theksuar të ndërtimeve të ansamblit, si dhe qartësia dhe prakticiteti i këtij sistemi, që lejon zgjerimin e qytetit, me anë të shtimit të herëpashershëm të parcelave të reja (Fig. 2).

Zona e dytë e mbrojtur, ajo në të dy krahët e shëtitores «Republika», i takon periudhës së tretë, gjatë së cilës vazhdoi zgjerimi i qytetit në troje të reja, duke iu bindur të njëjtit sistem urbanistik. Por zbatimi mbi gjysmë shekullor i këtij sistemi kishte prurë grumbullimin e një përvoje të pasur, saqë e bënte të mundur vazhdimin më të studiuar të tij dhe shmangien e disa mangësive. Një nga arteriet kryesore ekonomike, që lidh qytetin me viset fqinje, bëhet një bosht i fuqishëm kompozicional i strukturës urbanistike, një lloj shtylle vertebrore, nga e cila del dhe zhvillohet një rrjet i dendur rrugor. Drejtimi i ndryshëm i rrugëve në të dy krahët e këtij boshti dëshmon për shmangien nga rregullat e rrepta, nga monotonia dhe zhvillimi uniform, karakteristika të përgjithshme të sistemit ortogonal. Ndërtuesit korçarë kanë marrë nga ky sistem anët e tij pozitive, siç ishin prakticiteti dhe lehtësia e ndërtimit, duke ia nënshtruar zbatimin e tij kushteve konkrete të terrenit dhe të klimës. Funksioni i rrugës «Skënderbeg» ose i unazës së jashtme të qytetit si rrugë tranziti, e çliron

DOKOTOBOOK

DO NOT COPY



Fig. 1 Rrugë në Varoshin e vjetër



Fig. 2 Rrugë në Lagjen e Re

plotësisht këtë bosht nga funksionet ekonomike, duke i dhënë karakterin e një shetitoreje të mirëfilltë. Kompozimi i rrugëve të cilat hapen ndaj peizazhit rrethues (Fig. 3), intervalet e shkurtra të ndërprerjes së blloqeve të ndërtimeve, vendosja ballore e ndërtesave me përpunim të pasur arkitektonik e dekorativ, zgjerimi i hapësirës urbanistike nëpërmjet rrethimit me kangjella dhe zbukurimi i saj me sipërfaqet e gjelbëruara publike e vetiake të oborreve, si dhe me skulpturë monumentale e dekorative të rrethimeve dhe të banesave, kanë gjetur një përputhje të plotë me këtë funksion dhe i kanë dhënë vlera të vërteta estetike shëtitores. Nga ana tjetër dhe një sërë procesesh arkitektonike që ndodhën gjatë kësaj periudhe, si: vendosja e re e banesës në lidhje me rrugën, karakteri paraqitës i oborrit, përpunimi i tipologjisë së banesës dhe, në mënyrë të veçantë, realizimet e larta dekorative të elementeve prej guri, hekuri dhe në suva, gjejnë pasqyrim pikërisht në këtë shëtitore (Fig. 4). Në këtë mënyrë, me vënien në mbrojtje të kësaj zone sigurohet dhe ruajtja e një fondi banesash dhe elementesh, që pasuruan trashëgiminë ndërtimore dhe i dhanë një ngjyrë kaq karakteristike fizionomisë arkitektonike të Korçës.



Fig. 3 Rrugë drejt kodrave

Nga pazari i vjetër u vu në mbrojtje thuajse e gjithë pjesa që kishte arritur të ruhej. Por kjo ishte dhe pjesa më me interes, e cila barte të gjitha karakteristikat kryesore urbanistike dhe arkitektonike të pazarit mbas rikonstruksionit tërësor. Ajo është e plotësuar me të gjitha elementet përbërëse: sheshet, dyqanet, hanet, i ka të dukshme raportet funksionale ndërmjet elementeve, ruan skemën e rregullt urbanistike, si dhe ndërtimet plot vlera për zgjidhjet e tyre konstruktive dhe arkitektonike (Fig. 5).

Të njëjtat kritere u përdorën edhe për vënien në mbrojtje të banesave. Për periudhën e parë këtë detyrë e lehtëson fakti se numri i banesave të mbe-



Fig. 4 Elemente dekorative në hekur e gurë

tura ishte i pakët, por, nga ana tjetër, e vështirësonin gjendja tepër e dëmtuar e tyre si dhe ndryshimet që ato kishin pësuar me kohë. Kryerja e punimeve të kujdesshme restauruese, gjatë të cilave një vend të rëndësishëm zinin operacionet konsoliduese, plotësuese të pjesëve munguese dhe çliruese nga shtesat pa vlerë, mundën të zbulonin pamjen fillestare të disa prej tyre, dhe të vinin në dukje vlerat e vërteta të objekteve dhe tiparet e veçanta të këtij tipi në qytetin e Korçës (Fig. 6). Numri i shumtë i banesave të periudhës së dytë e të tretë e bënte më të rëndësishëm qëndrimin ndaj tyre, për të zgjedhur ato shembuj që do të përfaqësonin sa më mirë veçoritë kompozicionale të varianteve të ndryshme, në strukturën e pasur morfologjike të këtij tipi (Fig. 7). Vënia në mbrojtje e ansambleve të së njëjtës periudhë siguronte ruajtjen e elementeve të ndryshme arkitektonike dhe të trajtimit të jashtëm, duke mos e kufizuar sasinë e këtyre elementeve vetëm në atë të monumenteve të shpallura. E dëshirueshme ishte që objektet e zgjedhura për t'u vënë në mbrojtje të përfshiheshin brenda ansambleve të mbrojtura, sepse në këtë mënyrë ato do të vlerësoheshin më mirë në një mjedis të natyrshëm, ku ato kanë bërë jetën e tyre. Por në pamundësi të realizimit të këtij synimi, janë zgjedhur edhe banesa jashtë këtyre zonave, vlerat e të cilave përfaqësojnë më mirë tiparet dhe etapat e ndryshme të zhvillimit.

Legjislacioni për mbrojtjen e monumenteve dhe rregullorja «Për mbrojtjen dhe restaurimin e disa ansambleve me vlera urbanistiko-arkitektonike në qytetin e Korçës», i japin mbështetjen e nevojshme ligjore e juridike këtyre vlerësimeve, duke siguruar



Fig. 5 Pame e pazarit

DO NOT COPY

për sot dhe për të ardhmen ruajtjen e këtij fondi të çmueshëm të trashëgimisë kulturore.

JETA E QENDRËS HISTORIKE DHE E MONUMENTEVE NË QYTETIN E SOTËM. PROBLEME TË INTEGRIMIT

Sado i saktë dhe i mbështetur shkencërisht që të jetë, vlerësimi dhe përcaktimi i zonave dhe objekteve të vëna në mbrojtje, sado i plotë që të jetë legjislacioni për mbrojtjen e tyre, ata nuk mund të jenë të mjaftueshme në qoftë se problemi i mbrojtjes nuk do të shihet në një kuadër më të gjerë, lidhur me restaurimin, nga njëra anë, dhe në raport me zhvillimin e qytetit të sotëm, nga ana tjetër. Por këtu, nuk do të ndalemi në kriteret që janë përdorur dhe do të përdoren në punimet restauruese, problem ky gjerësisht i rrahur në literaturën dhe praktikën botërore e vendëse, ku është arritur në përfundime të njësuara dhe të pranuara përgjithësisht nga specialistët e kësaj fushe. Më me interes na duket diskutimi i problemit tjetër: jeta e qytetit të vjetër në strukturën e sotme dhe të ardhme të qytetit, ku mpleksen koncepte e interesa të fushave të ndryshme, duke mos arritur gjithmonë në mendime të njëjta ose në zgjidhje të pranueshme për të gjithë. Pra me fjalë të tjera për fatin e monumenteve shtrohet pyetja: a mund të bashkëjetojë e vjetra me të renë dhe si do të bashkëjetojë?

Le t'i shohim këto çështje në objektin konkret të studimit, në qytetin e Korçës.

Siç e vumë në dukje, ndryshimet rrënjësore të karakterit ekonomik, shoqëror e kulturor dhe rritja e mëtejshme e popullsisë, i dhanë një hov të ri e të paparë zhvillimit të qytetit. Problemet kryesore që shtronte ky zhvillim, në përgjithësi gjetën një zgjidhje të drejtë. Zonimi funksional i qytetit, ndarja e zonave të banuara nga ato ekonomike e industriale, organizimi i mirë i këtyre zonave, duke i pajisur me pjesët formuese të nevojshme, disa ndërhyrje që u bënë në strukturën ekzistuese të qytetit, riorganizimi i transportit të brendshëm etj. ishin disa masa të rëndësishme për të ardhmen e qytetit. Por, për plotësimin e kërkesave të reja, erdhi në ndihmë dhe trashëgimia e pasur e së kaluarës, e cila me arritjet e saj urbanistike dhe arkitektonike, mund të përballonte ende disa nevoja. Të marrim p.sh. problemin e banimit. Periudhat e mëparshme kishin krijuar një fond të konsiderueshëm banesash me arritje jo të papërfillshme në planin kompozicional dhe funksional, të afta për t'iu përgjigjur edhe për disa kohë kërkesave të reja të jetesës. Gjithashtu, një pjesë e mirë e plotësimit të nevojave të popullsisë për një përhapje uniforme të rrjetit tregtar, shëndetësor, kulturor, arsimor, bre-



Fig. 6 Banesë e hapur



Fig. 7 Banesë e tipit të ri

DO NOT COPY

nda ansambleve ose lagjeve të banuara, mund të zgjidheshin me lehtësi nga ndërtimet ekzistuese. Ndërmjet tyre u zgjodhën shumë banesa me një kompozim të zhvilluar që, me përmasat dhe mundësitë përshtatëse të tyre, u kthyen në çerdhe e kopshte, ambulanca e klinika, dyqane shitjeje e njësi shërbimi, muze e salla leximi, zyra etj. Kështu, një pjesë e ndërtimeve të reja të banimit dhe atyre social-kulturore, duke mos patur arsye për të zëvendësuar ndërtimet e vjetra dhe duke mos patur gjithnjë mundësi të futeshin në strukturën tepër kompakte ekzistuese, u ngritën në hapësirat e lira ose jashtë kësaj strukture. U arrit të kryhej kështu një proces krejt i natyrshëm vetëmbrojtjeje i qytetit të vjetër i nevojshëm për zgjidhjen e problemeve të ngutshme gjatë etapës së parë të zhvillimit të ri të qytetit. Përsa i përket problemit të mbrojtjes, ky proces krijoi kushte të favorshme për veprimtarinë gjurmuese e vlerësuese, sepse e gjeti të padëmtuar shumë fizionominë fillestare të qytetit.

Por në qoftë se vetëmbrojtja e qytetit të vjetër qe pozitive për periudhën e parë, vazhdimi i mëtejshëm i saj do të sillte pasoja negative në zhvillimin perspektiv, sepse nuk mund, as duhej penguar transformimi ose ripërtëritja e qytetit. Dhe tani kur ritmi i ndërtimeve të reja brenda strukturës së vjetër sa vjen e rritet dhe kur përcaktimi i vlerave të trashëgimisë ndërtimore tashmë është kryer, mund të mendohet për një përafrim më të studiuar të së vjetrës me të renë, duke i kanalizuar në rrugë të drejtë forcat krijuese dhe duke shfrytëzuar mundësitë ekonomike dhe juridike për zgjidhje pozitive e konkrete.

Probemi i integrimit të qendrës historike në qytetin e ri duhet parë në dy aspektet kryesore të tij: në atë shoqëror dhe në aspektin urbanistik. Në aspektin shoqëror zgjidhja e problemit varet nga mënyra e rigjallërimit të qendrës historike dhe të monumenteve, me fjalë të tjera, ç'funksione do të marrin ato, për t'u përfshirë aktivisht në jetën e sotme. Ndër funksionet e shumta që mund t'i jepen monumentit, ruajtja e funksionit fillestar do të ishte më e pëlqyeshme, sepse në këtë mënyrë monumenti do të jetonte brenda natyrës së vet, duke ruajtur koherencën ndërmjet elementeve përbërëse: funksion, kompozim, trajtim arkitektoniko-dekorativ, hapësirë rrethuese. Në rastin e qendrës historike të qytetit, të formuar kryesisht nga banesa, pjesa dërmuese e të cilave do të ruajë funksionet e banimit, kjo kërkesë plotësohet.

Por jo gjithnjë është e mundur ruajtja e funksionit fillestar, sepse ky mund të mos jetë i përshtatshëm për kërkesat e reja të jetesës, ose në raste të tjera, mund ta kthejë monumentin në një objekt muzeal pa jetë. Nga ana tjetër jo çdo funksion mund të jetë i pranueshëm, sepse do ta shkëpuste monumentin nga jeta e tij e natyrshme, ose mund të sillte ndryshime të tilla, që do të kompromentonin rëndë vlerat, për të cilat është vënë në mbrojtje. Pra, përcaktimi i funksionit që do të marrë monumenti, përbën një moment tepër të rëndësishëm për të ardhmen e tij dhe, njëkohësisht, do të shërbejë si një hallkë e rëndësishme e integrimit të tij në jetën e sotme të qytetit.

Rastet e ndryshimit të funksionit fillestar ndeshen si në banesat, ashtu dhe në ndërtimet e tjera, siç janë ato të pazarit. Përsa i përket banesës, jo të gjitha kënaqin kërkesat e mënyrës së re të jetesës, madje edhe ato më të zhvilluarat kanë mangësira për një jetë komode, kështu që një pjesë e popullsisë që jeton në qendrën historike do të vihej në kushte më të disfavorshme banimi. Kjo papërshtatshmëri është kapërcyer nga legjislacioni përkatës. Sipas rregullores për mbrojtjen e qendrës historike, të gjitha ndërtimet që përfshihen në të ndahen në monumente të kategorisë së parë dhe në monumente të kategorisë së dytë. Të parat janë ndërtime më me vlera, të cilat përfaqësojnë etapat kryesore të zhvillimit tipologjik dhe arritjeve arkitektonike, kështu që në to nuk lejohet asnjë ndryshim që prek kompozimin volumor, trajtimin arkitektoniko-dekorativ të pamjeve të jashtme dhe të brendshme dhe zgjidhjen planimetrike. Monumentet e kategorisë së dytë, që përbëjnë shumicën dërrmuese të ndërtimeve në zonat-muze dhe ato të mbrojtura, me volumet, raportet ndërmjet tyre, trajtimin, ngjyrat dhe materialet, i japin vlerën mjedisore e urbanistike ansamblit. Në këto monumente lejohen ndryshime apo përshtatje të brendshme në dobi të rritjes së komoditetit, duke përdorur për këtë qëllim struktura e materiale të reja, me kusht që të mos cënohet pamja e tyre e jashtme. Në këtë rast kemi përshtatje të funksionit dhe jo ndryshim tërësor të tij. Brenda këtij lejimi është bërë përshtatja e banesave të kategorisë së dytë edhe për funksione të tjera, si për çerdhe, kopshte, klinika, ambulanca, salla leximi, biblioteka, shtëpi-muze etj.

Një qëndrim tjetër është mbajtur gjatë trajtimit të banesave monumente të kategorisë së parë. Përveç funksionit të banimit, është parapëlqyer ai përdorim, i cili me kërkesat e veta funksionale të mos cënojë kompozimin planimetrik e volumor dhe, gjithashtu, të krijojë mundësinë e nxjerrjes në pah të vlerave të monumentit dhe të soditjes së tyre nga një masë e madhe njerëzish. Në këtë vështrim funksioni kulturor është më i përshtatshmi. Kështu një numër i madh banesash është kthyer në muze (Muzeu Historik, Muzeu etnografik-arkeologjik etj.), në galeri

DO NOT COPY

arti (banesa e «Piktorit të Popullit» Vangjush Mio), në shtëpi-muze të lidhura me ngjarje ose figura të shquara historike (banesat ku jetuan shoku Enver Hoxha, Ali Kelmendi, banesat e Mihal Gramenos, Themistokli Gërmenjit etj.). Praktika shumëvjeçare në zbatimin e këtyre kritereve, jo vetëm në Korçë, por edhe në qytetet e tjera, ka dhënë rezultate të kënaqshme. Është arritur, që në zonat-muze dhe të mbrojtura, të zhvillohet një jetë normale dhe pa kufizime për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të kohës.

Vështirësi më të mëdha paraqiste rigjallërimi i zonës-muze të pazarit të vjetër, meqenëse funksionet e tij të dikurshme thuajse kishin humbur përfundimisht. Kështu as sheshet e tregtimit, as dyqanet e prodhimit artizanal dhe as hanet për bujtjen e klientelës së pazarit, nuk mund të përdoreshin me qëllimet për të cilat ishin ndërtuar. Por ndryshimi tërësor i funksioneve të pazarit do të sillte pasoja negative, sepse do të prishte karakterin dhe përmbajtjen e ansamblit, kaq të nevojshëm për përceptimin, interpretimin dhe justifikimin e mjeteve arkitektoniko-dekorative të përdorura. Prandaj nga tërësia e funksioneve të mundshme, një vend të rëndësishëm zunë funksionet e përafërta me ato fillestare. Këtu futen njësitë e tregtimit, të riparimeve dhe të shërbimeve komunale, si dhe disa njësi të prodhimeve artizanale, të cilat kanë jetë ende dhe sot. Këto funksione do t'i japin pazarit atë lëvizje dhe gjallëri, kaq karakteristike për ansamblet e këtij lloji. Grupi i dytë i funksioneve është i karakterit kulturor e turistik, i cili ndihmon për një vlerësim më të plotë të arritjeve arkitektonike të ansamblit, njëkohësisht, zgjeron rrethin e vizitorëve dhe rrezen e përhapjes së përshtypjeve të fituara. Në ish Hanin e Manastirit është hapur Ekspozita e kulturës popullore e rrethit të Korçës, ku vizitori njihet me prodhimin artistik tradicional, një pjesë e të cilit prodhohej e tregtohej pikërisht në këtë pazar, si dhe me zhvillimin e tij në kushtet e sotme (Fig. 8). Në këtë kompleks kanë hyrë dhe disa njësi, ku prodhohet në mënyrë tradicionale për qëllime ekspozicionale, didaktike, dhe ku tregtohen objekte të këtij prodhimi. Kthimi i ish Hanit të Elbasanit, në pikë turistike me kuzhinë e pajisje karakteristike, përfshirja e një pjese të aktivitetit kulturor nëpërmjet organizimit të ekspozitave tematike e të përkohshme, të koncerteve etj. në mjediset e pazarit, do të jenë faktorë shtytës për një tërheqje më të madhe të publikut, pra për një gjallërim të jetës së ansamblit të vjetër. Përdorime të tjera të ndërtimeve të pazarit për klube, kafene, birrari, restorante, studio artistësh etj., do të ishin gjithashtu funksione të pranueshme që nuk binin ndesh me karakterin e pazarit.



Fig. 8 Ekspozita e kulturës popullore

Në qoftë se për mënyrën e integrimit të qendrës historike në jetën e sotme me anë të rigjallërimit të saj mund të gjenden rrugë të pranueshme, integrimi i saj në aspektin urbanistik është tepër delikat, sepse një veprim i nxituar sjell dëmtime të pariparueshme. Kuptimi i rëndësisë së këtij problemi dhe hartimi i një plani të studiuar rregullues, i cili do të marrë parasysh vlerat e vëna në mbrojtje, janë mjetet më të efektshme për ta zgjidhur edhe në aspektin urbanistik raportin ose bashkëjetesën e qendrës historike me qytetin e ri. Për të arritur në raporte të drejta ose bashkëjetesë të suksesshme ka rëndësi qëndrimi që do të mbahet lidhur me tri shfaqjet më të dukshme të këtij raporti: ndërhyrjet në qendrën historike, karakterin e ndërtimeve të reja pranë ose përqark qendrës historike, kalimin nga qendra historike në ndërtimet e reja.

Ndërhyrja me ndërtime të reja në qendrën historike është një nga veprimet më me pasojë për vlerësimin e strukturës urbanistike të vjetër. Heqja ose shtimi i një volumi të ri mund të prishë gjithë harmoninë dhe ekuilibrin e ansamblit, të arritura sipas një logjike të caktuar dhe të përpunuar, korrigjuar dhe konsoliduar për një periudhë të gjatë kohore sipas së njëjtës logjikë. Dëmin që mund të sjellë futja e një volumi të ri jashtë shkallës dhe funksionit të ansamblit po e ilustrojmë me disa shëmbuj nga e kaluara dhe e sotmja.

Do not copy

DO NOT COPY

Ngritja e kishës së re katedrale më 1937 në vend të së vjetrës, në mes të lagjes Varosh, me përmasat tepër të mëdha në plan dhe lartësi, me materialet dhe trajtimin e përdorur, mbeti e huaj në mjedisin rrethues, me një siluhetë përgjithësisht të shtrirë dhe me një strukturë të dendur. Me proporcionet e saj ajo nuk ka mundur të ndikojë as në thyerjen e kësaj shtrirjeje horizontale, por, përkundrazi, krijon përshtypjen e një mase zotëruese e shtypëse. E patretur nga mjedisi rrethues ka mbetur dhe një ndërtesë banimi në lagjen Barç, për shkak të përmasave dhe trajtimit eklektik të saj, larg frymës së përgjithshme të ansamblit përreth (Fig. 9).

Dëmtim serioz të profilit vetiak të strukturës së vjetër ka sjellë ndërtimi i një shkolle në fund të shëtitores «Republika». Bashkëveprimi harmonik i elementeve arkitektonike e dekorative, lidhja e goditur me mjedisin natyror nëpërmjet pauzave, të formuara si nga hapësirat e brendshme të gjelbëruara, ashtu dhe nga ndërprerja e parcelave nga rrugët tërthore që hapen ndaj kodrave të qytetit, janë arritjet më të vlefshme të kësaj shëtitoreje. Vëllimi masiv i ndërtesës së re, jo vetëm që ka dalë jashtë shkallës dhe ka thyer ritmin e brendshëm të ansamblit, por ka mbyllur dhe perspektivën drejt peizazhit rrethues, pra ka cënuar pikërisht vetitë më të çmuara të ansamblit të vjetër.

Prishje të karakterit dhe unitetit stilistik sjellin jo vetëm ndërhyrjet voluminoze në strukturën urbanistike, por edhe ndërhyrjet në të ashtuquajturën «arkitekturë minore». Në krijimin e vlerave të një ansambli të dhënë, një rol të rëndësishëm lozin elementet e trajtimit arkitektoniko-dekorativ të ndërtimeve që formojnë ansamblin. Një nga karakteristikat e këtij trajtimi në zonat e mbrojtura të qytetit të Korçës është dhe plastika e pasur dekorative e krijuar nga elementet e shumta, si pilastra e korniza, të nxjerra në reliev dhe të suvatuara. Këto elemente janë gjithashtu më të prekshme nga koha dhe kanë pësuar dëmtimet më të mëdha. Zhdukja e këtyre elementeve, mungesa e kujdesit në ripërtritjen e tyre dhe rrafshimi i fasadave ka sjellë në disa raste dhe humbjen e tipareve specifike të këtyre ansambleve.



Fig. 9

Duke u nisur nga dëmtimi që sjellin ndërhyrjet e llojeve të më sipërme, legjislacioni dhe rregullorja për mbrojtjen e qendrës historike përmbajnë dispozita të veçanta, të cilat ndalojnë ose kufizojnë futjen e volumeve të reja, duke vënë një kontroll të rreptë mbi ndërtimet e reja e të domosdoshme brenda zonave të mbrojtura. Por, përsa i përket ndërtimeve të reja jashtë qendrës historike ose në afërsi të monumenteve, ky legjislacion le një diapazon të gjerë interpretimesh. Në këtë rast njohja e mirë e trashëgimisë të së kaluarës, respektimi i vlerave të saj dhe gjetja e pikave të referimit ose të hallkave ndërlidhëse, do të jenë faktorët kryesorë, që, më tepër se rregullat, do të sigurojnë mbrojtjen e kësaj trashëgimie dhe bashkëjetesën e së vjetrës me të renë. Karakteri i ndërtimeve të reja, tiparet arkitektonike dhe raportet urbanistike të tyre me qendrën historike ose me hapësirën rrethuese të monumenteve do të ndikojë jo vetëm në vlerësimin e traditës, por dhe në fizionominë e përgjithshme të qytetit. Volumet e mëdha, trajtimi arkitektonik, materialet dhe ngjyrat krejt të ndryshme të ndërtimeve të reja në afërsi të qendrës historike dhe të monumenteve të veçanta do të sillnin, nga njëra anë, një ngushtim të hapësirës jetike, një farë mbytjeje të këtyre të fundit, ndërsa nga ana tjetër, një thyerje të menjëhershme të siluetit dhe një copëtim të hapësirës urbanistike.

Praktika botërore dhe e jona ka treguar se vështirësitë e zgjidhjes së këtij problemi nuk janë të pakapërcyeshme. Shembuj zgjidhjesh të pranueshme ka edhe në qytetin e Korçës, si në të kaluarën ashtu dhe në ditët tona. Mjafton të përmendim periudhën përgatitore, në mesin e shek. XIX e cila me përshtatjet që i bëri tipologjisë tradicionale dhe me dendësimin e strukturës urbanistike ekzistuese zgjidhi disa nevoja të ngutshme të kohës, duke përdorur mjete arkitektonike, të cilat jo vetëm që nuk e cënuan, por përkundrazi e pasuruan fizionominë e ansamblit të vjetër. Periudhat pasuese nuk mbetën në vend, por e pasuruan së tepërmi repertorin e mjeteve urbanistike dhe arkitektonike, duke përdorur sisteme e for-



Fig. 10

ma krejt të reja shprehëse dhe, megjithatë, mundën të gjejnë pika referimi për të krijuar një koherencë të re dhe për t'i dhënë një ngjyrë unitare fizionomisë së qytetit.

Në ditët tona në ndërtimin e një blloku banesash përballë zonës-muze të pazarit, ndonëse kjo mund të mos konsiderohet si gjetja më e përshtatshme, ndjehet përpjekje për një ballafaqim sa më të mirë të së resë me të vjetrën. Kompozimi me grupe të veçanta i ndërtimeve, diferencimet në lartësi dhe thyerjet në plan të volumeve, janë gjetur si pika referimi në këtë ballafaqim. Lartësia e madhe e ndërtimeve të reja në rastin konkret nuk ka sjellë shqetësime. Zona e gjelbëruar para pazarit dhe shëtitorja e gjerë ndërmjet ansambleve, kanë krijuar hapësirën e nevojshme ndarëse, e cila i kufizon së tepërmi pikat e shikimit të njëkohshëm të dy ansambleve dhe rrjedhimisht, nuk krijon projektime pamjesh mbi njëratjetrën (fig. 10).

Duke pasur të tjera kushte, afrimi i një blloku ndërtesash të reja banimi me zonën-muze, ka kërkuar një zgjidhje tjetër. Si pika referimi këtu janë gjetur volumi, trajtimi dhe elementet arkitektonike e dekorative të përdorura. Ansambli është kompozuar me ndërtime të veçanta që dalin me faqen e tyre të ngushtë në rrugë duke shmangur kështu rrezikun e krijimit të masave të mëdha voluminoze. Lartësia e ansamblit vjen duke u ulur në drejtim të zonës-muze duke kaluar nga banesa katërkatëshe, në tri dhe duke mbaruar me banesa dykatëshe. Me këto masa është arritur të ruhet proporcionimi i volumeve dhe një kalim i rrjedhshëm nga ndërtimet e reja në hapësirën e vjetër. Mbasi u zgjidh përgjithësisht drejt kompozimi volumor dhe ruajtja e tërësisë së hapësirës urbanistike, kërkime të suksesshme u bënë dhe në gjetjen e një shprehjeje të përshtatshme arkitektonike. Trajtimi i ballëve me lozha të thella, që të kujtojnë njësitë e hapura të banesave tradicionale, përdorimi me masë i elementeve dhe materialeve të traditës, si strehë ose pjesë çatish të mbuluara me tjegulla dhe ngjyrat e çelura janë gjetur si mjete të rëndësishme për ruajtjen edhe të tërësisë arkitektonike (Fig. 11).

Por, për vetë karakterin dhe kërkesat funksionale të ndërtimeve të reja, nuk është e mundur të manovrohet gjithnjë me mjetet e mësipërme. Në këto



Fig. 11

DO NOT COPY

raste krijimi i zonave të lira dhe i brezave të gjelbëruara janë pranuar si zgjidhje më të përshtatshme, si për harmonizimin e siluetës urbanistike, ashtu dhe për vlerësimin e qendrës historike. Kështu, siç e pamë dhe më sipër, sheshi i gjelbëruar dhe shëtitorja e gjerë, kanë krijuar hapësirën e nevojshme shkëputëse ndërmjet zonës-muze të pazarit dhe bllokut të ri të ndërtesave të banimit. Në të njëjtat kritere është mbështetur dhe studimi i qendrës së re të qytetit, rreth monumentit të Luftëtarit Kombëtar, e cila do të përmbajë ndërtime voluminoze, si Komitetin e Partisë, Pallatin e Kulturës, magazinë shumëkatëshe etj. Shtrirja e kufizuar e këtij kompleksi në thellësi të lagjes së vjetër ka dhënë mundësinë e krijimit të një zone të lirë me gjerësi të mjaftueshme për të bërë shkëputjen ndërmjet pjesës së re dhe asaj të vjetër, si dhe vlerësimin e pavarur të dy ansambleve.

Siç e shohim nga parashtrimi i mësipërm, gjenden të gjitha mundësitë për një bashkëjetesë të sukseshme të qytetit të vjetër me atë të ri. Në këtë mënyrë integrimi i qendrës historike në jetën e sotme nuk do të jetë formal dhe i rastësishëm, por si shenjë respekti për arritjet e periudhave të kaluara dhe do të krijojë kushtet e favorshme që kjo trashëgimi të plotësojë mesazhin e vet historik e kulturor. Nga ana tjetër qëndrimi i drejtë ndaj saj, e parë kjo si pjesë e pandarë e konceptit bashkëkohor në zhvillimin dhe ripërtrirjen e qytetit, do të jetë një kontribut i vlefshëm që i shton epoka e jonë këtij mesazhi dhe që do t'ia transmetojë brezave të ardhshëm.

POOR COPY

TAB I



Zonifikimi i Korçës

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Pirro THOMO

LES VALEURS URBANISTIQUES ET ARCHITECTONIQUES DE LA VILLE DE KORÇA AINSI QUE LEUR MISE SOUS LA PROTECTION DE L'ETAT.

RESUME

La nouvelle réalité historique créée dans notre pays, après l'installation du Pouvoir Populaire, offrit de nouvelles perspectives à l'évolution de la ville de Korça, tout comme à celle des autres villes. Outre les devoirs que cette évolution imposait, il fallait penser comment sauvegarder vivante l'histoire de la ville, les valeurs architectoniques, artistiques et d'ambience créées au cours de cette histoire, de quelle façon les intégrer dans la nouvelle structure de la ville, quels seraient la place et le rôle qui leur reviendraient à la vie actuelle. Les études sur l'appréciation et la mise sous protection des monuments et des ensembles visaient à mettre en évidence les habitations, et les zones contenant de précieuses valeurs historiques et architectoniques, des valeurs estimées non seulement en tant que témoignage de l'évolution d'une seule ville, mais encadrées dans toute l'évolution de l'architecture et de l'urbanisme albanais.

L'accomplissement graduel de ce devoir correspond au degré de la largeur et de la profondeur des études effectuées sur la ville de Korça tant sur le plan national que sur celui local. Ainsi, d'après la première étude de l'année 1973 sur la division en zones de la ville, le centre historique était composé de trois ensembles, deux zone-musées, et une zone protégée et de 14 habitations, qui par leurs valeurs architectoniques étaient qualifiées de «monuments culturels». Mais l'approfondissement de l'étude sur l'urbanisme et l'architecture de la ville apporta de nouvelles propositions quant à la sélection et à l'augmentation du nombre de zones et de monuments proclamés. La nouvelle division en zones, faite sur la base de cette étude, présente un centre historique divisé en quatre parties: deux zones musées et deux zones protégées ainsi que 23 habitations dénommées «monument culturel». A l'heure actuelle, le centre historique de la ville de Korça comprend une partie du vieux bazar et la meilleure partie conservée de l'ancien Varosh, dénommées zones musées, ainsi que les deux côtés du boulevard «Republika», avec les quatre rues parallèles partant de celui-ci et menant aux collines se trouvant à sa partie orientale et une partie du Nouveau Quartier (Jenimahalla), dénommés «zones protégées». De même, la partie sud-occidentale de la zone musée du bazar est entourée d'une zone protégée. (tab. I). Dans le cas présent, la différence entre les zones musées et celles protégées n'est pas établie pour différencier les valeurs qu'elles enferment, elle présente essentiellement des fins pratiques en s'appuyant à l'état concret des constructions, leur fonction, ce qui préciserait le caractère des interventions de restauration.

L'estimation et la mise sous la protection de l'Etat des ensembles de valeur de la ville de Korça, se sont basées sur des critères déjà définis et appliqués même pour les autres genres de l'architecture. Elles respectent le principe important qui considère le monument le porteur d'une double valeur: un document historique tangible et une oeuvre à valeurs architectoniques et artistiques. Naturellement, on a pris en considération soit les caractéristiques spécifiques des constructions populaires en comparaison avec les autres genres, soit les particularités des solutions concrètes architectoniques et constructives de la ville.

Le critère typologique fut l'un des principaux critères qui orientèrent la qualification d'une construction «monument culturel». Il donne à cette construction la pleine valeur du document historique non seulement à un certain degré ou période de développement, mais au cours de toute cette évolution, depuis les réuissites les plus simples jusqu'à celles les plus compliquées. Il se forme ainsi un cadre complet de toute cette création.

En s'appuyant seulement sur ce critère on ne peut pas résoudre tous les problèmes qui surgissent au cours de cette activité. L'une de ces questions se rapporte à l'étendu territorial de la typologie, donc à l'attitude qu'il faut adopter envers les exemples de la même typologie situés dans de divers centres ou régions du pays. Dans ces cas le critère de base fut celui de la sauvergarde de ces exemples, jusqu'à un certain point parallèles, puisqu'ainsi serait documentée la géographie de la typologie. Vues comme partie intégrante de l'évolution de l'architecture albanaise en général, les constructions de valeur de la ville de Korça ne pourraient être choisies qu'après avoir connu et précisé, soit en lignes générales, la palce et le rôle que cette ville occupe à cette évolution. Pendant l'étude de l'urbanisme et de l'architecture de la ville de Korça, on remarque trois périodes principales de son histoire, chacune représentant ses traits particuliers.

La première période, s'étalant sur un large espace temporel depuis la création jusqu'au milieu du XIXe sc, renferme une sé-

rie de processus et de phénomènes caractéristiques de cette période. Cette période se caractérise par la formation du nouveau centre administratif tout de suite après l'occupation ottomane du pays et son passage graduel vers un centre de production et d'échange, donc vers le raffermissement des traits urbains.

Au cours de cette période, même à la villé de Korça c'est le type de l'habitation à «tchardak» qui gagna du terrain. Quoique ici, ce type d'habitation, sur le plan compositionnel et architectonique décoratif ne connut pas les résultats dont se distinguent les variantes évoluées de Berat et de Shkodra, il jette de la lumière sur les limites de l'étendu de ce type dans notre pays et sur les traits spécifiques qu'ils revêtirent aux divers centres, conforme aux conditions concrètes de chaque centre.

La deuxième période marque le plus grand essor de la ville à cette époque et le tournant décisif qu'elle subit par le passage d'un petit centre à un centre important de la vie économique et sociale du pays. Si pendant la première période, avec ses réalisations architectoniques, la ville de Korça ne put pas se hausser au niveau des autres villes telle que Gjirokastra, Berati ou Shkodra, l'essor qu'elle connut à cette période lui donna une position dirigeante à l'application des nouveaux critères avancés pour l'époque jouissant d'une grande puissance rayonnante. La nouvelle étendue de la ville, occupant des terrains libres sans intervenir à l'ancienne structure, apporta pour la première fois dans notre pays l'application d'un système urbanistique régulier, qui, pratiquement, ouvrait la perspective d'un élargissement planifié de la ville. De pair à l'introduction de ce système, fut élaboré un nouveau type d'habitation lequel, avec sa disposition par rapport à la rue, l'aménagement de la cour, la solution compositionnelle et fonctionnelle ainsi que le traitement architectonique décoratif, complète mieux les nouvelles exigences des habitants pour un meilleur mode de vie culturel urbain.

Au cours de cette période s'effectue la reconstruction complète du bazar. Le bazar conserva pendant un certain temps le rôle qu'il jouait dans la vie économique de la ville en concentrant la plus grande partie de son activité de production et d'échange ainsi que l'organisation fonctionnelle médiévale, dictée par l'existence des corporations d'artisans. La reconstruction toucha la structure urbanistique en appliquant même dans cette partie de la ville les schémas géométriques irréguliers et en assurant une meilleure liaison fonctionnelle des parties constituantes: des lieux de commerce, des ateliers et des auberges. La reconstruction se sentit de façon radicale aux constructions du bazar où les anciennes boutiques réalisées avec des matériaux fragiles, furent substituées par de nouvelles constructions avec des matériaux résistants, briques, pierres, fer, et avec des structures constructives avancées résistantes aux secousses sismiques et au feu. Outre ces réalisations, les nouvelles constructions du bazar se distinguent par le riche traitement architectonique et décoratif.

Entre la première et la deuxième période, on a mis en évidence une étape intermédiaire préparatoire. Cette étape se caractérise par les efforts d'un ancien organisme pour répondre aux nouveaux rapports économiques et sociaux, lesquels exigent forcément des modifications dans le mode de vie. L'adaptation de la typologie existante à l'amélioration des conditions d'habitation, la réduction des cours par la limitation de l'activité de l'économie domestique l'aménagement des espaces libres à des fins constructifs qui apporta une compacité ultérieure de la structure urbanistique des anciens quartiers, le nouveau traitement de l'extérieur et de l'intérieur d'une habitation, l'élaboration des éléments architectoniques et décoratifs et enfin la découverte des nouvelles formes d'habitation, furent les principales réalisations de cette étape.

La troisième période de l'évolution de la ville (les années 1912-1944) quoique n'apporta aucune nouveauté essentielle en comparaison avec la précédente créa les conditions nécessaires à la naissance de quelques processus et apparences particulières qui donnèrent un nouveau contenu à l'urbanisme et à l'architecture de la ville. Pendant cette période se consolidèrent, quelques-unes des réalisations précédentes, lesquelles sur le plan urbanistique s'expriment par la poursuite du schéma urbanistique orthogonal, alors que sur le plan architectonique, quelques autres réalisations quant à l'amélioration de la solution fonctionnelle et compositionnelle de l'habitation, avancent; les centres économiques, sociaux et culturels (les principales artères de la ville) revêtent une forme plus complète; le traitement architectonique décoratif des façades et des éléments particuliers de l'habitation atteind un plus haut degré, des conceptions et des éléments nouveaux s'introduisent telle que l'habitation dont le rez-de-chaussée sert de boutique, des constructions sociales-culturelles etc.

Compte tenu de ces valeurs on définit le centre historique de la ville et les habitations dénommées «monument culturel». Pour pouvoir appliquer cette définition l'accent à été mis à la deuxième période puisque sa valeur dépasse sensiblement les confins locaux, demeurant un exemple assez expressif du caractère de la ville albanaise et celle des Balkans pendant une période assez importante de leur histoire qui se rattache à la naissance et à l'évolution des rapports capitalistes.

Si au binome: document historique-valeur architectonique et artistique, que la notion «monument culturel» contient, les prémisses déjà mentionnées satisfaisaient complètement le premier facteur, le deuxième facteur aiderait à mieux préciser concrètement les confins des zones musées ou protégées et les objets qui représenteraient mieux les traits et l'évolution de l'architecture. A cette fin, il fallait connaitre de pair la voie de l'évolution typologique, le niveau atteint par la structure urbanistique et le traitement architectonique constructif et décoratif de cette typologie et de ses éléments particuliers.

Se basant sur ces critères, on désigna à l'ancien Varosh une

DO NOT COPY

DO NOT COPY

zone qui avait mieux échappée aux interventions et aux modifications ultérieures et qui conservait bien le réseau routier caractéristique, un fond considérable d'anciennes constructions qui, par leurs rapports entre elles leurs dimensions et leur traitement architectural créaient presque l'atmosphère de la vie de l'époque (fig. 1).

De l'extension de la ville au cours de la deuxième période on écarta une partie de l'ex-Nouveau Quartier (Jenimahalla) où sont appliqués le mieux les principales caractéristiques du système urbanistique orthogonal: la liaison avec les principales artères de la ville la régularité du réseau routier, les limites des variations des dimensions du terrain de construction, la façon dont ces constructions y sont disposées, la tendence vers la plus favorable orientation, l'uniformité de la surface des cours et de leurs éléments constituants, l'uniformité marquée des constructions de l'ensemble ainsi que le caractère pratique et précis de système permettant l'élargissement de la ville par l'adjonction ultérieure des nouveaux ilots (fig. 2).

La deuxième zone protégée celle des deux côtés du boulevard «Republika» remonte à la troisième période au cours de laquelle se poursuivit l'extension de la ville sur de nouveaux terrains obéissant au même système urbanistique. L'application de ce système pendant plus d'un demi siècle avait assuré l'accumulation d'une riche expérience qui rendait possible une poursuite plus étudiée et l'écartement de quelques défauts. L'une des principales artères économiques qui rattache la ville aux alentours, devient un puissant axe compositionnel de la structure urbanistique, une sorte de colonne vertébrale d'où part et se développe un dense réseau routier. La différente orientation des rues des deux côtés de cet axe témoigne d'un échappement aux règles rigoureuses, à la monotonie et au développement uniforme, propres au système orthogonal. Les maitres constructeurs de cette ville empruntèrent à ce système ses côtés positifs tel que le caractère pratique et la facilité de construction qu'ils soumirent aux conditions concrètes du terrain et du climat. Le fonctionnement de la ceinture extérieure de la ville en tant que route de transit délibère entièrement cet axe des fonctions économiques, lui donnant le propre caractère d'un boulevard. La composition des rues (fig. 3) découpées en petits intervalles par des pâtés de maison, la disposition frontale des constructions comportant une riche élaboration architectonique et décorative, l'extension de l'espace urbanistique au moyen des clôtures à grilles et leur ornementation par les espaces verdoyants publics et celles des cours et par les sculptures monumentales et décoratives des clôtures, s'harmonisent bien à cet fonction et confèrent au boulevard de vraies valeurs esthétiques. D'autre part, même une série de processus architectoniques effectués au cours de cette période tel que: la nouvelle disposition de l'habitation par rapport à la rue, le caractère présentable de la cour, l'élaboration de la typologie de l'habitation, les décorations bien réussies en éléments de pierre, de fer, et en enduit, se reflètent aussi dans cette zone. (fig. 4). De cette façon, la mise sous la protection de l'État de cette zone assure la sauvegarde d'une série d'éléments et d'habitations qui enrichirent l'héritage des constructions et donnèrent une couleur si caractéristique à la physionomie architectonique de la ville de Korça.

Du vieux bazar, on mit sous protection presque toute la partie qui en fut conservée. C'était la partie la plus intéressante qui comportait toutes les principales caractéristiques urbanistiques et architectoniques du bazar, après sa reconstruction totale. Cette partie fut complétée de toutes ses éléments: places, magasins, auberges; les rapports fonctionnels entre les éréments sont bien distincts, elle conserve le schéma régulier urbanistique ainsi que les constructions pleines de valeurs par leurs solutions constructives et architectoniques (fig. 5).

Les mêmes critères furent respectés même pour la mise sous protection des habitations. En ce qui concerne la première période d'une part le choix en fut facile puisqu'elles ne subsistaient qu'à un petit nombre, mais d'autre part leur état assez endommagé ainsi que les transformations qu'elles avaient subies dans le temps, rendaient la situation assez difficile. Grâce aux travaux soigneux de restauration, au cours desquels une place importante revenait aux opérations de consolidation, de complètement et de l'enlèvement des adjonctions sans valeur, on put découvrir l'état original de quelques-unes d'elles et mettre en relief les valeurs réelles des objets ainsi que les traits particuliers de ce type dans la ville de Korça (fig. 6). Le grand nombre des habitations de la deuxième et troisième période éxigeait un choix soigné de celles qui représentaient le mieux les particularités compositionnelles des diverses variantes dans la riche structure morphologique de ce type (fig. 7).

La législation sur la sauvegarde des monuments et le règlement «Sur la protection et la restauration de quelques ensembles riches en valeurs urbanistiques-architectoniques de la ville de Korça», accordent l'appui législatif et juridique nécessaire à ces estimations, assurant ainsi à l'heure actuelle et à l'avenir la conservation de ce fonds apprécié de l'héritage culturel.

Mais, aussi précises et appuyées scientifiquement qu'elles soient, l'estimation et la définition des zones et des objets mis sous protection, aussi complète qu'elle soit la législation sur leur protection, elles ne pourraient pas être suffisantes si le problème de la sauvegarde ne se voyait pas dans un cadre plus large par rapport à l'évolution de la ville actuelle.

Comme nous l'avons déjà remarqué, les transformations radicales de caractère économique, social et culturel ainsi que la croissance ultérieure de la population, donnèrent un élan sans précédent au développement de la ville. Les principaux problèmes dictés par ce développement, trouvèrent en général, une solution convenable. Afin de satisfaire aux nouvelles exigences, on s'appuya sur le riche héritage du passé, qui par ses réalisations, urbanistiques et architectoniques put répondre à quelques besoins, tel que le problème de logement. De même, quelques-uns des besoins de la population pour une répartition uniforme du réseau commercial, sanitaire, culturel, à l'intérieur

des ensembles ou des quartiers habités, pourraient être résolus facilement par les constructions existantes. Ainsi il s'accomplit le processus naturel de l'autodéfense de l'ancienne ville, nécessaire à la solution des problèmes immédiats de la prémière étape du nouveaux développement de la ville. Quant au problème de la sauvegarde, ce processus créa des conditions favorables au domaine des recherches et des estimations parce qu'il trouva en bon état la physionomie originale de la ville.

Si l'autodéfense de l'ancienne ville était un fait positif pendant la première période, sa poursuite ultérieure amènerait des conséquences négatives au développement perspectif. A l'heure actuelle, quand le rythme des nouvelles constructions dans le cadre de l'ancienne structure va toujours croissant et la définition en zones des valeurs de l'héritage des constructions est réalisée, on doit recourir à un rapprochement plus élaboré entre le nouveau et l'ancien.

Le problème de l'intégration du centre historique dans la nouvelle ville doit être vu sous ses deux aspects principaux: celui social et celui urbanistique. Quant l'aspect social, la solution du problème dépend du mode dont on réanimerait le centre historique et les monuments, donc, en d'autres termes, des fonctions qu'ils revêtiraient pour être englobés dans la vie actuelle. Parmi les nombreuses fonctions qu'un monument peut remplir, la souvegarde de la fonction initiale serait la plus préférable puisque ainsi le monument peut conserver la cohérence entre les éléments constituants tels que: la fonction, la composition, le traitement architectonique, l'espace environnant. Cela se réalise dans le cas du centre historique de la ville qui est formé essentiellement d'habitations dont la plus grande partie conserve la fonction de logement. Mais toutes les habitations ne peuvent pas répondre aux exigences d'un nouveau mode de vie, même celles les plus développées à l'heure actuelle souffrent de défauts, ainsi, une partie de la population qui vit au centre historique logerait dans des conditions moins favorables. Dans ce cas, la législation respective vient en aide. D'après le règlement sur la protection du centre historique, toutes les constructions y comprises, sont divisées en monuments de la première catégorie et en monuments de la deuxième catégorie. Les premières sont des constructions de valeur qui représentent les principales étapes du dévelopement typologique et les réalisations architectoniques, donc, on n'y permet aucune modification qui touche la composition du volume, le traitement architectonique décoratif des intérieurs et des façades, la solution planimétrique. Les monuments de la deuxième catégorie, qui constituent la plus grande partie des constructions des zones-musées et de celles protégées, avec leurs volumes, les rapports entre eux, le traitement architectonique, les couleurs et les matériaux utilisés, donnent à l'ensemble la valeur urbanistique et d'ambiance. On permet à ces monuments des modifications ou des adaptations intérieures qui n'altèrent pas leur vue extérieure. Cette permission a rendu possible l'adaptation des habitations de la deuxième catégorie à de nouvelles fonctions (crèches, jardins d'enfants, bibliothèques, maison-musée etc).

Une autre attitude fut adoptée envers le traitement des habitations représentant des monuments de la première catégorie. A part la fonction de logement, on préfère un tel usage, qui par ses exigences fonctionnelles n'altère pas la composition planimétrique et celle des volumes et permet la mise en évidence des valeurs du monument. Sous cet angle, la fonction culturelle fut la plus convenable. Ainsi, nombre d'habitations se convertirent en musées, galeries d'art, maisons-musées rappelant des événements ou des figures historiques marqués etc.

La réanimation de la zone-musée de l'ancien bazar qui avait perdu presque toutes ses anciennes fonctions, représentait des difficultés. De toutes les fonctions possibles, une place importante revint aux fonctions proches de celles initiales. On y établit des magasins, des ateliers de réparations et de production artisanale, qui existent même à l'heure actuelle et donnent à cet ensemble son animation caractéristique. Le deuxième groupe de fonctions fut celui à caractère culturel et turistique qui aide à mieux estimer les réalisations architectoniques de l'ensemble.

Si, pour l'intégration du centre historique dans la vie actuelle par son réanimation, l'on peut trouver des solutions admissibles, son intégration sous l'aspect urbanistique est très délicate, parce qu'une démarche prématurée apporterait des dégâts irréparables. La compréhension de l'importance de ce problème ainsi que l'élaboration d'un projet d'aménagement bien étudié, qui aura en vue les valeurs mises sous protection, sont les moyens les plus efficaces pour résoudre même sous l'aspect urbanistique le rapport ou la coexistence du centre historique et de la nouvelle ville. Pour obtenir de justes rapports ou une coexistence bien réussie, il importe l'attitude qu'il faut adopter envers les trois plus apparents phénomènes de ce rapport: les interventions au centre historique, le caractère des nouvelles constructions aux alentours du centre historique, le passage du centre historique aux nouvelles constructions.

La pratique mondiale ainsi que celle de notre pays ont montré qu'on peut surmonter des difficultés de ce genre. Des exemples bien réussis du passé ou de nos jours, on en rencontre même dans la ville de Korça.

DOKTORI

DO NOT COPY

Nr. 1 1988

monumente

DO NOT COPY

GURI PANI

ARKITEKTURA E DY TEMPUJVE NË BUTRINT DHE PUNIMET RESTAURUESE NË TO

Tempujt e zbuluar në Butrint[1]), ofrojnë mjaft të dhëna të rëndësishme për një studim më të plotë të tyre. Nxjerrja në pah e elementeve arkitektonike e studimi i dëmtimeve në strukturë, për ndërhyrjet e ardhshme konsoliduese e restauruese, përbëjnë dhe qëllimin e këtij artikulli.

Monumentet që trajtohen në këtë punim janë tempulli i Asklepit dhe një tempull tjetër, ndoshta i Afërditës[2]) . Të dy tempujt, ndonëse jo të një kohshëm, lidhen me fillimet e organizimit të qendrës shoqërore të Butrintit. Tempulli i Asklepit është ngritur rrëzë shpatit jugor të Akropolit, aty ku ky i fundit zbret për t'u unifikuar me terrenin e sheshtë, në të cilin në një kohë relativisht më të vonë është konceptuar dhe ndërtuar Agoraja e qytetit (fig. 1). Tempulli i dytë është mbështetur në shpatin e thyer të Akropolit, në lartësinë 14 m nga niveli i të parit (fig. 2). Në zgjedhjen e vendit me sa duket është pasur parasysh prania e një burimi ujor (fig. 3), të shndërruar në faltore në natyrë,[3]) çka i përgjigjet më së miri karakterit dhe funksionit ritual të tempujve, në rastin tonë atij të Asklepit. Shembullin më të mirë të ngritjes së tempujve pranë vendburimeve ujore, të cilët në një periudhë më të lashtë kanë qenë shndërruar në qendra të shërbimit e rituale e gjejmë dhe në Delf[4]).

Arkitektura e tempujve. Në të dy tempujt ruhen mjaft nga elementet konstruktive e arkitektonike të tyre.

Për arkitekturën e tempujve Ugolini jep në vija të përgjithshme disa elemente tipologjike e stilistikore, duke u përqendruar më shumë në fazën e dytë, që i përket periudhës romake. Të dhëna plotësuese për fazat e ndërtimit, zgjidhjen planimetrike e disa krahasime të këtyre tempujve me aureolin iliro-epirot, të parë në një këndvështrim tjetër jepen nga A. Baçe, i cili bën përpjekje për rikonstruksionin hipotetik të planimetrisë së tempujve të Asklepit, duke i shtuar atij dhe mjedisin e burimit të ujit, në rolin e mjedisit të epistodomit[5]). Jepen gjithashtu të

1) Tempujt janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike, të kryera në vitin 1926 nga L.M.Ugolini. Një përmbledhje e këtyre punimeve është botuar në revistën **«Albania antica»** Vol. 3, Romë 1942, f. 91-108.

2) S. Dakaris, **Dodona,** Janinë, 1971, f. 54 «Ky rit u përhap nga Pirroja në Zacymthes, Leukos, Actium, Ambraki dhe Buthrotum». Megjithatë deri më sot nuk ka të dhëna arkeologjike ose epigrafike për një tempull të Afërditës.

3) A. Baçe, **Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek ilirët,** «Monumentet» 2, f. 9.

4) D. Papastamos, **Delphes et musee,** Athenes, 1973, f. 4. Ky autor shpreh mendimin se tempulil i Delfit, që ze një periudhë më të lashtë (shek. VI p.e.r), lidhet me burimin e ujit.

5) A. Baçe, **Vep.cit,** fq 24.

DO NOT COPY



Figura 1

dhëna për datimin e tyre, të lidhura këto me ngjarjet historike që zhvillohen në këto treva.

Temenosi dhe më vonë tempulli i Asklepit i ngritur në shek. IV p.e.s shfaqen në pikënisje të ndërtimeve të tjera, të cilat çuan në një periudhë relativisht më të vonë në formimin e qendrës shoqërore të qytetit. Tempulli ruan mjaft nga elementet konstruktive dhe arkitektonike të tij, që ndihmojnë për të vecuar dy faza. Në fazën e parë (shek. IV p.e.r.), me rëndësi në zgjidhjen arkitektonike të tempullit të Asklepit, ishte vendosja e tij tangenciale me aksin qendror të qendrës shoqërore. Ky element urbanistik duket ndikoi në formimin arkitektonik të tempullit.

Tempulli i Asklepit është i dukshëm vetëm nga njëra anë, me fasadën ballore që paraqitet përballë hyrjes për në qendrën shoqërore. Zgjidhja planimetrike e tempullit të Butrintit paraqitet e thjeshtë, e tipit postil in antis. Nga ana konstruktive tempulli është zgjidhur me elemente konstruktive të kohës, tra – kolonë. Gjurmët e mbështetjes së kolonave të fasadës ballore, duken në linjën e ruajtur të stilobatit të tempullit.

Fragmente të shumta antefiksesh të ripërdorura në muraturën e faltores së fazës së dytë dhe kapiteli dorik (fig. 4) janë elementet që ruhen nga fasada. Këto të dhëna na ndihmojnë për një rikonstruksion

DO NOT COPY



Figura 2

hipotetik të fasadës së tempullit në fazën e parë. Për frontonin, në mungesë të të dhënave të tjera, jemi mbështetur te Vitruvi[5a]). Muret e fazës së parë të tempullit, të ndërtuara me blloqe guri gëlqeror të bardhë, kanë shërbyer edhe si substruksion për fazën e dytë. Muri në anën lindore të tempullit me gjerësi rreth 0.72 m kapet në skajin verior përbri shtesave të fazës së dytë (fig. 5). Po këtë gjerësi ka dhe muri në anën perëndimore të tempullit, i mbuluar nga muri me kontraforte i faltores së fazës së dytë. Këto mure mbyllin nga ana lindore dhe perëndimore dy mjediset e tempullit, pronaosin dhe naosin. Në anën jugore pronaosi ishte i hapur e konturohej nga linja e stilobatit, mbi të cilin duken gjurmët e dy kolonave e dy pilastrave në anë të anteve, që mbanin ngarkesën e antablementit. Nga ana veriore pronaosi lidhet me naosin me anën e një porte. Ndriçimin ky mjedis e merrte vetëm nga porta, që shërbente për të komunikuar me pronaosin. Të dy këto mjedise janë shtruar me pllaka guri kuadratike. Pllakat që shtrojnë naosin janë më të mëdha (0.36 x 0.90 m, 1.60 x 0.95 m). Niveli i dyshemesë së naosit është më



Figura 3

i lartë se ai i pronaosit rreth 0.20 m. Linjat e mureve anësore të tempullit dhe gjurmët që ato kanë lënë në stilobat, tregojnë në mënyrë bindëse, se kemi të bëjmë me një tempull me ante. Përmasat e naosit janë 6.04 x 4.25 m dhe të pronaosit 6.04 x 1.85 m. Gjerësia e tempullit rezulton 6.04 m dhe gjatësia e tij, e cila përmbledh hapësirën 1.85 m të pronaosit, hapësirën 4.25 m të naosit, gjerësinë e stilobatit 0.5 m dhe gjerësinë 0.69 m të murit ndarës të mjediseve është 7.3 m (ose rreth 8 m duke shtuar gjerësinë

5a) Vitruvi, **Ten boocs of architecture,** III 3; 5.

DO NOT COPY



Figura 4



Figura 5

e murit fundor). Gjurmët e murit fundor, prania e mjedisit me burimin e ujit dhe kufizimi me masivin shkëmbor në anën veriore të tempullit, të bëjnë të mendosh se tempulli nuk ka «opisthodomos». Funksionin megjithëse të cunguar të këtij mjedisi mund ta ketë luajtur shpella me burimin e ujit, në të cilën janë gjetur një numur i madh enësh nga autori i gërmimeve të tempullit[6]). Raste të tilla të tempujve pa opisthodomos janë të njohura[7]) kryesisht për tempuj të vegjël, ku pamja e prapme nuk duket.

Fasada ballore, në bazë të gjurmëve të anteve dhe dy kolonave mbi stilobat, lejon të përcaktohet një hapësirë e mundshme e interkolumjeve. Për këtë ndihmon zbulimi i një ganxhe (kunji) të fiksuar në skajin perëndimor të stilobatit, që duket se shërbente për lidhjen e pilastrit. Për analogji pritej që edhe në anën tjetër të skajit lindor të stilobatit të ndeshnim në po këtë element, por dëmtimet e mëvonshme kishin zhdukur çdo gjurmë të tij. Blloqet e stilobatit në pjesën e dukshme, ishin të fërkuara nga përdorimi i gjatë i tyre, ç'ka përcakton dhe hapësirën e interkolumit anësor. Pjesa tjetër e sheshit të stilobatit, përveç sektorëve që zinin kolonat, ndihmonin për të përcaktuar dhe interkolumin ndërmjet tyre[8]). Kolonat kanë lënë një gjurmë të rrumbullakët me diametër rreth 0.60 m. Hapësira e lëmuar, që i takon interkolumit midis kolonave, është 1.0 m, e barabartë me interkolumin ndërmjet kolonave e pilastrave anësore.

Faza e dytë e tempullit, që përfaqësohet me faltoren e Eskulapit (fig. 6), ruan të njëjtin orientim dhe në planimetri ruan pothuajse konturet e fazës së parë (fig. 5). Ndryshime të vogla bëhen në planimetri duke u zgjeruar, për aq sa e lejonte muri me kontraforte i analemës së teatrit dhe korridori i hyrjes për në parodosin e teatrit. Pra, kemi një zgjerim e një zgjatim të vogël, që nuk shkon më shumë se 0.60 m në anën jugore e 0.60 m në anën lindore. Muret e faltores janë formuar nga një masë blloqesh të vogla, në formë drejtkëndore, të lidhura me llaç gëlqere. Masa e llaçit është sheshuar mbi sipërfaqen e gurëve, duke zënë një sipërfaqe më të madhe në vetë trashësinë e fugës së muraturës (fig. 7). Linjat e fugave vertikale e horizontale janë theksuar me anën e një vizimi që është bërë me një mjet metalik, kur llaçi ishte i njomë. Teknika e ndërtimit dhe materiali i përdorur në këto konstruksione është karakteristike për shek. II e.r.[9]).

Harku i qemerit që mbulon mjedisin e faltores, ruan mjaft elemente të zgjidhjes konstruktive të saj. Harku është formuar nga tulla të vendosura në këmbë (fig. 8) mbi të cilat fillon masa mbushëse (e formuar me gurë e llaç gëlqere), ku mbështeten shkallët e

DO NOT COPY



Figura 6



Figura 7



Figura 8



Figura 9

6) L.M. Ugolini, **vep.cit.** f. 98 (këtu autori përmend rreth 260 enë të zbuluara brenda këtij mjedisi).

7) Coulton JJ. **Greak architects at work, London 1977,** f. 123.

8) A. Baçe – **vep.cit.** f. 20. Këtu autori përmend kolona tetëkëndëshe të fasadës ballore, por gjurmët që përmendëm më lart dhe mungesa e ndonjë fragmenti kolone tetëkëndëshe, na shtyjnë të mendojmë më shumë se kolonat duhet të kenë qenë të rrumbullakta. Gjithashtu zgjatimet anësore të anteve nuk e mbyllin hapësirën e interkolumjeve në masën 50-60 cm siç ishte menduar (po aty fq. 20, fig. 30), por me vendosjen e pilastrave, kjo hapësirë zgjerohet deri në 1.00 m që do të linte të lirë kalimin midis tyre.

9) G. Lugli. **La tecnica edilizia Romana,** Roma 1957 vol. I fq. 633-634.

DO NOT COPY

teatrit e korridori që lidhte kavenë me skenën. E kësaj periudhe është dhe rikonstruksioni që pëson skena e teatrit. Siç shihet në fazën e dytë, tempulli ka humbur mjaft nga rëndësia e bukuria e fazës së parë. Rindërtimet e tij lidhen me ndërtimet dhe shtesat që pësoi teatri në shekujt e parë të erës sonë.

Tempulli i rindërtuar ose faltorja e Eskulapit e mbuluar me qemer cilindrik, ka planimetri drejtkëndëshe (6.05 x 8.60 m). Lartësia e qemerit nga niveli i dyshemesë, arin 4.40 m dhe është e përafërt me lartësinë e supozuar të tavanit të tempullit të fazës së parë. Hyrja e faltores e pajisur me një portë dhe dy dritare me hark (fig. 9) është afruar në një plan me murin e analemës së teatrit. Fasada me kolona e tempullit është zëvendësuar me sipërfaqen e sheshtë të fasadës ballore të faltores së Eskulapit dhe njehsohet me murin mbajtës të shkallareve të reja të teatrit (fig. 6).

Mjedisi aneks pranë tempullit[10]). Në krahun perëndimor të tempullit, në kuotën e sheshit të shtruar me pllaka guri, duket një këmbë shkallë në funksion të një mjedisi (fig. 6). Kjo shkallë, rreth 7.20 m e gjerë e rreth 0.30 m ngritur nga kuota e sheshit është përgatitur me gurë gëlqerorë të një cilësie të mirë, ku duken të gdhendura, përveç një kornize të theksuar, edhe dy këmbë grifoni, të ngjashme me ato të radhës së parë të teatrit. Mbi këto shkallë, në një fazë të dytë është shtuar edhe një radhë tjetër (26 cm e lartë) po me blloqe guri gëlqeror, si duket për të fituar kuotën e dyshemesë së mjediseve. Një korridor i gjerë, rreth 1.30 m, vazhdon gjatë gjithë gjerësisë së këtij mjedisi. Dy kthina të barabarta, me përmasa 3.07 x 4.13 m, përbri njera-tjetrës, shtrihen në anën veriore të korridorit.

Përdorimi i këtij monumenti ende është i papërcaktuar, ndonëse ka të ngjarë që të ketë shërbyer fillimisht si mjedis shtesë i tempullit të Asklepit dhe më vonë i faltores së Eskulapit. Në të mirë të këtij supozimi mund të merret krahasimi me një rast analog të zbuluar në Delfi[11]). Rrënojat e fazës së parë[12]) janë mbuluar nga ndërtimet e periudhave të mëvonshme, të cilat kanë ruajtur në përgjithësi zgjidhjen planimetrike të fazës së parë (fig. 10).



Figura 10

10) Kemi të bëjmë me një ndërtim, me dy kthina dhe një korridor para tyre, jo thjesht me një ndenjëse siç mendohej më parë (A. Baçe, **vep.cit.** f. 21).

11) Petsos F.M. – Delf, Athinë 1983, f. 23.

12) Mjediset ndihmëse duhet të jenë ndërtuar në shek. III p.e.r. kur fillon e ndërtohet teatri. Mendojmë kështu, duke marrë për bazë zbukurimin e ngjashëm të këtyre dy objekteve, si dhe shkëputjen e tempullit nga këto mjedise. nga galeria perëndimore e teatrit.



Figura 11

Rikonstruksioni hipotetik i tempullit të fazës së parë (Asklepit).

Forma e përgjithshme e këtij tempulli në fazën fillestare të ndërtimit të tij duket i është nënshtruar raporteve proporcionale të përcaktuara mirë[13]). Megjithatë raportet e njohura 1 : II ose 1 : 618 (prerje e artë)[14]) do të ishin të vështira të zbatoheshin për rikonstruksionin e tempullit të Asklepit. Më të mundshme për qëllimin tonë do të ishin përdorimi i raporteve për orderin dorik[15]) që i gjejmë në shumë tempuj antik dhe si më i krahasueshëm mund të shërbejë tempulli i thesauros të athinasve në Delfi (fig. 11). Si rregull, për llogaritjen e këtij të fundit është marrë për bazë hapësira e lirë midis kolonave e cila është 1 1/2 këmbë antike më e gjerë nga diametri i poshtëm i kolonës. Duke krahasuar tempullin e Asklepit me atë të thesaurosit të Athinës në Delf, ndryshimi midis tyre del më qartë, ç'ka i korrespondon edhe ndërtimit të tyre në kohë të ndryshme. Prandaj rregullat e proporcionalitetit në tempullin e Delfit duhet të merren me rezervë përderisa këto ndryshime reflektohen para së gjithash në lartësinë jo të barabartë të kolonave. Kështu në theasurosin e Athinës, me gjerësi të fasadës ballore 6.30 m, është gjetur i përshtatshëm një hap i kolonave baras me 3D dhe lartësi e tyre 6 1/2. D. Në tempullin e Asklepit me diametrin e kolonës 0.5 m dhe hapësirën ndërmjet kolonave 1 m, përfitohet i njëjti hap prej 3 D, ndonëse ka ndryshuar koncepti i lartësisë së kolonave[16]). Duke kthyer në madhësi absolute vlerat e moduleve[17]), përftohen këto dimensione të fasadës kryesore të tempullit të Asklepit: gjerësi e fasadës ballore 6.04 m, hapi i kolonave 1.6 m (6 m) diametri i kolonave 0.5 m (2 m), lartësia e tyre 3 m (12 M), ndërsa gjatësia e

13) J. Coulton. **vep.cit.** f. 64... Autori duke bërë fjalë për raportet proporcionale të tempujve dorikë të periudhës helenistike, bën fjalë edhe për ndryshime të njërit tempull nga një tjetër i së njëjtës periudhë ose i së njëjtës zonë. Prandaj edhe në përpjekjen tonë për rikonstruksionin hipotetik do të marrim me rezervë raportet proporcionale të njohura.

14) Vitruv, **vep.cit.** 4,1, 11, 6.3.3.

15) Vitruv, **vep.cit.** 4.3.3.-9.

16) Është pasur parasysh dhe Vitruvi (VI, 2.1-5) i cili rekomandon që në zgjedhjen e proporcioneve të kolonave duhet pasur parasysh ana konstruktive dhe paraqitja e tyre estetike.

17) Dimë se moduli i tempullit dorik është i lidhur drejtpërdrejtë me përmasat e hapit të kolonave. Në shek. IV p.e.r. diametri i poshtëm i kolonave është llogaritur përgjithësisht me 2 module. Për Butrintin (M) Moduli = 0.296 m.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 12



Figura 13

arkitraut e barabartë me hapin e kolonave. (fig. 12).

Për gjatësinë e tempullit, do të marrim për bazë faktin që, shpella e burimit, duke qenë jashtë mureve të tempullit si në fazën e parë dhe të dytën, nuk duhet të jetë përfshirë në planimetrinë e këtij të fundit. Në kohën e ndërtimit të teatrit, shpella del se është përdorur si bazament i shkallëve të galerisë perëndimore, nëpërmjet së cilës ngjitej për në diazomë[18]). Për pasojë, jemi të mendimit se për këtë tempull nuk është ruajtur ligjësia e rekomanduar e proporcionalitetit, rrjedhimisht edhe gjatësia e tij është reduktuar në 7.76 m (fig. 5).

Nga autoblementi nuk ruhen gjurmë që të na ofrojnë të dhëna për të përcaktuar lartësinë e tij. Kështu që në rikonstruksionin hipotetik (fig. 12) lartësia rreth 6 m e tempullit është nxjerrë duke u mbështetur në normat e njohura[19]).

18) Gjurmët e lëmimit nga ana e sipërme e gurëve që mbulojnë shpellën e burimit tregojnë se mbi to kalonin spektatorët për t'u ngjitur në teatër, me anë të galerisë perëndimore. Pjesa e ulët e sheshit, është tani me tri shkallë, por fillimisht ishin 6 shkallë duke mos llogaritur dhe dy sheshe, prej të cilave ruhen gjurmë.

19) Për lartësinë e pjesëve të ndryshme të anteblementit janë marrë parasysh normat e rekomanduara, sipas të cilave është përcaktuar lartësia e arkitraut – M, e frizës 1 1/2 M dhe ajo e kornizës 1/2 M, lartësia e antoblementit 3 M, lartësia e frontonit 4 M (1/7 e gjerësisë së tempullit), 1 M lartësia e kapitelit rezulton një lartësi e përgjithshme 21 M = = 5 metra.



Figura 14



Figura 16

TEMPULLI MBI TEATËR

Një zgjidhje tjetër planimetrike dhe arkitektonike, paraqet tempulli mbi teatër. Nga ky tempull, ruhen mjaft mirë gjurmët e stereobatit në pjesën më të madhe të tij, të përbëra nga tri këmbë shkallë dhe një pjesë e muraturës së naosit (fig. 13) dhe një kapitel (fig. 14). Pronaosi është dëmtuar nga shkarja e murit mbajtës të stilobatit, i cili gjatë rrëshqitjes ka marrë me vete edhe krejt rreshtin ku mbështeteshin kolonat e pronaosit (fig. 15).



Figura 15

Për planimetrinë e tempullit, të cilën me të drejtë A. Baçe e krahason me tempullin e Dionës në Dodonë[20]), do të mundohemi të japim një rikonstruksion hipotetik të mundshëm të planimetrisë. Fasada ballore, ndryshe nga tempulli i Asklepit në bazë të elementeve konstruktive dhe arkitektonike që disponojmë, duket se është formuar nga 4 kolona jonike, që zbukurojnë hyrjen, kurse konstruksioni me mur i fasadave anësore, pa kolona, mbyll brenda saj mjedisin e naosit. Nga ana e prapme, tempulli nuk ka kolona. Shkallët e stilobatit, prej guri gëlqeror, të ngjashme me ato të teatrit[21]), japin një terminus, për ndërtimin e këtij tempulli. Bllokët në muraturën e mjedisin të naosit, të vendosura brinjasi (orthostate), janë ngritur mbi sipërfaqen e sheshtë

20) A. Baçe, **vep.cit.** f. 24 dhe e S. Dakaris, **Dodona,** (bot. anglisht) Janinë 1971, f. 51.

21) Radha e parë e stereobatit të tempullit, zbukurohet me disa figura në formë në radhën e parë të shkallëve të teatrit ose në shkallën e mjedisin aneks pranë tempullit të Asklepit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 17

të stilobatit (fig. 16), duke lënë nga faqja e jashtme një kornizë me gjerësi 10 cm. Për shkak të cilësisë jo të mirë të materialit të gurtë, është bërë patinimi me gëlqere e pluhur guri, e cila i jepte muraturës një sipërfaqe të lëmuar dhe të bardhë. Muret ruhen pjesërisht në dy dhe tri radhë. Mbi sipërfaqen e sipërme të blloqeve që formojnë këto mure duken gjurmët e fiksimit, me ganxha metalike (fig. 13) të blloqeve. Muri që ndante pronaosin nga naosi është shkatërruar, megjithatë ruhen gurët e themelit të tij (fig. 17,13). Shkallët e stereobatit ruhen thuajse të plota vetëm në tri faqet anësore të tempullit, ndërsa faqja ballore ka rrëshqitur disa metra më poshtë, pjesërisht e zbuluar kohët e fundit në tatëpjetën e terrenit. Për dyshemenë e mjediseve të pronaosit dhe naosit nuk kemi gjurmë, mbasi në një fazë të dytë ajo është rindërtuar dhe veshur me mozaikë (fig. 13).

Duke përfunduar përshkrimin e gjurmëve të ruajtura nga ky tempull mund të përmendim trakte të murit të terracimit[22]), të cilat mund të ndiqen pas shpinës së teatrit. Ato kthehen me kënd të drejtë me drejtim nga veriu, duke formuar një shesh kuadratik me dimensione 20 x 20 m. Ngjitja për në tarracën e krijuar nga këto mure bëhej nga ana perëndimore, ku ruhen gjurmët e shkallëve të korridorit (fig. 1).

Mbi bazën e këtyre të dhënave mund të arrihet edhe në rikonstruksionin e këtij tempulli. Tempulli mbi teatër i orderit jonik, në formulim planimetrik paraqitet diçka më i madh se tempulli i Asklepit. Përmasat më të mëdha të tij në raport me tempullin e Asklepit duket se janë zgjedhur me qëllim të caktuar. I pari duke qenë i vendosur rrëzë faqes shkëmbore të akropolit me kuotë rreth 15 m më të lartë, do të barazohej në iluzionin optik, me tempullin e Asklepit. Ndërsa orderi jonik me linjat elegante të tij, ka pasur për qëllim të theksojë këtë objekt në sfondin e ashpër të faqes shkëmbore të akropolit.

Rikonstruksioni i tempullit qëndron kryesisht në përcaktimin e përmasave të plani-



Figura 18

22) Është më bindës të lidhim ndërtimin e këtyre mureve me tempullin se sa të quajmë ato mure rrethimi, si përmenden ato deri më sot. (N. Ceka, **Fortifikimi antik i Butrintit,** «Monumentet» Tiranë 1976 f. 31).

DO NOT COPY



Figura 19



Figura 20

metrisë së tij. Elementet e tjera të arkitekturës, si fasada, për mungesë të dhënash, nuk mund të formulojmë qoftë edhe në menyrë hipotetike, ashtu sikurse vepruam me tempullin e Asklepit, të orderit dorik[23]). Megjithatë duke u mbështetur në rregullat e vendosura për orderin jonik, kemi marrë parasysh rregullshmërinë e hapësirave te kolonave, e ndhur kjo me aksin e mureve anesore të mjediseve. Mbi këtë bazë ndërtuam grafikisht rrjetën uniforme kuadratike që rekomandohet për përcaktimin e pozicionit të kolonave dhe mureve. Kuptohet që kolona e parë në të dy ekstremet e tempullit është vendosur në një aks me muret anësore[24]).

Ndjekja e gjurmëve të mureve, ndihmon për të arritur në zgjidhjen hipotetike të planimetrisë së tempullit (fig. 18). Duke përfshirë dhe tri shkallët e stereobatit përmasat e tempullit arrijnë 7.80 x 11.70 m. Llogaritja grafikisht e hapësirave aksiale të kolonave përcakton jo vetëm hapin e kolonave prej 2.0 m, por edhe gjerësinë rreth 2.5 m të pronaosit.

Faza e dytë e tempullit ka të bëjë me rindërtimet e tij, të cilat qëndrojnë në rregullime të vogla, si shtrimi me mozaikë i dyshemesë, ç'ka tregon për përdorimin e tij edhe në shekujt e parë të erës sonë[25]).

23) Kjo spjegohet me atë që rregullat në sistemin jonik, nuk lidhin çdo element me një modul të vetëm e të përbashkët siç e pamë në orderin dorik, por formojnë një lloj zinxhiri (Vitruv, III, 3, 5) në mënyrë që çdo element të varet suksesivisht nga i mëparshmi e zakonisht nga ai para tij.

24) J. Coulton, **vep.cit.** f. 71.

25) A. Baçe, **vep.cit,** f. 26.

DOKUMENT KOPJE

PUNIMET E RESTAURIMIT

Studimi i elementeve arkitektonike e konstruktive në dy monumentet e trajtuara më lart, është i lidhur me detyrat e dala për përgatitjen e udhëheqjen e projektit të restaurimit,

Strukturat e vjetra, të dy monumenteve të qendrës shoqërore të Butrintit, që ne trajtuam më lart janë në një masë të madhe të paqëndrueshme, mbasi materialet e përdorura në ndërtimin e tyre tashmë janë dobësuar nga ekspozimi i gjatë në natyrë. Shembujt e strukturave të qëndrueshme tra-kolonë, të tempujve në fazën fillestare të ndërtimit të tyre, sot paraqiten fragmentare. Kjo edhe për shkak të transformimeve të tyre në një periudhë të dytë. Strukturat e tjera si: trakte të murit të naosit në tempullin mbi teatër, rrënojat e stereobatit ose shtrimi me pllaka janë gjurmët antike më të ruajtura të këtyre tempujve (fig. 5.19).

Ndryshe paraqitet gjendja në strukturat me llaç të faltores së Eskulapit ose në mjediset aneks të saj. Në këto struktura, që sot ruhen në nivele të ndryshme, kontrollet e sforcimeve strukturore, në pjesët e dukshme kuptohen me lehtësi. Muri me kontraforte i faqes perëndimore të faltores së Eskulapit, krijon një mbështetje më të qëndrueshme të qemerit të madh që mbulonte mjediset e faltores. Konstruksioni i qemerit, i cili i mbështetet murit të analemës së teatrit nga perëndimi si dhe përdorimi i elementeve të reja strukturore, me të cilat u projektua faltorja e Eskulapit shkaktoi ngarkimin e konstruksioneve të vjetra. Kjo ka sjellë si pasojë uljet e këtyre të fundit, që shfaqen në masën e trashë të murit lindor të mjedisit aneks, me anë të çarjeve tërthore ose prishjen e mbështetjes së harkut të qemerit të faltores pas lëvizjes së blloqeve të shkallares së teatrit. Në këto raste rrënojat arkeologjike na ndihmuan të gjejmë shkakun e shkatërrimit të tyre, duke vërejtur çarjet në strukturë. Gjurmë të degradimit të vazhdueshëm duken edhe në qemerin që mbulon hapësirën e gjatë të faltores së Eskulapit, në formën e të çarave, në gjerësinë e masës së qemerit. Në rastin tonë, kur mbi harkun e qemerit është një masë e trashë mbushje e nevojshme për mbështetjen e shkallëve të teatrit të fazës së dytë, procesi i riparimit të harkut të qemerit është i mundur vetëm pas largimit të masës mbushëse, që është jashtë kritereve të restaurimit. Për të ruajtur fragmentet origjinale të harkut duhej ndërhyrë me mjaft kujdes për të siguruar mbështetjen mbi murin ndarës të mjediseve të faltores dhe mbi disa brinjë rigjidimi, (fig. 20) të cilat u menduan të bëheshin prej betoni. Materialet e tjera p.sh. hekuri për mbështetjen e pjesëve të shkëputura të qemerit, menduam të mos i përdorim për dy arsye. Së pari oksidimi i elementeve mbështetëse metalike do të bënte ndotjen e muraturës dhe së dyti përdorimi i elementeve metalike të paoksidueshme nuk ishte ekonomik.

Ndërhyrjen konservuese në pjesët e ndryshme të muraturave të degraduara të faltores dhe mjedisit aneks pranë saj janë bërë të diferencuara, duke analizuar strukturat e sotme. Riparimet e para u kryen në sipërfaqet e dëmtuara të muraturës. Punimet që u përqëndruan në përforcimin pjesë-pjesë të tyre sipas projekteve të hartuara për këtë qëllim u bënë me kujdesin më të madh. Fillimisht nisi me pastrimin e sipërfaqeve të sipërme të mureve nga dherat dhe bimësia që dëmtonte vetë bërthamën e tyre. U bënë dhe ndërhyrje të tjera të pjesshme si restaurimi plotësues i boshllëqeve në fasadë, pa krijuar shqetësim në konfiguracionin e përgjithshëm të saj (fig. 9).

Ndryshe qëndronte puna në përgatitjen e ndërhyrjes restauruese në tempullin mbi teatër. Përgatitja e projektit të restaurimit për këtë sektor u përqëndrua në ringritjen e blloqeve të bazamentit të shkallëve të stereobatit. Ky proces anastiloze ndihmoi në krijimin e një imazhi më të plotë të konturеve të planimetrisë së tempullit.

Me këtë ndërhyrje konservuese e restauruese u krijua një gjendje më e stabilizuar dhe e qëndrueshme e strukturave të dëmtuara. Punimet e restaurimit dhe gjurmimi arkitektonik i tyre krijuan një kuadër relativisht më të plotë për arkitekturën e këtyre dy monumenteve, që shquhen për format e tyre elegante.

GURI PANI

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE DES DEUX TEMPLES A BUTRINT ET LEUR RESTAURATION

RESUME

Les fouilles archéologiques effectuées à Butrint, offrent beaucoup de données importantes à une étude plus complète de ses temples. Cet article a pour but de mettre en évidence les éléments architectoniques et d'étudier les endommagements qu'a subis leur structure, afin de mieux prévoir les procnaines interventions de restauration. Il s'agit de deux temples, d'un temple dédié à Asclepios et d'un autre dedié peut-être à Aphrodite. Le premier qui plus tard devint le noyau du centre social de la ville, se situe au pied du flanc méridional de l'Acropole alors que l'autre s'élève tout près, environ 15 m plus haut.

L'architecture des temples. *Sur l'architecture des temples, Ugolini décrit en grosses lignes quelques éléments typologiques et stylistiques. De la comparaison établie entre ces temples et les autres temples de l'Illyrie et de l'Epir, A. Baçe avance quelques données complémentaires vues sous un autre angle.*

Le temple d'Asclepios conserve beaucoup de ses éléments constructifs et architectoniques qui aident à définir deux phases. Pendant la première phase (IVe sc.av.n.è) la planimétrie du temple se présente simple du type prostyle à antes. Sur la ligne conservée du stylobate on remarque les traces de l'appui des colonnes de la façade frontale. De la façade on conserve aussi plusieurs fragments d'antéfixes reutilisés dans la maçonnerie du temple de la deuxième phase, ainsi qu'un chapiteau dorique (fig. 4). L'appareil en blocs de pierres calcaires blanches de la première phase du temple, a servi de substruction à la deuxième phase. Seulement une des faces du temple d'Asclepios est visible, celle qui se trouve en face de l'entrée qui donne accès au centre social. La largeur 0,72 m du mur du temple est définie par un fragment conservé à l'extremité nord du mur oriental, à côté de l'adjonction de la deuxième phase (fig. 5). On constate la même largeur pour le mur occidental du temple qui est déjà perdu sous le mur à contreforts du temple de la deuxième phase. Ces murs renferment côté est et côté ouest les deux pièces du temple, le pronaos et le naos qui sont pavés de dalles de pierres quadrangulaires, dont celles du naos sont plus grandes (0,36 m x 0,9 m x 0,95 m). Les dimensions du naos sont 6,04 m x 4,25 m et celles du pronaos 6,04 m x 1,8 m. La largeur du temple résulte 6,04 m et sa longueur 7,7 m.

Dans la façade frontale, les traces des antes et des deux colonnes au-dessus du stylobate, permettent à définir les entrecolonnements. Les colonnes ont laissé une trace ronde d'un diamètre de 0,6 m. L'espace lisse qui constitue l'entrecolonnement, d'une longueur de 1 m, est égale à celle entre les colonnes et les pilastres latérales.

La deuxième phase du temple, représentée par le temple d'Esculape, conserve presque la même planimétrie et l'orientation de la première phase (fig. 5). Les murs sont en petits blocs quadrangulaires, liés avec du mortier de chaux assez compact. L'appareil et le matériel utilisé représentent une caractéristique du IIe sc.

L'arc de la voûte qui couvre les pièces du temple est construit avec des briques disposées à pied (fig. 8). Tout au-dessus se trouve le remblai (des pierres et du mortier de chaux) qui sert d'appui aux gradins du théâtre et au corridor qui reliait la cavea avec la scène.

Le temple reconstruit d'Esculape présente une planimétrie, rectangulaire (6,05-8,60 m) surmontée de voûte cylindrique. La voûte se trouve à une hauteur de 4,40 m du plancher. La façade de l'entrée du temple, qui fut déplacée pour être au même plan que le mur du théâtre, est percée d'une porte flanquée de deux tenêtres arquées (fig. 9).

La pièce annexe près du temple. *A l'ouest du temple au niveau de la place pavée de dalles de pierres, on remarque une marche d'une largeur de 7,20 m et d'une hauteur de 0,30 m. Elle est faite en pierre calcaire de bonne qualité, où l'on a gravé une corniche bien distincte et deux pattes de griffons pareils à ceux de la première rangée des gradins du théâtre. Au-dessus de cette marche, pendant la deuxième phase afin d'atteindre le niveau de la pièce, fut ajouté une deuxième marche d'une hauteur de 26 cm. Au nord du couloir, se situent deux pièces juxtaposées avec les mêmes dimensions: 3,07 m x x 4,13 m.*

On n'a pas pu définir la fonction de ce monument, mais on pense qu'il a dû servir d'annexe au début au temple d'Ascle-

pios et plus tard à celui d'Esculape. La comparaison avec un cas analogue découvert à Delphes renforce cette supposition.

Reconstruction hypothétique du temple de la première phase (Asclépios)

«Il parait que la forme générale du temple d'Asclepios, pendant la première phase de sa construction, fut soumise à des rapports proportionnels bien définis. L'emploi des rapports de l'ordre dorique conviendrait mieux à notre but. Au thésauros d'Athène à Delphes (fig. 11) l'entrecolonnement est de 1 1/2 pieds attique plus large que le diamètre inférieur de la colonne. Une comparaison entre le temple d'Asclepios et celui du thésauros d'Athène à Delphes met mieux en évidence leur différence. Ainsi, au thésauros d'Athine à Delphes, à la façade frontale d'une largeur de 6,30 m les colonnes sont hautes de 6 1/2 D et la distance entre les axes des colonnes est égale à 3 D (3 diamètres). Au temple d'Ascelpios où le diamètre des colonnes est de 0,5 m et l'entrecolonnemnet 1 m, la distance entre les exes des colonnes apparait de nouveau égale à 3 D. en convertissant en valeur absolue les valeurs des modules on obtient ces dimensions de la façade principale du temple d'Asclepios: une largeur de la façade frontale de 6,04 m un entrecolonnement de 1,6 m, un diamètre des colonnes de 0,5 m, une hauteur de 3 m, une longueur de l'architrave égale à l'entrecolonnement.

La longueur du temple réduite à 7,76 m nous fait penser qu'on n'a pas tenu compte de la loi recommandée de la proportionnalité.

Les traces conservées de l'entablement, ne permettent pas une définition de sa hauteur.

Le temple situé plus haut que le théâtre

De ce temple, on conserve en bon état les traces du stéréobate composé de trois marches d'escalier, ainsi qu'une partie des murs du naos (fig. 13). Le pronaos fut endommagé par l'affaissement du mur de soutènement du stylobate qui emporta dessous toute la rangée où s'appuyaient les colonnes du pronaos. (fig. 15). La planimétrie du temple ressemble à celle du temple de Dioné à Dodone. D'après les éléments constructifs et architectoniques conservés, la façade frontale, différemment de celle du temple d'Asclepios, est formée de 4 colonnes ioniques, alors que la construction en mur des façades latérales, sans colonnes, renferme la pièce du naos. Dans la partie postérieure du temple il n'y a pas de colonnes. Les gradins du stylobate, en pierre calcaire, pareils à ceux du théâtre, donnent un terminus à la construction de ce temple. Les blocs des murs du naos, disposés de biais s'élèvent sur la surface plate du stylobate. Dans les trois faces latérales du temple les gradins du stéréobate sont conservés presque entièrement. Dernièrement, sur la pente du terrain on a découvert des fragments de la façade frontale qui a subi un glissement de quelques mètres. Nous ne disposons d'aucune trace sur le plancher du pronaos et du naos, puisque au cours de la deuxième phase il fut reconstruit et pavé de mosaïque (fig. 13).

Sur la base de ces données on peut obtenir la reconstruction du temple qui consiste surtout à définir les dimensions de sa planimétrie. D'après les calculs, les dimensions du temple sont 7,80 m x 11,70 m, (y compris les gradins du stéréobate). Le calcul graphique des espaces entre les axes des colonnes définit un entrecolonnement de 20 m et une largeur du naos de 2,5 m. Pendant la deuxième phase le temple connut quelques petits aménagement tel le pavement du plancher en mosaïques, ce qui prouve sa fréquentation même pendant les premiers siècles de notre ère.

Travaux de restauration

Les anciennes structures des deux temples déjà mentionnées, dans leur plus grande partie se présentent assez endommagées puisque leurs matériaux de construction se trouvent, depuis longtemps déjà, exposés aux agents atmosphériques: Les exemples des structures soudes poutre-colonne des temples de la phase initiale de leur construction, aujourd'hui se présentent fragmentés à cause de leurs transformations pendant une deuxième période. Les autres structures telles les fragments du mur du naos au temple au-dessus du théâtre, les ruines du stéréobate ou le pavement en dalles, sont les traces les plus antiques conservées de ce temple (fig. 5,19).

Il se présente autrement l'état des structures liées au mortier du temple d'Esculape ou de sa pièce annexe. Le mur à contreforts de la face occidentale du temple, crée un appui plus solide à la grande voûte qui surmontait les pièces du temple. La construction de la voûte qui s'appuie au mur occidental du théâtre ainsi que l'introduction des nouveaux éléments structuraux à la conception du temple d'Esculape devinrent une charge pour les anciennes constructions. Cela apporta l'affaissement de celles-ci qui dans l'épais mur de l'annexe se reflèta par des fissures ou par l'endommagement du pied-droit de la voûte à cause du déplacement des blocs des gradins du théâtre. Les traces d'une dégradation continue se présentent en forme de fissures dans la largeur de la voûte qui couvre l'espace le long du temple d'Esculape. Pour conserver les fragments de l'arc original, il fal-

DO NOT COPY

lait intervenir attentivement afin d'assurer l'appui sur la cloison de pièces du monastère et d'aménager quelques tirants de rigidité (fig. 20). On pensa les réaliser en béton puisque l'oxydation des éléments d'appui métalliques tacherait le mur et l'usage des éléments métallique inoxydables ne serait pas économique.

Les interventions de conservation effectuées aux différentes parties de la maçonnerie dégradée du temple et de son annexe, furent différenciés. Les réparations immédiates sur les surfaces délabrées de la maçonnerie se concentrèrent essentiellement à leur consolidation en partie, selon les projets élaborés dans ce but. On commença par le déblaiement de la partie supérieure du mur et son renforcement en mortier de chaux. Puis, on procéda à d'autres interventions partielles telle le remblayage des lacunes de la façade sans altérer sa configuration générale (fig. 9).

L'élaboration du projet de restauration du temple situé plus haut que le théâtre, consista à l'installation des blocs du soubassement des grandins du stéréobate. Ce processus d'anastylose aida à créer une image plus complète des contours de la planimétrie du temple.

Par ces interventions de restauration et de conservation, les structures endommagées devinrent plus solides. Les travaux de restauration et les recherches sur leur architecture, créèrent un cadre plus complet sur l'architecture de ces deux monuments, qui se distinguent des grands temples contemporains par leurs formes élégantes et leur souplesse.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 1 1988

DO NOT COPY

monumentet

Guntram KOCH

SARKOFAGËT E PERIUDHËS PERANDORAKE NË SHQIPËRI

Në Shqipëri njihen një sërë skulpturash të periudhës perandorake romake, nga shek. I deri në shek. e II të e.s. Veçanërisht të shumta janë skulpturat që i përkasin periudhave në paqe të perandorisë, shek. II dhe shek. III. Ato na japin të dhëna të shumanshme për jetën, përfytyrimet fetare, tregtinë dhe ekonominë e kohës. Këto skulptura janë kopje të shtatoreve greke, të gjetura në radhë të parë në Apolloni dhe Butrint; portrete: kryesisht nga Durrësi, Apollonia dhe Butrinti: relieve dhe altarë funerarë, të përhapur në tërë vendin me një shumëllojshmëri formash; si dhe shtatore dekorative, relieve votivë, urna hiri dhe së fundi sarkofagë.

Sarkofagët, të cilët në shek. II-III janë veçanërisht të shumtë në tërë perandorinë romake, mund të shihen si krijime tipike perandorake. Në të kundërt në Shqipëri ata janë gjetur në një numër relativisht të vogël. Por, brenda kuadrit të përgjithshëm, këta sarkofagë kanë rëndësi si dëshmitarë të artit dhe kulturës antike.

Sipas kritereve sarkofagët mund të veçohen në grupe të ndryshme:

1) Në perandorinë romake ka pasur 3 qendra prodhimi të sarkofagëve, në Romë, Athinë, dhe Dokimeion (në Frygi, në Azinë e Vogël), prodhimet e të cilave nuk u kufizuan në një periferi të ngushtë, por u eksportuan larg.[1])

2) Krahas tyre në mjaft vende u prodhuan sarkofagë prej guri lokal, të cilët shërbenin vetëm për përdorimin në vend, duke u kufizuar kështu në një rajon të caktuar. Ato i përmbahen pjesërisht traditës vendase, ndërsa në mjaft raste kopjojnë ekzemplarët e qendrave kryesore.[2])

3) Së fundi në Azinë e Vogël ka kavo, në të cilat përgatiteshin për eksport prodhimet e mermerta gjysmë të gatshme, që përpunoheshin më tej në punishtet lokale. Këto prodhime gjysmë të gatshme qenë të destinuara për vendet që nuk kishin mermer.[3])

Në këtë kuadër situata në provincat romake paraqitet poliedrike. Në të ka a) Sarkofagë lokalë që i përmbahen traditës b) Prodhime gjysmë të gatshme të imponuara nga Azia e Vogël, të përpunuara në vend ose të përdorura në gjendje të papërfunduar c) Sarkofagë lokalë, të cilët kopjojnë ekzemplarët e importuar nga njëra prej qendrave d) Origjinalë të importuar nga qendra të tjera lokale, ndoshta dhe të kopjuar në vend.

Në territorin e Shqipërisë nuk hasen të tëra rastet e mësipërme, por sidoqoftë mjaft prej tyre. Rrjedhimisht kemi të bëjmë me një situatë interesante. Në Shqipëri janë gjetur fragmente sarkofagësh lokalë (Nr. 1-3). Njëri nga ekzemplarët është përpunuar më tej nga një prodhim gjysmë i gatshëm me girlanda, nga ishulli i Prokonezit (Nr. 4). Në një fragment tjetër, gjasisht me mermer prokonezi, nuk kuptohet qartë në se tabula e madhe është gdhendur fillimisht në Prokonez apo në Shqipëri (Nr. 5). Një fragment kapaku me një dekor të pazakonshëm duket se është importuar i përpunuar (Nr. 6). Një pjesë e ekzemplarëve është nga Roma (Nr. 7-9), njëri nga

1) Për Romën G. Koch – H. Sichtermann, **Römische Sarkophage,** München,, 1982, Për Athinën, **Po aty,** f. 366 v. Për Dokimeionin, **Po aty,** f. 497 v.

2) **Po aty:** f. 276. (Provincat e Perëndimit); f. 314. v. (Provincat e Ballkanit); f. 476 v. (Azija e Vogël); f. 558 v (provincat e tjera në lindje).

3) Po aty, f. 484 v.

DO NOT COPY



Legjenda

- Sarkofagë vendas
  Einheimische sarkophage
- Sarkofagë prokonezi
  Prokonesische sarkophage
- Sarkofagë romakë
  Stadtrömische sarkophage
- Sarkofagë atikë
  Attische sarkophage
- Sarkofagë nga Asosi
  Sarkophage aus Assos

– Shenjat e bardha tregojnë vendgjetje të pasigurta



Fig. 1. Fragmente të një sarkofagu nga Durrësi, sot në Beograd (Nr. 1).
Fig. 1. Fragmente eines Sarkophages au Durres, Belgrad (Nr. 1).

Assosi në Azinë e Vogël (Nr. 30) dhe së fundi një shumicë (Nr. 10-29) është importuar nga Athina. Në parashtrimin e mëposhtëm sarkofagët i kemi renditur sipas grupeve dhe vendgjetjes, duke i përmbledhur në fund dhe në një tabelë.[4])

I. Sarkofagët vendës

1. Dyrrah (Durrësi), sot në muzeun nacional të Beogradit (fig. 1).

2. Lartësia 0,57 m, Gjatësia 0,65 m.

Gur gëlqeror.

Prej sarkofagut ruhen tri fragmente të puqshëm të faqes së përparme, në mesin e së cilës gjendej tabula ansata me një mbishkrim në gjuhën greke. Në fushën e djathtë ruhet kiçi i një anije dhe një lopatë e vendosur pjerrtas. Vizatimi jep edhe velën e madhe të fryrë nga era. Në këtë paraqitje njohim anijen e mallrave, navis oneraria.[5]) Në kiç ajo duket se ka pasur një ndërtim të ulët, të cilin e hasim edhe në shembujt e tjerë (fig. 3).

Fillimisht, pjesa e përparme e sarkofagut ndahej në tri pjesë: një tabula në mes dhe dy fusha me relieve anash. Një gjymtyrizim të tillë nuk e hasim në Shqipëri, por ai është mjaft i shpeshtë në Ballkan: në provincat e Dalmacisë, Panonisë, Mëzisë së Sipërme dhe Mëzisë së Poshtme,[6]), por në to tabula zakonisht është më e gjatë. Modeli për këtë skemë duhet të jetë marrë nga Italia e Veriut.[7]) Në provincën e Maqedonisë, së cilës i përkiste dhe Durrësi, më të zakonshme janë skemat e tjera.[8]) Modeli i mësipërm, i marrë nga veriu ose verilindja, është unik.

Paraqitja e anijeve në sarkofagët është mjaft e rrallë.[9]) Me sa duket në këtë rast kemi të bëjmë me një dekor të gdhendur nga skulptori sipas një porosie të veçantë. Ekzemplari i Durrësit na jep të dhëna të



Fig. 2. Fragment i sarkofagut Nr. 1.
Fig. 2. Ein Fragment des Sarkophages der Abb. 1.

4) Nuk kemi marrë në konsideratë fragmentin e murosur në kishën e Shën Gjon Vladimirit (rr. Elbasanit), pasi nga figura nuk kuptohet mirë nëse ai ka qenë ose jo pjesë e ndonjë sarkofagu. (C. Praschniker – A. Schober, **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien, 1919, f. 57. Nr. 1) Për një fragment të gjetur në Peshkëpi (Dh. Budina, Iliria, 3, 1975, 381 Nr. 33, fig. 18) s'ka ndonjë të dhënë të re më të plotë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3. Sarkofag me anije, prodhuar në Romë, Kopenhagen.
Fig. 3. Stadtrömischer Sarkophag mit Frachtschiffen, Kopenhagen



Fig. 4. Sarkofag me tabul, Durrës (Nr. 2).
Fig. 4 Sarkophag mit Tabula, Durres (Nr. 2)

rëndësishme në këtë drejtim. Për krahasim me të mund të sjellim një sarkofag nga Kopenhageni, të prodhuar në qytetin e Romës, ku në faqen e përparme, ndërmjet një kulle në të majtë dhe një fari në të djathtë, janë paraqitur tri anije mallrash (fig. 3)[10]. Mungesa e mbishkrimit nuk na ndihmon me porosidhënësin. Një paralele tjetër gjejmë në një sarkofag lokal nga Sidona, sot në Bejrut, në të cilin në njërën nga faqet anësore paraqitet një anije mallrash me vela, e punuar në mënyrë të përsosur[11]. Ndërmjet sarkofagëve të shumtë të gjetur në Sidone ai është i veçantë. Por edhe këtu nuk mund të përcaktohet dot shkaku i zgjedhjes së anijes si simbolikë, vetëm se mund të supozojmë se porositësi ka qenë pronar anijesh, tregtar ose kapiten. Së fundi mund të përmendim faqen anësore të një sarkofagu lokal nga Selaniku[12], ku në një formë tepër të thjeshtëzuar paraqitet një anije. Dy burra në anije mbajnë një shportë të madhe, ndërsa një i tretë i përshëndet nga bregu, por dhe në të nuk ka asnjë sqarim për skenën. Edhe në këtë rast duhet supozuar se kemi të bëjmë me një sarkofag të porositur prej dikujt që ka të bëjë me udhëtimet në det.

5) Për navis oneraria-n: A. Göttlicher Antike Welt 8, 1977, Heft 3, f. 47 v, J. Morrison, **The Ship, Long Ships and Round Ships,** 1980. f. 55 v A. Göttlicher, **Die Schiffe der Antike,** 1985, f. 105 v.

6) G. Koch – H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 314, v. Tab. 347, 352, 254, 360.

7) **Po aty,** f. 322, 332.

8) **Po aty,** f. 346, Tab. 373 v.

9) **Po aty,** f. 124, **Vep. cit,** tab. 132-135, Krahaso dhe fragmentet nga Odesso s-i (G. Koch-H. Sichtermann, **vep. cit,** f. 338 dhe shën 21. Nga mbishkrimi ruhen vetëm gjurmë fare të vogla.

DO NOT COPY

Mbishkrimi në ekzemplarin e Durrësit vijon:[13])

1 Φ]λάβεις Λον-
γ]εῖνος ζῶν
κα]τεσκεύασα ἐ-
μοι]τήν ληνὸν κε ἑ-
τερα]ν τῇ συνβείῳ μου
. . . .]νε ἥτις ἔζησεν κα-
λῶς μ]ετ ἐμοῦ ἔτη XXVIII
μῆνα]ς τέσερας ἡμέρας V
ἐνὰ δὲ] πολλὰ περειπλεύ-
σας κὲ] πολλὲς ἐξουσείες
υπ]ηρετήσας κεῖ-
μ]ε ἐνθάδε ζή-
σας έ]τη τεσσερα(ν)



Fig. 5. Sarkofag me tabul, Durrës (Nr. 2).
Fig. 5. Sarkophag mit Tabula, Durres (Nr. 2).

(Unë) Flavius Longinos së gjalli ndërtova arkivolin tim dhe të sime shoqeje që jetoi me mua 28 vjet, 4 muaj, 5 ditë. Pasi lundrova shumë rreth e qark dhe pata shumë poste të larta, shtrihem këtu, pasi jetova vjet 4 . . . (të paktën 40, gjasisht 48 ose 49).

Flavius Longinos-i, megjithë emrin romak, parapëlqeu mbishkrimin në gjuhën greke. Sipas gjasës, pronar i një ose disa anijeve, ai i pati fituar paratë e tij me tregti, dhe, ndoshta i pasuruar në moshë të pjekur, zuri poste të ndryshme në qytetin e tij të lindjes, në Dyrrah. Në sarkofagët romakë zanati ose situatat e jetës së të vdekurit përmenden mjaft rrallë. Krjedhimisht ekzemplari nga Durrësi ka një vlerë të veçantë.[14])

Të dhëna të sakta për datimin nuk ka, tipologjikisht ekzemplari në fjalë duhet t'i përkasë shek. II, me gjasë më të madhe gjysmës së dytë.



Fig. 6. Sarkofag me girlanda prej mermeri Prokonezi, Durrës (Nr. 4)
Fig. 6 Girlandensarkophag aus prokonesischen Marmor, Durrës (Nr. 4)

10) Kopenhagen, Ny Carlsberg Clyptotek 787 G. Koch-Fl. Sichtermann, **vep.cit,** f. 125, Tab. 133. A. Göttlicher, **Schiffe...**, f .115, fig. 74. O. Hockmann, **Antike Seefahrt,** 1985, f. 71, fig. 59.

11) Beirut muzeu Kombëtar, G. Koch-H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 565, A. Götlicher, **Schiffe...**, fig. 63.

12) Selanik Muzeu arkeologjik, 1833; G. Koch-H. Sichtermann, f. 352, 355, Tab. 380/81, datuar në v. 145.

13) C. Praschniker-A. Schober, **vep.cit,** f. 45, Sipas figurës leximi nuk kontrollohet dot pasi origjinali ka humbur.

14) Krahaso grupin e vogël të sarkofagëve nga Roma me paraqitjen e zanateve. G. Koch – H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 121.

DO NOT COPY







Fig. 7, 8, 9. Sarkofag me girlanda prej mermeri, prokonezi, Durrës (Nr. 4)
Fig. 7, 8, 9. Girlandensarkophag aus prokonesischen Marmor, Durrës (Nr. 4).

DO NOT COPY

Literatura C. Praschniker – A. Schober, **Archäologische Forschungen ih Albanien und Montenegro,** Wien, 1919, f. 45, fig. 57, 57a, G. Koch – H. Sichtermann-, f. 316.

2. Dyrrah, muzeu arkeologjik (fig. 4,5).
Lartësia 0,71 m. Gjatësia 2,05 m. Gjerësia 0.92 m.
Gur gëlqeror.

Nga sarkofagu ruhet arka e sheshuar me daltë të dhëmbëzuar. Në pjesën e poshtme shihen gropëzat e një daltimi më të ashpër, ndërsa anash vendet e kllapave për mbajtjen e kapakut. I vetmi dekor i tij është një tabul e vogël drejtkëndëshe me skaje të profiluar në pjesën e përparme. (lartësia 0,245 m, gjatësia 0,415 m). Në rastin e dhënë duket se kemi të bëjmë me një ekzemplar lokal, me zbukurim tepër të thjeshtë, të gjysmës së dytë të shek. II.

Mbishkrimi vijon:
VALERIAE VVLCACI
AE. Q.V.A. XXIX VALERIVS
VVLCACIVS, PATER, ET
SENTIVS VESTAL. MARIT
COMMVNITER. POSVER

Valeriae vulcaci/ae q(uae) v(ixit) a(nnos) 29, Valerius/Vulcacius pater et/Sentius Vestal(is) marit(us)/Communiter posuer(unt)
Valeria Vulkacias, që jetoj 29 vjeç ia vendosën sëbashku (këtë sarkofag) Valerius Vulkaciusi, i ati, dhe Sentius Vestaliusi, i shoqi.

3. Aulon (Vlorë) Muzeum, zbuluar në vitin 1981 në Vlorë.
Lartësia 0,70 m. Gjatësia 2.55 m.
Gjerësia 1,27 m.
Gur gëlqeror.

Fragmenti i përket kapakut-çati të një sarkofagu me akrotere në skajet. Kapaku është zgavruar në anën e brendshme. Poshtë, në skajin e jashtëm, gjendet një dhëmb, i cili futej në gropëzën e skajit të sipërm të arkës. Fragmenti, gjasisht i gjysmës së dytë të shek. II, është i papublikuar. Informacioni i përket V. Beretit.

II. Sarkofagë të importuar nga Prokonezi, të përpunuar (ose pjesërisht të përpunuar) në vend.

4. Dyrrah, Muzeu arkeologjik, Nr. inv. arkës 234, i kapakut 235. (fig. 6-9).
Arka: Lartësia 0,75 m. Gjatësia 2,055 m. Gjerësia 0,80 m.
Kapaku: Lartësia 0,44 m. Gjatësia 2,09 m. Gjerësia 0,60 m.
Mermer prokonezi

Pjesa në mes të anës së përparme, e cila në foto ndryshon në ngjyrë, është e plotësuar. Kapaku lidhej me faqet anësore të arkës me nga një kllapë.

Sarkofagu është importuar nga Prokonezi, duke shenjuar në të katër anët harqet e girlandave dhe mbajtësit e tyre. Si i tillë ai është një nga sarkofagët gjysmë të gatshëm që u prodhuan me shumicë në kavot e Prokonezit për t'u eksportuar në skajet e ndryshme të perandorisë romake.[15]) Kjo gjendje gjysmë e punuar ruhet ende në anën e pasme (fig. 9) dhe në anën e majtë. Në të kundërt, ana e përparme (fig. 6) dhe ana e djathtë (fig. 8) janë përpunuar më tej në Durrës. Girlandat janë rrumbullakosur dhe lëmuar, janë evidentuar kokët e gozhdëve nga të cilat vareshin ato, nga masa e mermerit janë formuluar breza, nga konturet në formë zemre që vareshin nga



Fig. 10. Sarkofag me girlanda prej mermeri Prokonezi, Damask.
Fig. 10 Girlandensarkophag aus prokonnesischem Marmor, Damaskus

girlandat janë gdhendur vile rrushi. Janë përpunuar profilet e skajit të sipërm dhe të poshtëm, ndërsa në pjesët e përparme, të dy konturet e rrumbullakëta, në mes të harqeve të girlandave anësore janë kthyer në disqe të sheshta flijimi. Nga konturi drejtkëndësh, në pjesën e mesit, është përpunuar një tabul me konture të dala, brenda së cilës gjendej dhe një disk tjetër (prej tij ruhet një pjesë e vogël nga skaji i poshtëm). Gjendjen origjinare të pjesës së përparme të sarkofagut e kuptojmë nga një ekzemplar nga Damasku (fig. 10). Në anën e djathtë të sarkofagut të Durrësit (fig. 8), disku brenda harkut të girlandave është shndërruar në një lule, me një kurorë fletësh rretheqark. Së fundi, në Durrës është rrafshuar edhe kapaku.

Paralele të sakta për përpunimin e mësipërm nuk gjejmë në ndonjë provincë tjetër. Meqenëse në Durrës gjetjet janë të mangëta, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse kishte ndonjë punishte për importimin dhe përpunimin e prodhimeve gjysmë të gatshme të Prokonezit, ose në se ky ekzemplar ishte unik.

Proporcionet e ulëta të sarkofagut tregojnë se ai i përket shek. II, më saktë mesit të këtij shekulli.

Literatura: **Shqipëria arkeologjike** (1971) tab. 108; P. Pensabene, **Dialoghi di archeologia,** N. s, 3. 1981, 87, fig. 3, 92, 346, G. Koch – H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 346.

5. Dyrrah. Muzeu arkeologjik Nr. inv. 819 (fig. 11)

Lartësia 0,585 m. Gjatësia 1,04 m.

Mermer, gjasisht nga Prokonezi.

Ana e pasme e sarkofagut është e sheshuar, me sa duket gjatë ripërdorimit të tij. Për këtë arsye nuk përcaktohet dot me saktësi në se faqja e majtë mbaronte ose jo në këtë vend. Rrjedhimisht nuk jemi të sigurtë në se kemi të bëjmë me pjesën e përparshme të një sarkofagu, me një pllakë varri ose me një pjesë të ndonjë ndërtimi tjetër sepulkral.

Në pjesën e gjatë të fragmentit gjendet një «tabula ansata» me mbishkrim, me skaje të profiluara, ndërsa në fushën e ansa-a një lule. Sipërfaqja jashtë tabulës është gdhendur me daltë me majë.

Sarkofagë me zbukurime të tilla hasen, ndonëse jo shpesh, në Dalmaci, Mëzinë e Poshtme dhe në Bithini. Ka gjasë që ata të jenë sjellë në gjendje



Fig. 11. Fragment sarkofagu (?) Durrës (Nr. 5).
Fig. 11 Fragment eines Sarkophages (?), Durres (Nr. 5)





Fig. 12-13. Fragment kapaku – çati, Peqin (Nr. 6).
Fig. 12 – 13 Fragment eines Dachdeckels, Peqin (Nr. 6)

15) Për prodhimin dhe shpërndarjen e prodhimeve gjysmë të përgatitur, **Po aty,** f. 484 v,

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14-16. Sarkofagu i Meleagerit, Durrës, sot në Stamboll (Nr. 7).
Fig. 14 — 16 Meleagersarkophag aus Durres, Istanbul (Nr. 7)





DO NOT COPY



Fig. 17. Fragment sarkofagu dionisiak të prodhuar në Romë, Durres (Nr. 8)
Fig 17 Fragment eines stadtrömischen dionysischen Sarkophages, Durrës (Nr. 8).



Fig. 18. Vizatimi i fragmentit nga Prashnikeri.
Fig. 18 Zeichnung des Fragmentes Abb. 17 von Praschniker

gjysmë të punuar nga Prokonezi.[16]) Në Dyrrah sarkofagut të mësipërm i është shenjuar të paktën mbishkrimi, gjasisht është përpunuar lulja dhe ndoshta është lëmuar skaji i tabulës.

Mbishkrimi vijon si më poshtë:

L. VALERIO. M.
FELICI. SPL
AEDILI. AUGURI
ITEM. II VIRO
XXXXVI

L. Valerio M[arci Filio?]/Felici spl[endido ose Splendidissimo Viro]/, aedili, auguri,/ (. . . .) /item duumviro/ [qui vixit annos?]XXXXVI.

«Për Lucius Valerius-in (birin e Markut?) Felix, kalorës romak . . . Edil, Augur. . . gjithashtu Duumvir, . . . (i cili jetoi?) 46 (ose më tepër vjet).

I vdekuri, që si kalorës (Eques Romanus) i përkiste shtresës së lartë romake, ishte edil, augur dhe duumvir. Sarkofagu duhet t'i përkasë gjysmës së dytë të shek. II. Të dhëna më të sakta për të nuk kemi.

6. Peqin (gjasisht stacioni romak Klodiana) Gjetur në kështjellë (fig. 12 – 13).

Lartësia 0,45 m. Gjatësia 0,905 m. Gjerësia 0,91 m.

Mermer Prokonezi.

Kemi të bëjmë me dy fragmente të bashkueshme të një kapaku-çati të thyer që në antikitet dhe të lidhur me një kllapë në anën e tij të pasme. Kapaku ka formën e zakonshme të kapakëve të sarkofagëve të Prokonezit, me akrotere relativisht të mëdha.[17]) Në një nga anët e gjata, me sa duket në faqen e përparshme, është gdhendur tabula e përzgjatur në

16) **Po aty,** f. 487, Nr. A. Fig. 11 A
17) **Po aty,** f. 486. fig. 10.1.

DO NOT COPY

Literatura C. Praschniker – A. Schober, **Archäologische Forschungen ih Albanien und Montenegro,** Wien, 1919, f. 45, fig. 57, 57a, G. Koch – H. Sichtermann-, f. 316.

2. Dyrrah, muzeu arkeologjik (fig. 4,5).
Lartësia 0,71 m. Gjatësia 2,05 m. Gjerësia 0.92 m.
Gur gëlqeror.

Nga sarkofagu ruhet arka e sheshuar me daltë të dhëmbëzuar. Në pjesën e poshtme shihen gropëzat e një daltimi më të ashpër, ndërsa anash vendet e kllapave për mbajtjen e kapakut. I vetmi dekor i tij është një tabul e vogël drejtkëndëshe me skaje të profiluar në pjesën e përparme. (lartësia 0,245 m, gjatësia 0,415 m). Në rastin e dhënë duket se kemi të bëjmë me një ekzemplar lokal, me zbukurim tepër të thjeshtë, të gjysmës së dytë të shek. II.

Mbishkrimi vijon:
VALERIAE VVLCACI
AE. Q.V.A. XXIX VALERIVS
VVLCACIVS, PATER, ET
SENTIVS VESTAL. MARIT
COMMVNITER. POSVER

Valeriae vulcaci/ae q(uae) v(ixit) a(nnos) 29, Valerius/Vulcacius pater et/Sentius Vestal(is) marit(us)/Communiter posuer(unt)
Valeria Vulkacias, që jetoj 29 vjeç ia vendosën sëbashku (këtë sarkofag) Valerius Vulkaciusi, i ati, dhe Sentius Vestaliusi, i shoqi.

3. Aulon (Vlorë) Muzeum, zbuluar në vitin 1981 në Vlorë.
Lartësia 0,70 m. Gjatësia 2.55 m.
Gjerësia 1,27 m.
Gur gëlqeror.

Fragmenti i përket kapakut-çati të një sarkofagu me akrotere në skajet. Kapaku është zgavruar në anën e brendshme. Poshtë, në skajin e jashtëm, gjendet një dhëmb, i cili futej në gropëzën e skajit të sipërm të arkës. Fragmenti, gjasisht i gjysmës së dytë të shek. II, është i papublikuar. Informacioni i përket V. Beretit.

II. Sarkofagë të importuar nga Prokonezi, të përpunuar (ose pjesërisht të përpunuar) në vend.

4. Dyrrah, Muzeu arkeologjik, Nr. inv. arkës 234, i kapakut 235. (fig. 6-9).
Arka: Lartësia 0,75 m. Gjatësia 2,055 m. Gjerësia 0,80 m.
Kapaku: Lartësia 0,44 m. Gjatësia 2,09 m. Gjerësia 0,60 m.
Mermer prokonezi

Pjesa në mes të anës së përparme, e cila në foto ndryshon në ngjyrë, është e plotësuar. Kapaku lidhej me faqet anësore të arkës me nga një kllapë.

Sarkofagu është importuar nga Prokonezi, duke shenjuar në të katër anët harqet e girlandave dhe mbajtësit e tyre. Si i tillë ai është një nga sarkofagët gjysmë të gatshëm që u prodhuan me shumicë në kavot e Prokonezit për t'u eksportuar në skajet e ndryshme të perandorisë romake.[15]) Kjo gjendje gjysmë e punuar ruhet ende në anën e pasme (fig. 9) dhe në anën e majtë. Në të kundërt, ana e përparme (fig. 6) dhe ana e djathtë (fig. 8) janë përpunuar më tej në Durrës. Girlandat janë rrumbullakosur dhe lëmuar, janë evidentuar kokët e gozhdëve nga të cilat vareshin ato, nga masa e mermerit janë formuluar breza, nga konturet në formë zemre që vareshin nga



Fig. 10. Sarkofag me girlanda prej mermeri Prokonezi, Damask.
Fig. 10 Girlandensarkophag aus prokonnesischem Marmor, Damaskus

girlandat janë gdhendur vile rrushi. Janë përpunuar profilet e skajit të sipërm dhe të poshtëm, ndërsa në pjesët e përparme, të dy konturet e rrumbullakëta, në mes të harqeve të girlandave anësore janë kthyer në disqe të sheshta flijimi. Nga konturi drejtkëndësh, në pjesën e mesit, është përpunuar një tabul me kontura të dala, brenda së cilës gjendej dhe një disk tjetër (prej tij ruhet një pjesë e vogël nga skaji i poshtëm). Gjendjen origjinare të pjesës së përparme të sarkofagut e kuptojmë nga një ekzemplar nga Damasku (fig. 10). Në anën e djathtë të sarkofagut të Durrësit (fig. 8), disku brenda harkut të girlandave është shndërruar në një lule, me një kurorë fletësh rretheqark. Së fundi, në Durrës është rrafshuar edhe kapaku.

Paralele të sakta për përpunimin e mësipërm nuk gjejmë në ndonjë provincë tjetër. Meqenëse në Durrës gjetjet janë të mangëta, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse kishte ndonjë punishte për importimin dhe përpunimin e prodhimeve gjysmë të gatshme të Prokonezit, ose në se ky ekzemplar ishte unik.

Proporcionet e ulëta të sarkofagut tregojnë se ai i përket shek. II, më saktë mesit të këtij shekulli.

Literatura: **Shqipëria arkeologjike** (1971) tab. 108; P. Pensabene, **Dialoghi di archeologia,** N. s, 3. 1981, 87, fig. 3, 92, 346, G. Koch – H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 346.

5. Dyrrah. Muzeu arkeologjik Nr. inv. 819 (fig. 11)

Lartësia 0,585 m. Gjatësia 1,04 m.

Mermer, gjasisht nga Prokonezi.

Ana e pasme e sarkofagut është e sheshuar, me sa duket gjatë ripërdorimit të tij. Për këtë arsye nuk përcaktohet dot me saktësi në se faqja e majtë mbaronte ose jo në këtë vend. Rrjedhimisht nuk jemi të sigurtë në se kemi të bëjmë me pjesën e përparshme të një sarkofagu, me një pllakë varri ose me një pjesë të ndonjë ndërtimi tjetër sepulkral.

Në pjesën e gjatë të fragmentit gjendet një «tabula ansata» me mbishkrim, me skaje të profiluara, ndërsa në fushën e ansa-a një lule. Sipërfaqja jashtë tabulës është gdhendur me daltë me majë.

Sarkofagë me zbukurime të tilla hasen, ndonëse jo shpesh, në Dalmaci, Mëzinë e Poshtme dhe në Bithini. Ka gjasë që ata të jenë sjellë në gjendje



Fig. 11. Fragment sarkofagu (?) Durrës (Nr. 5).
Fig. 11 Fragment eines Sarkophages (?), Durres (Nr. 5)





Fig. 12-13. Fragment kapaku – çati, Peqin (Nr. 6).
Fig. 12 – 13 Fragment eines Dachdeckels, Peqin (Nr. 6)

15) Për prodhimin dhe shpërndarjen e prodhimeve gjysmë të përgatitur, **Po aty,** f. 484 v,

DO NOT COPY



Fig. 14-16. Sarkofagu i Meleagerit, Durrës, sot në Stamboll (Nr. 7).
Fig. 14 – 16 Meleagersarkophag aus Durres, Istanbul (Nr. 7)





DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 17. Fragment sarkofagu dionisiak të prodhuar në Romë, Durres (Nr. 8)
Fig 17 Fragment eines stadtrömischen dionysischen Sarkophages, Durrës (Nr. 8).



Fig. 18. Vizatimi i fragmentit nga Prashnikeri.
Fig. 18 Zeichnung des Fragmentes Abb. 17 von Praschniker

gjysmë të punuar nga Prokonezi.[16]) Në Dyrrah sarkofagut të mësipërm i është shenjuar të paktën mbishkrimi, gjasisht është përpunuar lulja dhe ndoshta është lëmuar skaji i tabulës.

Mbishkrimi vijon si më poshtë:

L. VALERIO. M.
FELICI. SPL
AEDILI. AUGURI
ITEM. II VIRO
XXXXVI

L. Valerio M[arci Filio?]/Felici spl[endido ose Splendidissimo Viro]/, aedili, auguri,/ (. . . .) /item duumviro/ [qui vixit annos?]XXXXVI.

«Për Lucius Valerius-in (birin e Markut?) Felix, kalorës romak . . . Edil, Augur. . . gjithashtu Duumvir, . . . (i cili jetoi?) 46 (ose më tepër vjet).

I vdekuri, që si kalorës (Eques Romanus) i përkiste shtresës së lartë romake, ishte edil, augur dhe duumvir. Sarkofagu duhet t'i përkasë gjysmës së dytë të shek. II. Të dhëna më të sakta për të nuk kemi.

6. Peqin (gjasisht stacioni romak Klodiana) Gjetur në kështjellë (fig. 12 – 13).

Lartësia 0,45 m. Gjatësia 0,905 m. Gjerësia 0,91 m.

Mermer Prokonezi.

Kemi të bëjmë me dy fragmente të bashkueshme të një kapaku-çati të thyer që në antikitet dhe të lidhur me një kllapë në anën e tij të pasme. Kapaku ka formën e zakonshme të kapakëve të sarkofagëve të Prokonezit, me akrotere relativisht të mëdha.[17]) Në një nga anët e gjata, me sa duket në faqen e përparshme, është gdhendur tabula e përzgjatur në

16) **Po aty,** f. 487, Nr. A. Fig. 11 A
17) **Po aty,** f. 486. fig. 10.1.

DO NOT COPY

mënyrë të pazakonshme, me anse të mëdha dhe skaje të profiluara. Prej saj ruhet vetëm pjesa e djathtë e tabulës dhe ansa e djathtë. Fusha e tabulës nuk është e thelluar, ndërsa profilet ngrihen nga sipërfaqja. Kjo tregon se tabula nuk u përpunua më vonë, por u përgatit si e tillë që në fillim.

Një zbukurim të tillë nuk e hasim në kapakët e sarkofagëve të Prokonezit, por tabulat e mëdha i gjejmë në një sërë arkash nga ky vend (krahaso nr. 5 fig. 11[18]). Në ekzemplarin e Peqinit tabula është përpunuar që në Prokonez. Kjo mbështet edhe hipotezën se në Prokonez përgatiteshin arka gjysmë të gatshme me tabula ansata.

Në rastin e Peqinit nuk është kryer ndonjë përpunim në vend, nuk është shenjuar mbishkrimi dhe nuk janë përpunuar ornamentet e akrotereve.

Duke marrë parasysh proporcionet relativisht të ulëta, kapaku i përket fundit të shek. II[19]).

III. Sarkofagët e importuar në gjendje plotësisht të përpunuar

A. Sarkofagët nga qyteti i Romës

7) Dyrrah, Sot në Stamboll, në Muzeun Arkeologjik, nr.inv. 2100 (fig. 14 – 16).

Arka: Lartësia 0,57 m. Gjatësia 2,415 m.

Kapaku: Lartësia 0,125 m.

Mermer.

Sarkofagu i ruajtur në një gjëndje mjaft të mirë, ka një mori skenash nga miti i Meleagerit, birit të mbretit Oineus nga Kalidoni[20]. Në pjesën e përparme fig. 14), nga e majta në të djathtë paraqiten: vrasja e Meleagerit nga Apolloni; karroja e luftës me dy kuajt e Meleagerit; Meleageri i plagosur për vdekje e i mbartur nga shokët; Oineu që nxiton drejt korteut; Althaja, e ëma, që vrapon nga e majta e mbajtur prej një shërbyeseje; vetëvrasja e Althajës. Anët kufizohen nga dy dioskurët me kuaj. Në anën e majtë (fig. 15) paraqitet lufta e Meleagerit kundër Thestiadëve, në të djathtën, dy motrat e pikëlluara të Meleagerit në varrin e të vëllait. Në kapakun e ulët jepet skena e gostisë pas gjuetisë. Në anën e djathtë shihet një kazan mbi zjarr, që përzihet prej një burri. Majtas itj gjendet derri i egër, flija e vrarë, që do të gatuhet. Pjesën më të madhe e zënë nëntë njerëz të shtrirë, të ndarë në dy grupe dhe të mbështetur në jastëkë. Në skajin e majtë jepet Atalanta, mikesha e Meleagerit, afër saj gjasisht vetë heroi dhe në të djathtë sërishmi dy dioskurë.

Sarkofagu i Durrësit paraqet një ekzemplar të punuar në qytetin e Romës, me një kualitet të përkryer. Ai duhet t'i përkasë periudhës së hershme të Antoninëve, rreth v. 140-150. Ky është dhe sarkofagu më i hershëm perandorak i gjetur në Shqipëri.

Literatura. G. Koch, ASR XII 6, f. 110, Nr. 81. tab. 68-72, 78 a-b, 114 a, 116 a-c, G. Koch-H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 163, f. 263, 272. Shën 28 tab. 186.

8. Dyrrah. Muzeu arkeologjik Inv. 2136. (fig. 17-18).

Lartësia 0,44 m. Gjatësia 0,375 m.

Mermer.

Fragmenti i përket një sarkofagu dionisiak nga Roma. Në pjesën e përparshme ruhet pjesa e parme:



Fig. 19. Fragment sarkofagu dionisiak të prodhuar në Romë, Vatikan.
Fig. 19. Fragment eines stradtrömischen dionysischen Sarkophages, Vatikan

18) N. Asgari, në: **Studien zur Religion und Kultur Kleinsiens,** Festaschrift. F.K. Dörner, 1978, f. 37 v, G. Koch-H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 487, Nr. A.

19) **Po aty,** f. 491.

20) G. Koch, **Die antiken Sarkofagreliefs,** XII XII, 6, f. 3 G. Koch – H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 161 v.



Fig. 20. Fragment sarkofagu dioniak i prodhuar në Romë, Durrës, sot në Stamboll (Nr. 9).
Fig. 20. Fragment eines stadtrömischen dionysischen Sarkophages aus Durres, Istanbul (Nr. 9).

Fig. 21. Fragment sarkofagu atik me girlanda, dikur në Durrës (Nr. 10).
Fig. 21. Fragment eines attischen Girlandensarkophages, früher Durres (Nr. 10)



Fig. 22. Faqe anësore sarkofagu atik me girlanda, Antakya.
Fig. 22. Nebenseite eines atischen Girlandensarkophages, Antakye



DO NOT COPY



Fig. 23. Fragment sarkofagu atik me girlanda, Durrës (Nr. 11).
Fig. 23. Fragment eines attischen Girlandensarkophages, Durres (Nr. 11)

e një gomari me kokën anash, i cili mbart një mbulesë. Mbi të, siç kuptohet nga paralelet, qëndronte satiri, që luante në një vegël muzikore. Prej saj ruhet një pjesë e vogël, në të majtë të kokës së gomarit, e mbajtur nga dora e satirit. Në sfond dallohen këmbët e një njeriu të kthyer djathtas. Prej tyre këmba e djathtë paraqitet e tërhequr, ndërsa e majta e shtyrë para. Trupi i tij i zhveshur, paraqitet midis gomarit dhe figurës së djathtë. Linea-alba e lakuar lehtë, gjoksi dhe rrëza e kofshës janë punuar me relief të sheshtë. Prashnikeri e ka parë këtë fragment më të plotë. Në vizatimin e tij (fig. 18) shihen konturet e Satirit, por edhe aty mënyra e mbajtjes së instrumentit muzikor nuk kuptohet qartë. Prej Satirit të ri ruhej krahu i djathtë i ngritur lart dhe koka e kthyer pas. Figura në të djathtë nuk i përket «silenit me shkopin e udhëtimit», por një gruaje që flijon këndezin. Si gomari me satirin ashtu dhe flijimi i këndezit, të shoqëruar dhe me figura të tjera, hasen shpesh në sarkofagët dionisiakë. Ekzemplari i Durrësit mund të krahasohet me një fragment nga Vatikani (fig. 19), edhe ky tepër i dëmtuar dhe i plotësuar[21]). Ekzemplari i Durrësit mund të datohet në vitet, 150-160. Si i tillë ai është një nga shembujt e hershëm të kësaj skene, ndoshta më i hershmi. Në pjesën e majtë të sarkofagut, si në Vatikan, duhet të jetë paraqitur Dionisi.

Literatura: C. Praschniker, **Österreihische Jahreshefte** 21/22, 1922-24, Beiblat, 214 Nr. 1, fig. 125, Koll 272 shën. 38.

9. Dyrrah. Sot në Stamboll, në muzeun arkeologjik Nr. Inv. 2101 (fig. 20).
Lartësia 0,52. Gjatësia 0,91 m.
Mermer.

Fragmenti paraqet gjysmën e djathtë të pjesës së përparshme të një sarkofagu të zbukuruar me figura nga shpura e Dionisit. Nga e majta në të djathtë vijojnë Dionisi në këmbë, mbi një bamazent



Fig. 24. Sarkofag atik me girlanda, Athinë.
Fig. 24. Attischer Sarkophag mit Girlanden, Athen

21) Për Satirin mbi gomar, F. Matz, **Die Abtiken Sarkofaga reliefs** IV; 1; f. 70; Nr.Th. 117. Për silenin me shkop: Matz, **vep.cit,** 58, Nr. Th. 99. Për gjelin e flisë: Matz: **vep.cit,** 78, Nr. Th. 120 (me shembuj) I. Jucker, Archaol, Anzeiger 1980, 469, fig. 30. E. Lissi – Caronna, Atti della Accademia Nazionale dei Lincei, Rendiconti 38, 1983, f. 155 v, Nr. 1, Tab. 1. f. f. F. Rebecchi, Archaol. Anzeiger, f. 141. fig. 1, 2. Fragmenti në Vatikan: F. Matz, **Die Antiken Sarkofagenreliefs,** IV, 3, 308, ff. Nr. 163, Tab. 185.2, dhe Shtojca 80, 1.

DO NOT COPY

rrethor, dhe një satir vallëzues që i bie një flaüti të dyfishtë prej të cilit ruhen gjurmë të pakëta. Në këmbët e satirit paraqitet një panterë e shtrirë për tokë. Pas satirit vijojnë një menadë e mbështjellë në veshjen e saj dhe një Pan vallëzues me kokën e kthyer pas. Në këmbët e tij paraqitet një shportë prej së cilës del një gjarpër. Më tej vijon një satir duke vallëzuar, me një kimbalë në dorë dhe një menadë me timpanon. Në faqen e djathtë ruhen gjurmët e një burri dhe një peme.

Në skajin e sipërm të fragmentit gjendet dhëmbi për kapjen e kapakut. Megjithëse ky dhëmb nuk haset shpesh në sarkofagët e prodhuar në Romë, fragmenti i mësipërm, sipas ikonografisë dhe stilit, është prodhuar në Romë ose në rrethinat e saj. Në anën e majtë duhet të vijonin figura të tjera të rrethit të Dionisit, duke kërcyer dhe duke i rënë veglave.[22]). Paralelet për renditjen e këtyre figurave mungojnë.

Sarkofagu është prodhuar në vitet 150--160 në Romë, në një punishte që punonte me cilësi të lartë dhe që kish disa karakteristika të veçanta të saja.

Literatura F. Matz, ASR IV, 4, 492, Nr. 338, tab. 337, G. Koch, H. Sichtermann, **vep. cit,** f. 272, shën. 38.

B. Sarkofagët atikë

10. Dyrrah (sipas K. Praschnikerit nga kisha e Petovës). Sot i zhdukur.

Lartësia 0,76 m. Gjatësia 0,52 m.

Fragmenti përbëhej nga dy copë të bashkueshme me njëra-tjetrën. Skaji i profiluar është i dalë para. Në skajin e djathë ruhej një kokë kau me një girlandë të lidhur me fjongo. Nga e majta e girlandës, zbre[illegible] një kalli i cili dukej se vijonte me një kërcyell të hollë deri në taban. Korniza e sipërme e profiluar, koka e kaut, kallinjtë dhe fjongot tregojnë se fragmenti i përket një sarkofagu atik me girlanda.[23]) Për krahasim mund të sjellim faqen e një sarkofagu nga Antakja (Turqi), të prodhuar në Athinë (fig. 22). Sipas tipologjisë fragmenti i Durrësit është prodhuar rreth vitit 150.



Fig. 25. Fragment xokoli sarkofagu atik, Durrës (Nr. 12).
Fig. 25. Fragment vom Sockel eines attischen Sarkophages, Durres (Nr. 12)



Fig. 26. Xokol sarkofagu atik me Hipolitin, Beirut.
Fig. 26. Sockel eines attischen Hippolytossarkophages, Beirut

Literatura: C. Praschniker, **Österreihische Jahreshefte** 21/22, 1922-24. Beiblat 184, Nr = 56, fig. 100. G. Koch-H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 440, Nr. 60, 465 (ekzemplari i Antakjas, **po aty,** f. 439, Nr. 25).

22) G. Koch, F. Matz, **vep.cit,** IV, 2, f, 178, Nr. 72-74; Tab. 81; 86; 1.

23) Për sarkofarët atikë me girlanda G. Koch-H. Sichtermann, **vep.cit.** f. 435, v, Tab. 467, 468.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

11. Dyrrah, Muzeu arkeologjik inv. Nr. 101 (fig. 23).

Lartësia 0,37 m. Gjatësia 0,41 m.

Mermer pentelik.

Në fragment ruhen pjesët e një girlande, poshtë nga e djathta një tjongo, ndërsa sipër një sfinks i ulur majtas. Mermeri pentelik, përpunimi i girlandës, kallinjtë e lidhur dhe sfinksi i ulur, tregojnë qartë se fragmenti i përkiste një sarkofagu atik me girlanda. Një paralele ofron pjesa e pasme e një sarkofagu me erosë nga Athina, në të cilin, në harqet e girlandave, paraqiten sfinkse me fytyrën e drejtuar nga mesi (fig. 24). Sfinkse të tillë shihen dhe në faqet anësore.[25]). Për këtë arsye nuk mund të përcaktohet dot dhe se kujt faqe i përket fragmenti i Durrësit.



Fig. 27. Fragment kapaku – çati sarkofagu atik, Durrës, (Nr. 13).
Fig. 27. Fragmente eines attischen Dachdeckels, Durres (Nr. 13)

Përdorimi i shpeshtë i trapezit për pjesët e girlandës e daton fragmentin rreth vitit 170.

12. Dyrrah, Muzeu arkeologjik, inv. 158 (fig. 25).



Fig. 28. Fragment kapaku – çati sarkofagu, atik, Durrës Nr. 14).
Fig. 28. Fragment eines attischen Dachdeckels, Durres (Nr. 14)

Lartësia 0,31 m. Gjatësia 0,52 m.

Mermer pentelik.

Fragmenti i përket xokolit të një sarkofagu atik. Mbi zonën e poshtme të dhëmbëzuar vijon një shirit gjysmë cilindrik, i zbukuruar me fletë të vendosura në formë luspash. Brezi mbajtës i figurave del paksa përpara. Në të shihen gjurmë shputash të ndryshme, por vetë figurat janë hequr më vonë me daltë. Nga sfondi i relievit ruhet vetëm një pjesë e vogël, i cili ka po aq gjurmë këmbësh.

Breza të tillë me fletë gjejmë në një sërë sarkofagësh atikë[26]). Në këtë drejtim, me fragmentin e Durrësit ngjason tepër një sarkofag Hippoliti nga Bejruti (fig. 26)[27]). Si i tillë ai duhet t'i përkasë çerekut të tretë të shek. II.

113. Dyrrah, Muzeu arkeologjik (fig. 27).

Fragmenti i majtë. Lartësia 0,34 m. Gjatësia 0,625 m. Gjerësia 0,35 m.

Fragmenti i djathtë. Lartësia 0,35 m. Gjatësia 0,85 m. Gjerësia 0,35 m.

Mermer pentelik.

Të dy fragmentet e puqshëm me njëri-tjetrin i përkasin kapakut-çati të një sarkofagu atik. Në pjesën e tij të poshtme gjendet një brez lehtësisht konveks i cili qëndronte paksa më brenda arkës. Në të

24) Athinë, muzeu Nacional 1181, G. Koch – H. Sichtermann, **vep.cit,** f. 439; Nr. 26.

25) Antakya 15 948, **Po aty,** 438, Nr. 10. Athinë Ephorie, **Po aty,** 439, Nr. 20 Worcester, **Po aty;** 441; Nr. 81.

26) Krahaso **Po aty,** Tab. 408, 420, 422, 430, 436, 439, 449; 459; 459. 469; 471; 476.

27) Beirut muzeu nacional, f. 393, tab. 425.

DO NOT COPY



Fig. 29. Fragment sarkofagu atik, Durrës (Nr. 15).
Fig. 29. Fragment eines attischen Sarkophages, Durres (Nr. 15)



Fig. 30. Fragment sarkofagu atik, Durrës (Nr. 16).
Fig. 30. Fragment eines attischen Sarkophages, Durres (Nr. 16)



janë gdhendur gjethe akanthi. Breza të tillë hasen shpesh në kapakët-çati të sarkofagëve atikë, të zbukuruar shpesh me ornamente (krahaso Nr. 23 fig. 42 dhe Nr. 29, fig. 51)[28]. Në vend të tjegullave të vogla në formë flete, të zakonshme për sarkofagët atikë (krahaso Nr. 14, fig. 28, Nr. 22 fig. 41), këtu paraqiten imbrices-et e mëdhenj e të sheshtë dhe tjegullat e ngushta. Në rastin e dhënë duket se kemi të bëjmë me një përpunim lokal të Dyrrahut, i cili imiton format e çative të Azisë së Vogël. Në të majtë ruhen shenjat e një akroteri të paornamentuar, ndërsa frontoni ka vetëm një kornizë të punuar përciptas.

Kapaku relativisht i ulët tregon për një sarkofag relativisht të hershëm, të çerekut të tretë të shek. II[29].

Fig. 31. Fragment sarkofagu atik me erosa, dikur në Apolloni, (Nr. 17).
Fig. 31. Fragment eines attischen Erotensarkophages, früher Apollonia (Nr. 17)



Fig. 32. Ana e ngushtë e një sarkofagu atik me erosa, Athinë.
Fig. 32. Schmalseite eines attischen Erotensarkophages, Athen

14. Dyrrah, Muzeu arkeologjik, inv. 306 (fig. 28).
Lartësia 0,375 m. Gjatësia 0,56 m.
Mermer pentelik.

Pjesa e sipërme e fragmentit është rrafshuar gjatë ripërdorimit, ndërsa tri anët janë thyer në mënyrë të çrregullt. Në të paraqiten tjegullat e vogla në formë flete, karakteristike për kapakët-çati të sarkofagëve atikë. Por brinja e kulmit, e zakonshme për to, këtu mungon (krh. Nr. 22 fig. 41)[30]. Fragmenti duhet t'i përkasë gjysmës së dytë të shek. II.

15. Dyrrah, Muzeu arkeologjik, inv. 4796 (fig. 29).)
Lartësia 0,28 m. Gjatësia 0,72 m.
Mermer pentelik.

Fragmenti paraqet pjesën e sipërme të arkës së sarkofagut, me një kornizë me varg vezësh dhe fletësh, si dhe kokën e kthyer majtas të një djalo-

shi. Mermeri pentelik, përpunimi i kornizës dhe fytyrës, para së gjithash i vetullave, qerpikëve dhe flokëve, tregon se fragmenti i përket një sarkofagu atik të gjysmës së parë të shek. III, gjasisht fillimit të këtij harku kohor.

Pamja e djaloshit është e qetë. Si i tillë fragmenti mund t'i përkasë përfigurimit të legjendës së Hippolitit, që haset shpesh në sarkofagët atikë. Për ekzemplarët e shek. III është karakteristik vargu i djel-



Fig. 33. Fragment sarkofagu atik, Apolloni (Nr. 18).
Fig. 33. Fragment eines attischen Sarkophages, Apolonia (Nr. 18)

28) **Po aty,** me tab. 429, 460, krh. tab. 419.
29) **Po aty,** f.371.
30) **Po aty,** f. 371. Kjo brinjë mungon dhe në raste të tjera p.sh. tek kapaku i papërfunduar i sarkofagut të Melegerit në Athinë, **(Po aty)** f. 399, Tab. 429.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 34. Fragment sarkofagu atik, Apolloni (Nr. 19, 20).
(Nr. 19, 20).
Fig. 34 – 35. Fragment eines attischen Sarkophages, Apollonia



Fig. 36. Sarkofag atik me Akilin, Apolloni
Fig. 36 Fragment eines attischen Achillsarkophages, Apollonia
Nr. 20)

moshave që qëndrojnë të qetë, paksa të kthyer dhe paksa të rrotulluar[31]).

Literatura: **Shqipëria arkeologjike,** 1971 Tab. 107. **L'art Albanais a travers les siecles, Paris,** Petit Palais, 1974, 75 (1976) Nr. 273, k. 465.

16. Dyrrah, Muzeu arkeologjik, inv. 497 (fig. 30). Lartësia 0,18 m. Gjerësia 0,14 m.
Mermer pentelik.
Koka është thyer nga pas, nga e djathta dhe në hundë. Siç e tregon plastika e çrregullt e fytyrës, koka i përkiste një reliefi të ktnyer djathtas. Në të paraqitet një djalosh me flokë të shkurtëra, të valëzuara lehtë. Përfigurimi i flokëve me anën e trapanit në formë kanalesh të shkurtëra, vetullat, theksimi i skajit të brendshëm të syrit nëpërmjet një vrime si dhe thellimi i shkurtër me trapan mbi buzën e sipërme tregon se koka i përkiste një sarkofagu atik të gjysmës së parë, më saktë të çerekut të dytë të shek. III. Për nga mënyra e punimit koka dallon nga frag-

31) Agrixhent Sh. Nikolla **Po aty,** f. 394 Tab. 426 krh. dhe sarkofagun e Pelopsit në Athinë, **Po aty,** f. 404, Tab. 438.

menti. Nr. 15, rrjedhimisht ajo nuk i përket të njëjtit sarkofag. Përfigurimi nuk na le të përcaktojmë në se kemi të bëjmë, si në fragmentin Nr. 15, me mitin e Hippolitit.

17. Kolkondas, kisha e Shën Kozmait, nën anijatën jugore. Fragmenti gjasisht është i sjellë nga Apolonia në kohën e ndërtimit të kishës në vitin 1814-15. Sot i zhdukur.

Lartësia 0,62 m. Gjatësia 0,75 m.

Sipas të dhënave të L. Rejit fragmenti ishte prej guri gëlqeror.

Koka e kaut në skaj, korniza e sipërme dhe stili në përgjithësi lidhen mirë me ekzemplarët atikë. Rrjedhimisht duhet të kemi të bëjmë me një origjinal atik, prej mermeri pentelik. Lart, afër mesit, ruhet vrima e kllapës që e lidhte me kapakun.

Fragmenti i përket anës së djathtë të ngushtë të një sarkofagu. Pjesa e pasme, siç kuptohet nga koka e kaut, ka qenë e zbukuruar me girlanda.[32]) Në pjesën e përparshme duhet se kanë qenë paraqitur erosë. Zona ornamentale e sipërme, ka paralele të shumta në sarkofagët e hershëm atikë.[33]) Në sarkofagët atikë shihen edhe fëmijë vallëzues, të cilët sjellin në altar një fli. Por në Apolloni sendet që ata mbajnë në dorë nuk kuptohen mirë. Fëmija i majtë duket se mban në supin e majtë shkopin e thyrsosit, nga i cili varet një fjongo. Një pozë të ngjashme ka-



Fig. 37. Sarkofag atik me Akilin, Napoli.
Fig. 37 Attischer Achillsarkophag, Neapel



Fig. 38. Sarkofag atik me Akilin, Romë.
Fig. 38. Attischer Achillsarkophag, Rom

32) Për anët e gjata të Sarkofagëve me Herkulin, luftën e Centaurve ose një skenë dionizjake në të cilën qoshet janë më bukrone. **Po aty,** tab. 422, 423.
33) Krh. **Po aty,** Tab. 406, 409/10, 447-449, 454-456, 467, 468, 475.
34) **Po aty** f. 431. Nr. 37 – 44. Krh dhe f. 429, Nr. 2. Tab. 455.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 39. Dy fragmente xokoli të një sarkofagu atik, Gjirokastër (Nr. 21)
Fig. 39. Zwei Sockelfragmente eines attischen Sarkophages Gjirokastra (Nr. 21)



Fig. 40. Xokol i një sarkofagu atik me Meleagri Delfi.
Fig. 40. Sockel eines attischen Meleagersarkophages Delphi

në dhe dy fëmijët e paraqitur në faqen anësore të një sarkofagu atik nga Athina (fig. 32). Por në këtë të fundit altari ka formë tjetër[35]).

Fragmenti i Apolonisë duhet t'i përkasë një sarkofagu atik nga më të hershmit, në të cilët girlandat, që fillimisht paraqiteshin në çdo anë, zëvendësohen në njërën nga faqet me skena me figura. Ai është, prodhuar rreth vitit 150, ose fare pak pas tij.

Literatura L. Rey, Albania, Cahiera d'Archeologie, d'Histoire et D'art. 5, 1953, 55, Nr. 2, tab. 16, 1, G. Koch-H. Sichtermann, **vep. cit,** f. 431, Nr. 42. f. 465.

18. Apoloni, Muze inv. Ap. 117 (ose 147) (fig. 33).

Lartësia 0,63 m, gjatësia 0,47 m.

Mermer pentelik.

4) Në dy dokumente mesjetare të vitit 1324 vendi quhet Redonum dhe Rheones (L. Thalloczy, C. Jirecek, E. Sufflay, **Acta et diplomata res Albaniae Media Aeatis illustrantiae I,** Vindobonae 1913, nr. 694 dhe 788, me emrin Redoni shënohet ky vend edhe në ditarët e M. Sanudos (11 Maj 1500) (I. Zamputi, **Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506.** Pjesa e dytë (1499-1506) Tiranë 1979 dok. 55.

5) S. Pulaha **«Qëndresa e Popullit Shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII»** (dokumente osmane) Tiranë 1978 dok. 49 f. 78-79.

6) H. Ceka, **Busti i mbretit Gent apo figurë e mitologjisë ilire,** «Iliria» 6, Tiranë 1976 f. 143-147.

DO NOT COPY



Figura 1

p.e.r. janë zbuluar rreth 300 m në V.L. të kalasë, gjithashtu tulla antike të përmasave 0.44 x 0.44 x 0.08 m, si dhe bloqe të mëdha gurësh të punuar me teknikën rustika janë ripërdorur në muret mesjetare[7]).

Gjatë një ekspedite nënujore në zonat bregdetare të Adriatikut u zbuluan, nën nivelin e ujit, trakte muresh me gurë të latuar që i përkisnin vendbanimit të hershëm të periudhës ilire[8]). Në mesjetë në saje të pozitës së tij të rëndësishme në kontrollin e lëvizjeve të karvaneve që vinin nga Dalmacija, Rodoni del për herë të parë në fillim të shek. XIV (1324) si një qendër piraterie, nga ku grabiteshin anijet raguzane dhe më vonë, në fillim të shek. XV, ato venedikase[9]). Në shek. XIV dhe XV në Kepin e Rodonit pranë kalasë përmenden emrat e katër manastireve, si dhe ndonjë shtëpi që tregon për embrionin e ndonjë fshati[10]). Nga manastiret e përmendura ai i Shën Mërisë dhe i Shën Ndout përfaqësojnë një të vetëm[11]), ndërsa njeri nga dy të tjerët, Shën Anastasija ose Shën Kolli mund të ketë qenë në territorin e kalasë, pasi atje, gjatë punimeve të restaurimit në vitin 1967, u gjet një basorelief guri, i cili

7) H. Myrto, **Hartë e monumenteve dhe gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit,** «Monumentet» 2/1981, f. 60.

8) N. Ceka, M. Zeqo, **Kërkimet nënujore në vijën bregdetare dhe ujërat e brendshme të vendit tonë,** «Monumentet» 2 1981, f. 60.

9) A. Dyselie, **Gjendja e Kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumentave Raguzane** «Studime Historike» 1977/1 f. 123.

10) A. Dyselie, **Vep.cit.** f. 125.

11) A. Meksi, **Kishat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut.** «Monumentet», 1 (27) 1984 f. 103-125.

DO NOT COPY

paraqiste figurën e një ëngjëlli (fig. 2). Gjatë shek. XIV Kepi i Rodonit ka shërbyer edhe si skelë për anijet që transportonin grurin e ardhur nga Ishmi[12]).

Kalaja mesjetare e ka zanafillën nga koha e Skënderbeut. Sipas Barletit, Mehmeti II pasi dështoi në rrethimin e tretë të Krujës, shkoi në vendin e quajtur Kepi i Rodonit, ku Skënderbeu kish filluar shumë kohë më parë ndërtimin e një qyteti dhe e prishi atë që nga themelet[13]). Për ndërtimin e kësaj kalaje nga Skënderbeu bëjnë fjalë edhe një sërë dokumentash veneciane të viteve 1500-1501[14]), ndërsa në vitin 1463 Skënderbeu kish lidhur kontrata me mjeshtra muratorë raguzanë për punime në këtë kala[15]). Por me që në kalanë e Rodonit u kryen punime edhe nga venecianët, është e nevojshme të analizohen me hollësi të gjitha burimet historike që bëjnë fjalë për këto punime, për të dalë në dukje se çfarë kishte ndërtuar Skënderbeu në këtë kala.

Venecianët u interesuan për rindërtimin e Rodonit në pragun e përgatitjes së kryengritjes së armatosur në Shqipëri, që do të udhëhiqej nga Skënderbeu i Ri. Në këtë rast ata synonin të shtinin përsëri në dorë qytetet bregdetare shqiptare që kishin humbur.

Rëndësia strategjike e kalasë përcaktohet qartë në relacionet para fillimit të punimeve, «... ky vend, thuhet në një relacion, është i vendosur në mënyrë të tillë që pak ushtarë nuk mund ta dëmtojnë, ndërsa shumë nuk kanë se ku të qëndrojnë, dhe prandaj në se do të gjenden dy galere në çdo krahë, kurrë nuk mund të vinin të vendoseshin aty ushtritë. Ky kep jo vetëm zotëron dy gjiret prej Ulqinit në Durrës, por zotëron edhe të gjithë vendin e Shqipërisë...»[16]).

Në Janar të vitit 1500 ngarkohet Proveditori i Shqipërisë, Andrea Mikeli, për të parë vendin dhe mundësitë e fortifikimit të tij, ndërsa në fund të marsit fillojnë punimet me një ritëm shumë të ngadaltë[17]). Në prill të këtij viti Rodoni kishte filluar të popullohej[18]). Në maj të vitit 1500 dërgohet në Rodon gëlqere nga Spliti, hapen disa furra në vend dhe fillojnë punimet për pastrimin e hendekut që kishte qenë



Figura 2

mbushur me dhe. Ustallarët janë marrë nga vendësit dhe kërkojnë të largohen nga kushtet e këqia. Kërkohen në mënyrë të përsëritur të holla, lëndë druri dhe ushqime për rojet, përndryshe rrezikohet braktisja e veprës.[19]) Po në këtë muaj, Proveditori i Shqipërisë, Andrea Mikeli, braktis ndërmarrjen dhe shkon në Durrës[20]). Deri në qershor të vitit 1500 nuk kishte mbërritur akoma lënda e ndërtimit e mendohet se fortifikimi duhet rrënuar e braktisur[21]). Deri në tetor të këtij viti ishin vendosur 70 — 80 familje të varfëra brenda rrethimit. Punimet e kryera konsiderohen të pafrytshme dhe një shpenzim i kotë, pasi për ta plotësuar si duhet fortifikimin duheshin shpenzime të mëdha dhe po aq për ta mbajtur[22]). Gjithashtu do të duhej të ndërtohej një mur me gjatësi 700 hapash nga ana e detit. Në dhjetor të vitit 1500 dër-

12) A. Dyselie, **Vep.cit,** f. 126.
13) M. Barleti, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë, 1964, f. 483.
14) I. Zamputi, **Vep.cit.** faqe 130, 138, 139, 146, 155, 156, 157, 158, 160, 169, 170, 181, 213, 228, 233, 255, 289, 300.
15) P. Thomo, **Vep.cit.**. f. 116.
16) I. Zamputi, **Vep.cit.** dok. 65, f. 160 — 161.
17) I. Zamputi, **Vep.cit.** dok. 15, 30.
18) **Po aty** dok. 37.
19) I. Zamputi. **Vep.cit.**
20) **Po aty** dok. 57; 59.
21) **Po aty** dok. 80.
22) **Po aty** dok. 140



Figura 3

gohen 23 stratiote si roje, por pasi ata mësuan se vendi ishte i shkretë dhe në gjendje të keqe refuzojnë të qëndrojnë[23]). Punimet vazhduan edhe gjatë vitit 1501, më 20 janar njoftohet se nuk janë dërguar materialet e ndërtimit dhe se njerëzit e atij vendi mund ta ndjejnë veten të braktisur[24]). Ndërsa 3 muaj më vonë, në fund të prillit 1501, Proveditori i Shqipërisë, Andrea Mikeli, raporton në senat se punimet në Currila janë përfunduar[25]). Më 31 tetor 1501 Proveditori i ri i Shqipërisë, Anton Boni, njofton këshillin e të dhjetëve në Venedik se pasi kish verifikuar në vend gjendjen e Currilave «Ky popull (shqiptarët e ngarkuar për mbrojtjen e Rodonit) ankohet me të madhe se, pasi ka hyrë në bindje ndaj zotërive tuaja, pasi pati premtime shumë të mëdha nga ana e Marin de Greçi, si dhe nga ana e paraardhësit tim se do të nozullohej e do të bëheshin fortifikime në atë vend, tani e sheh veten të mashtruar e të braktisur nga çdo ndihmë e përkrahje...»[26]). Prandaj, shton Proveditori, është krejt e nevojshme që zotëritë tuaja shumë të shkëlqyera me shpejtësinë më të madhe, të mendoni për fortifikimin e atij vendi....»[27])

Siç kuptohet nga ky dokument i fundit, kontributi





LLAÇ - PIKTURA POSHTE SHENES SE SHEN MERKURIT

Figura 4

DO NOT COPY

i venecianëve në rindërtimin e kësaj kalaje ka qenë fare i paktë dhe punimet janë kufizuar me sa duket vetëm në riparimin e ndërtimeve egzistuese. Më e qartë del kjo po të krahasojmë gjurmët e ruajtura në vënd me ato që egzistojnë para fillimit të punimeve nga venecjanët, të cilat përmenden në dokumente si ndërtime të kryera nga Skënderbeu.

Po të shohim mbetjet e këtyre ndërtimeve që ruhen në ditët tona ato përbëhen nga një bastion më se 10 m i lartë, si dhe një mur i harkuar me frëngji, që krijonte me bastionin korridorin e një hyrje të dyfishtë dhe që nga veriu vazhdonte në drejtim të detit ku përfundonte në një kullë të rrumbullakët. (fig. 3). Muri i harkuar nuk lidhet me bastionin, por i mbështetet atij në të dy vendet ku ishin vendosur portat. Ai është i lidhur organikisht me murin që shkon në drejtim të detit dhe me kullën e rrumbullakët (fig. 4). Pra kemi të bëjmë me dy periudha ndërtimi. Periudhës së parë i takon bastioni dhe muri që vazhdon prej tij në drejtim të jugut, ndërsa periudhës së dytë i takon krejt kompleksi i hyrjes me gjithë kullën e rrumbullaktë në breg të detit. Megjithëse këto dy pjesë janë ndërtuar me një diferencë jo të largët kohe, ato janë konceptuar që në fillim si një e tërë, përndryshe kjo pjesë e fortifikimit nuk do t'i shërbente mbrojtjes së krejt kalasë, përkundrazi do të ishte pika më e dobët e saj. Në qoftë se do t'u referohemi burimeve dokumentare para fillimit të ndërtimeve veneciane do të bindemi se ky kompleks ka qenë ndërtuar nga Skënderbeu dhe ndoshta periudha e dytë i takon gjithashtu fazës së parë të ndërtimeve në vitet 1451-52, pasi teknika e ndërtimit për të dy pjesët është e njëjtë (fig. 5,6). Në një dokument të fillimit të qershorit të vitit 1500 thuhet se muri i kalasë përfundonte me nga një «kullë në anë të detit në secilin krah dhe një pirg në mes të malit, i cili është i rrënuar përgjysmë, shumë i trashë, me shumë kazemate e bombardjerë (frëngji topash), të bëra prej Skënderbeut që e ndërtoi»[28]). Pra kulla në breg të detit dhe për pasojë edhe muri i harkut me frëngji, i njëkohshëm me të, ka qenë ndërtuar nga Skënderbeu, i cili kishte ndërtuar edhe shumë frëngji për topa. Një e dhënë tjetër që vërteton se ky mur ishte ndërtuar nga Skënderbeu është se në dokumentin në fjalë shënohet se muret kishin një trashësi shumë të madhe prej 14 këmbësh dhe lartësi 6 këmbë, që i përgjigjet lartësisë së vogël dhe trashësisë së madhe të mureve të kompleksit të hyrjes.

Venecianët u përqendruan në pastrimin e hendekut para mureve, që ishte 10 hapa i gjerë dhe po aq i thellë, ndërsa në disa vende arrinte thellësinë 20 hapa pas mbushjes që ishte krijuar nga rrëshqitja e dheut. Ky kanal parashikohej të arrinte thellësinë 40 hapa, aq sa kish qenë para mbushjes. Muri nga bastioni në drejtim të jugut kishte shkarë pjesërisht bashkë me dherat dhe kishte mbushur hendekun. Punimet do të jenë përqendruar kryesisht në rindërtimin e këtij muri, si dhe në ndërtimin e rivelinit (ndërtim mbrojtës i jashtëm) që kish filluar qysh në qershor të vitit 1500. Riparime më të vogla mund të jenë bërë edhe në kompleksin e hyrjes si dhe në pjesën e sipërme të bastionit. Nga sa kuptohet edhe prej dokumentave të fundit të kësaj periudhe impenjimi i venecianëve në rindërtimin dhe kompletimin e kësaj kalaje ishte i paktë. Pas largimit të Skënderbeut të Ri, i cili kishte zbarkuar në Lezhë në fillim të marsit 1501 dhe rënies së Durrësit në dorë të turqve, venecianët e braktisën Rodonin dhe kjo kala nuk u përdor më si një qendër e fortifikuar. Tani që e kemi të qartë se rrënojat e kalasë së Rodonit, të ruajtura deri në ditët tona, i përkasin periudhës së Skënderbeut, të ndërtuara rreth viteve 1451-1452 dhe në vitin 1463, do të ishte me vlerë të preknim interesin që paraqesin këto gjurmë në artin e fortifikimeve të kohës.

Si nga shqyrtimi i arkitekturës së vetë monumentit, ashtu edhe nga përshkrimi i tij në dokumentet veneciane, të bie menjëherë në sy, trashësia e madhe e mureve të kalasë në raport me lartësinë e tyre. Në dokumentet veneciane muret konsiderohen si të një «trashësije të jashtëzakonshme» duke qenë vetëm 6 këmbë të larta. Këto përmasa i përshtaten murit të harkuar me frëngji, që ndodhet në të djathtë të hyrjes, i cili ka qenë rreth 2 m i lartë. Kulla qendrore (torion) përshkruhet me shumë kazemate e frëngji për artileri të ndërtuara nga Skënderbeu. Këto të fun-

23) **Po aty** dok. 166
24) **Po aty** dok. 182
25) **Po aty** dok. 218
26) **Po aty** dok. 235
«Quel populo lamentandosse che venuti ala dediction de le signorie vostre cum amplissime promissione factegli per Marin di grezi et per el precessor mio si de prouisione comme de la fortificatione. De quel loco, se vedono hora essere sta decepti et derilicti da aiuto et fauore...».
27) **Po aty** dok. 235.
28) **Po aty** dok. 65.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 5



Figura 6



Figura 7

dit nuk janë ruajtur por muret e saj arrijnë një trashësi prej 6 m. Me interes është edhe kulla rrethore në breg të detit që lidhet me murin e harkuar me frëngji. Ajo ka qenë një kullë tipike për artileri, me mure të gjera dhe me një lartësi jo më të madhe se 4 m. Kulla është mjaft e rrënuar, por në qemerin e rrëzuar të mbulesës së saj mund të dallohen gjurmët e një oxhaku me prerje drejtkëndëshe (25 x 30 cm), që shërbente për nxjerrjen e tymrave që shkaktoheshin nga djegja e barutit.

Si përsa i përket lartësisë së vogël të mureve, ashtu edhe për formulimin e kullës në fjalë kemi të bëjmë me ide mjaft të përparuara për kohën, kur sapo kishin filluar hapat e para të futjes së koncepteve moderne për fortifikimin[29]). Frëngjitë e ruajtura në kalanë e Rodonit janë kryesisht të tipit «Vrimë çelsi» dhe përfundojnë në anën e jashtme me një vrimë të rrumbullaktë për nxjerrjen e grykës së zjarrit dhe me një të çarë vertikale sipër saj për vrojtimin e qitjes. E çara vertikale në disa raste është e lidhur me vrimën e rrumbullakët (fig. 7) dhe në disa raste

29) Gj. Karaiskaj, **Fillimet e fortifikimeve për artileri në Shqipëri.** (Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin «Mbrojtja, studimi dhe restaurimi i monumenteve të kulturës në Shqipëri». Tiranë 8-9 Shtator 1986).

e veçuar prej saj. (fig. 6). Por, ajo që paraqet më tepër interes është një frëngji, me hapje më të gjerë në anën e jashtme, për topa të një kalibri më të madh, këto frëngji të njohura në literaturë dhe si të tipit «Goje» shfaqen në disa vende të Evropës Qendrore pas viteve 60 të shek. XV[30]. Njëra nga frëngjitë e ndërtuara në kompleksin e hyrjes, ndryshe nga ç'na paraqitet në skicën e dhënë nga P. Thomo, mbulon me zjarr anësor rrëzën e murit që shkon në drejtim të veriut, si dhe një pjesë të kanalit pranë tij. Në këtë rast kemi të bëjmë me një nga karakteristikat thelbësore të sistemeve fortifikuese të bastionuara, të cilat shfaqen gjatë shek. XVI. Jo më pak interes paraqet edhe përmendja në dokumentet veneciane i dy elementeve të fortifikimit, që gjithashtu janë karakteristike për fortifikimet e mëvonshme të bastionuara. Këto janë: **kordoni** dhe **rivelini,** i pari është një kornizë e gurtë e cila ndërtohej për të penguar vendosjen e shkallëve, ndërsa e dyta një ndërtim i jashtëm në formë trekëndëshi. Përsa i përket rivelinit duhet të kemi parasysh çfarë kanë kuptuar në atë kohë me këtë term, pasi shfaqja e një elementi të tillë në një periudhë kaq të hershme, do të ishte një novacion me të vërtetë shumë i madh për kohën që bëjmë fjalë.

Një gjurmim më i hollësishëm i këtij monumenti nëpërmjet gërmimeve arkeologjike do të sillte ndoshta të dhëna të reja me vlerë për këtë periudhë kyçe në historinë e fortifikimeve.

DO NOT COPY

30) Gj. Karaiskaj, **Frëngjitë për topa në fortifikimet mesjetare, origjina dhe evolucioni i tyre** «Monumentet» 1 (31)/ 1986, f. 93-111.

Gjerak KARAISKAJ

DONNEES SUR LA FORTERESSE DE RODON

RESUME

La forteresse de Rodon est une des plus importantes constructions défensives de l'histoire de notre architecture militaire de la période passagère entre les fortifications typiques médiévales et celles bastionnées, qui marquent une nouvelle époque dans l'histoire de la fortification.

Partant de l'analyse faite sur des sources historiques et des ruines architectoniques cet article a pour but d'établir une distinction entre les parties de la forteresse construites à l'époque de Skanderbeg et la contribution des vénitiens à la construction de cette fortification ainsi que de faire ressortir la place qu'elle occupe dans l'architecture militaire de l'époque.

Th. Ippen qui fut le premier à porter intérêt à l'étude de cette forteresse, après l'avoir considérée comme l'une des constructions de Skanderbeg, avance une brève description de ses ruines et une esquisse schématiuqe de sa planimétrie.

Pirro Thomo fournit une description plus détaillée du monument ainsi qu'une planimétrie plus exacte. Il se sert des données historiques qui font mention de la reconstruction de la forteresse par les vénitiens en 1500 et y distingue, se basant essentiellement à la technique de construction, deux périodes de construction dont la deuxième appartient aux vénitiens. Ceux-ci, d'après P. Thomo, avaient construit la partie supérieure de la tour centrale, le mur à sa droite, et les meurtrières, le mur d'enceinte extérieur, sans altérer la configuration générale de la forteresse.

La forteresse s'érige sur un cap entre la ville de Durrës et celle de Lezha, connu au moyen-âge par le nom du Cap de Currila ou du cap de Rodon. Le peuple l'appelait aussi la forteresse de Muzhli de Skanderbeg lui donnant ainsi le nom du village situé tout près, qui est mentionné pour la première fois en 1568 dans la région de Musje, H. Ceka identifie Rodon au nom d'un divin illirien qu'on trouve même dans les frappes monétaires de Gent, de Lis et des Labéates. La présence des tessons de céramique de la période urbaine illyrienne ainsi que les dernières découvertes sous-marines, y prouvent l'existence d'une ancienne agglomération illyrienne. Grâce à sa position favorable au contrôle des va et vient des caravanes de Dalmatie, au début du XIVe sc (1324) Rodon est mentionné pour la première fois comme un centre de piraterie. Au XIVe et XVe sc on cite les noms de trois monastères et de quelques maisons, situés au cap de Rodon, près de la forteresse. A cette époque il servait de quai aux navires qui transportaient le blé venant d'Ishmi.

L'origine de la forteresse médiévale remonte à l'époque de Skanderbeg. Selon Barlet, Mehmet II, après avoir manqué le troisième siège de Kruja, se retira au Cap de Rodon et démolit depuis ses fondations une ville que Skënderbeg avait commencée à faire construire depuis longtemps. De la construction de cette forteresse par Skanderbeg, font mention une série de documents vénitiens des années 1500-1501. En 146[illegible] Skanderbeg avait conclu un contrat avec des maitres-maçons de Ragouse sur les travaux de la construction de cette forteresse. Puisque dans la forteresse de Rodon travaillèrent même les vénitiens, il est nécessaire d'analyser minutieusement toutes les sources historiques qui en font mention afin de distinguer ce que Skënderbeg avait fait construire avant.

Les vénitiens s'intéressèrent à la reconstruction de Rodon à la veille de la préparation de l'insurrection armée en Albanie qui serait guidée par Skanderbeg-le-jeune. Dans ce cas, ils visaient mettre de nouveau la main sur les villes maritimes qu'ils avaient déjà perdues.

En janvier 1500 André Michel chargé provéditeur de l'Albanie, vint voir le pays et les possibilités de sa fortification et à la fin du mois de mars, les travaux s'entamèrent à un rythme assez lent. En avril de la même année, Rodon commença a être peuplé. En mai 1500, de Split on y envoya de la chaux on y construisit des fours et on commença à déblayer le fossé. Les maçons, qui étaient autochtones, voulaient s'éloigner à cause des mauvaises conditions. Ils exigeaient de façon répétée de l'argent, du bois, des aliments pour les gardes et l'oeuvre risquait d'être abandonnée, c'est à ce mois là que le provéditeur de l'Albanie, André Michel quitta Rodon. Jusqu'en octobre de la même année, environ 70-80 familles pauvres s'étaient installées à l'intérieur de l'enceinte. Les travaux effectués furent considérés comme des frais inutiles, puisque pour compléter la fortification, et pour l'entretenir, il fallait dépenser encore de grosses sommes. De même, du côté de la mer il fallait construire un mur d'une longuer de 700 pas. En décembre 1500 on envoya 23 statiotes comme gardes, mais après avoir connu les mauvaises conditions de vie ces gardes refusèrent d'y rester. Un document du 20 janvier 1501 dit que les matériaux de construction ont tardé à venir et les gens du pays se croient abandon

DO NOT COPY

nés. Trois mois plus tard, à la fin du mois d'avril 1501, le provéditeur de l'Albanie, Andre Michel rapporta au sénat que les travaux à Currila avaient pris fin. Le 31 octobre 1501 le nouveau provéditeur de l'Albanie Anton Boni, après avoir vérifié sur place la situation à Currila, écrit au Conseil des Dix que ce peuple (les albanais chargés à défendre Rodon) se lamente après être convaincu par vos seigneurs et après avoir eu de grandes promesses de la part de Marin de Greci et de mon predecesseur, sur les travaux qu'on y entamerait, se voit privé d'aide et de faveur. Il continue que c'est pour cette raison qu'il supplie les excellents seigneurs de penser immédiatement à la fortification de cet endroit.

D'après ce dernier document, la contribution des vénitiens à la reconstruction de cette forteresse fut minime et leurs travaux se limitent, paraît-il, à la réparation des constructions qui existaient. Cela ressort mieux si l'on compare les traces conservées sur place avec celles qui existaient avant le commencement des travaux par les vénitiens, lesquels, dans les documents sont mentionnés comme effectués par Skanderbeg.

Si l'on observe les ruines conservées, on remarque un bastion haut de 10 m ainsi qu'un mur arqué percé de meurtières qui créait avec le bastion un corridor et une double entrée, se poursuivait au nord vers la mer et se limitait d'une tour ronde à son extrémité. Le mur arqué n'est pas lié avec le bastion, il s'y appuie à l'endroit où sont aménagées les deux portes et s'allonge vers la mer. Donc, il faut distinguer deux phases de construction. Le bastion et le mur qui s'allonge vers le sud remontent à la première période de construction alors que tout le complexe de l'entrée avec la tour ronde au bord de la mer appartient à la deuxième phase de construction. Quoique ces deux blocs sont construits à une petite intervalle de temps on remarque le même appareil des murs. Ils sont conçus dès le début comme une unité, autrement cette partie de la fortification ne servirait pas à la défense de toute la forteresse, elle serait son plus faible point. Les sources documentaires antérieures au commencement des constructions vénitiennes, nous convainquent que ce complexe fut fait construire par Skanderbeg et peut être la deuxième période aussi appartient à la première phase des constructions aux années 1451-52, puisque la technique de la construction est la même. Un document du début de Juillet 1500 dit que le mur de la forteresse se termine des deux côtés par une tour au bord de la mer avec une tour centrale au milieu de la montagne, à moitié ruinée, assez épais, munie de casémates et de canonnières faites par Skënderbeg qui l'a faite construire.

Donc, la tour au bord de la mer, et par conséquent le mur arqué muni de meurtières ont été faits construire par Skanderbeg qui avait fait construire aussi beaucoup de connonières. Ce document renforce cette idée en nous renseignant aussi que le mur était d'une épaisseur de 14 pieds et d'une hauteur de 6 pieds, ce qui répond à la petite hauteur et à la grande épaisseur des murs du complexe de l'éntrée.

Les vénitiens, effectuèrent le déblaiment du fossé situé devant les murs, d'une largeur et d'une profondeur de dix pas, qui était remblayé par le glissement du terrain. On prevoyait atteindre la profondeur de 40 pas, telle qu'elle avait été avant le remblayage. Le mur qui s'allongeait du bastion vers le sud, avait glissé en comblant le fossé. Les travaux ont dû être concentrés essentiellement à la reconstruction de ce mur et à la construction du revelin qui avait commencé depuis le mois de Juillet 1500. De petites réparations ont dû être effectuées au complexe de l'entrée et à la partie supérieure du bastion. D'après les derniers documents de cette période, les vénitiens n'ont pas beaucoup contribué à la reconstruction et au complètement de cette forteresse. Après l'éloignement du Skanderbeg-le-jeune qui avait débarqué à Lezne au début du mars 1501 et après la chute de Durres qui tomba dans les mains des turcs, les vénitiens abandonnèrent Rodon et cette forteresse cessa d'être un centre fortifié.

Maintenant qu'il est clair que les ruines de la forteresse de Rodon, conservées jusqu'à nos jours, remontent à la période de Skanderbeg surtout vers les années 1451-52 et 1463, il est nécessaire de parler un peu de l'importance que ces traces représentent pour l'histoire de l'art des fortifications de l'époque.

L'examen de l'architecture du monument ainsi que sa description dans les documents vénitiens, font remarquer l'épaisseur des murs de la forteresse par rapport à leur hauteur. Dans les documents vénitiens, les murs sont considérés assez bas et d'une «épaisseur extraordinaire». Les dimensions correspondent au mur arqué muni de meurtrières, d'une hauteur de 2 m situé à la droite de l'entrée. De même, par la description, la tour centrale se présente munie de plusieurs casémates et canonnières faites construire par Skenderbeg. Celles-ci ne se conservent plus mais les murs atteignent une épaisseur de 6 m. La tour ronde au bord de la mer qui est liée au mur arqué avec meurtrieres represente une tour typique à l'artillerie, aux murs epais, pas plus hauts que 4 m. La tour se conserve assez endommagée. Sur la voûte ruinée de sa couverture on distingue nettement les traces d'une cheminée à coupe quadranguiaire (25 cm x 30 cm) par où passaient les fummees produites par la combustion de la poudre.

Les murs bas ainsi que la formulation de la tour en question représentent des idées assez avancées pour l'époque où l'introduction des conceptions modernes n'avait fait que les premiers pas. Les meurtrières conservées dans la forteresse de Rodon, surtout l'une d'elles dont l'ouverture est plus large à l'extérieur, représentent de l'intérêt. L'une des meurtrières construites au complexe de l'entrée, différemment à ce que représente l'esquisse de P. Thomo, couvre de feu latéral le pied du mur qui va vers le nord ainsi qu'une partie du fossé tout près. Dans ce cas nous avons à faire à l'une des caractéristiques essentielles des systèmes fortifiés bastionnés qui apparaissent au cours du XVIe sc. Les documents vénitiens mentionnent aussi deux éléments de fortification, le cordon et le revelin qui sont caractéristiques des fortifications ultérieures bastionnées.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 1 1988

monumentet

DO NOT COPY

Gjergj FRASHERI
Sulejman DASHI

FILLIMET E ARTIT ISLAMIK NË QYTETIN E BERATIT

Gjurmimet tona na kanë çuar në përfundimin se vepra më e hershme e sferës islamike në qytetin e Beratit i takon të jetë xhamia që ndodhet pranë akropolit të kalasë, e mbetur në gjendje rrënojë dhe e quajtur nga tradita gojore si xhamia e Kuqe (fig. 1). Prej punimeve të pastrimit e të konservimit që u kryen në mbetjet e kësaj xhamie, në vitet 1976-77, rezultoi se salla e ndërtesës nuk ishte në formë katrori, por drejtkëndëshi në planimetri (8,25 x x 7,50 m) dhe e mbuluar dikur me çati druri e tjegulla. Duke u nisur nga teknika e mureve të mbetura mund të dallojmë se ndërtesa ka kaluar dy periudha ndërtimi. Kjo duket nga ndryshimi i teknikës së ndërtimit të minaresë e bazamentit të saj me kluaso-



Fig. 1. Xhamia e Kuqe, mbetjet para gërmimeve.

DO NOT COPY

nazh (qargjir), ndaj mureve të tjera formuese të sallës, të realizuara vetëm me gurë të çrregullt e llaç gëlqereje (fig. 2, 3, 4). Këtë përfundim e përforcon edhe prania e dy niveleve dyshemesh brenda sallës. Dyshemeja e poshtme, origjinare, e shtruar me tulla si të minaresë, mbi taban të hollë harasanit dhe ajo e sipërmja, që i takon periudhës së dytë, e shtruar me rrasa guri mbi një nënshtresë prej 60 cm lartësi, të përbërë nga hedhurina ndërtimi (fig. 5). Gjithashtu, për dy periudha ndërtimi flet edhe ndryshimi (modifikimi i hyrjes së minaresë, me heqjen (gdhendjen) e paturës për të zgjeruar hapësirën. Shqyrtimi i lidhjeve të mureve anësore të sallës me strukturat e minaresë, treguan se ndërtesa në fazën fillestare ka qenë realizuar me teknikën e kluasonazhit dhe se më vonë, muret e sallës së saj janë rindërtuar duke u ngritur edhe niveli i dyshemesë. Madje nga mbetjet është e vështirë të kuptohet pamja e hajatit në fazën fillestare, por në periudhën e dytë xhamia e ka patur hajatin në formë L-je, me njërin krah përpara hyrjes së sallës, ndërsa krahun tjetër në anën e djathtë të saj. Për formimin e hapësirës së hajatit, në krahun e djathtë, është shfrytëzuar muri i kalasë, mbi të cilin mbështeteshin trarët e dyshemesë e të çatisë (fig. 6). Veçoria e kësaj xhamie është vendosja e pazakonshme e minaresë në krahun e majtë të hyrjes në sallë. Në të vërtetë një dukuri e tillë është një rast i veçantë në tipologjinë shqiptare të xhamive (fig. 7, 8, 9, 10, 11). Veç kësaj, minareja e xhamisë së Kuqe, në kalanë e Beratit ka edhe cilësi të tjera dalluese tipologjike, zhvillimin cilindrik të trupit të minaresë (pa faqe), që është gjithashtu një shfaqje shumë e rrallë në arkitekturën e minareve tona, e ngjashme kryesisht me ato të dekadave të para të pushtimit osman. Mbështetur në elementet tipologjike e stilistike të xhamisë së Kuqe, një pjesë e të cilave i kemi trajtuar edhe në një punim të mëparshëm[1]), mbetemi gjithmonë të mendimit se ajo është ndërtuar në fund të shek. XIV, në periudhën e mbretërimit të Bajazitit i (1389 – 1402).



Fig. 2. Xhamia e Kuqe, planimetria.

*

E lidhur me periudhën osmane na tërheq vëmendjen një çështje thelbësore për qytetin e Beratit, deri sot pak e hulumtuar. Dihet se gjatë sundimit pesëshekullor të Perandorisë Osmane, qyteti e humbi emrin Beligrad dhe u quajt me emrin e sotëm Berat. Është e njohur tashmë se mbas pushtimit të pjesës më të madhe të Shqipërisë, deri në vitet 30

1) Shih më hollësisht: S. Dashi dhe Gj. Frashëri, **Zhvillimi i arkitekturës islamike shqiptare të xhamive**, «Monumentet», 2 (1986) 55-57.

DO NOT COPY



Fig. 3. Xhamia e Kuqe, gjatë pastrimeve.



Fig. 5. Mbetje të dyshemesë së periudhës së dytë ndërtimore.

të shek. XV, përparimi i osmanëve u ndërpre për disa dekada, në sajë të rezistencës së pashoqe shqiptare nën udhëheqjen e organizuar të Skënderbeut. Ndryshe nga qytetet e tjera të çliruara të Shqipërisë, që hynë më vonë nën sundimin osman, si: Kruja, Drishti më 1478, Shkodra më 1479, Durrësi më 1501, Berati vazhdoi të mbetej nën pushtetin e osmanëve pa ndërprerje qysh prej vitit 1417, në kohën e Muratit II (1421-1451) dhe të Mehmetit II (1451-1481). Dihet gjithashtu se zhvillimi dhe qytetërimi i vendit tonë, në këtë shekull të rezistencës epike, pësoi një rënie të ndjeshme. Qytete të mëdha e të lulëzuara të Shqipërisë, pas shkatërrimit që sollën luftërat e gjata e të mëdha, jo vetëm humbën shkëlqimin e dikurshëm, por në mjaft raste ato u rrudhën në vendbanime të vogla, me popullsi të paktë, apo u reduktuan thjesht në qendra ushtarake me garnizone të pushtuesit në kështjellat e tyre. Vetëm pas disa dekadash kur luftërat me perandorinë ishin zbehur, kryesisht përgjatë shek. XVI, i shohim ato në rrugën e një zhvillimi të ri të shoqëruar edhe me depërtimin e islamizmit në masën e popullsisë. Por, midis qyteteve shqiptare që



Fig. 4. Xhamia e Kuqe, mbas pastrimeve.



Fig. 6. Gjurmë të mbështetjes së trarëve të dyshemesë në murin e kalasë.

u shkretuan, pati ndonjë prej tyre që nuk pësoi fatin e shumicës, tek i cili nuk ra e njëjta valë shkatërrimtare.

Berati doli nga kjo epokë invazionesh me humbje më të vogla. Për pasojë, ashtu si në Prizren, Janinë, apo në Elbasan, edhe në Berat jeta qytetare e rimori shpejt veten, që në shekullin e parë të pushtimit. Arsyet janë të brendshme dhe të jashtme. Nga njëra anë sepse disa sundimtarë vendës, të përçarë e të pafuqishëm nga grindjet feudale, gjetën që në fillim gjuhën e nënshtrimit me osmanët dhe nga ana tjetër sepse qe interesimi i veçantë i Portës së Lartë për ta



Fig. 7. Xhamia e Kuqe, mbetjet e minaresë.



Fig. 8. Xhamia e Kuqe, bazamenti i minaresë.

patur me çdo kusht në dorë një rajon të tillë me epërsi ekonomike e strategjike; ekonomike, prej fushave pjellore të Myzeqesë dhe strategjike, për të kontrolluar Vlorën, pedanën e Portës për pushtimet e ardhshme të saj në Evropën Perëndimore.

Politika që Porta e Lartë ndoqi në Beligradin shqiptar ka një veçori ndaj qyteteve të tjera shqiptare në përgjithësi. Më qartë ajo duket në anën thelbësore të kësaj politike, në nivelin e veprimit të reformave islamizuese të popullsisë. Megjithëse Berati u mbajt gati tërë shek. XV pa ndërprerje në duart e osmanëve, ritmet e procesit të islamizimit, në krahasim me shumë qytete të tjera të vendit, qenë relativisht të dobëta. Kështu, në fillim të shek. XVI, nga të 572 shtëpitë e qytetit, vetëm 11 shtëpi ishin myslimanizuar[2]). Ky trajtim i diferencuar lidhur me të drejtat e banorëve të Beligradit shqiptar nga ana e Portës, duket akoma në faktin se shumë nga lagjet e qytetit

2) S. Pulaha, **Popullsia shqiptare e Kosovës, gjatë shek. XVI-XVII,** Tiranë, 1984.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

së bashku me faltoret e vjetra të ritit bizantin, ju lanë banorëve të krishterë të paprekura, me të drejtat e këtij besimi, jo vetëm në kohën e pushtimit të tij, por edhe në periudhat e mëvonshme. Bile, edhe në fund të shek. XVI e më tej, kur islamizimi përfshiu pjesën dërrmuese të banorëve të qytetit tashmë të zmadhuar nëpër varosh, banorët brenda bërthamës së vjetër të qytetit, si për shembull ata të kalasë, mbetën përsëri të krishterë, aq sa vazhduan të ndërtonin edhe faltore të reja të krishtera, një fenomen ky i rrallë për qytetet — kështjella shqiptare të pushtuara.



Fig. 9. Xhamia e Kuqe, prerje gjatësore

Në këtë kuadër mund të gjykohet se ende pas disa dekadave të pushtimit të qytetit, e konkretisht në kohën e Mehmetit II (1451 — 1481), nuk mund të flasim për islamizimin e popullsisë së qytetit. Por, megjithëse popullsia beratase vazhdonte në këtë periudhë të gëzonte plotësisht të drejtat e besimit të vjetër, elementi njerëzor islamik ishte rritur ndërkohë në gjirin e qytetit. Ai nuk kishte lindur prej tij, por kishte hyrë nga jashtë, natyrisht nëpërmjet ardhjes së garnizonit ushtarak otoman dhe vendosjes së tij në zemrën e kalasë. Dëshmi për këtë është ngritja pas xhamisë së Kuqe edhe e një faltoreje tjetër islamike, xhamisë së Fatihut, në akropolin e kalasë, rreth mesit të shek. XV. Xhamia e Fatihut, ose siç quhet ndryshe nga tradita vendase xhamia e Bardhë, u ngrit jo më pranë, si faltorja e parë, por brenda mureve të akropolit (Fig. 12).

Mbetjet e kësaj ndërtese të evidentuara nga punimet e pastrimit e të konservimit të kryera nga Instituti i Monumenteve të Kulturës në vitin 1977[3]), ndodhen në anën veriore të akropolit, midis tri kullave që formojnë njërin kënd të tij. Krejt kjo anë e akropolit, buzë mureve rrethuese të tij, qarkohet nga brenda prej një sistemi ndërtimesh radhazi, të cilat kanë shërbyer kryesisht për depozita armatimesh, ushqimesh e pajisjesh të tjera të nevojshme për garnizonin ushtarak të kalasë. Muret e xhamisë ngrihen pikërisht mbi disa nga këto substraksione, gjë që e bën ndërtesën të ngrihet në lartësi e të dominojë tërë sheshin përpara saj. Ajo ngrihet mbi një sallë të mbuluar mbi qemerë guri dhe një llagëm, i cili komunikon me mjediset e brendshme të kullave që rrethojnë xhaminë. Nga pikëpamja tipologjike xhamia është e thjeshtë. Ajo përbëhet nga salla (me hapësirë të brendshme 9,42 x 7,60 m) dhe hajati (me hapësirë të brendshme 5,76 x 10,65 m) i vendosur përpara hyrjes, i cili zgjerohet tej ndërtesës në krahun e majtë (Fig. 13, 14, 15, 16, 17). Minareja, ndryshe nga ajo e xhamisë së Kuqe, është vendosur si zakonisht, në të

3) Punimet u kryen nga Dega e Monumenteve të Kulturës së Beratit nën drejtimin e S. Dashit. Materiali i këtyre punimeve botohet për herë të parë.



Fig. 10. Xhamia e Kuqe, prerje tërthore.

djathtë të hyrjes së sallës. Prej saj ruhen sot vetëm 9 këmbë shkallë. Ngjitur me minarenë, në anën e jashtme të ndërtesës, një palë shkallë, që e qarkojnë atë, të ngjisin në sheshin përpara hyrjes së hajatit, në platformën e vogël midis tri kullave. Në anën jugore të faltores (përkundrejt minaresë) kalimi midis mureve rrethuese të akropolit dhe atyre të ndërtesës është gjithashtu në terren të pjerrët. Ngjitja dhe zbritja këtu nuk bëhet më me shkallë (si në krahun e minaresë), por nëpërmjet një rrugice të gjerë e të pjerrët të shtruar me kalldrëm, me sa duket për të krijuar mundësinë e lëvizjeve të mjeteve të rënda luftarake për te kullat. Pas punimeve të pastrimit u pa se muret e xhamisë ruhen ceket mbi nivelin e dyshemesë së sallës dhe vetëm bazamenti i minaresë arrin në 2,5 m. Megjithëse të dhënat qenë të pakëta, prej materialit të varfër arkeologjik u konstatua se krejt ndërtesa ka qenë e mbuluar me çati druri e tjegulla. Një copë kolonë rrethore guri gëlqeror (diametër 0,35 m), latuar mirë,

DO NOT COPY



Fig. 11. Xhamia e Kuqe, detaj i teknikës së ndërtimit në bazamentin e minaresë.



Fig. 12. Xhamia e Bardhë, mbetjet para pastrimeve.

Fig. 13. Xhamia e Bardhë, planimetria.



na tregoi se hajati ka qenë i hapur, me kolona guri.[4])

Xhamia shquhet për një strukturë solide të muraturës në dallim nga faltoret e tjera të vendit tonë, të ndërtuara nga Mehmeti II, të cilat në përgjithësi u ngritën me shpejtësi. E tërë muratura e saj së bashku me atë të mjediseve poshtë, është realizuar me gurë të bardhë (gëlqerorë) të punuar në formë katërkëndëshi këndrejtë e të vendosur në rreshta të rregullt (Fig. 18, 19). Pikërisht bardhësia e plotë e mureve të ndërtesës, e ka bërë atë të emërtohet në traditën vendase si xhamia e Bardhë. Gurët e qosheve të ndërtesës dhe veçanërisht ato të bazamentit të minaresë, për aq sa ruhen, të



lënë të kuptosh se ndërtesa në lartësi ka qenë trajtuar me gurë të punuar akoma më imët e me finesë. Brendia e xhamisë ka qenë krejt e suvatuar me patinaturë gëlqereje. Një ngritje e lehtë në dyshemenë e sallës flet për ekzistencën e mafilit në ballin perëndimor të saj, që ashtu si edhe minberi në anën lindore kanë qenë prej druri.

Si të gjitha faltoret e sulltan Fatihut në qytetet — kështjella të vendit tonë, edhe xhamia e Bardhë ndodhet brenda në kala. Ato shpesh quhen «Fetëhije» (e Fatihut), por në ndonjë rast i gjejmë edhe midis faltoreve të emërtuara e «Hunqarit». Periudha e Mehmetit II shënon për vendin tonë një epokë luftërash, pushtimesh e rrethimesh e jo një periudhë qytetërimi e ndërtimesh. Në këto rrethana, ndërtimi i xhamisë së Bardhë mbart disa kushte specifike ndaj

Fig. 14. Xhamia e Bardhë, planimetria e nënstrukturave.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 15. Xhamia e Bardhë, prerje tërthore.



Fig. 16. Xhamia e Bardhë, prerje gjatësore.

faltoreve të tjera që Fatiu ngriti në viset shqiptare. Ajo bën përjashtim për faktin se nuk qe e para faltore islamike që ngrihej në qytetin e Beratit, siç ndodhte me qytete të tjera në këtë kohë. Pajisja e Beratit, tashmë prej disa dekadash nën zotërimin e osmanëve, me një xhami të dytë në kala, ka lindur si nevojë e rritjes së personelit ushtarak osman i caktuar për mbrojtjen e qytetit, gjë që ka më shumë mundësi të ketë ndodhur pas rrezikut që krijoi rrethimi i Skënderbeut më 1455. Sado që i shërbente vetëm këtij personeli, arkitektura e kësaj ndërtese nuk është më një rast i çuditshëm i kalasë, siç shprehet Çelebiu për arkitekturën e xhamisë së Kuqe. Tipologjia, teknika e ndërtimit dhe minareja me faqe nuk janë më si tek xhamia e Kuqe, inspirime të modeleve nga koha selxhuke, por anojnë me tiparet e arkitekturës bashkëkohore osmane. Nga ana tjetër, zgjidhja për të e pikës më dominuese të kalasë, përbën një hap në futjen e siluetit islamik në mjedisin urban të qytetit të Beratit.

Megjithëse Porta e Lartë i respektoi të drejtat e qytetarëve beratas më shumë se kudo në viset shqiptare, nuk mund të besohet se ajo e la pas dore këtu programin e vet islamizues. Dhuna e hapur nuk ishte e vetmja formë për t'ia arritur qëllimit. Nga kjo pikëpamje të bie në sy fakti se shumë nga figurat e personalitetet me origjinë shqiptare, të cilët shfaqen shumë herët në shek. XV, janë me prejardhje nga ky ra-

DO NOT COPY



Fig. 17. Xhamia e Bardhë, galeria lidhëse me kullat.



Fig. 18. Xhamia e Bardhë, mbetjet e minaresë.

jon. Kështu përshembull, nga familja feudale e Skurajve të Beratit, njëri prej tyre, Isa bej Skura, pat arritur në kohën e sulltan Muratit II, në detyrën e guvernatorit të Anadollit e pak më vonë vezir. Raste të tilla gjenden edhe nga familja feudale e Muzakëve[5]), etj. Politika e diferencuar dhe favorizuese që ndoqi Porta e Lartë me Beligradin shqiptar u shfaq më hapur, pikërisht në mes të shek. XV, me një akt tjetër të saj. Në një kohë kur ushtritë e gjeneralët e Perandorisë derdhnin energjitë e tyre për të pushtuar kështjellat shqiptare e për të shtypur rezistencën e udhëhequr nga Skënderbeu, sulltan Mehmeti II, i lëshoi Beligradit shqiptar me firmën e tij një berat[6]), të titulluar «Hatti – Eman», nëpërmjet të cilit ai u jepte përgjithmonë banorëve të këtij qyteti, lirinë e ritit, të zakoneve të tyre dhe privilegje të veçanta, duke i përjashtuar prej të gjitha taksave, detyrimeve ndaj mallrave të importit (dogana), tributeve dhe

4) Karakteristika të tjera të faltores të cilat u fituan nga pastrimi janë: Muret e sallës kanë trashësi 0,83 m, ndërsa ato të hajatit (bazamentit të tij) 0,58 m dhe janë punuar me të njëjtën teknikë, me gurë gëlqerorë e llaç gëlqere. Hyrja e hajatit (1,41 m) ka qenë më e gjerë nga ajo e sallës (1,02 m). Lidhja midis tyre bëhej nëpërmjet një rrugëze (me gjerësi 1,41 m) të krijuar nga niveli më i lartë i dyshemesë prej harasani të hajatit, në të dy krahët e këtij kalimi.

5) F. Babinger, **Maometto il Conquistatore,** 1957, f. 78, 120, 401; Fjalori Enciklopedik Shqiptar, **«Muzakët»,** Tiranë 1985, f. 730-731.

6) Fjala berat vjen nga arabishtja «bera'a», që do të thotë imunitet, privilegj. Në Perandorinë Osmane berati ishte një diplomë me kushte të caktuara privilegjesh dhe imuniteti, i cili u jepej për t'u zbatuar autoriteteve qeveritare të provincave apo qyteteve. Kjo lloj diplome duhet dalluar nga «dabt fermani», që vjen nga arabishtja (dabi, pronë) dhe persishtja (ferman, urdhër), i cili është gjithashtu një dokument me kushte të caktuara dhurimi, por që u jepej për t'a zbatuar ushtarakëve pronarë, H.A.R. Gibb dhe H. Bewen, **Islamic Society and the West,** London 1960, vol. I. Part. I, f. 49, 50, 122 dhe Part II, f. 23, 98.

prej shpenzimeve të detyrueshme për vepra filantropike[7]), si të vetmin detyrim ai u caktoi atyre, që të mbronin Vlorën sa herë që asaj do t'i kanosej rreziku i huaj.

Sigurisht që këto privilegje, të cilat Beratit iu dhanë shumë shpejt pas pushtimit osman, së bashku me mundësinë për t'i shfrytëzuar ato me imunitet në shekujt e ardhshëm[8]), ndikuan padyshim në ripërtëritjen e menjëhershme të jetës qytetare dhe të zhvillimit të tij kulturor. Ne mund të supozojmë se është pikërisht kjo politikë e Portës, e cila ua zhveshin interesat feudalëve beratas për t'u bashkuar në rezistencën popullore skënderbegiane dhe kështu mund të shpjegohet edhe preokupimi i shfaqur i Stambollit, për mbrojtjen e Beligradit shqiptar në rrethimin e tij të vitit 1455. Me beratin sulltanor, Beligradi shqiptar mendojmë se hyri që në shek. XV në rangun e qyteteve «beli», të cilët numëroheshin me gisht në të gjithë perandorinë, më i madhi i të cilëve ishte vetë Stambolli.[9]) Ne jemi të mendimit gjithashtu se është pikërisht diploma mbretërore (berati), emri që zuri vend në gojën e popullsisë për ta dalluar këtë qytet nga të tjerët, si «Beligradi me berat» apo «qyteti me berat», në kuptimin e qytetit me privilegje, megjithëse në praktikat shtetërore osmane deri në shekullin e fundit ai vazhdonte të cilësohej akoma si Beligradi shqiptar.



Fig. 19. Xhamia e Bardhë, pas konservimit.

*

Përkujdesi i Portës së Lartë për ta patur Beligradin shqiptar një pikë të fortë mbështetëse për qëllimet e saj pushtuese në perëndimin e largët, u dukën më tej me hipjen në fron të djalit të madh të Mehmetit II, sulltan Bajazidit II, i mbiquajtur i shenjtë (1481-1512)[10]). Në kohën e tij, Berati, ashtu si disa qytete të tjera të viseve shqiptare, reflektoi dukuritë e para orientale në fizionominë urbanistike të qytetit.

Dhënia e privilegjeve dhe respektimi i të drejtave të banorëve, nuk përbënte garanci që Beligradi shqiptar t'i shërbente Stambollit për shumë kohë. Po-

7) Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë**, Tiranë 1973 f. 27. Dokumenti ka qenë i shkruar në një pllakë bakri dhe deri vonë ndodhej në bibliotekën e Kurt Ahmet Pashës, në teqenë e sheh Hasanit, pranë xhamisë Mbret. Ai u zhduk më 1914, me djegjen e kësaj biblioteke. Bisedime mbi historinë bujqësore të Shqipërisë f. 12. doreshkrim, pranë Arkivit të Institutit të Historisë Tiranë.

8) Sipas kanunameve mbretërore osmane, vendimet e çdo sulltani respektoheshin dhe mbeteshin të pandryshuara edhe nga sulltanët pasardhës.

9) Mbi të drejtat e qyteteve beli shih: T. Stoianovich, **Model and mirror of the premodern Balcan city,** Studia Balcanica, La ville **Balcanique** (XV-XIX siècle), Sofia 1970, nr. 3. f. 89-90.

10) Bajazidi II lindi nga martesa e sulltan Mehmetit II në v. 1447 me Gjylbeharin, një vajzë shqiptare e krishtere (F. Babinger, **Maometto il conguistatore,** Milano, 1957, f. 98, 632). Gjithashtu është i njohur respekti i veçantë që konservoi Mehmeti II për të, aq sa varri i Gjylbeharit ndodhet pranë varrit të të shoqit në kullien e Fatihut në Stamboll **(Po aty,** f. 93, 430, 431). Po ashtu dihet ndihma që i dhanë Gjylbeharit personalitetet ushtarake e politike me origjinë shqiptare të Portës, për sjelljen në fronin e sulltanit, të djalit të saj Bajazidit II, pas vdekjes të të shoqit (J. Hammer, **Storia del'Impero Ottomano,** Venezia, 1828, vëll. VII, f. 6-15). Sipas Hammerit, nga të dhjetë emërimet që bëri sulltan Bajazidi II për vezirët e mëdhenj të tij, gjashtë prej tyre qenë figura me origjinë shqiptare, të cilët me veprimtarinë e tyre mbuluan 23 nga 31 vjetët e mbretërimit të tij (J. Hammer, vol. VII, Tabela në fund të librit, nr. 9).

DO NOT COPY

pullsia e besimit të krishterë nuk mund të garantonte qëllimet e sigurinë e Perandorisë. Reforma islamizuese ishte në të gjitha rastet arma më e fuqishme e sundimit të saj. Dhe pikërisht në qytetet beli të shpallura prej saj, të cilët në pamjen e jashtme ruanin «respektin» e Portës së Lartë, kundërveprimi i saj, qe në të njëjtën kohë më i madh se kudo. Ndoshta bërthamat e vjetra urbane të tyre i ruajtën vërtet privilegjet e dhëna, porse ato shpejt u gjendën të rrethuara prej lagjeve të reja me popullatë të islamizuar, të cilat formuan edhe pjesën dërmuese të qytetit.



Fig. 20. Kulli e Bajazitit III. Gen plani.

E njëjta gjë ndodhi edhe me Beligradin shqiptar. Vetëm një sanksion i tillë zyrtar si «berati sulltanor», i dhënë bile qysh herët nga osmanët, mund të shpjegojë faktin që qyteti i krishterë i shek. XV (lagjet brenda kalasë) shpëtoi nga presioni pesëshekullor i islamizimit. Porse ai jo vetëm që i humbi shpejt përmasat e qytetit, por erdhi vazhdimisht duke u bërë pjesë gjithnjë e më e vogël në hapësirën përherë në rritje të Beratit të islamizuar mesjetar.

Përveç dy faltoreve që u ndërtuan në akropol, të cilat u shërbenin garnizonit ushtarak osman, kalaja nuk u prek më asnjëherë nga ndërtimet e sferës islamike. Trualli mbi të cilin zunë vend objektet përfaqësuese të pushtuesit u bë varoshi, në këmbët e kalasë. Piketa e parë për qendrat e reja të varoshit të ardhshëm u vu pikërisht në kohën e Bajazidit II, në fund të shek. XV. Me urdhërin e tij, gjatë dy dekadave të fundit të këtij shekulli, u ngrit qendra e parë urbane islamike e Beligradit shqiptar, bërthama e së cilës përbëhej prej xhamisë me emrin e tij (e mbiquajtur Mbret), teqesë së sektit halveti, medresesë, imaretit, shkollës për dije fillestare dhe disa objekteve të tjera plotësuese, që e rrethonin faltoren (fig. 20). Nga të dhënat që kemi deri sot ky kompleks përbën kullën e parë që është ndërtuar në vendin tonë. Rreth pamjes fillestare dhe datës së përfundimit të kullës së Bajazidit (Mbret), mungojnë akoma mjaft të dhëna të sakta, por nga gjurmimet e viteve të fundit, mund të sqarohen disa çështje. Padyshim, në këtë mjedis arkitektonik, rëndësi të dorës së parë merr xhamia (fig. 21, 22), për të cilës sipas mbishkrimit që ndodhet në frizin e mafilit të përkthyer nga V. Buharaja, mësojmë se ajo ka pësuar një rikonstruksion të thellë në vitin 1248 h (31 maj 1832 deri më 20 maj 1833[11]). Kështu, e vetmja e dhënë për pamjen e saj të parë, mbetet vetëm përshkrimi mjaft i paktë që na jep Çelebiu. Sipas tij «midis

11) Për të gjitha mbishkrimet në osmanisht që do të trajtohen në këtë punim, kemi patur një ndihmë konkrete nga orientalisti ynë i gjuhëve të vjetra V. Buharaja. Këto mbishkrime janë transkriptuar, transleteruar, përkthyer në shqip dhe komentuar prej tij.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21. Xhamia Mbret, pamje nga jugu.



Fig. 22. Xhamia Mbret, pamje nga veriu.

30 faltoreve myslimane që kishte Berati në atë kohë, xhamia e Bajazidit vazhdonte të frekuentohej më shumë. Ajo ishte në planimeri 60 x 50 gjurmë, me tri porta, një përpara ndërtesës dhe nga një në të dyja anët e saj. Minareja dallohej për lartësinë dhe bukurinë e saj. Një korridor i madh, sa ç'ishte vetë xhamia, i qëndronte asaj përpara. Sipas tij, xhamia e Bajazidit qe punuar në sistemin e vjetër dhe e mbuluar me tjegulla[12]. Çelebiu nuk na jep asnjë të dhënë rreth ndonjë mbishkrimi të faltores apo të datës së ndërtimit të saj. Përpjekje për të saktësuar një datë për themelimin e monumentit ka bërë L. Rey, i cili duke e datuar ndërtesën brenda periudhës së mbretërimit të Bajazidit II, shikon mundësinë e vitit 1492[13]). Supozimi i Rey-it nuk është pa vend. Në verën e vitit 1492 Bajazidi II erdhi në Shqipëri, në krye të ushtrisë për shtypjen dhe nënshtrimin e popullsisë kryengritëse himariote, për ndërtimin e kalasë së Tepelenës dhe aplikimin e disa reformave shtetërore,[14]), të lidhura këto me islamizimin në masë të popullsisë. Sigurisht që ndërtimi i faltoreve islamike ishte një pikë themelore e programit të ekspeditës së sulltanit, gjë që vërtetohet me faktin se me emrin e tij janë të lidhura disa objekte të ngritura në atë kohë në vendin tonë. Ka shumë mundësi që xhamia Mbret e Beratit së bashku me aksesorët e saj arkitektonikë, të jetë dhuruar apo porositur nga Bajazidi në muajt që ai qëndroi në Shqipëri. Po gjithashtu është krejt e natyrshme që kullia të ketë përfunduar së ndërtuari më 1492, domethënë që ajo të jetë porositur më përpara, midis viteve 1481-1492, sepse Berati, si një pikë e fortë mbështetëse në kufirin perëndimor të perandorisë, nuk ka mbetur jashtë vëmendjes së sulltanit të ri për osmanizimin e jetës qytetare. Sidoqoftë, vetë fakti i ndërtimit të një kullieje në fund të shek. XV dhe përmasat planimetrike të xhamisë, të cilat nuk u arritën më vonë nga asnjë faltore tjetër myslimane të ndërtuar në vendin tonë, janë shumë kuptimplote për angazhimin e posaçëm dhe me seriozitet të Portës ndaj Beligradit shqiptar.

Faltorja përbëhet nga salla e lutjeve (12,1 x x 15,4 m), minareja në të djathtë të hyrjes dhe hajati (18,6 x 9,9 m) i cili zgjerohet nga të dy krahët më

12) Shqip. para dy shek. **vep. cit,** f. 62.

13) L. Rey, **Guide de l'Albanie,** Paris 1930, f. 110, 11.

14) Hammer, J. **vep.cit,** vol. VII, f. 91-92, Bajazidi qëndroi në Shqipëri disa muaj, prej qershorit deri në mes të dimrit të vitit 1492. Për lëvizjet e tij në këtë rajon ka mungesa të dhënash. Ardhja e tij në Berat, as mund të supozohet, as mund të mohohet. Dihet saktë vetëm për 24 ditët e qëndrimit të tij në Tepelenë, ku asistoi në punimet e kalasë.

tepër se salla, aq sa del edhe bazamenti i minaresë. Mbulimi me çati druri të hapësirës mjaft të madhe të sallës ka kushtëzuar zgjidhjen e saj me anë të një konstruksioni ndihmës, që është arkada prej tri harqesh, vendosur tërthor dhe në mes të hapësirës së sallës mbështetur mbi dy kolona dhe dy pilastra rrethore prej guri. Arkada krijon një lloj ndarje në dy pjesë afërsisht të barabarta të hapësirës së sallës, në njërën prej të cilave, në anën veriore, është vendosur mafili prej druri, i cili zhvillohet në formë U-je. Përveç kolonave e pilastrave prej guri, për mbajtjen e tij në lartësi shërbejnë edhe dy kolona e dy pilastra të tjera prej druri, të vendosura simetrikisht me të parat. Hyrja për në mafil bëhet nga jashtë ndërtesës, nëpërmjet një porte në faqen përkundrejt minaresë. Sallës i korrespondojnë respektivisht dy tavane, që ndahen gjithashtu nga arkada trishe. Tavanet janë të një niveli të lartë artistik prej gdhendjeve dhe trajtimi në formë mozaiku prej druri. Vendin e rozetave qendrore e zenë dy kube të vogla, të rrethuara nga një numër rozetash plane (fig. 23). Gjithashtu, mihrabi në anën jugore dhe mihberi prej guri janë mjaft të dekoruar (fig. 24). Salla ka tri porta, dy anësore dhe një qendrore, e cila komunikon me hajatin. Ndriçimi i saj bëhet nga dy radhë dritaresh në të katër faqet e ndërtesës.

Në frizin e mafilit ndodhet mbishkrimi i përmendur më sipër (fig. 25). Mbishkrimi shtrihet në krejt gjatësinë e frizit dhe lexohet si zakonisht nga e djathta (veriu) në të majtë (jugu). Teksti është shkruar në 26 fushëza dhe secila fushëzë përmban nga dy vargje. Vargjet janë tetë rrokësh i dyzuar. Fushëza e fundit përmban shifrën që tregon vitin e rindërtimit të xhamisë. Mbishkrimi është osmanisht me përjashtim të fushëzave nr. 15, 16, 20 dhe 21, të cilat janë dhënë në persisht dhe ndonjë shprehje e veçantë në gjuhën arabe. Përmasat e çdo fushëze janë 47 x 15 cm. Shkrimi është i karakterit thuluth, i bukur, elegant dhe i lexueshëm. Vërehet se mbishkrimi është retushuar nga mbarimi i shekullit XIX ose fillimi i shek. XX. Duket se gjatë këtij retushimi, janë shkaktuar gabime gjuhësore, disa prej të cilave mund të ndreqen lehtë, por ka edhe të atilla të rënda që ja ndryshojnë kuptimin origjinalit[15]). Një konstatim i tillë i përkthimit



Fig. 23. Xhamia Mbret, pjesë e mafilit dhe tavanit.



Fig. 24. Xhamia Mbret, mihrabi dhe mihberi.

15) Një nga këto gabime është p.sh., vargu i parë i fushëzës nr. 5. Në këtë varg thuhet: «Kur e pa (veziri i madh) se në **qytetin e uruar** të Beligradit shqiptar, xhamia e sulltan Bajazidit Veliut ... ishte **ekspozuar** tepër ndaj (rrezikut) të rrënimit». Në të vërtetë versioni i drejtë është përkthimi: «**Me rastin e ardhjes së tij**», në vend të fjalëve «në qytetin e uruar» (V. Buharaja).

DO NOT COPY



Fig. 25. Xhamia Mbret, mbishkrimi në frizin e mafilit (transkriptimi dhe transliterimi).

u vërtetua edhe nga vrojtimi i gjurmëve të shkrimit origjinal që kishin mbetur pa retushuar, si dhe më vonë nga shqyrtimi i vetë shablloneve të shkrimit origjinal, të gjetura gjatë punimeve të restaurimit.

Nga përmbajtja e mbishkrimit mund të nxirren disa të dhëna për historinë e monumentit. Veziri i Madh i kohës së sulltan Mehmetit dhe mëkëmbësi i tij, serdari i madh (kryegjenerali) Mehmet Rushiti, pasi erdhën në Berat pane se xhamia e sulltan Bajazidit II ishte në rrezik shembjeje. Me ta konstatuar këtë gjendje vendosëm që xhamia të rindërtohej. Punimet u kryen nën kujdesin e vulëmbajtësit (myhyrdarit) të vezirit të madh, Mehmet Eminit, i cili që njëkohësisht kryeadjutant i Portës së Lartë. Nëpërmjet tekstit të mbishkrimit merret vesh se në këto punime rindërtuese janë kryer pikturimi i brendisë së sallës, rindërtimi i mihberit dhe i mihrabit dhe lihet të nënkuptosh edhe punime të tjera, të cilat nuk përcaktohen. Në fund të tekstit jepet emri i poetit që e ka thurur mbishkrimin, i quajtur Irziu,[16]) si dhe data

16) V. Buharaja, ka vënë në dukje se Irziu është autor i shumë kronogrameve të tjera të rrethinës së Beratit në gjysmën e parë të shek. XIX. Sipas shqyrtimit që i ka bërë një pjese të tyre, autori mendon se Irziu ka qenë një njohës i mirë i gjuhëve të vjetra orientale dhe me kërkesa ndaj talentit të tij poetik.

DO NOT COPY



me fjalë e me shifra i përfundimit të rindërtimit, 1248 h, që i takon vitit 1832 – 1833.

Minareja, prej së cilës sot ka mbetur vetëm bazamenti i saj, siç mund të gjykohet edhe nga fotografitë, ka qenë një gjymtyrë e bukur e ndërtesës (fig. 26). Ajo ka qenë e lartë dhe mjaft e hollë, me seksion poligonal tetëkëndor dhe e suvatuar nga jashtë në ngjyrë të bardhë. Bazamenti i saj i mbetur, i cili vjen nga koha e themelimit të xhamisë, është gjithashtu me seksion poligonal dhe i realizuar me teknikën e qargjirit, ndërsa më vonë, ndoshta në kohën e rindërtimit, duket se është suvatuar. Dallimet stilistike midis kësaj minareje ndaj asaj të xhamisë së Kuqe janë tashmë krejtësisht të dukshme. Minareja.



بسم الله الرحمن الرحيم رب الأنام
والصلوة على النبي والصحب الكرام

عصرينك سلطان محمود خان صدر اعظم
هم وكيل مطلق ذو القدرة والاحتشام

حضرت سردار اكرم نام كريم محمد رشيد
صرف همت ايلدي خيره كه اكمالا انفصام

چون خزاين يك مشرق اولديغي كوردي اول
هب اساسندن محمد والسون ايندي اعتزام

غيرت اتمام سرانه بذل ايتدي وجود
حق كاناتن ويره انساسنه دلدي احتشام

حيرت آور نقشي كركسه بوطرز عجيب
ديركل صنع ستر مانى ايدرام تمام

چون مزين مصقل اندە آغلاغش صور
كوزكور اسرار الطاف خفيه بانظام

لهذه اى خامهٔ معجز نويس ظرز قبل
خون لآى نظم ابكار معانيدن كلام

يعنى آرتيور بلقرار يده تشريفه كيم
جامع سلطان بايزيد وقف اول همام

او سربلندى كه عالى محمد آبين
مهر ايله صدر عالى صافدل ويكنام

سويله پرطيز مهندس وايله نيا ايدوب
ماشاء الله ينه شاسنهٔ خاص وعوام

پرتوانداز افيوضات الهى حقايم
حالت افزا اول نفوش

بيت مصوره سنه جامع ولكش بنا
دينسه شائسته سزاوار هذه والسلام

سالم مصباح روحانيه مرضوع شيرش
چشم شيطان لعين محرسش سيف وسهام

ظلمت كنده [نقوش] اولوب اچون جان ودل
شعله ورلكش قنادلى مثال انجم نظام

عاشق ولدار گان ايتدى رجوع بندگ
قره عينى صلوتيوز سهيا دلارام

نور روحلاى اصل الله مقر اهل ذكر
نزل كروبيان عالم بالا عظام

صاحب الخيرات ايچون ذالك علوه دستكى
وعيده شكرى كه ايردى خير به حسن ختام

لفظ و معنا عرضا اتمامنه دى تاريخن
بيك اكيرمى فرق سكزده سنه والاتمام

سنه ١٢٤٩

مؤذن ايدر اذانوز حى على الصلوة
رميدم بلبل كى كلدسته سنده صبح وشام

عندليب آسا نوا رخشم فرن خوانرا
روز شبها نظر باغ ارم كلفتى قام

پى قصور انشاسنه هيچ قالمش جاى نقط
صاكلى يه خوب سنشايه بكر خوشخرام

لوحش الله حاى احسان قلب مؤمنين
روضه جنتاى فرين صاحب محمد مقام

طوت ترام اسپ كلك طيفى سمت شمال
بوصفه بوزادى تو كيمه تا الى يوم القيام

بارك الله بنيه بنيه بونيه جمله ايليه
حق بوتون خيريله اولدوعالده بكام

DO NOT COPY

e xhamisë së Bajazidit II në Berat është një shembull i qartë se arkitektura klasike osmane shfaqet shumë herët në mjediset urbane shqiptare.

Hajati është gjithashtu më i madhi i këtij tipi që ruhet në vendin tonë (fig. 27). Në tri anë, ai është i hapur me portik, me kolona prej guri dhe harqe gjysmë rrethore. Faqet lindore e perëndimore shpohen nga arkada triharqesh, ndërsa ajo veriore prej një sistemi pesëharqesh, në mes të të cilave ndodhet porta. Dyshemeja e hajatit ndahet në dy pjesë të barabarta prej një kalimi në nivel më të ulët, nga

DO NOT COPY



Fig. 26. Xhamia Mbret, minareja



Fig. 28. Xhamia Mbret, brendi e hajatit.



Fig. 27. Xhamia Mbret, hajati para restaurimit.



Fig. 29. Xhamia Mbret, porta e hajatit.

DO NOT COPY



Fig. 30. Xhamia Mbret, muri jugor pas restaurimit.

porta deri në hyrjen e sallës. Në buzët e këtij kalimi ngrihen katër kolona guri, dy në secilën anë, të vendosura simetrikisht, të cilat thyejnë hapësirën e madhe të hajatit (fig. 28), si në rastin e sallës së faltores, për të ndihmuar strukturat mbajtëse të çatisë së madhe.

Punimet e restaurimit të vitit 1980 sqaruan disa çështje të tjera lidhur me pamjen origjinare të xhamisë. Me zhveshjen nga suvatimet të disa pjesëve me faqet e jashtme, rezultoi se muret e sallës së faltores ruanin teknikën e qargjirit, të njëjtë me atë të bazamentit të minaresë, nga e cila u kuptua se strukturat kryesore të ndërtesës, qoftë muret perimetrale ashtu edhe kolonat, nuk u prekën gjatë rindërtimit të vitit 1832 – 1833, përjashtuar meremetimet apo përforcimet e tyre. Gjithashtu, me anë të sondazheve në themelet e hajatit, gjurmimit të lidhjes së mureve të sallës me atë të portikut si dhe shfrytëzimit të shenjave që strehët e çatisë së vjetër kanë lënë në pjesën konike të minaresë, dolëm me përfundimin se qysh nga koha e themelimit, ndërtesa ruan përmasat planimetrike dhe në përgjithësi edhe proporcionet së bashku me elementet arkitektonike të altimetrisë së saj.[17]) Nevoja e ndërhyrjes rindërtuese, për të cilin bën fjalë mbishkrimi, duhet kuptuar se ka ardhur në këtë rast nga rreziku i shembjes së krejt çatisë së vjetër të xhamisë, të sallës dhe hajatit, si dhe nga frakturat që mund të kenë rezultuar në strukturat e muraturave mbajtëse e harqeve në përgjithësi. Përsa i takon hajatit, një gjë të tillë na u vërtetua nga një sondazh në pjesën e sipërme të portalit (mbi qemerin e portës), ku me zhveshjen nga suvatimi, doli dekorimi plastik i hershëm i tij (fig. 29). Në këtë mënyrë, veç rindërtimit të çatisë dhe meremetimit të strukturave të mureve, në punimet e vitit 1832 – 33, është kryer krejt suvatimi i ndërtesës jashtë e brenda (përfshirë edhe bazamentin e minaresë), duke e mbuluar kështu teknikën e vjetër. Me interes është këtu përpjekja e rindërtuesve për t'iu përmbajtur



Fig. 31. Teqeja e Halvetive dhe mbetjet e konakëve.

aspektit estetik të teknikës origjinale në fasadat e jashtme, duke e imituar atë me anë të efektit që krijohet nga ngjyrosja me shirita të bardhë horizontalë e vertikalë mbi fushën ngjyrë gri të suvasë (fig. 30). Gjithashtu të reja u bënë të gjitha tavanet që paraqesin vlera për një studim më vete. Po ashtu u ribënë dritaret e dyert, zbukurimi me stuko-reliev i mihrabit, tërë dyshemetë me pllaka guri të ndërtesës, pikturimi i sallës, pikturimi dhe elementet dekorative të minberit prej guri, mafili prej druri dhe pikturimi i tij, etj. Për ngjitjen në mafil duket se gjatë rindërtimit është shtuar edhe shkallarja e jashtme prej guri në anën lindore si dhe është hapur porta korresponduese[18]). Pastrimet nxorrën në dukje edhe vaskën e ujit për shërbimin e avdesit pranë hyrjes perëndimore të sallës së ndërtesës.

Si kudo në rajonet ballkanike, për ndërtimin e xhamive të para, modelet e tyre qenë projekte të importuara nga zyrat qëndrore perandorake osmane, pasi përveç të tjerave, kanonet islamike nuk njiheshin nga popullsitë e krishtera. Zbatimi i projekteve të tilla u kushtëzua edhe nga një konditë tjetër themelore. Për sa kohë që shteti perandorak osman qe i fortë dhe në ngjitje, sistemi i tij i centralizuar vepronte me forcë e fanatizëm kudo e në çdo sferë edhe në fushën e artit e të arkitekturës së vendeve përbërëse të Perandorisë. Por, prej gjysmës së parë të shek. XVII, kur shteti osman mori tatëpjetën dhe kur ky nivel imponimi filloi të dobësohet, atëhere traditat lokale të këtyre vendeve, nëpërmjet zyrave të arkitekteve osmanë të qyteteve, e shtuan gjithnjë e më tepër fuqinë e tyre të veprimit, derisa në dy shekujt e ardhshëm vunë dorë rrënjësisht në krijimin e arteve vetjake islamike, gjithnjë brenda sferës osmane. Megjithatë një kufi kohor i prerë për fillimet e dukshme të veprimtarisë së këtyre traditave lokale në këtë sferë nuk mund të vendoset. Por nga ana tjetër nuk mund edhe të pranohet që këto tradita të bënë qëndruar indiferente ndaj dukurive të importuara që u shfaqën nga pushtuesi sado herët në qytetet e tyre. Edhe tek xhamia e Bajazidit II në Berat, që mbetet brenda kufirit kohor të faltoreve të para islamike të ngritura në vendin tonë, vërejmë se tradita vendëse e artit të të ndërtuarit është në rrugën e veprimtarisë në këtë temë të re të krijimtarisë. Midis elementeve të mbetura nga ndërtimi fillestar i saj, bie në sy teknika e ndërtimit të mureve dhe të bazamentit të minaresë me kluasonazh, harqet e portikut, të cilët nuk janë të mprehta (fund-lundre), por gjysmërrethore, numri i madh i dritareve në fasadë, minareja e tipit gjilpërë e ndonjë tjetër. Xhamia Mbret, pra, nga njëra anë tregon se islamizimi i banorëve të qytetit ka nisur në fund të shek. XV dhe nga ana tjetër se mjeshtrit qytetarë e kanë përfshirë edhe këtë temë arkitektonike për ta zhvilluar atë më tej në rrugën e traditave vetjake.

Në kullien e xhamisë Mbret të Beratit, vend kryesor në planin urbanistik zinte edhe teqeja me konakët e saj, e vendosur në anën lindore të kompleksit. Sipas Çelebiut, ajo ishte teqeja e sheh Hasanit, në dy kate dhe e sektit halveti[19]). Ne nuk e kemi pamjen e saj, për shkak se një shekull më vonë, pas vizitës së Çelebiut, ajo u rindërtua nga Kurt Pasha në vitin 1782 me pamjen e sotme (fig. 31). Por nga hetimet në monument mund të nxirren disa të dhëna që i



Fig. 32. Teqeja e Halvetive, planimetria.

PDF OF COPY

takojnë modelit fillestar të teqesë dhe të konakëve të saj.

Sot ndërtesa e teqesë përbëhet nga salla e faljes me planimetri katrore (7,20 x 7,20 m), mjedisi i varrimeve në anën lindore (7,20 x 5,00 m), një ambjent tjetër i vogël (1,50 x 2,40 m) për shërbesa fetare të veçanta, i vendosur në anën veriore dhe hajati i hapur në anën jugore, nga është edhe hyrja për në sallën qendrore (fig. 32). Salla e faljes ngrihet në lartësi mbi tërë ndërtesën, duke lënë nën vete çatinë në formë L-je të dy mjediseve të tjera (fig. 33, 34, 35). Kjo ngritje e volumit qendror, e cila përbën theksin kryesor arkitektonik të ndërtesës, duket se ka qenë kushtëzuar nga dy nevoja funksionale. E para, nga vendosja në brendi e mafilit, i cili ka kërkuar detyrimisht lartësinë për dy kate të sallës, e dyta nga nevoja e ndriçimit të duhur, i siguruar nëpërmjet shtatë dritareve që dalin mbi çatinë në formë L-je në nivel më të ulët. Për ngjitjen në mafil janë ndërtuar një palë shkallë guri në anën veriore të hajatit. Në sallë hyhet nga porta e vetme në skajin VP të saj, mbi të cilin është murosur një mbishkrim (fig. 36). Në nivelin e katit të parë salla ka edhe pesë dritare të tjera, prej të cilave dy nuk japin pothuajse fare dritë, pasi lidhen me mjedisin – tyrbe, ndërsa tri të tjera, në anën e portikut, lejojnë të hyjë një dritë e vakët. Interes paraqet edhe mjedisi – tyrbe. Në të hyhet nga një portë e veçantë në anën lindore. Ndryshe nga kërkesat e zakonshme të tyrbeve, të cilat qëndronin më shpesh si objekte të veçanta për të theksuar vetveten, në teqenë halvetiane të Beratit, varri monumental nuk është një objekt i pavarur e i shkëputur. Këtu mjedisi i parashikuar për këtë funksion, lidhet më ngushtë me konceptin e një mauzoleumi, për t'i shërbyer ndërtesës me funksion më të rëndësishëm. Për më tepër në brendinë e tij nuk është kursyer as ndriçimi i bollshëm, që në tyrbet e mbyllura preferohet të jetë i dobët. Kërkesa për një grafikë të pasur e të ekuilibruar në pamjen e jashtme, nuk i ka sjellë pengesë arkitektit për t'i hapur këtij mjedisi, përveç dritareve me dritë indirekte nga ana e portikut, edhe gjashtë dritare të mëdha në dy nivele, nëpër të cilat depërton direkt drita lindore.



Fig. 33. Teqeja e Halvetive, prerje e sallës në lartësi dhe konfigurc cioni i mbulesave.

Në mënyrë të ndjeshme, dritëhijen, monumentit ia shton gjymtyra më elegante e tij – portiku me arkadë. Ai përbëhet nga pesë harqe gjysmërrethore në ballë dhe nga një në dy anët e tjera. Harqet mbështeten mbi pesë kolona guri një copëshe të holla dhe një tjetër në skajin JL, e trashë prej murature guri. Si në elementet arkitektonike të portikut, ashtu edhe në ato të eksterierit të ndërtesës, spikat proporcioni i goditur dhe kërkesa për realizimin e tyre në gur të gdhendur. Në mënyrë të veçantë tërheq vëmendjen stilistika e punimit të elementeve prej guri të hyrjes së teqesë, kolonave dhe harqeve të por-

17) Proporcionet planimetrike të xhamisë së sotme përkojnë me të dhënat e Çelebiut, gjë që e ndihmon përfundimin tonë.

18) Në përshkrimin e tij Çelebiu numëron vetëm tri porta që të futnin në xhami (**Shqip. para dy shek.** vep.cit, f. 62). Hyrja për në mafil është e katërta, gjë që vërteton hapjen e saj gjatë rindërtimit.

19) **Po aty,** f. 62, 64. Sulltan Bajaziti II, ndryshe nga sulltanët paraardhës, përkrahte sektin halveti. Në kohën e tij, dervishët e këtij sekti u përhapën në të gjitha vendet e perandorisë dhe ushtruan me forcë influencën e tyre ndaj sekteve të tjera islamike (Babinger, **vep.cit.** f. 601, 611, 612, 722).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 34. Teqeja e Halvetive, pamje kryesore (jug).



Fig. 36. Teqeja e Halvetive, porta e sallës.



Fig. 35. Teqeja e Halvetive, pamje nga lindja.



Fig. 37. Teqeja e Halvetive, dritare në katin përdhe.

DO NOT COPY



Fig. 38. Teqeja e Halvetive, pjesë e arkadës së hajatit.



Fig. 39. Teqeja e Halvetive, pjesë e parmakëve.

tikut të kapiteleve e parmakëve, kornizave në dritaret etj. (fig. 37, 38, 39), të cilat përshkohen nga fryma klasike dhe kjo ka arsyen e saj. Pak është folur deri sot, por duhet kujtuar se lëvizjet nacionale në Evropë gjatë shek. XVIII-XIX, reflektuan edhe në zhvillimin e artit e të kulturës një shije të re, që i takon sferës së romantizmit, e cila në veprat e arkitekturës u karakterizua nga imitime të stilistikës klasike. Padyshim që një lëvizje e këtij karakteri ndodhi edhe në Shqipëri, e cila u shpreh në mënyrë më të konkretizuar në kohën e pashallëqeve e më tej me Rilindjen. Rrjedhimet e saj u shfaqën edhe në fushën e arkitekturës, dukuritë e së cilës fillojnë të duken qysh në gjysmën e parë të shek. XVIII. Në mjaft nga monumentet tona të artit e të arkitekturës të këtyre shekujve të fundit, veçanërisht ndër faltoret e krishtera dhe islamike, si dhe në ndërtesa të tjera të rëndësishme qytetare, mund të verifikohen pëlqime stilistike të kësaj shijeje të re, të cilat mund t'i dallojmë si stil neoklasik shqiptar.

Përpjekja për t'iu shmangur një arkitekture që «peshon rëndë», siç ndodh shpesh në teqetë e ndërtuara me mure guri e çati me tjegulla, në rastin e teqesë së Halvetive të Beratit është një arritje e suksesshme. Në sajë të disa gjetjeve të goditura arkitektonike, ndërtesa jo vetëm i është shmangur rrezikut të monotonisë, por ajo paraqet në këtë drejtim, një rast origjinal për gjininë e vet në arkitekturën shqiptare mesjetare dhe ndoshta edhe për atë osmane në përgjithësi. Kështu, për variacion të pikës më delikate të saj, peshës së mbulesës, është gjetur me shumë vend nxjerrja e volumit të sallës (shkëputja) në lartësi, gjë e cila e ka eliminuar monoblokun e çatisë së shtrirë të zakonshme duke krijuar përkundrazi, një siluetë variabël. Përvoja për një zgjidhje të tillë kompozicionale nuk ka munguar në mjedisin e Beratit, i cili e ka karakteristikë dalluese dinamikën e lëvizjes së volumeve në ndërtesat e kultit dhe të banimit. Nga ana tjetër, proporcionet e matura të ngritjes së këtij volumi, kanë bërë që faltorja së jashtmi të duket më e lartë, iluzivisht trikatëshe. Ndërtesa lartësohet më tej nga elemente të tjera. Peshë nga sipërfaqja e mureve të gurta shkëpusin gjithashtu hapësirat e një numri të bollshëm dritaresh. Lehtësim të ndjeshëm sjell portiku me transparencën dhe elegancën e vet. Përveç hedhjes që i jep strukturës së ndërtesës në vertikalitet, portiku i krijon monumentit në çdo kohë të ditës, kontrast me ngjyra të forta grafike. Padyshim që vlerat arkitektonike e artistike të teqesë së Kurt Pashës, siç u mbiquajt mbas punimeve rindërtuese të tij më 1782, meritojnë vëmendje të veçantë, sepse ajo qëndron midis veprave tradicionale, prej të cilave mund të ndiqet e të kuptohet niveli që arriti arkitektura shqiptare e qytetit të Beratit, në shekujt e fundit të mesjetës.

Monumenti sot ka dhjetë mbishkrime, të cilat si ai i xhamisë pranë nuk janë trajtuar në literaturë. Mbishkrimi i parë, i gdhendur mbi një rrasë mermeri, ndodhet mbi portën e hyrjes në sallë (fig. 36). Ai bën fjalë për Kurt Ahmet Pashën si arkitektin e ndërtimit të kësaj faltoreje në vitin 1196 h, të cilit i takon të ketë mbaruar më 16 dhjetor 1782. Sipërfaqja në të cilën është gdhendur titulli i mbishkrimit është e ndarë nga rrasa ku është gdhendur teksti. Ajo është formuar prej copash të vogla e të veçanta dhe ka formën e një gjysmë rrethi. Rrasa e madhe me përmasa 87 x 65 cm, rrethohet prej një kornize mermeri me seksion poligonal. Në pjesën e sipërme korniza mbyllet në formën e një gjysmë rrethi, të mbështetur mbi dy kapitele.



Fig. 40. Teqeja e Halvetive, mbishkrimi mbi portën e sallës (transkriptimi dhe transliterimi).

Teksti i mbishkrimit përbëhet prej tri dyvargjesh. Vargjet janë gdhendur njëri nën tjetrin (fig. 40). Bie në sy ndonjë gabim ortografik, bërë si duket në mënyrë të ndërgjegjshme për nevoja metrike. Përmbajtja e shkurtër e mbishkrimit është kjo: «I zoti i veprave të mira e të dobishme – Kurt Ahmet Pashai – ia lehtësoftë zoti kryerjen e veprave më të mira që i pëlqejnë atij .... (dhe pas katër vargjesh), Kurt Ahmeti, ngriti këtë faltore të dashurisë mistike me arkitekturë të këndshme, ..., ç'kronogram i bukur për teqenë halvetiane! Viti 1196 h.» Emri i vargëzuesit është Ishkiu. Ai ka jetuar në gjysmën e dytë të shek. XVIII dhe emrin e tij e takojmë në shumë mbishkrime të Beratit të kësaj kohe[20]).

Mbishkrimi i dytë ndodhet brenda teqesë, mbi pjesën e sipërme të veshjeve prej druri dhe është realizuar me penel. Nga përmbajtja e tij del se Kurt Pasha nuk është vetëm arkitekti i ndërtesës, por edhe i të gjitha pajisjeve dhe zbukurimeve të brendisë së saj. Ai njëkohësisht na paraqitet si njeri i zgjedhur, me pushtet dhe sundimtar, i cili i ka përballuar këto punime me shpenzimet e tij, pra është dhe ktitori i rindërtimit të teqesë. Sipas këtij mbishkrimi, punimet në brendinë e teqesë kanë përfunduar një vit më vonë nga ato të ndërtesës, në vitin 1197 h (prej 17 dhjetorit 1782, deri më 8 dhjetor 1783).

Mbishkrimi i hartuar në formën e trembëdhjetë distikëve, është shkruar me penel në ngjyrë trëndafili të mbyllur, në një lartësi 1,80 m nga dyshemeja. Vargu i shkathët e i rrjedhshëm është tetë rrokësh i dyzuar. Vargjet e dyta të distikëve rimojnë që të gjitha midis tyre. Teksti është shkruar në fushëza të blerta, me shkronja të karakterit ta'lik. Ai është shkruar bukur, por pa kujdes. Bien në sy gabime të rënda gjuhësore. Përmbajtja e shkurtuar e kronogramit është kjo: «Mbaroi së ndërtuari kjo faltore e shenjtë dhe e stolisur.... Po ta shohë piktori kinez tavanin e saj si Saturni, Do të prishet nga fytyra dhe do të shfaqë në ballë ngjyrën e paaftësisë[21]). A do t'ish çudi nëqoftëse kjo vepër i shton shkëlqimin botës? Kjo vepër, arkitekti i së cilës është sundimtari

20) Emri i vargzuesit nuk del në tekst drejtpërdrejtë. Por duke menduar se emri i vargëzuesit është rregullisht i pamungueshëm në kësi lloj mbishkrimesh, atë mund ta gjejmë edhe këtu me pak mundime. Ai ndodhet në vargun e pestë dhe pikërisht në fjalën عشقی (**ashki,** ose më mirë **ishki**). Autori duhet ta ketë përdorur këtë fjalë me dy kuptime 1) ashki ose ishki – që ka të bëjë me dashurinë mistike, siç e kemi përkthyer dhe 2) Ashki ose më drejtë Ishki – si emër të përveçëm, pra emri i vargëzuesit. Në këtë rast vargu do të përkthehet në këtë mënyrë: «Kurt Ahmeti ngriti, o Ishki, këtë faltore me arkitekturë të këndshme». Vetëm se në këtë rast fjala duhej të ishte shkruar në trajtën e drejtë (Ishkija), gjë që autori nuk e ka bërë sigurisht për arsye metrike (V. Buharaja, doreshkrim).

21) Kuptohet se të gjithë krahasimet e hiperbolizuara të përdorura në tekstet e mbishkrimeve janë krejtësisht ireale dhe pa vlerë, ndonëse ato kanë qenë një dukuri e zakonshme dhe bile e domosdoshme në mesjetë. Midis tyre vlen të sqarohet vetëm se arabët kanë njohur kinezët si piktorë të pakapërcyeshëm **(Po aty).**

DO NOT COPY

i mbretërisë së bujarisë, i pushtetshmi i drejtë dhe i zgjedhur, shenjtori vullnetmadh e hirplotë, Kurt Pasha, i zoti i bujarisë, minierë e besës, Qëllimi i mirë dhe çiltërsia e tij as që mund të bisedohen, atij ia bëri mbarë zoti, Dhe derdhi si ujë florinë dhe zbukuroi këtë ndërtesë ...., Kjo është .... teqe halvetiane, Tyrbja e Mehdi Hasanit dhe varri i atij që mban emrin e Myrtezait[22]), Lëvdatat morën fund, tashti është koha të jepet viti i ndërtimit..., Zihniu e dha të plotë vitin ..., Bujaria e Ahmetit bëri t'i çelet fytyra këtij vendburimi të zotit, viti 1197 h».

Siç shikohet viti i ndërtimit i dhënë në këtë mbishkrim nuk përputhet plotësisht me vitin e mbishkrimit mbi portën e teqesë, që është 1196. Pra ndryshimi është prej një viti. Kjo ka ardhur sigurisht nga që punimet plotësuese në brendinë e teqesë janë kryer pas përfundimit të ndërtesës (viti 1196). Nga ana tjetër nuk është e domosdoshme që ndryshimi midis këtyre dy shifrave të jetë plot dymbëdhjetë muaj. Ai mund të jetë një ndryshim edhe prej disa javësh ose edhe disa ditësh. Viti 1196 i kalendarit arab ka përfunduar më 16 dhjetor 1782 dhe një ditë më vonë, domethënë më 17 dhjetor 1782, ka filluar viti 1197. Kështu mbarimi i punimeve të brendisë së teqesë mund të ketë ndodhur tamam në kohën e kalimit nga viti 1196 në vitin 1197. Autori i mbishkrimit të sallës së teqesë, Zihniu, i cili sigurisht nuk e ka hartuar tekstin po atë ditë që kanë përfunduar punimet, ka preferuar të shënojë datën e përfundimit të mbishkrimit të tij.

Mbishkrimi i tretë ndodhet po brenda sallës së teqesë, në frizin e mafilit dhe mban datën 1197 h (1782-1783). Në këtë mbishkrim Kurti, i biri i Mehmetit, na paraqitet si mirimiram. Ai përmendet përsëri si ndërtuesi i teqesë. Këtu përdoret termi teqeja e re, e cila na le të nënkuptojmë për ekzistencën e teqesë së vjetër përpara saj. Gjithashtu theksohet se Kurt Pasha ndërtoi edhe tyrben me dy varre brenda ndërtesës, nga e cila del se teqeja e vjetër nuk e ka patur këtë mjedis. Mbishkrimi na flet edhe për dy shehlerët e varrosur në tyrbe, sheh Hasanin, vdekur më 1080 h (1669-1670) dhe sheh Aliun, të birin e Fadliut, vdekur në vitin 1099 h (1687-1688).

Ky kronogram, i cili është më i gjatë nga dy të parët dhe që përbëhet nga njëzet distikë, të shkruar në ngjyrë të kuqe mbi fushë të verdhë e me shkronja të dukshme elegante të tipit thuluth sipas grafisë arabe, ndodhet siç thamë në frizin e mafilit dhe i vendosur në formën e gërmës L. Teksti i shkurtuar i mbishkrimit është: «... Pastaj (lutuni) për lartësinë e tij, pashanë e nderuar që quhet Kurt Ahmet..., Ai është nga ata të cilët bota i tregon me gisht, është miri-miran, mir Mehmed-zadi, ..., Pra ai ngriti këtë faltore të bukur...., Ç'teqe madhështore kjo Teqe e re!..., Ngjitur me teqenë ai (Kurti-V.B.) ngriti tyrbenë e shenjtë e të ndritur, brenda së cilës qëndrojnë dy shënjtorë varrbekuar, ..., Në pyetësh për emrat e prijësave që pushojnë këtu...., Dije se njëri është Mehdi Hasani, tjetri Aliu..., Hasani ka kaluar (vdekur-V.B.) në vitin 1080, kurse Aliu ynë më 1099, dije se të dy këta udhëheqës kanë qenë të tarikut të drejtë xhelveti. Sidomos njohësi i thellë i perëndisë... xhelvetiu i dytë, sheh Aliu... biri i Fadliut..., Kur mbaroi ndërtimi i saj, Muhamed Ishkiu tha ... kronogramin, Një faltore e bukur dhe një seli e lartë e urdhërit tonë halveti (dhuruar) nga Ahmeti, viti 1197». Mbishkrimi na sqaron më tej për disa hollësira të tjera rreth historisë së monumentit. Prej tij bëhet e qartë se ndërhyrja e shek. XVIII është një rindërtim i teqesë së vjetër në të njëjtin vënd, rindërtim ky i kryer nga Kurt Ahmet Pasha, si ktitor dhe arkitekt i saj dhe i përfunduar krejtësisht në vitin 1783. Faktin më të sigurtë për egzistencën e teqesë së vjetër mbishkrimi na e jep në një drejtim tjetër. Nëpërmjet tij del në pah prania e dy klerikëve të teqesë, të cilët kishin jetuar më se një shekull më parë nga momenti i rindërtimit të monumentit. I pari prej tyre, sheh Medi Hasani, një asket xhelveti, kishte shërbyer në teqenë në fjalë në mesin e shek. XVII, deri në vitin e vdekjes së tij më 1080 h (1669-1670). Kjo e dhënë përkon edhe me atë të nxjerrë nga shënimet e Çelebiut për Beratin, i cili e identifikon këtë teqe me emrin e sheh Hasan efendiut[23]). Pas tij, sheh Aliu, edhe ky asket xhelveti, vazhdon t'i shërbejë teqesë deri në vitin e vdekjes më 1099 h (1687-1688). Për të kuptohet shkoqur se ka qenë nga Berati dhe se fama e tij në teologjinë xhelvetiane pat arritur deri në Indi. Sidoqoftë, paraqitja e këtyre dy personazheve të teqesë të shek. XVII provon ekzistencën e saj para punimeve të Kurt Pashës.

Por përmbajtja e mbishkrimit lidhur me këto dy figura na çon edhe më tej. Atyre u është dhënë një vend i rëndësishëm në historinë e teqesë, ata vlerësohen si themeluesit e terakatit xhelveti. Sipas mbi-

22) Myrteza sipas kuranit është epitet i emrit Ali. **(Po aty).**

23) Meqenëse në kohën e Çelebiut teqja vazhdon të përmendet me emrin e sheh Hasani, del se ai ishte gjallë në këtë kohë, prandaj për saktësi, si vit të vdekjes së tij duhet pranuar 1670.

DO NOT COPY



Fig. 41. Teqeja Halveti, pamje e çatisë.

shkrimit në qoftë se teqja vazhdonte të predikonte e t'i thurrte lavde këtij tarikati tashmë në fund të shek. XVIII, kjo ndodhte në sajë të punës së madhe të këtyre dy asketëve dhe rridhte që nga koha e tyre. Por duke qenë themeluesit e tarikatit xhelveti, kjo s'duhet kuptuar se ata ishin ndërtuesit e mirëfilltë të teqesë. Përkundrazi, po nga mbishkrimi kuptohet se ata kishin qenë vetëm protagonistët, të cilët e kishin futur teqenë në rrugën e drejtë, domethënë që kishin mundur ta bënin atë të braktiste tarikatin e vjetër (halveti) dhe të përqafonte urdhërin e ri të drejtë fetar xhelveti[24]). Dëshmi direkte për këtë është përsëri Çelebiu. Gjatë vizitës së tij në Berat, e cila përkon me periudhën kur teqeja drejtohej nga sheh Hasani, ajo vazhdonte akoma të njihej si teqe halvetiane. Afirmimi i saj në tarikatin xhelvetian duket se ka ndodhur gjatë kohës që ajo drejtohej nga pasuesi tjetër sheh Aliu. Në këtë drejtim, është kuptimplotë mbivlerësimi që mbishkrimi i bën këtij kleriku, si figura vendimtare në dhënien e orientimit xhelvetian të teqesë. Përfundimisht mund të thuhet se mesi i shek. XVII ka qenë kufiri kohor i ndërrimit të terikatit të teqesë. Kjo dëshmon për ekzistencën më të lashtë si teqe halvetiane, çka përkon me themelimin e ndërtesës si pjesë e kullies së Bajazitit II, vetë ky përkrahës i urdhërit halveti.

Të shtatë mbishkrimet e tjera ndodheshin deri disa kohë më parë në mjedisin-tyrbe të faltores. Ato janë epitafet e shtatë varreve të njerëzve më të dalluar në historinë halvetiane të teqesë. Katër të parat u takojnë varreve të katër asketëve xhelvetij, vdekur përpara rindërtimit të teqesë, të vendosur kronologjikisht: e sheh Medi Hasanit dhe e sheh Aliut, për të cilët folëm më sipër, e sheh Hysenit gjithashtu nga Berati, i vdekur në vitin 1187 h (1773-1774) dhe e të birit të tij, dervish Mesudit, vdekur në të njëjtin vit me të atin, po më 1187 h. Këto varre kanë qenë fillimisht jashtë teqesë. Edhe sipas mbishkrimit të tretë, ato arritën të futeshin në një mjedis të mbyllur vetëm me ndërtimin e teqesë së re. Tërthorazi kjo na bën të ditur se teqeja e vjetër para rindërtimit të Kur Pashës nuk e ka patur mjedis-tyrbe.

Tri mbishkrimet e tjera tregojnë se varrimet janë bërë mbas kohës së rindërtimit të teqesë. Dy prej tyre u takojnë respektivisht varrit të Kurt Pashës[25]), emri i të cilit nuk përmendet direkt mbi mbishkrim, por kuptohet fare qartë nëpërmjet tekstit të tij dhe datës së vdekjes 1201 h (1786-1787): tjetri është i djalit të tij, i cili siç del nga madhësia e varrit, përdorimi

24) Në të gjitha mbishkrimet nuk vlerësohet apo të nderohet asnjë asket i kohës kur teqja kishte qenë halvetiane.

25) Teksti i mbishkrimit është ky: «Thuaj, o zavalli Ishki vitin e kalimit (vdekjes – V.B.) të tij (ai) është i pesti i tyre (Ev kadxhim) viti 1201», që i takon viti 1786-1787. Sipas V. Buharasë, mospërmendja me emër e Kurt Pashës në këtë varr, është bërë nga poeti me mendimin se ai duhej të kuptohej menjëherë nga përmendja e tij si i pesti në radhë. Ndërsa vargu i katërt prej tri rrokjesh pa kuptim është shkruar për të plotësuar shifrimin në ebxhed të vitit 1201 h.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 42. Teqja Halveti, gjurmët në faqen veriore.



Fig. 43. Konakët e teqes Halveti, pas restaurimit.

i fjalëve «miri i pafajshëm» dhe viti i vdekjes 1204 h (1789-1790) duket se ka vdekur aksidentalisht rreth moshës 12 vjeç. Epitafi i fundit është i varrit të sheh Aliut, një tjetër asket xhelveti nga Berati, vdekur më 1208 h (1793-1794), pasardhësit e të cilit e drejtuan teqenë për disa dekada më vonë gjatë shek XIX. Vlen të përmendet se shkruesi i mbishkrimeve të Kurt Pashës dhe të djalit të tij është përsëri Ishkiu.

Si nga analiza e mbishkrimeve të faltores, ashtu edhe nga analiza arkitektonike e objektit, rezultoi se ndërtesa nuk është ngritur tërësisht nga themelet prej valiut të Beratit të shek. XVIII Ahmet Kurt Pashës, porse një pjesë e saj vjen nga një periudhë më e hershme ndërtimore, e ndoshta që nga koha e themelimit të kullies, në fund të shek. XV. Mbështetur edhe në përshkrimin e Çelebiut, teqeja në gjendjen e hershme duket se ka qenë vetëm ndërtesa e sallës së sotme, e ngritur kjo në lartësinë e dy kateve dhe e lidhur në anën lindore me ndërtime të reja, të cilat kanë qenë konakët e saj. Për këtë përfundim dëshmojnë disa gjurmë të jashtme të monumentit, për të cilat po qe se do të pranonim në një çast se ndërtesa është ngritur «ex novo» në vitin 1782, atëhere ato do t'i konsideronim difekte të rënda të ndërtuesve. Por, në fakt, ato vijnë si rrjedhim i transformimit të teqesë së vjetër dhe shtimit të portikut e të mjedisit-tyrbe. Ndaj pretendimeve të larta estetike të rindërtuesve të vitit 1782, dalja e kulmit të çatisë së mjedisit-tyrbe, diku në faqen jugore të saj, nuk mund të besohet për një zgjidhje të goditur, veçse të detyruar (fig. 41). Po ashtu, për ekzistencën e sallës përpara ndërhyrjes së valiut të Beratit, flet mjaft qartë faqja veriore e ndërtesës. Një derë e murosur në krahun e djathtë tregon se më përpara në



Fig. 44. Konakët e Teqes Halveti, pamje ballore.

mafil hyhej nga kjo anë e ndërtesës (fig. 42). Provën më bindëse e jep njëra nga dritaret e mbyllura të kësaj faqeje, e cila në vitin 1782 është murosur e pikturuar nga brenda. Ajo na jep njëkohësisht edhe një ide të përafërt të lartësisë dykatëshe të teqesë së vjetër. Duke vrojtuar se këto dritare ngrihen pak mbi nivelin e dyshemesë së mafilit dhe se teqeja në këtë anë ka qenë e lidhur me mjediset e tjera, rezulton se ato kanë shërbyer për shikimin nga jashtë ndërtesës të ceremonive që zhvilloheshin brenda sallës së faltores. Nga kjo del se lartësia e sallës së vjetër duhet të ketë qenë rreth një metër më e ulët nga niveli i çatisë së sotme të monumentit.

Mbi egzistencën e ndërtimeve të tjera ngjitur në faqen veriore të teqesë së hershme, përfundimi nxirret nga zgjidhja e çrregullt që i është dhënë çatisë së sallës në punimet e Kurt Pashës. Së pari, kjo çati nuk është me katër kullime (megjithëse mbulon një sallë katrore), madje del me kallkan në anën veriore, gjë që nënkupton vazhdimësinë e ndërtesës në këtë anë. Së dyti, kundrejt planimetrisë kuadratike të sallës, kulmi i kallkanit nuk bie në mes të gjatësisë së murit verior, por pëson një spostim të ndjeshëm në krahun e majtë të tij. Për pasojë, pjerrësia e çatisë është plotësisht bindëse për lidhjen direkte të çatisë së teqesë me mbulesat e mjediseve të tjera pranë. Këto mjedise duhet të kenë qenë konakët e teqesë së vjetër, për të cilat Çelebiu pohon se ka parë 40 dhoma të vogla pranë saj në kohën e tij. Duket se ato zhvilloheshin pandërprerje në anën veriore dhe lindore, duke krijuar një oborr në mes. Nga studimi i tyre i bërë me rastin e punimeve të restaurimit në vitet 1978-1979, rezultoi se në pjesët e mbetura të konakëve ruhej konstruksioni origjinal (fig. 43, 44, 45). Dhomat janë ngritur mbi strukturat me qemerë të një galerie gjysmë nëntokësore, e cila mblidhte dhe kanalizonte ujërat që vinin nga lartësitë e kodrave në veri[26]). Dhomat e konakëve i kanë hyrjet me shikim nga oborri i teqesë. Ato lidhen nëpërmjet një hajati me portik prej kolonash druri, të cilat mbështeten mbi kolona guri, që vinë nga kati përdhes. Secila dhomë është pajisur me nga një oxhak e dollap muri, e me sergjenë në të gjitha faqet (fig. 46). E gjithë kjo ndërtesë e gjatë, mbulohej nga një çati dy ujëse me tjegulla, e cila i përfshinte të gjitha dhomat. Gjatë kohës së rindërtimit të teqesë, më 1782, duket se një pjesë e tyre, pikërisht ato ngjitur me të në anën lindore, u prishën dhe në vend të tyre



Fig. 45. Konakët e Teqes Halveti, prerje tërthore.

26) Në grykën ujëmbledhëse lartësia e qemerit të galerisë arrin deri 9 m. Ndërsa përgjatë rrjedhjes së tij drejt lumit, posa fillon terreni i sheshtë, galeria merr formën e një kanali të rregullt me seksion të qemerit 3 m. gjërësi dhe 3 m lartësi. Ai ruan këto përmasa edhe pas rënies në nivel që bën me mbarimin e konakëve. Pikërisht struktura e kësaj galerie është shfrytëzuar për vendosjen mbi të, të dhomave të konakëve.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 46. Gdhendje druri në parmakët e konakëve.

është ngritur biblioteka e Kurt Pashës, e cila u grabit dhe u dogj në vitin 1914. Pikërisht nga kjo kohë, për hyrjen në mafil është hequr dorë nga dera në faqen lindore dhe shkallët e vjetra, pasi me prishjen e mjediseve në këtë anë mbas djegjes së tyre, ky komunikim u bë i përshtatshëm. Kësaj periudhe të tretë ndërtimit të monumentit i takon edhe çelja e derës së mafilit në krahun e hajatit të teqesë së bashku me shkallët e gurta që të ngjisin në të, realizuar në formën e një adaptimi. Bindja për këtë të krijohet po të vërehet shkelja e parë e shkollës, të cilës ja kufizon hapësirën lëvizëse kolona JP e portikut. Nga ana tjetër vetë shkallët janë shumë të ngushta, sepse i detyrohen prezencës së portës së hyrjes për në sallën e faltores. Gjithashtu, prej këtyre kufizimeve shkallët detyrohen të tejkalojnë pjerrësinë normale e të ndjehen të sforcuar në ngjitje. Ky adaptim ka sjellë së fundi edhe rritjen e lartësisë së tavanit të portikut në këtë pjesë, për të bërë të mundur kalimin normal të njerëzve për në mafil (fig. 47, 48, 49).

Në përfundim mund të themi se kullia e Bajazitit e ndërtuar në fund të shek. XV shënon nismën e procesit të islamizimit të banorëve të Beligradit shqiptar dhe njëkohësisht përbën qendrën e parë islamike në urbanistikën e qytetit të Beratit.

*

Shekulli XVI është padyshim edhe periudha e islamizimit në masë të banorëve të qytetit. Në fund të këtij shekulli raporti midis banorëve muhamedanë ndaj atyre të krishterë anoi për të parët. Krahas këtij procesi, numri i popullsisë së qytetit shënon në këtë kohë rritje të ndjeshme në krahasim me atë që ishte në fund të shek. XV dhe Berati radhitet midis qyteteve më të mëdha të Shqipërisë. Nëqoftëse kullia e xhamisë Mbret shënoi fillimin e një tizionomie të re



Fig. 47. Teqeja e Halvetive Mihrabi.



Fig. 48. Teqeja e Halvetive, Mafili.



Fig. 49. Teqeja e Halvetive, Tavani

urbanistike për varoshin e qytetit, përgjatë shek. XVI, veprat e artit e të arkitekturës së sferës islamike nisën ta pasurojnë siluetën e tij. Objekte të tilla si xhamitë, mesxhide, teqetë, medresetë, shkollat për fillestarë, banjo (hamamet), varret monumentale (tyrbet), menca për të vobektët (imaretet), etj. zunë të ngriheshin fillimisht në pikat kryesore të varoshit, e më pas duke prekur lagjet e tjera të qytetit.

Është për t'u shënuar se këto vepra qysh në fillim nuk u ngritën pa pretendime artistike. Berati i shek. XVI sillte nga shekujt e kaluar lulëzimin e njohur të artit e të arkitekturës shqiptare të sferës bizantine. Porositësit e objekteve islamike, të cilëve u duhej padyshim të konkuronin dukuritë social-kulturore të mëparëshme, duket se kanë patur në Berat një angazhim të veçantë. Kullia e xhamisë Mbret është një rast i qartë. Në gjysmën e parë të shek. XVI, megjithëse dimë se janë kryer ndërtime në pazarin e vjetër të qytetit së bashku me një mesxhid, në lagjen Vakëf një xhami dhe një mesxhide në kohën e sulltan Sulejmanit (1521-1561) dhe ndonjë mesxhide tjetër në mjediset ende të pakëta në këtë kohë me popullsi myslimane, të dhënat mbi pamjen arkitektonike, stilin e teknikën e tyre, mungojnë. Por kemi në mes të shekullit, një monument me vlera të gjera njohëse jo vetëm për historinë e zhvillimit të qytetit të Beratit, por edhe për atë të arkitekturës shqiptare mesjetare në përgjithësi – kullien e Skurajve (Isgurlinjve), e quajtur ndryshe e «Plumbit», për shkak të mbulesave prej plumbi të objekteve përbërëse të saj (fig. 50). E ndërtuar në vitin 961 h (1553-1554)[27]), ajo përbëhej nga xhamia në qendër të kompleksit (fig. 51, 52) dhe e shoqëruar përreth prej teqesë, medresesë, shkollës për fëmijë, banjës publike dhe disa ndërtimeve të tjera plotësuese, si imareti, furra, menca, etj., të gjitha këto të mbuluara me fletë plumbi[28]). Nëpërmjet këtij kompleksi monumental, feudalët vendas Skura aspiruan me ambicje t'i jepnin qytetit të tyre, një vepër të paarritur deri atëhere, qëllim të cilit ia arritën.

Nga objektet e kullies së dikurshme sot ruhet vetëm xhamia dhe pak mbetje të banjos publike. Me

27) V. Buharaja, **Mbishkrimet turko-arabe të vendit tonë si dëshmi historike,** Konferenca II e Studimeve Albanologjike, Tiranë 1968, II, ff. 81-85. Gjatë punimeve të restaurimit të kryera në monumentet në vitin 1978-79, nën drejtimin e S. Dashit, të publikuara në revistën «Monumentet» nr. 15-16, 1978, **Një xhami e vjetër në Berat,** f. 101-108, mbi portën e hyrjes së sallës së xhamisë u gjend vëndi i mbishkrimit të themelimit të saj i mbyllur me suva në kohën e rikonstruksionit në gjysmën e dytë të shek. XIX. Mbishkrimi mungonte. Por sipas një dëshmije të vitit 1853-54, një mexhmuaje (përmbledhje vjershash, aforizmash) të mbledhur e të kopjuar nga teologu beratas Sali Bisha, mbishkrimi është kopjuar prej tij. Kronogrami përbëhet prej tre distiqesh njëmbëdhjetë rrokësh, të shkruar me shkronja ta'lik. Teksti i tij është: «Këtë xhami e ndërtoi Gazi Izgurliu. E vërteta është se kjo xhami plot dritë i dha qytetit një shkëlqim si dita, viti 961». Data e kronogramit del nga llogaritja ebxhed të vargut të fundit, që i takon vitit 1553-1554. Ky kronogram është më i vjetri në gjuhën osmanishte që njihet deri sot në qytetin e Beratit (V. Buharaja).

28) **Shqip. para dy shek.,** vep.cit., f. 62, 64, 67.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 50. Xhamia e Plumbit. Pas restaurimit.



Fig. 51. Xhamia e Plumbit. Vendi i mbishkrimit.



Fig. 52. Xhamia e Plumbit. Mbishkrimi i datës së ndërtimit (transkriptimi dhe transliterimi).

pamjen e sotme xhamia e Plumbit vjen me një rikonstruksion të kryer pas vitit 1854, i cili e ka tjetërsuar vetëm hajatin e saj. Volumin kryesor të ndërtesës e zë salla e faltores që ndriçohet në tri anë me nga pesë dritare të vendosura në tri nivele. Sallën e mbulon kupola sferike, e cila duke rënduar mbi një tambur të ulët tetëfaqësh shkarkon në katër trompat e qosheve. Ballin e xhamisë e zë hajati dhe në të djathtë të ndërtesës lartësohet minareja e tipit gjilpërë (fig. 53), për të cilën Çelebiu duke e cilësuar të bukur, vë në dukje se ajo «ka shembull vetëm minaren e Melik Gaziut në qytetin Niksar të Sivasit[29]). Si muret e sallës, ashtu edhe bazamenti i minaresë janë realizuar me teknikën e qargjirit, nëpërmjet një plastike të rreptë gjeometrike, gjë që e dallon dukshëm ndërtimin e tyre të hershëm ndaj haja-

29) Po aty, f. 62.

tit. Në pamjen që mori pas rikonstruksionit të shekullit të kaluar, hajati paraqitet i mbyllur dhe i mbuluar me katër kupola, dy të mëdha në anët me formë eliptike në plan dhe dy të vogla në aksin qendror në formë gjysmësfere. Për mbajtjen e tyre shërbejnë pesë harqe dhe dy kolona guri në mes të hapësirës së hajatit. Ai ndriçohet prej gjashtë dritareve, dy në faqen jugore dhe katër në atë perëndimore.



Fig. 53. Xhamia e Plumbit, Minareja.

Mbi pamjen origjinare të hajatit na ndihmon pikësëpari përshkrimi i Çelebiut, sipas të cilit ai ka qenë «mbuluar me shtatë kupola të veshura me plumb dhe të mbështetura mbi kolona të bardha të shkëlqyeshme mermeri[30]). Pak të dhëna rreth kësaj pamjeje mund të vilen drejtpërdrejtë nga monumenti pa kryer sondazhe. Ai duhet të ketë qenë më i gjatë në drejtimin ballor, duke i shtuar hapin e një kupole të vogël, me hapësirë sa ajo midis dy kolonave egzistuese. Ndërsa faqet anësore të hajatit shtriheshin në vazhdim të mureve të sallës dhe jo siç dalin sot jashtë volumit të saj. Dyshemeja e hajatit ndahet në dy pjesë, nëpërmjet kalimit me kuotë më të ulët të një korridori drejt hyrjes për në sallë, i cili ruante përmasat origjinare. Hapësirës së tij i korrespondon sot ajo e dy kupolave të vogla. Mbi këto të dhëna jemi përpjekur të rikompozojmë pamjen fillestare të portikut të hapur me shtatë kupola të xhamisë (fig. 54)[31]).

Kullia e Skurajve e ngritur në mes të shek. XVI, shënoi dy dukuri të rëndësishme. Në planin urbanistik ajo përcaktoi një qendër të re për varoshin e Beratit, e cila me kohë u kthye edhe epiqendra e qytetit modern. Në planin artistik ajo shkoi më tej se kompleksi i Bajazitit II. Ndërsa tek xhamia Mbret, vetëm disa prej elementeve të saj, si minareja dhe arkada e portikut, qenë trajtuar sipas kërkesave të arkitekturës klasike osmane, tek ajo e Skurajve, fryma klasike i përshkoi tërë gjymtyrët e ndërtesës. Nga kjo pikëpamje xhamia e Plumbit, e tipit «sallë me kupolë dhe portik të hapur përpara hyrjes», e cila vjen në Berat pas ndërtimit të xhamisë së Fatihut në Prishtinë (1461), të Iljaz Mirahorit në Korçë (1492), të Isakut në Manastir (1509), të xhamisë së Muradies në Vlorë (1536-1538) dhe për mendimin tonë bashkëkohëse me xhaminë e Gjin Aleksit në Rusanj të Delvinës dhe asaj të Allajbegisë në Burim të Dibrës (gjysma e parë e shek. XVI), është një shembull tjetër tipik që konfirmon përfundimin se, tipologjia e xhamisë klasike osmane kultivohet në viset tona paralelisht me qëndrën e perandorisë.

30) Po aty.

31) Mundësitë e vendosjes së shtatë kupolave në një radhë të vetme në ballin e xhamisë, e përjashton mungesa e gjurmëve të strukturave mbajtëse në murin perëndimor të sallës. Në këtë mur ka gjurmë të mbështetjes vetëm për tri kupola, një të vogël në mes, me hapësirë sa korridori dhe dy më të mëdha anash saj. Në bazë të këtyre gjurmëve, zgjidhja që kemi dhënë paraqet mundësinë e vetme të formulimit të shtatë kupolave. Pamja e sotme të kujton këtë kombinim midis kupolave të mëdha e të vogla. Por për arsye të shkurtimit të gjatësisë së hajatit në përmasën e një kupole të vogël, rikonstruksioni ka kërkuar zgjerimin e tij. Kjo është arsyea që dy kupolat e mëdha anësore nuk kanë formë rrethore, por kanë marrë formë eliptike në plan.

DO NOT COPY

Krijimi i këtyre dy qëndrave të reja e të mëdha në varoshin e qytetit përcakton, për mendimin tonë, kufirin kohor kur Berati shfaq në fizionominë e vet tiparet islamike. Ato dëshmojnë se në mes të shek. XVI, kur ndoshta banorët e besimit të krishterë përbënin ende pjesën dërrmuese të popullsisë, në qytetin e Beratit ishte krijuar bërthama qytetare e civilizimit islamik. Mbi këtë bazë islamizimi i mëtejshëm i popullsisë së qytetit mori ritme të përshpejtuara në dekadat e ardhshme. Kështu mund të shpjegohen statistikat e fundit të shek. XVI, kur Berati, qyteti më i madh i viseve shqiptare[32]), nga të 1094 shtëpitë e tij, 650 prej tyre qenë kthyer në besimin muhamedan[33]). Kjo dukuri u favorizua si nga shtimi i ritmeve të zhvillimit të ekonomisë gjatë këtij shekulli, ashtu edhe nga reformat e vazhdueshme perandorake, veçanërisht nga ato të kryera në kohën e sulltan Sulejmanit (1521-1561).

Tendenca gjithnjë në rritje e këtyre faktorëve solli për rrjedhojë, në gjysmën e dytë të shek. XVI dhe në gjysmën e parë të shek. XVII, shtimin me ritme më intensive edhe të ndërtesave shoqërore e kulturore islamike. Ato padyshim prunë ndryshime në hapësirën urbane të qytetit dhe ndikuan në zhvillimin e ardhshëm urbanistik të tij. Pikërisht krijimi i këtyre dy qendrave qe nisma e këtij zhvillimi të ri. Ato dëshmojnë, nga kjo pikëpamje, se Berati doli nga nocioni i qytetit-kështjellë dhe hyri në këtë kohë, në rrugën e një qendre prodhuese zejtare e tregtare. Muret rrethuese nuk përbënin më kufijtë e hapësirës urbane të tij, por qyteti zbriti nga kalaja dhe u vendos në pjesën fushore të luginës së Osumit. Kalaja mbeti tashmë një nga lagjet e tij, që vazhdonte të banohej nga banorë të krishterë.

Dy qendrat e reja, përreth të cilave u rreshtua gjithnjë e më tepër popullsia muhamedane, u bënë edhe zemra e qytetit të ardhshëm. Nën presionin e saj, ajo pjesë e popullsisë së krishterë që ndodhej në varosh, u detyrua të spostohej gjithnjë e më tepër, larg qendrës së re. Prej mesit të shek. XVI e ka zanafillën lagjja Goricë në krahun tjetër të lumit Osum, e cila mbeti si kalaja, një lagje periferike e qytetit, e banuar nga të krishterë. Ato mbetën të tilla edhe më vonë, kur qyteti u zgjerua më tej me banorë myslimanë, të cilët preferuan gjithnjë pjesën e ulët të luginës, duke u përhapur qysh në fillim të shek. XVII në anën perëndimore dhe lindore, me lagjet Murat Çelepie dhe të Skurajve.

Në përfundim, duke u mbështetur në të dhënat e fituara nga gjurmimet e derisotme, mund të themi se periudhën prej fundit të shek. XIV e deri në mesin e shek. XVI, e shohim për qytetin e Beratit si kohën e fillimeve të artit e të arkitekturës islamike. Prej kësaj kohe e më tej mund të flasim për krijimtari aktive beratase-islamike në fushën e artit, arkitekturës dhe urbanistikës.



Fig. 54. Xhamia e Plumbit, Planimetria dhe rikonstruksioni i saj hipotetik.

DO NOT COPY

32) **Historia e Shqipërisë,** vëll. I, Tiranë 1959, ff. 343-348.
33) S. Pulaha, **Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI,** Tiranë, 1984, f. 651.

Gjergj FRASHËRI
Sulejman DASHI

DO NOT COPY

LES DEBUTS DE L'ART ISLAMIQUE DANS LA VILLE DE BERAT

Les résultats de nos recherches nous indiquent que la plus ancienne oeuvre islamique de Berat est la mosquée en état de ruine situé près de l'acropole de la forteresse nommée par la tradition orale «la mosquée Rouge». La salle rectangulaire de la construction (8,25 m x 7,50) a été surmontée d'un toit en bois et en tuiles. On y distingue deux phases de construction. Au début le plancher était pavé de briques, pareilles à celles utilisées au croisonnage du soubassement du minaret. A une deuxième période, les murs de la salle furent refaits en pierres alors que le plancher fut pavé de dalles. A cette époque la mosquée était dôtée d'un portique avec la forme de «L» majuscule qui d'un côté précède l'entrée de la salle, de l'autre son parois à droite où l'on s'est servi du mur de la forteresse pour appuyer les poutres du plancher et du toit du portique. Cette mosquée représente quelques particularités telles la disposition du minaret à la gauche de l'entrée, un cas particulier dans la typologie des mosquées en Albanie, ainsi que l'aménagement d'un minaret cylindrique. Nous sommes toujours de l'avis qu'elle fut construite à la fin du XIVe sc, à l'époque de sultan Bayazed Ier.

Un autre fait lié à la période ottomane, peu exploré jusqu'à heure actuelle, est la transformation du nom de la ville de Beligrad en Berat. On sait que la ville de Berat prise depuis 1417 par les ottomans, demeura telle quelle même à l'époque de sultan Mourad II et Mehmet II différemment à beaucoup d'autres villes albanaises qui furent prises plus tard comme Kruja et Drishti en 1478, Shkodra en 1479, Durrësi en 1501. Cela peut s'expliquer par l'importance stratégique et économique que cette ville représentait pour la réalisation des visées futures de la Porte Sublime en Occident. Ici vient en considération l'acte officiel inscrit par Mehmet II sous la forme d'un «berat» selon lequel on accordait pour toujours aux citadins de Berat la liberté du rite, des coutumes et des privilèges particuliers et les chargeait de défendre la ville de Vlora en cas de danger. Il paraît que cet important acte officiel rangea la ville de Berat au rang des villes «belli» de l'Empire. De même, il la différencia des autres centres urbains du pays en l'appelant «Beligrad avec berat» ou «la ville avec berat» dans le sens de la ville privilégiée qui plus tard devint le synonyme du nom de la ville et fut affirmée au cours du XIXe sc.

Une autre mosquée celle de Fatih, appelée par la tradition orale «la mosquée blanche» située à l'intérieur des murs de l'acropole de la forteresse, témoigne la présence du garnison ottoman à Berat, à l'époque de Mehmet II. Cette mosquée, dont on ne possède que les ruines, s'élèvait au-dessus d'une salle et d'un canal souterrain surmontés de voûtes de pierre. Elle est formée de la salle (9,42 m x 7,60 m), et du portique qui précède l'entrée (5,76 m x 8,65 m). La construction a été couverte d'un toit en bois et en tuiles tandis que le portique à colonnades de pierre etait ouvert. Les murs sont faits de pierres calcaires blanches en rangées régulières. Les fouilles mirent au jour les traces du mafil à l'ouest de la salle et celles du minbar à l'est, tous les deux en bois. La typologie, l'appareil des murs et le minaret à faces ne ressemblent plus à ceux de la mosquée Kouge, inspirations des anciens modèles de la mosquée d'Anatolie, mais se penchent vers les traits de l'architecture ottomane depuis l'epoque de Mehmet II. L'engagement de la Porte Sublime pour avoir à Beligrad de l'Albanie, un point fort d'appui, apparut plus tard, à l'époque de Bayazed II (1481-1512). A cette époque-là Berat, comme quelques autres villes des contrées albanaises, reflèta les premières apparences orientales à la physionomie urbanistique de la ville. A part les deux mosquées construites à l'acropole qui servaient au garnison militaire ottoman, la forteresse ne connut pas d'autres constructions islamiques. C'est varosh qui devint le centre des constructions islamiques. A l'époque de Bayazad I fut construit le premier centre islamique de Beligrad albanais qui comprenait la mosquée Mbret, le «tékké» du secte halveti, l'imaret, le médréssé, l'école primaire et quelques autres accessoires, qui entouraient la mosquée.

L'inscription qui se trouve à la frise du mafil, traduit par V. Buharaj nous renseigne que la mosquée en 1248 de l'hégire a subi une profonde reconstruction. Tchelebi nous donne une plus ancienne description sans nous laisser la date de sa construction. Rey la remonte en 1492. C'est une datation qu'il faut prendre en considération puisque en 1482 Bayazeed II vint en Albanie. La mosquée comprend la salle des prières (12,1 m x 15,4 m), le minaret à la droite de l'entrée et le portique (18,6 m x 9,9 m) qui s'élargit des deux côtés dépassant les murs de la salle. La couverture en toit de bois du grand espace de la salle a conditionnée l'établissement d'une arcade à trois arcs disposée de biais au milieu de la salle appuyée sur deux colonnes et deux pilastres rondes en pierre. En outre, le mafil en bois s'appuie sur deux colonnes et deux pilastres en bois disposés symétriquement aux premiers. A la salle correspondent deux plafonds séparés d'une arcade triple. Ils présen-

DO NOT COPY

Nr. 1 1988

monumentet

DO NOT COPY

YLLI DRISHTI

PIKTURA MURORE NË KISHËN E SHËN VENERANDËS–PLLANË

Kisha e Shën Venerandës, që ndodhet në lindje të fshatit Pilanë (Lezhë), ngrihet në lartësinë e kodrës mes një gjelbërimi të dendur. Oborri i saj rrethohet me mur guri, jo shumë të lartë. Ajo është një kishë e madhe njënefshe (9,2 x 7 x x 5 m) dhe përbëhet prej naosit dhe narteksit (foto 1). Monumenti është një ndërtim i shek. XIV[1]). Në anën e jashtme kisha është trajtuar thjesht, me gurë të papunuar gëlqerorë dhe shtufi, të lidhur me llaç gëlqereje dhe me rërë të ashpër. Narteksi është i hapur, e rrethuar me arkada mbi pilastra, me prerje katrore, me muraturë me tulla të kuqe. Ai mbulohet me tavan me trarë të skuadruar, mbi të cilët mbështetet dyshemeja e mafilit. Dera kryesore e monumentit ndodhet në faqen perëndimore të kishës. Një derë tjetër, në pjesën qendrore të faqes veriore të naosit, komunikonte me mjediset ndihmëse, tashmë të rrënuara.

Naosi[2]) në faqen lindore ka një apsidë rrethore të madhe e të lartë, si dhe dy nike të vogla anash.[3]). Ai ndriçohet prej 7 dritaresh (0,80 x 0,55 m), prej të cilave 6 janë me hark. Pesë gjenden në murin jugor dhe një në atë verior. Dritarja e murit perëndimor është rrethore. Naosi mbulohet me tavan druri, i cili vazhdon pa ndërprerje edhe në pjesën e mafilit.

Kisha e Shën Venerandës ruan pikturë murore në faqen perëndimore të naosit dhe në atë lindore të narteksit.

Kisha përmendet në dokumentacionin historik të shek. XVII, kur kalon nën vartësinë e peshkopatës së Lezhës, Krujës apo Durrësit. Marin Bici, kryepeshkop i Tivarit, në vitin 1610, e quante kisha e mirë për



Foto 1 Kisha e Shën Venerandës Pllanë (pamje e jashtme)

1) A. Meksi, «**Kishat mesjetare në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut,** «Monumentet 2/1983, f. 70.

2) Naosi ka një shtrirje gjatësore 14 m dhe gjerësi 7 m.

3) Apsida është e gjerë 2,30 m, niket anash janë në lartësinë 3,20 m dhe kanë këto përmasa: 0,80 m lartësi, 0,55 m gjerësi. Guri i altarit është i takuar me apsidën. Ai ka lartësinë 1,05 m, gjatësi 2 m dhe gjerësi 0,75 m. (shih planimetrinë 1).



Skica 1. Planimetria (Kisha e Shën Venerandës – Pllanë – Lezhë)

500 veta e Shën Barbarës, me një hajat të bukur përpara[4]). Në vitin 1624, Benedikt Orsini, peshkop i Lezhës, e cilëson atë: «si më e mira kishë e Shqipërisë»[5]). Së fundi, këtë kishë e shohim të numërohet ndër kishat e Lezhës nga Mark Skura, peshkop i Arbërit, në vitin 40 të po këtij shekulli[6]).

Piktura në naos. Piktura ruhet në anën e djathtë të hyrjes perëndimore, ajo ka gjerësi 1,8 m dhe lartësi 1,95 m, duke filluar në lartësinë 0,45 m nga dyshemeja.[7]) Piktura është realizuar me teknikën e afreskut, në një suport jo shumë të trashë,[8]) ngjyra është e lidhur mjaft mirë me intonakon.

Skena pranë murit jugor na paraqet Shën Jakovin dhe Shën Venerandën. Këto figura rrethohen dhe ndahen nga njëra-tjetra prej një shiriti ngjyrë okër të çelët (8 cm gjerësi), kornizuar me linjë kafe. Megjithëkëtë, ato komunikojnë njëra me tjetrën duke krijuar një grup dyfigurësh. Figura e Shën Jakovit paraqitet me trupin përballë, me pelerinën që zbret deri në tokë. Kokën e ka të kthyer (në gjysmë profil) në drejtim të figurës pranë. Mbi veshjen kafe në okër, ai mban një pelerinë të bardhë, e cila pothuaj mbulon këmbët e figurës.

Shën Veneranda paraqitet veshur me të bardha dhe mbuluar me pelerinë të kuqe me pala të mëdha. Ajo qëndron përballë me shikimin drejt. Në dorën e djathtë të shtrië mban një degë ulliri, kurse me dorën tjetër para gjoksit mban një rrotë të dhëmbëzuar me një dorezë të madhe që del jashtë kornizës. Portretet e të dy figurave janë të rrethuara nga aureola të bardha, të vogla dhe të çrregullta. Mbi flokët e Shën Venerandës, kurora, është pikturuar me linjë të errët e pa elegancë. Anash figurave janë shkrime në gjuhën latine me emrat e tyre. Të dy figurat janë realizuar në pjesën e sipërme mbi një sfond blu të errët, i cili sot është degraduar, më poshtë sfondi është ngjyrë rozë, (shih skicën nr. 3).

Stilistikisht trajtimi i figurave mendojmë se është i veçantë. Kjo vihet re menjëherë, sidomos në koloritin me dritë që përdor piktori. Ngjyrat janë të kursyera, megjithatë ato janë në harmoni me njëra-tjetrën. Kryesoret janë: e kuqja, e bardha, roza dhe bluja. Veshjet e figurave trajtohet me pala të gjera, që derdhen natyrshëm, pikturuar me një hije dritë të ëmbël që duken si të marra nga natyra. Veshjet janë punuar me tone e gjysmë tone, me kalime graduale e delikate, duke i dhënë figurave volum dhe monumentalitet: Ajo që të tërheq tek këto figura është pikturimi i përgjithshëm i tyre, për të cilat piktori është kujdesur më shumë, ndërsa detajet lenë për të dëshiruar. Nëse në trajtimin e portreteve është punuar me dashuri dhe kujdes për të

4) I. Zamputi, **«Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, në shek. XVII»**, Tiranë 1963, dok. 2/98.
5) **Po aty,** dok. 2/131.
6) **Po aty,** dok. 2/361, dok 3/401.
7) Ky brez i pjesës së poshtme është pikturuar me ornamente gjeometrike, vija zig-zake të kuqe e të zeza të vendosura në sfond gri.
8) Shtresa e parë 0,8 cm dhe intonakoja 0,15 – 0,2 cm dhe përbëhen prej gëlqereje, rërë, pluhur guri.

DO NOT COPY

dhënë formën, duke përdorur ngjyrën rozë, me tone e gjysmë tone, në pikturimin e detajeve është punuar pa kujdesin e duhur. Trajtimi pa finesë e me linjë të errët i vetullave, syve, mjekrës apo edhe i duarve të figurave ia ul vlerat artistike pikturës dhe të bind për një përzierje stilesh pikturimi.

Trajtimi koloristik me dritë dhe ai stilistik të bindin se piktura e naosit është një përzierje e pikturës protorenesanse italiane dhe asaj bizantine. Elementet stilistike të pikturës bizantine këtu janë minimale në krahasim me tonin që iu jep kësaj pikture fryma e përgjithshme e stilit perëndimor, gjë e cila vërehet me kontaktin e parë. Linjat e errëta në vizatimin e syve, vetullave, duarve, degës së ullirit, sfondi blu i errët, aureola e bardhë[9]), kurora dhe qëndrimi monumental e statik tek figurat e Shën Venerandës janë elementet të artit bizantin.

Penelata e gjerë, delikatesa në trajtimin e volumit, ngrohtësia jetësore në trajtimin e portreteve, krehja e flokëve, shkrimet pranë portreteve, drita e përgjithshme që përshkon të dy figurat flasin për një piktor, i cili ka rënë në kontakt me artin perëndimor, por që akoma nuk është shkëputur nga ndikimet e artit bizantin. Analizat kimike të suportit mbajtës tregojnë se dhe në përgatitjen teknologjike të llaçit është përdorur përbërja e pikturës murore italiane (tabelat grafike).

Duke u munduar të japim mendimin tonë mbi datimin e kësaj pikture, mendojmë se ajo është e njëkohshme me ndërtimin e kishës, është realizuar në periudhën para pushtimit turk dhe lidhet me shumë krijime, por pa arritur vlerat artistike të pikturave murore të kishave të Rubikut, Apollonisë, Maligradit, Beratit etj.

Duke e krahasuar nga ana stilistike me pikturat murore të njëkohshme, vemë re vendin e veçantë, që zë piktura e naosit. E këtij mendimi është edhe Dhorka Dhamo sipas së cilës: «Është interesante të theksohet se piktura në të gjitha kishat e stilit romanik ka qenë bizantine. . . . përjashtim përbën grupi i shenjtorëve të paraqitur në këmbë një e nga një, përbrenda harqeve me majë të kishës së



FAQJA LINDORE E NARTEKSIT

Skica 2 Faqja perëndimore e naosit

Zejmenit (Pllanë), të realizuar në frymën e pikturave protorenesanse dhe që përbëjnë një fenomen më vete.[10])

Këto ndikime i ndiejmë më të forta në arkitekturë në mjaft kisha të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, si p.sh. kisha e Shën e Premtes në Çetë të Kavajës, kisha e Shën Ndout Rubik, katedralja e madhe e Sergut dhe Bakut në Shkodër, kisha e Vaut të Dejës.

Piktura e narteksit

Piktura murore e narteksit ndodhet në të dy anët e hyrjes së faqes perëndimore. Ajo është realizuar në lartësinë 1 m nga dyshemeja. Në të dy anët e shkallëve të hyrjes janë vendosur dy varre, ndërtuar me pllaka guri. Në të djathtë, skena me gjerësi 1,17 m, e lartë 2,60 m, paraqet Shën Mëhillin, ndërsa në të majtë skena me gjerësi 1,66 m dhe lartësi 2,60 m paraqet Shën Gjergjin. Piktura

9) Aureolat në artin bizantin janë mjaft të mëdha, rrethore dhe me ngjyrë okër të artë, të kuqe, blu, lejla.

10) Dh. Dhamo, **«Piktura murale e mesjetës në Shqipëri»** f. 13. Tiranë 1974, **«Tradita, Onufri e pasuesit e tij,** Disertacion, 1987, f. 86.

DO NOT COPY

me ngjyrë të kuqërremtë. Pjesa e kraharorit është mbuluar me një parzmore, të pikturuar me ngjyrë kafe, të vizatuar me linjë më të errët, ndërsa në pjesën e poshtme të këmbëve, pulpat, pikturohen me dritë-hije e me finesë. Pjesa e këmbëve veshur me çorape ngjyrë okër është konturuar me linjë jeshile, duke vizatuar edhe gishtat e këmbëve. Skena rrethohet me shirit të kuq e të zi (i gjerë 1 cm). Nën këmbët e Shën Mëhillit është shtrirë një figurë pothuaj e zhveshur, e pikturuar pa mjeshtëri që, duke e krahasuar me vlerat artistike të figurës së Shën Mëhillit, të çudit me mospërfilljen e piktorit për të. I njëjti qëndrim mbahet edhe në pikturimin e figurave të tjera, në skenën e Shën Gjergjit, ku e gjithë vëmendja është përqendruar në figurën e tij.

Piktura e narteksit ka mbuluar një pikturë më të hershme, fragmentet e së cilës ruhen poshtë skenës së Shën Mëhillit. Ky fragment (1,17 x 0,25 m) është realizuar mbi një suport llaçi, (0,5 cm) i njëllojtë si teknologji me atë të pikturës në naosin e kishës (tabelat grafike). Piktura është realizuar me teknikën e afreskut. Në të shquajmë këmbët dhe një pjesë të pelerinës së kuqe, të një figure të pikturuar mbi një sfond okër. Duke u nisur nga ana stilistike, teknologjike dhe nga rezultatet e analizave kimike të ngjyrave të njëjta (ngjyra e kuqe) jemi të mendimit se kjo pikturë është e njëkoshme me pikturën e naosit. Madhësia e fragmenteve të këmbëve rezulton për një figurë më të lartë se sa figura e Shën Mëhillit.

Mendojmë se do të na ndihmonin për datimin e kohës së pikturimit edhe shkrimet e incizuara mbi këtë pikturë në gjuhën italiane, që i përkasin shek. XVII.[15]).

Frang Bardhi, në relacionet e tij të vitit 1641, pasi përshkruan gjendjen e kishave në trevat e veriut, thekson se: «Të gjitha janë të pikturuara me pikturë greke... n'asnjerën nuk shihet vjeti, as nuk dihet me siguri për ato të moçmet, nga kush kanë qenë ndërtue...».

Incizimet e bëra mbi pikturë në narteks, të cituara më sipër kanë si datë vitin 1614, ndërsa shënimet e M. Bicit janë më të hershme, më 1610. Mendojmë se piktura e vjetër e narteksit lidhet me traditën e vjetër të pikturimit, të fasadave të kishave,



Skica 3 Faqja lindore e narteksit

por ndofta, për arsye të dëmtimit të saj, më vonë është mbuluar me pikturë tjetër. Duke u mbështetur në faktin se pikturimi i skenës së Shën Gjergjit (vrasës dragoi) përhapet më tepër pas shek. XV-XVI, si dhe nga fakti se incizimet e bëra mbi pikturë janë të vitit 1614, mendojmë se piktura e dorës së dytë në narteks duhet t'i përkasë shek. XVI.

Ndërtimi i narteksit, që ka lidhje me shtimin e mjediseve të kishës për ceremoni të ndryshme fetare, duke mbrojtur kështu edhe pikturat nga agjentët atmosferikë,[16]) mendojmë se duhet të jetë i njëkohshëm me realizimin e pikturës.[17])

Piktura në narteks i përket një dore pikturimi. Ajo është realizuar me nivel të mirë artistik. Kjo vë-

15) Shkrimet në skenën e Shën Gjergjit ndodhen poshtë portës kryesore të hyrjes në qytet. Aty lexojmë: «Fu brucciata a cella... la coppa di argeuto da ca...» Sipër bishtit të kalit lexojmë: «I dodici di febracio io Doni Nicolo Floiagni conduce alla nuvella messa qui et poi figli versi dal vessio 1693...». Tek këmba e kalit lexojmë: «1702 sono rubati la coppa argauto da cono e cuocci d'oro». Tek bishti i kalit lexojmë: «1717 furono massacrati tre personi della piana». Në skenën e Shën Mëhillit shkrimet janë në pjesën e poshtme të krahut të tij të djathtë: «1614 e 1686 oscuro la luna».

16) Në gjendjen e sotme narteksi është rindërtim i shekullit tonë.

17) Në relacionet e M. Bicit, që mbajnë datën 1610, përmendet ekzistenca e narteksit të kishës, gjë që flet për ndërtimin e tij shumë kohë më parë.

DO NOT COPY

rehet sidomos në pikturimin e figurave kryesore. Gjendja e mirë tregon për piktorë me eksperiencë dhe me njohuri teknike. Duke paraqitur në këtë shkrim përmbajtjen dhe vlerat e pikturës murore të kishës së Shën Venerandës, Pllanë, mendojmë se në të kanë dhënë talentin e tyre dy piktorë anonimë të periudhave të ndryshme.

Vlen të theksohet vlera e veçantë që paraqet në historinë e artit shqiptar piktura e naosit, si dëshmi e vetme e ruajtur e artit humanist protorenesans.

DO NOT COPY



Foto 3 Shën Mëhilli



Foto 4 Shën Gjergji në kalë

Ylli Drishti

DO NOT COPY

L'AFRESQUE DE L'EGLISE DE SAINTE VENDREDI

L'église de Sainte Vendredi est aménagée à l'est du village Pllane (Lezhë) et s'élève au milieu de la verdure de la partie dominante de la colline. C'est une grande église à une nef (19,2 x 7 x 5 m) formée du naos et du narthex (ph. I).

La construction du monument remonte au XIVe sc. Les parois extérieurs de l'église sont d'un appareil simple en pierres calcaires brutes. Le narthex est ouvert entouré d'arcades surmontant des pilastres à section carrée d'appareil en briques rouges. La porte principale de l'église est ménagée sur la face occidentale alors qu'une deuxième porte perce la partie centrale de la face nord du naos. A l'est s'élève une assez haute abside circulaire, flanquée des deux côtés d'une petite niche. L'éclairage est assuré par sept fenêtres dont six sont arquées et l'autre en oeil-de-boeuf.

Un document du XVIIe sc. fait mention de cette église, quand elle passe sous la dépendance de l'évêché de Lezhe, Kruja ou Durrës.

Les fresques conservées dans cette église occupent la face occidentale du naos et celle orientale du narthex. La peinture murale du naos, conservée à la droite de l'éntrée occidentale est d'une largeur de 1,8 m et d'une hauteur de 1,95. Elle est réalisée par la technique à fresque sur un support pas très épais. La scène représente Sain Jacob à côté de Sainte Vendredi. Le corps de Saint Jacob est de face, couvert d'une pélerine qui tombe jusqu'à terre et la tête de profil vers l'autre figure à côté.

Sainte Vendredi se présente habillée en blanc, portant dessus une pélerine rouge à grands plis. Elle se présente debout, de face. De la main droite elle tient un rameau d'olivier et de l'autre elle tient devant sa poitrine une roue dentée, avec un grand manche dépassant la corniche. Les deux portraits sont surmontés de blanches auréoles, petites et irrégulières. A côté des deux figures on lit leur nom en latin. Les deux figures sont réalisées dans la partie supérieure, sur un fond bleu foncé, qui se conserve assez dégradé. Plus en bas, le fond devient rose.

On pense que, du point de vue stylistique, le traitement des figures se présente particulier. Cela s'aperçoit tout de suite à l'éclat du coloris utilisé par le peintre. Les couleurs épargnées se marient bien. On distingue le rouge, le blanc, le rose et le bleu, Les habits des figures sont à grands plis, peints d'un ombre-lumière doux qui semble être pris de la nature. Ils sont réalisés de tons et demi-tons par des passages graduels et délicats en rendant les figures plus monumentales. En général, la peinture de ces images est attirante, bien inspirée, mais les détails laissent à désirer.

L'éclat du coloris et le traitement stylistique nous font penser que la peinture du naos reflète un mélange de la peinture de la protorenaissance italienne avec celle byzantine. Les éléments stylistiques de la peinture byzantine constituent un minimum en comparaison avec le ton que lui donne le style occidental. Les lignes sombres au dessin des yeux, des sourcils, des mains, du rameau d'olivier, du fond bleu, de l'auréole blanche, ainsi que l'attitude monumentale et statique de la figure de Sainte Vendredi, représentent des éléments de l'art byzantin.

Nr. 1 1988

monumentet

DO NOT COPY

Reshat GEGA

ARKITEKTURA DHE RESTAURIMET NË MANASTIRIN «FJETJA E SHËN MËRISË» NË ARDENICË

Në kuotën më të lartë të kodrave të fshatit Kolonjë (rr. Lushnjes), ndodhet një nga manastiret më të bukura të vendit tonë. Manastiri «Fjetja e Shën Mërisë» ka një pozitë dominuese, pranë arterieve rrugore me rëndësi të dorës së parë. Në periudhën antike, në anën perëndimore të kodrave kalonte dega jugore e rrugës Egnatia e cila shfrytëzohej edhe në mesjetë duke lidhur ekstreme si Budua në veri dhe Korfuzi në jug[1]). Me rëndësi zonale ka qenë rruga që niste nga fshati Kolonjë për në fshatin Libofshë. Në këtë rast manastiri qëndronte si një stacion kulmor, i cili qe në kontakt me raportet ekonomike e shoqërore që këto dy zona realizonin mes tyre.

Pellgu i Myzeqesë, në sajë të pozitës kyçe, ka pasur vazhdimisht një nivel të lartë zhvillimi ekonomiko-kulturor. Dëshmi për këtë janë qytetet, vendbanimet, ndërtimet e karakterit të ndryshëm, si edhe të dhëna të tjera materiale të gjetura në shumë pika të zonës.

Reflekse të gjendjes ekonomike e kulturore janë edhe ndërtimet e kultit të këtij pellgu (Tab. 1). Nga një numër i madh manastiresh që ekzistonin më parë, një pjesë u zhdukën, të tjera kanë lënë si gjurmë rrënojat e tyre, ndërsa një pakicë si Manastiri i Shën Mërisë së Apolonisë dhe ai i Ardenicës mbijetojnë më tej. Prej manastireve të tjera të mesjetës së mesme mund të përmendim manastirin e Shën Savës, gjurmët e të cilit u zbuluan në perëndim të qytetit të Lushnjes, aty ku sot është lagjja e Saravës, manastirin e Shën Kollit në fshatin Karbunarë, të kthyer më vonë në tepe, Kishën e Madhe, ose të Kuqe, prej së cilës ruheshin deri vonë themelet në pjesën e sipërme të kodrës së Lushnjes, dhe së fundi manastiri i Shën Varvarës, pranë fshatit Barbullinjë. Në të ruhen fragmente pikture të periudhës bizantine. Sipas të dhënave të derisotme mund të themi se kemi të bëjmë me një kishë të tipit bizantin, me planimetri qendrore, ndërtuar në shek. XII-XIII[2]). Nga manastiret e mëvonshme mund të përmendim manastirin e Shën e Premtes, pranë fshatit Mërtir shek. XVII-XVIII), atë të Shën Gjergjit, në fshatin Shën Gjergj, manastirin e Shën Mërisë në fshatin Babunjë, të Shën Todrit në Kadi Pasha (shek. XVIII), të Shën Mërisë në Kolkondas (shek. XVIII), të rindërtuar në shek. e XIX me fonde nga Ali Pashë Tepelena.

Manastiri i Ardenicës përmendet nga studiues dhe udhëtarë, të cilët janë mjaftuar kryesisht me dhënjen e datave që ofrojnë mbishkrimet e vendosura në pika të ndryshme të mureve[3]) dhe me supozime për fillesat ndërtimore të këtij kompleksi[4]). Nga tërësia e vlerave të manastirit, janë trajtuar ato që lidhen me pikturën e kishës së madhe, ku janë realizuar edhe ndërhyrje restauruese[5]).

1) H. Ceka, **Dega jugore e rrugës Egnatia,** «Monumentet», 2, 1971, f. 25-32. A. Baçe, **Rrugët shqiptare në mesjetë (shek. VII-XV),** «Monumentet» 1, 1984, f. 59.

2) C. Praschniker, **Muzakhie und Mallakastra,** Wien, 1920.

3) Bardhyli: **Historia e Bibliotekave në Shqipëri,** «Ylli i Dritës», v. XIV, 1938, Nr. 4. f. 162-169.

4) A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo.: **Historai e arkitekturës shqiptare** (maket) Tiranë 1979, f. 279.

5) S. Mihalçka, **Manastiri i Ardenicës dhe konservimi i pikturës murore,** «Monumentet», 1986, f. 77-97. S. Adhami, Një ansambël monumental në Myzeqe, Tradita ndërtimore në Shqipëri, 1981, f. 18-24.

DO NOT COPY

Duke u nisur prej vitit 1984 në këtë kompleks janë intensifikuar punimet e restaurimit në tërë aspektet dhe problematikën që paraqitet. Punimet përfshijnë tërë volumet si të konakëve ashtu edhe të kishave.

PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK

Manastiri i Ardenicës bën pjesë në tipin e manastireve ortodokse ku veçori kryesore është zhvillimi i planimetrisë me fokus qendror kishën. Kompleksi që përfshin majën më të lartë të kodrës i shfrytëzon mjaft mirë mundësitë që afron terreni. Ky i fundit ka kushtëzuar edhe formën planimetrike të konakëve, konturi i të cilave formon një trekëndësh të parregullt (Tab. II fig. 1). Thuajse në qendër të kompleksit ndodhet kisha «Fjetja e Shën Mërisë», ndërsa në qoshen verilindore të saj, ngjitur me konakët e kësaj ane, qëndron kapela e «Shën Triadhës». Vargu i konakëve, në pjesën më të madhe, është dy katësh. Në të përfshihen dhomat e fjetjes, dhoma për miqtë, mjediset e depove dhe qilarëve, furra, stallat, mulliri për nxjerrjen e vajit dhe dhoma e rojes së portës. Uji sigurohet me anë të sterave. Sipërfaqja e zënë nga kompleksi është 2500 m^2. Pjesa e lirë organizohet në katër oborre, prej tyre oborri perëndimor zhvillohet në dy nivele, një pjesë e zë platforma, në kuotë të njëjtë me hajatin e kishës.



Figura 1

Forma e terrenit bëri që ndërtimet të realizohen në disa nivele. Pjesën më të lartë e zë kapela e Shën Triadhës, pastaj vjen Kisha e Madhe, ndërsa kuotën më të ulët e zë qoshja perëndimore e konakëve.

Konakët që zënë sipërfaqen më të madhe të kompleksit, përfaqësojnë pjesën e tij periferike. Fasadat nga oborri përshkohen nga një korridor i hapur, i cili realizon komunikimin e mjediseve të vendosura njëri pas tjetrit.

Hyrja kryesore zhvillohet në formën e një galerie të mbuluar me qemer cilindrik, me seksion më të shtrirë se gjysma e rrethit. Hyrja tjetër, për bagëtinë, ndodhet në anën veriore (Tab. III fig. 1).

Blloku i hyrjes përbën pjesën më të trajtuar, jo vetëm nga ana formale, por edhe funksionale. Ai përkon me rrugën që të sjell në manastir nga fshati i Kolonjës, të rrethit Lushnjes. Këtej bëhet edhe paraqitja e parë me vizitorin. Kalldrëmi i rrugës ndërpritet vetëm nga porta e mbuluar me hark guri (Tab. II fig. 2). Në korridorin e parahyrjes së portës gjenden sofate për ndenjje. Pas portës, në krahun e djathtë, ndodhet mjedisi i mullirit të vajit, i mbuluar me qemer cilindrik me formuese veri-jug. Qemeri është i ndërtuar me tulla dhe përforcohet nga dy harqe-nervatura. Ndriçimi kryhet nga tri dritare në faqen lindore. Faqja e kundërt nuk ka dritare, pasi kjo anë ndodhet, thuajse në tërë lartësinë, nën tokë. Karshi portës së mullirit, ndodhet dhoma e rojes së portës, e mbuluar po me qemer cilindrik të ndërtuar me një teknikë si e para.

Mjediset mbi këtë bllok kanë qenë më të zgjedhurat (Tab. III fig. 2). Ndër to dallon pjesa qendrore, mbi hyrje, e cila shërbente si dhomë pritjeje. Ajo i ka të suvatuara të dyja fasadat dhe pjesërisht strehët e çatisë, të cilat kanë një profil të kurbuar, veçori që haset edhe në banesat qytetare. Në ballë ajo

del me dy dritare, ndërsa në qendër ndodhet porta e drurit e cila i shërbente ballkonit (Tab. II fig. 3). Dy dritare të tjera, në nivel më të ulët, ndodhen në faqen anësore (Tab. III fig. 2). Brendia ndahet në dy pjesë: në dhomë dhe paradhomë, në anën e një muri-çatma. Paradhoma, e cila zë krahun perëndimor, ndriçohej nga dy dritare (fig. 1). Hyrja ndodhet në qoshen jugore, prej nga me dy këmbë shkallë kalohet në një korridor të ngushtë, i cili shërben edhe për dhomën e pritjes. Në korridor hyhet nëpërmjet shkallësh druri në skajin lindor të vargut të dhomave. Shkallët janë prej guri dhe përfshijnë nën veten e tyre gjurmë të njërit prej harqeve të katit përdhes, të cilët formonin arkadën e vazhduar për tërë anën jugore e jugperëndimore të dhomave (Tab. IV, fig. 2). Në veri të dhomës së pritjes ndodhen dy dhomat mbi mullirin e vajit. Hyrjet e tyre janë të drejtpërdrejta dhe kanë të përbashkët platformën e një shkalle të vogël (fig. 3). Më tutje në drejtimin nga veriu, ndërtimi është më i ri. Dhomat e kësaj pjese deri në qoshen veriore, kanë qenë përdorur si klasa shkolle në periudhën e fundit të jetës së manastirit, ndërsa kati përdhe i tyre ka shërbyer si katua apo vend për mbajtjen e bagëtisë. Ndarja e parë e katoit komunikon në krahun perëndimor me një dhomë të mbuluar me qemer



Figura 3



Figura 2



Figura 4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 5

guri, e cila ka funksionuar kohët e fundit si vend për të sëmurët psikikë (Tab. III fig. 1). Në këtë mjedis mund të hyhet edhe nga oborri, nëpërmjet një shkalle guri. Në qoshen verilindore të konakëve ndodhet një hajat, i cili kufizohet prej dhomave dhe sterës ngjitur me kapelën e Shën Triadhës (fig. 4).

Vargu i krahut verior përbëhet nga dhoma të lidhura nga një korridor gjatësor, hyrja e të cilit del në oborrin verior. Ky krah vazhdonte deri në drejtim të murit perëndimor të narteksit të kishës. Sot një pjesë e tij është zhdukur, gjasisht nga ndonjë zjarr. Thuajse e plotë ruhet vetëm fasada jugore, ku dallohen dritaret dhe porta me hark. Faqja veriore, ruhet vetëm në lartësinë e katit përdhe, ku ndodheshin stallat (fig. 6). Më tej linja thyhet, dhe dhomat që pasojnë në drejtimin perëndimor spostohen për nga jashtë. Dy mjediset e para të këtij segmenti janë përdorur si furrë pjekje. Mjedise të tjera ndihmëse ka patur edhe në anën e jashtme. Fasada nga oborri i kësaj pjese ka qenë me arkadë guri, prej së cilës ruhen vetëm dy harqe. Në pjesën e brendshme të njërit nga pilastrat e tyre dallohet një gur me gjurmë llaçi shamot, i cili dikur ishte pjesë e ndonjë stere uji. Në faqen e jashtme të pilastrit, ndodhet një pllakë guri me mbishkrim në gjuhën greke, e cila mban datën 1770 (fig. 7). Nga gjurmët e sotme nuk kuptohet nëse kjo pjesë ka qenë me dy kate ose jo. Gjurmët e vjetra të ndërtimit në vazhdim janë të padiskutueshme, pasi deri në qoshen perëndimore, një rindërtim dy katësh, i kohëve të fundit ka zhdukur mjaft nga gjurmët e para.

Dhomat e mësipërme komunikojnë me krahun jugperëndimor nëpërmjet korridorit të hapur si në katin përdhe, ashtu edhe në atë të sipërm. Ndërsa kati përdhe i krahut jugperëndimor ruan formën origjinale të arkadës, pjesa tjetër është rindërtuar me kolona guri, mbi të cilat mbështetet struktura e sipërme prej druri. Korridori i sipërm i krahut jugperëndimor komunikon me oborrin me anë të një shkalle dyrampëshe, të realizuar me dy qemere lehtësuese (fig. 8). Ashtu sikurse në mjediset e hyrjes edhe në dhomat e kësaj pjese, dyert janë të mbuluara me harqe guri të përvizuar nga sipër me një shirit tullash. Në drejtim të hyrjes, godina ndërpritet. I tërë seg-



Figura 6

menti jugperëndimor i dhomave, në anën e jashtme të tij, është i përforcuar nga një sërë kontrafortesh (fig. 9).

Kishat

Kisha e Shën Triadhës është një kapelë me përmasa 7,50 x 3,70 m, së cilës nga ana lindore i ngjitet volumi i një stere (fig. 4). Hyrjen ajo e ka në anën perëndimore dhe ndriçohet nga dy dritare të vogla, në faqen jugore (Tab. III fig. 1). Përmasat e brendshme janë 515 x 306 cm. Nga ana veriore kapelës i mbështeten dhomat e manastirit, duke lënë në këtë mënyrë të lira faqen perëndimore dhe jugore. Mbulimi bëhet nga çati dyujëse me kallkane në fasadat. **Absida** është një thellim me seksion jo plotësisht gjysmë rrethor, brenda trashësisë së murit, i cili shërben edhe si mur ndarës i kapelës me sterën. Në krahun verior të absidës ndodhen të thelluarat e protezisit, të cilat kanë seksion gjysmë rrethor, më të vogël nga ai i absidës. Porta e hyrjes është e mbuluar me hark guri. Me gurë të punuar janë dhe shpatullat, ndërsa e tërë fasada perëndimore është e suvatuar. Shpatullat dhe arkitrarët e dy dritareve janë me nga një bllok guri gëlqeror. Pranë dritares lindore ndodhet një reliev me qeramikë (fig. 10).

Kisha «Fjetja e Shën Mërisë» ndodhet fare pranë kapelës së Shën Triadhës, në jugperëndim të saj. (Tab. III fig. 2). Kisha është e tipit bazilikal, e mbuluar me çati druri dhe tavan të rrafshtë[6]). Mjediset e saj kryesore janë: naosi, narteksi me dy kate, dhoma e pagëzimit, hajati perëndimor me dy kate, kambanarja dhe së fundi hajati jugor. Në ekstremin lindor të këtij hajati, ngjitur me kishën, ndodhet një sterë me çesmën nga jugu. Salla kryesore ndahet në tri anijata nga dy rreshta kolonash druri. Pjesa e bemës kufizohet nga ikonostasi, me dysheme 10 cm më të lartë se salla.

Absida në pjesën e brendshme është rrethore. Në mesin e



Figura 7

saj ndodhet një dritare e ngushtë dhe në krahët, brenda seksionit të murit, zhvillohen protezisi dhe diakonikoni, kurse në qendër ndodhet tavolina e altarit (fig. II).



Figura 8

6) P. Thomo, A. Meksi, **Arkitektura pasbizantine në Shqipëri,** «Monumentet», 11/76, f. 131.

DO NOT COPY



Figura 9

DO NOT COPY

Figura 11



Figura 10





Figura 12

Faqja lindore në të dy anët e absidës ka edhe dy dritare të vogla (fig. II). Në murin verior pranë linjës së ikonostasit ka një dritare frëngji (fig. 12). Ndriçimin kryesor salla e merr nga dritaret e faqeve veriore dhe jugore, katër për secilën anë. Muri perëndimor ka katër dritare katërkëndëshe të vendosura dy e nga dy në nivelin e kateve të narteksit. Në faqen e jashtme të dritareve veriore dhe jugore, mbi arkitraun e gurit, zhvillohen harqe me tulla e gurë. Hapësira midis tyre është mbushur me dy pllaka tulle çerekrrethore. (fig. 18).

Struktura e çatisë përveç mureve anësore shkarkon edhe në kolonat prej druri. Tavani është i rrafshët me kuadrate të formuara nga listela të profiluara. Në qendër ka një rozetë, dekori i së cilës është i formuar nga ndërthurje drejtkëndëshash të profiluar.

Hyrjet për në naos janë tri, në faqet veriore dhe jugore dhe më e madhja në faqen perëndimore. Dyshemeja është e shtruar me pllaka drejtkëndëshe guri gëlqeror, me gjerësi jo më tepër se 0,60. Në qendër të dyshemesë, nën rozetën e tavanit, ndodhet rozeta e dyshemesë me pllaka guri e organizuar brenda një kuadrati me tri rrathë koncentrikë.

Narteksi në katin e dytë zë tërë gjerësinë e naosit dhe të oborrit verior (Tab. III fig. 2), ndërsa në katin përdhe mbetet i njëjtë me naosin (Tab. III fig. 1). Dyshemeja e këtij kati, e njëjtë me dyshemenë e naosit, ruan po atë kuotë. Komunikimi i narteksit me mjedisin e jashtëm kryhet nga dy porta, në faqen jugore dhe perëndimore. Hyrja jugore, ashtu sikurse dy hyrjet anësore të naosit, është realizuar vonë me arkitrarë metalikë. Hyrja e faqes perëndimore nga brenda mbulohet me arkitra, ndërsa jashtë me hark të dyfishtë guri të alternuara me tulla. Narteksi, ndahet në tri pjesë, me anë të dy harkadave prej guri me nga dy harqe të mbështetura në murin e naosit dhe atë përballë tij. Muri i naosit në katin përdhe është i patinuar deri në nivelin e dyshemesë me gëlqere të përzier me lesh dhie. Në anën veriore, ky kat, kufizohej nga një mur tek tullë, tej të cilit krijohet korridori që lidh, nëpërmjet një portë të hapur vonë, oborrin verior me atë perëndimor.

Muri perëndimor i narteksit përsa i përket ven-



Figura 13

DO NOT COPY

dosjes së dritareve dhe portës ripërsërit murin perëndimor të naosit. Në katin e tij të dytë kalohej nëpërmjet një shkalle druri në qoshen veriperëndimore. Në anën jugore gjendet dhoma e pagëzimit, njëkatëshe, me hyrjen pranë murit perëndimor të narteksit.

Secila kolonë ka kapitele dhe jastëkë druri. Ato, dyshemeja, edhe çardaku në bllokun e hyrjes, janë me dru lisi. Sipërfaqet e mureve, përjashtuar faqen lindore të zbukuruar me afresk, janë të pasuvatuara. Në qendrën e faqes me pikturë afër dyshemesë, ndodhet një nike e mbuluar me hark. Afresku nuk mbulon tërë sipërfaqen e murit, duke lënë paprekur, në pjesën më të madhe, frontonin (Tab. V. fig. 2). Në linjën e sipërme dallohen copa të prera të trarëve të dikurshëm (Tab. VI, fig. 1). Dritaret e kësaj faqeje si të katit përdhe, ashtu edhe të të sipërmit profilohen me gurë gëlqerorë, me buzët e brendshme të gdhendura imët (fig. 14). Hapja e dritareve është më e vonë se piktura, pasi ajo ndërpret skenat e saj të fundit.

Hajati perëndimor në katin përdhe, ka një harkadë e cila zë tërë ballin e godinës (fig. 15). Harqet janë me gurë gëlqerorë të konturuar me shirit tullash dhe kapitelet janë të thjeshta pa ndonjë dekor të veçantë, veç tri shkallëzimeve të njëpasnjëshme (Tab. VII).

Në anën jugore të hajatit ndodhet kulla e kambanares, me hyrje për çdo kat të hajatit. Kulla është ndërtuar kohët e fundit, por me hedhjen e



Figura 14



Figura 15

theksuar vertikale ajo zë një vend të veçantë në tërë siluetën e kompleksit. Ajo është e lartë 22 m, me fasada të suvatuara, të cilat krijojnë në qoshe breza të profiluar. Në çdo kat ka një dritare për çdo anë. Në katin e fundit, ku gjenden këmbanat, dritaret janë më të mëdha për shpërndarjen më të mirë të tingujve. Lëvizja në kullë kryhet nëpërmjet një shkalle druri.

Hajati në fasadën jugore të kishës është njëkatësh (fig. 1). Arkada, me gurë gëlqeror ka hap kolonash pak më të madh se në hajatin perëndimor. Kapitelet janë trajtuar më me kujdes, të profiluara me gjethe apo rombe në reliev në qoshet (Tab. VII). Kolonat cilindrike mbështeten mbi pllaka guri. Komunikimi me oborrin bëhet me një shkallë me planimetri gjysmë rrethore. Shtresa e dyshemesë është pjesërisht me pllaka guri të periudhës së parë ndërsa mbulimi bëhet me çati njëujëse, linja e sipër-

POOR COPY

DO NOT COPY



Figura 16



Figura 17

me e së cilës kalon në nivelin e fundit të dritareve të naosit. Muratura e anëve lindore dhe veriore, të pambuluara nga ndërtime të tjera, është prej gurësh shtufi të lidhur me llaç gëlqereje. Në të vihen re dy zona horizontale të dallueshme nga teknika dhe forma e gurëve. Linja e ndarjes së tyre përkon me xokolin e absidës. Pjesa e poshtme që shërbente si bazament nuk është me gurë të punuar. Në pjesën e sipërme gurët vendosen në rreshta horizontalë me faqe pak a shumë të punuara. Qoshet e kishës janë punuar me kujdes, me gurë gëlqerorë. Me një përkujdesje mjaft më të madhe është ndërtuar absida (fig. 11). Planimetria e saj mbi nivelin e xokolit është shtatë faqëshe, ndërkohë xokoli është gjysmë rrethor, me gurë shtufi të papunuar (Tab. X, fig. 1). Tërë pjesa tjetër e absidës është me gurë gëlqerorë të gdhendur me kujdes. Faqet në pjesën qendrore kanë nike absidale të mbyllura sipër me harqe guri të alternuara me tulla. Më sipër vijon një rresht i alternuar me gurë e tulla, dhe së fundi korniza formohet nga gurë të profiluar e të shkallëzuar. Muri mbi absidën, meqenëse kisha ka çati dyujëse, përfundon me fronton.

Sistemi i furnizimit me ujë (Tab. III).

Territori i manastirit nuk ka burime ujore. Vetëm në gjysmë të rrugës për në fshatin Kolonjë, ndodhen dy burime me prurje të pakëta uji. Në këto kushte nevojat për ujë janë përballuar duke krijuar katër stera për mbledhjen e ujit të shiut, tri nga cilat i kemi përmendur më lart. **E katërta,** ndodhet nën nivelin e dyshemesë së korridorit, në veri të narteksit (Tab. III fig. 1). Fasada e çesmës së sterës është trajtuar me kujdes. Edhe këtu, përdoren gurë e pllaka guri gëlqeror të puthitura shumë mirë. Pjesa e saj qendrore trajtohet si nike. Furnizimi me ujë bëhej nga çatitë e kishës dhe të dhomave të këtij krahu nëpërmjet ullukesh qeramike.

Stera pus është e vetmja sterë që qëndron e shkëputur prej volumeve të tjera arkitektonike (Tab. III). Volumi i saj ndahet në dy nivele: në depozitën nën tokë dhe pjesën mbi tokë. Depozita është katërkëndëshe e mbuluar me qemer cilindrik tulle. Planimetria e volumit mbi tokë është gjashtëkëndëshe (fig. 16). Tubacioni i qeramikës për prurjen e ujit ndodhej mbi një harkadë prej së cilës kanë mbetur dy harqet e para. Harkada vazhdonte drejt lindjes (fig. 17).

Stera jugore e Kishës së Madhe ka një vëllim kubik të mbuluar me qemer të përfshirë nën çatinë e hajatit. Fasada e saj ndodhet në një rrafsh me atë të hajatit. Përballë saj gjendej mbulesa e portikut me dy harqe anësore dhe një ballor, prej së cilës ruhen kolonat me kapitelet dhe fillesat e qemerit dhe harqeve. Çesma ka një nike të mbuluar me hark të profiluar guri të kufizuar me një shirit tulle. Si thembra të harkut shërbejnë dy pjesë kornize antike. Pranë gjurmës së harkut ndodhet vrima e kontrollit të nivelit të ujit.

Stera ngjitur me kishën e vogël, e punuar me gurë të gdhendur, ka qenë e mbuluar me çati dyujëse. Në pjesën fundore është vendosur një govatë ku mblidheshin ujërat. Brendësia e sterës dhe fugat e pjesës qendrore janë suvatuar me llaç shamot. Në

DO NOT COPY

faqen jugore, të pasuvatuar, ndodhet i murosur një reliev antik mermeri.

Të katër sterat kishin një vëllim rreth 80 m^3 ujë. Shpërndarja e tyre në të katër skajet e manastirit i përgjigjej shtrirjes së konakëve. Trajtimi i tyre është i larmishëm dhe në harmoni të plotë me të tërën.

RESTAURIMET DHE SONDAZHET

Ndërhyrjet në kompleksin e manastirit kanë pasur si qëllim kryesor konsolidimin e strukturave, evidentimin e fazave ndërtimore me vlerë, eliminimin e fazave dhe ndërhyrjeve të vona pa vlerë, të cilat pengonin leximin e objektit dhe së fundit dhënja e një funksioni bashkëkohor për ta gjallëruar dhe për ta bërë të njohur me masat.

Nëpërmjet vrojtimtit të strukturave, gjurmëve, si edhe sondazheve, krijuam një ide më të plotë për fazat, volumet dhe skemën funksionale pararendëse. Punimet restauruese u bashkërenduan me sondazhet, të cilat ndihmuan për përcaktimin e masës së ndërhyrjes restauruese, si për ndërhyrjet e karakterit të përgjithshëm, ashtu edhe për pjesët e veçanta.

Ndërhyrjet në konakët

Ndërhyrjet restauruese të konakëve, nisur me ritme të ngadalta në vitet 70, prekën fillimisht vetëm qoshen jugperëndimore e perëndimore, duke riparuar çatinë dhe dyshemenë e tyre. Vitet e fundit, ndërhyrjet u përshpejtuan në kohë duke u rritur edhe në vëllim. Këto ndërhyrje synuan në prekjen e tërë kompleksit, duke i dhënë së fundit një funksion të plotë bashkëkohor.

Konakëve, veçanërisht atyre të pjesës lindore, krahas ndërhyrjeve konsoliduese në strukturë, ju evidentuan format dhe pjesët e panjohura arkitektonike. Të tilla qenë: çardaku i hyrjes në fasadën nga oborri (Tab. XI, fig. 2), korniza (Tab. XII, fig. 2)., dy portat në qoshen që formon blloku i hyrjes me dhomën nga veriu (Tab. XI, fig. 1, 3), dyshemeja e vjetër në këtë dhomë e shtruar me tulla të pjekura, muret rrënojë në mjediset përdhese, si edhe gjurmët e shkallëve të kunetave të vjetra. Këto të fundit dolën në dritë pas uljes së dherave në nivelet origjinale (Tab. XI, fig. 5). Të gjitha këto elemente që lidhen ngushtësisht me historinë ndërtimore të manastirit u lanë të dukshme dhe u konsoliduan. Dy portat e murosura u hapën e u plotësuan në bazë të gjurmëve. Po kështu mbi bazën e gjurmëve u riformulua korridori (Tab. XI, fig. 2, 4) si dhe ballkoni në fasadën e jashtme (Tab. XII, fig. 3). Këto plotësime janë të karakterit integrues dhe zënë një përqindje të pranueshme në raport me të tërën. Riformulimi i tyre, i bazuar në gjurmët e sigurta, nuk fsheh ose dëmton elemente e gjurmë të tjera. Pra, ndërhyrja rezervon mundësinë e plotë të risjelljes në gjendjen e parë. Me restaurimin e këtyre elementeve mjediset filluan të komunikojnë si në fazën fillestare. (Tab. IV, fig. 2)

Çardakut iu pastruan e konservuan elementet e mbetura. Tavanet prej druri u konservuan dhe u plotësuan në pjesët që mungonin, në dhomën e pritjes dekori u realizua sipas pjesëve të ruajtura. Dhomat me tavane me suva me kallama u risuvatuan, por me rrjetë teli.

Elementet përbërëse të interiereve; dyert, dritaret, dollapët, sergjenët e fashatura u ruajtën në gjendjen origjinale duke plotësuar vetëm pjesët e mangëta. Gjurma e dyshemesë së vjetër me tulla u konservua, ndërsa pjesa tjetër u shtrua me pllaka tulle fabrike, me përmasa 25 x 25 cm, që i afrohen përmasat origjinale 26 x 30 x 4 cm. Mjediset me dysheme druri u lanë të tilla.

Ndaj tërë mureve u kryen ndërhyrje konservuese. Probleme të karakterit konstruktiv pati vetëm një pjesë e murit të jashtëm në dhomat nga jugu, i cili shfaqte epje për nga jashtë. Më të ndjeshëm këtë difekt e kishte bërë humbja e aftësisë mbajtëse të



Figura 30

kontraforit. Si masë përforcuese u vendosën tiranta metalike në nivelin e dyshemesë, të cilat lidhën murin e dëmtuar me dy muret e brendshme, si dhe u krye pastrimi e injektimi me lëng gëlqereje i zonës ku muri kishte shpërbërje dhe degradim të llaçit. Kontrafortit iu përforcua tabani me themel butobetoni dhe u vendosën katër unaza metalike që e shtrëngojnë seksionin e tij në katër nivele (Tab. XII fig. 5) e (fig. 30). Në kontrafortet e rrënuara, të cilat dolën në dritë pas uljes së nivelit të dheut, u kryen punime përforcimi.

Ulja dhe kërkimi i niveleve origjinale të kalldrëmeve dhe dyshemeve, solli në dritë elemente me vlerë. Në qoshen perëndimore përveç mureve të mjedisve të rrënuara, doli hyrja e dytë e manastirit (fig. 18). Gjatë gërmimit u vunë re disa nivele djegjeje, 30 – 40 cm larg njeri-tjetrit. Në qoshen juglindore të konakëve dolën dy mure të ngjitur tërthor mjedisit, me vrimat ku shkarkonte kuneta e ujit (Tab. XI, fig. 5). Nga sondazhi u pa se këto dy mure janë të lidhura me pjesën e bllokut të hyrjes. Pas tyre në drejtim nga jugu themeli ulet shumë (Tab. XIII, fig. 1). Po kështu në mjediset e katonjve dhe mullirit dolën struktura të vjetra muresh.

Nga gërmimet u bë e qartë se manastiri e ka patur problem terrenin e pjerrët. Për këtë arsye largimi i ujërave është organizuar me kujdes dhe zona me më tepër rrezik është pajisur me kontraforte (fig. 19).

Me funksionin e ri, si hotel turistik, u lidhën edhe disa punime të veçanta. Ana funksionale e ripërdorimit të ri respektoi skemën e vjetër. Në bllokun e hyrjes u vendosën dhoma e pritjes, restoranti dhe kuzhina në veri të saj, kafeteria, veranda dhe bari i hapur në krahun tjetër. Pas kuzhinës vazhdojnë: magazina frigorifer dhe dhoma fjetjeje, të cilat shkojnë gjatë krahut verior deri tek furra e vjetër. Përveç dhomave të fjetjes, një pjesë e mirë e të cilave do pajisen me banja, do të ketë edhe dy taverna, njëra tek mulliri i vajit dhe tjetra në mjediset përdhese të



Figura 18

DO NOT COPY

anës jugore. Gjurmët e mureve të vjetra nuk do të preken. Për pjesën e katojve dhe të mullirit të vajit doli e domosdoshme eliminimi dhe parandalimi i lagështisë, për shkak të nivelit të lartë të dherave nga ana e oborreve (fig. 20). Për këtë u krye një drenazhim i thellë dhe dyshemetë u hidroizoluan. Në mjediset e pritjes dhe restorantet u realizuan disa oxhakë, në vendet ku ka patur të tillë. Sipas funksionit, në përshtatje me frymën e arkitekturës së manastirit, u vendosën ndriçues të tipeve qirinj, shandanë apo fenerë. Këto të fundit u vendosën në oborr, hajate e korridore.

Kisha e Madhe inkuadrohet në ripërdorimin modern të manastirit. Pas restaurimit ajo do të përbëjë një nga sektorët më të rëndësishëm muzealë të kompleksit. Mjedisi i naosit do të pajiset me orenditë që i mungojnë si: shandanë, mbajtëse qirinjsh etj. Ndërsa narteksi, do të pajiset me një numër të vogël ikonash më përfaqësuese të kishës ose të zonës, të vendosura thjeshtë, pa e ngarkuar interierin.

Qëndrim vlerësues si dhe restaurues u mbajt edhe për mjedisin rrethues të manastirit. Në këtë ide bën pjesë ndërtimi i rrugës për në manastir, nëpërmjet të cilës lehtësohet mjaft frekuentushmëria, si dhe pyllëzimi, i cili vazhdon e do të vazhdojë të bëhet.



Figura 19



Figura 20

DO NOT COPY

Fazat e ndërtimit të konakëve. Duke patur parasysh vrojtimet, sondazhet, si edhe mbishkrimet, do të përpiqemi të japim një radhitje të fazave ndërtimore.

Blloku i hyrjes, ku ndodhet data 1477, është pjesa më e vjetër e manastirit e ruajtur në lartësi. Terreni në këtë zonë është i qëndrueshëm dhe ka vuajtur më pak nga fenomeni i rrëshqitjes. Kësaj kohe i takojnë dhe muret rrënojë në vazhdimin nga veriu dhe rrënojat në qoshen juglindore. Pjesa e poshtme e murit të portave të mjediseve jugperëndimorë është më e hershme nga dy muret anësore. Kjo dallohet qartë nga nivelet e dyshemesë së dikurshme. Ky mur diferencohet nga arkada e kësaj pjese dhe së bashku me rrënojat në qoshen perëndimore e ato në pjesën e humbur nga jugu duhet t'i takojnë fillimit të shek. XVIII duke u lidhur në kohë me Kishën e Madhe. Në këtë fazë manastiri arrin zgjerimin më të madh, të njëjtë me gjendjen e sotme. Në gjysmën e dytë të shek. XVIII ndërtohet pjesa e furrave (fig. 7). Të kësaj periudhe duhet të jenë pjesë të mureve anësore në konakët jugperëndimorë. Në fillim të shek. XIX rindërtohet pjesa në veri të bllokut të hyrjes deri në zonën e furrave. Këtu bën përjashtim burgu, i cili është më i hershëm dhe ka shërbyer, me sa duket, si sterë uji (fig. 29). Kështu manastiri mori thuajse pamjen e sotme, përveç kullës së kambanares të ndërtuar në shekullin tonë.



Figura 29

Ndërhyrjet në kishat

Ndërhyrjet restauruese në kishat e manastirit u lidhën me synimin për të kërkuar gjurmë më të vjetra, si dhe për përcaktimin e renditjen e fazave ndërtimore të tyre. Në këtë gjë na nxiti dhe gojëdhana për themelimin e manastirit gjatë despotatit të Epirit, shek. XIII-XIV. Nga strukturat mbi sipërfaqen e tokës nuk dallohet asnjë gjurmë e kësaj periudhe. Ndaj edhe barra kryesore i ngeli sondazheve.

Kapela e Shën Triadhës pjesët mbi nivelin e tokës dhe një pjesë të vogël të sterës, i ka të rindërtuara rreth 50 vjet më parë. Në përgjithësi gjendja e saj fizike ishte e mirë, me përjashtim të faqes veriore, e cila për shkak të rrëshqitjes, ka krijuar çarje në të dy qoshet. Pas riparimeve të çatisë nisëm kontrollin në thellësi. Gërmimi u krye me shtresa 20 cm, Materiali i nxjerrë përbëhej nga mbeturina ndërtimore, llaçra e copa tulle, (Tab. XV).

Rreth 30 cm poshtë nivelit të sotëm, në qoshen jugperëndimore, doli shtresa me tulla (27 x 27 x 3,5 cm) e dyshemesë para rindërtimit të fundit, e vendosur mbi llaç të varfër gëlqereje. 75 cm më poshtë doli niveli i dyshemesë fillestare edhe kjo shtruar me pllaka tulle 28 x 18 x 4,5 mbi llaç gëlqereje. Rreth 1 m larg murit lindor doli muri i vjetër me gjerësi 0,73 m dhe lartësi 0,50 m. Në dyshemenë e kësaj faze duket gjurma e bazës së ikonostasit prej druri. Në kanalin e tij dallohen gjurmët e djegies. Pjesa e altarit e ka dyshemenë pak më të ngritur kundrejt pjesës tjetër. Ndërsa për të kaluar jashtë, në nivelin e oborrit, shërbejnë dy këmbë shkallë. Me thellimin e terrenit, në hapësirën midis kishës së vjetër dhe sterës, nuk doli ndonjë material i cili do të lejonte datimin e kapelës, përveçse skeletë. Skeleti i sterës (Tab. VIII) qe i vendosur me kokë nga perëndimi dhe thuajse tërë trupin e kishte poshtë themeleve.[7])

Kufiri dhe ndërthurja e këtyre ndërtimeve shquhet qartë nga sondazhi i bërë jashtë (Tab. VIII fig. 5) Muri perëndimor i sterës ka në përbërjen e vet gurë të ripërdorur me suva shamoti, kurse muri rrënojë nuk ka suvatim. Nga elementet pëbërëse që lidhen me ritualin nuk ka gjurmë, pasi rrënimi ka ndodhur nën nivelin e tyre, por është e qartë se absida ka qenë e zhvilluar brenda seksionit të murit. Muri veriut, në anën e dëmtuar nga rrëshqitjet, është i ri.

Gjendja pas gërmimeve, do të ruhet si e tillë

7) Nga vrojtimi paraprak që iu bë këtyre skeleteve, rezulton se njëri prej tyre ka tipare të mirfillta adriatike, të cilat hasen rëndom tek ne, mbas shek. XII të e.s. ndërkohë që skeleti i dytë aludon për një formë ndërmjetëse adriatikore-mesdhetare tipike për shekujt e fundit të mesjetës së hershme (të dhënat i kemi nga antropologu i Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike, Aleksandër Dhima).

DO NOT COPY

duke bërë vetëm ndërhyrje konservuese. Duke qenë në mjedise të mbyllura kjo lehtësohet mjaft. Krahas konsolidimit të dyshemeve dhe murit rrënojë e suvatuan dritaret, porta etj. Fasada lindore e sterës u pastrua nga gëlqerja dhe u mbushën fugaturat.

Fazat e ndërtimit të kapelës së Shën Triadhës. Nëpërmjet evidentimeve dallojmë 4 faza ndërtimore. Në fazën e parë ekzistonte vetëm kapela e vjetër (Tab. VIII, fig. 1), hyrja e të cilës ka qenë nga perëndimi, kurse terreni jashtë, nga lindja e saj, përdorej si varrezë. Pas saj u ndërtua stera me gurë të një stere më të vjetër. (Tab. VIII fig. 3). Në fazën e tretë kapela u zgjatua deri te stera (Tab. VIII fig. 4). U mbulua kapela e vjetër dhe u krijua e reja me dysheme tulle. Faza e fundit ka të bëjë me një rindërtim të vonë, i cili nuk e prek shumë formën planimetrike. (Tab. VIII fig. 5, 6).

Kisha e Fjetjes së Shën Mërisë është objekti ku është punuar më gjatë, si në arkitekturë ashtu edhe në objektet e artit. Fillimisht u krye ekzaminimi i strukturave mbajtëse dhe mbuluese. Themelet paraqiteshin në gjendje të mirë, ndërsa në mure dallohesh in dëmtime. Muri verior i naosit ka pësuar lëvizje rrotulluese për nga jashtë duke krijuar një kurbëzim, thuajse në qendër, në nivelin e tavanit. Për të parandaluar zhvendosjet e mundshme në nivelin e trarëve të çatisë u vendosën tiranta hekuri. Dinamika e lëvizjeve, si në këtë mur, ashtu edhe në pikat e tjera është pasur nën kontroll (fig. 21). Po kështu vërehet ulja e absidës kundrejt pjesës tjetër. Ndaj saj nuk u bë ndonjë ndërhyrje, pasi bazamenti rezultoi i qëndrueshëm.

Muri perëndimor i naosit, më i vjetri i kishës, kishte dëmtime më të mëdha. Kjo ishte shkaktuar nga ngarkesa e dyfishë, nga çatia e naosit dhe e narteksit, si dhe gjendja e tij e keqe fizike. Zonat më të dëmtuara qenë ato pranë dritareve. Kjo ka sjellë fryrjen e faqes nga narteksi, duke dhënë pasoja edhe në afresk. Në mungesë të materialeve konsoliduese, në formë rrëshirash, me të cilat do të injektohej muri në thellësi, u aplikua metoda e ribërjes. Në pjesën e dëmtuar muri u rindërtua, duke shkëputur paraprakisht afreskun. Pas ndërhyrjes afresku u rivendos. Për lidhjen e murit në gjatësi dhe shpërndarjen e njëtrajtshme të ngarkesave të çative mbi nivelin e sipërm të afreskut u vendos një tra betonarmeje. Përveç rigjenerimit me lëndë lisi në hajatin perëndimor, prekjet e tjera patën karakter çlirues, evidentues dhe vlerësues. Në hajatet e shkallët u largua shtresa e çimentos dhe u riparuan shtresat origjinale. Në bazamentin e kolonadës së hajatit perëndimor u plotësua shtresa me tulla. Në katin përdhe të narteksit u pastruan nga gëlqerja muret dhe har-



Figura 21

qet e gurit dhe u mbyll porta në qoshen veriperëndimore, si e vonë dhe e pa vlerë.

Fasadës së sterës jugore të kishës i mungonte mbulimi (fig. 22), por forma e tij ishte plotësisht e



Figura 22

DO NOT COPY

qartë. Mungesa e këtij elementi ndihej në tërë unitetin e elementeve të oborrit. Duke pasur parasysh këtë dhe anën funksionale vendosëm që ai të riformulohej. Me realizimin e këtij elementi u vendos, ekuilibri jo vetëm në kuadrin e ngushtë të fasadës, por edhe për tërë mjedisin. Në procesin e përkujdesjes futëm edhe kambanaren, e cila nuk fsheh apo cënon ndonjë pjesë me vlerë.

Sondazhet dhe punimet në truallin brenda dhe jashtë kishës pasuruan dhe sqaruan akoma më tepër imazhin e saj arkitektonik. Në zonën para portës veriore të kishës me uljen e nivelit të dherave dolën mbetjet e një mjedisi. Nga sondazhet rezultoi se në muret veriorë, jugorë dhe lindorë të naosit ka gurë me copa afresku. Rrjedhimisht, këtu është përdorur material nga mure të tjera me shtresë pikture (fig. 23). Këta mure në pjesën e themeleve nuk lidhen me murin perëndimor. Interieri i naosit është i pikturuar në të katër faqet e tij, por në faqen perëndimore përveç kësaj shtrese pikture ka edhe një tjetër të nënvënë. Shtresa e pikturës që duket mbulon tërë sipërfaqen e interierit dhe konceptohet në harmoni me elementet e arkitekturës. Katër dritaret e faqes perëndimore rrinë natyrshëm me skenat e afreskut. Ndërkohë këto dritare ndërpresin skenat e pikturës të narteksit, çka tregon se piktura e fundit në naos është realizuar më pas (Tab. VI, fig. 3). Pranë dyshemesë së katit të sipërm të narteksit doli harku me tulla i një



Figura 23

dritareje, i cili qëndronte i fshehur nën pikturë. Kjo dallohet edhe në krahun tjetër. Sektori midis tij e arkitraut plotësohet me dy tulla çerek rrethi (Tab. V, fig. 3). Me heqjen e këtyre të fundit doli pjesa e prapme e afreskut të shtresës së parë në naos. (Dy dritaret qëndrojnë simetrike me fasadën dhe portën (Tab. V. fig. 1). Kjo e fundit ka qen, më e lartë, me kulmin afërsisht në nivelin e dyshemesë së sipërme të narteksit. (Tab. V, fig. 4). Porta ekzistuese ruan të njëjtën gjerësi, ndërsa lartësinë e ka zvogëluar për t'u përshtatur me katin përdhe të narteksit (Tab. VI, fig. 4). Sipërfaqja brenda linjës së fazës së parë të portës nuk është përfshirë nga piktura, çka tregon se në kohën kur fasada qe e pikturuar porta vazhdonte të kishte formën e saj origjinale edhe pse dritaret u mbyllën. Me pastrimin e sipërfaqes të gëlqeres u pa se piktura ka qenë shtrirë ose ka vazhduar deri në pjesët e poshtme të muraturës. Në fasadën jugore të naosit janë përdorur jo vetëm gurë me copa arfesku, por edhe suva shamoti. Gurë të tillë gjenden edhe në sofatin e hajatit. Pranë shkallës së hajatit dolën gjurmët e një stere uji (Fig. 24), një pjesë e së cilës përfshihet nga muri i harkadës. Konturi i jashtëm i saj është poligonal, ndërsa i brendshmi rrethor, me diametër 2,60 m (fig. 25).

Sondazhet treguan se stera aktuale qëndron e shkëputur nga kisha (Tab. XII fig. 2).



Figura 24

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 25

Fazat e ndërtimit të kishës «Fjeta e Shën Mërisë». Vrojtimet tregojnë se ndërtimi i saj ka kaluar të paktën tri faza, të cilat kanë lënë gjurmë në murin perëndimor të naosit dhe lidhen me tri shtresat pikturore të kishës.

Në fillim është ndërtuar volumi i naosit, planimetria e të cilit ka qenë e njëjtë me të sotmen. (Tab.



Figura 26

IX, fig. 1). Në këtë fazë interieri qe i pikturuar. Kjo pikturë haset në murin perëndimor dhe në gurët e ripërdorur. Muri perëndimor ka pasur dy dritare dhe portën e lartë (Tab. V. fig. 1). Fasada ka qenë e zhveshur, pa pikturë. Në këtë fazë funksionin kryesor e kryente porta e madhe. Të kësaj kohe duhet të jenë edhe dy sterat; stera pus në oborrin perëndimor dhe stera rrënojë, e cila ka pasur pa dyshim formë pusi.

Faza e dytë solli ndryshime vetëm në anën perëndimore, ku fasada u pikturua duke bllokuar dy dritaret (Tab. IX, fig. 3). Porta e madhe vazhdoj të qëndrojë e pandryshuar (Tab. V, fig. 2,4). Në këtë fazë ndërtohet një hajat i hapur prej druri, gjurmët e të cilit shfaqen në konfiguracionin e pikturës dhe mbeturinat e trarëve të konstruksionit të sipërm (Tab. VI, fig. 1, 6).

Në fazën e tretë ndryshimet janë të mëdha. (Tab. X). Muret veriorë, lindorë dhe jugorë të narteksit u ringritën nga themeli duke lenë gjurmë fare të pakta në qoshen verilindore. Ky veprim mund të gjejë justifikim vetëm në njohjen e dobësisë së mureve të vjetra. Në këtë mënyrë humbi edhe piktura e këtyre tri faqeve, ndërkohë që ajo e faqes perëndimore vazhdoi të ruhet së bashku me murin. Me ribërjen e tri mureve të naosit, në murin perëndimor u hapën katër dritare, të cilat ndërpresin pikturën e narteksit. Ndarja në dy kate e narteksit solli reduktimin e lartësisë së portës së madhe. (Tab. X, fig. 2). Narteksi shoqërohet me hajatin perëndimor. I kësaj faze është edhe hajati jugor së bashku me sterën. Ndërtimi i hajatit e prish sterën-pus të kësaj ane duke ripërdorur një pjesë të materialit të saj. Kjo fazë datohet me pllakën e vendosur në hajatin perëndimor (fig. 26). Në këtë mënyrë kisha mori pak a shumë pamjen që ka edhe sot, me përjashtim të disa ndryshimeve të vona si; ndërtimi i murit me tulla në katin përdhe të narteksit, ndërtimi i kambanares etj.

Datimi

Të dhënat dokumentare për datimin mungojnë. Shumë nga studiuesit, apo udhëtarë që kanë parë manastirin, i drejtohen gojëdhanës se ai është themeluar në kohën e despotatit të Epirit, në shek. e XIII, pa sjellë të dhëna materiale e dokumentare.

Në dokumentet historike, përmendja më e hershme e manastirit «Fjetja e Shën Mërisë» në Ardenicë, i përket v. 1715[8]). Vetë objekti ofron disa mbi-

8) I. Snjegozov, Istorija Ohridakata arhipiskopija-Patriarshija st padanotv u pod Turcit do neinata uniçorhenia (1394-1764) Sofie 1932 f. 117.

shkrime. Data më e vjetër është ajo që ndodhet në ballin e brendshëm të hyrjes së manastirit, ku në gjuhën greke shkruhet 1 Maj 1477. Mbishkrimi në brendësi të naosit, mbi portën kryesore, jep datën 1743-44, kohë në të cilën kisha pikturohet prej vëllezërve Kostandin e Athanas, nga Korça[9]). Një pllakë guri në ballin e hajatit perëndimor të kishës jep datën 1754, ndërsa pllaka prej guri, në harqet e mbetura të furrës daton 1770. Në kishë gjendet një ikonë e Shën Mërisë e v. 1731[10]) dhe një tjetër e pikturuar nga murg Simoni i këtij manastiri, shek. XVII[11]). Deri në vitet tridhjetë të shekullit tonë në kishë gjendej një këmbanë e madhe me datën 1708 dhe tri të tjera më të vogla me datën 1738. Krahas gojëdhanas për themelimin e manastirit, një tjetër bën fjalë për celebrimin në këtë kishë të Skënderbeut në vitin 1451.[12])

Nga këto të dhëna del se ky kompleks ekzistonte përpara Kishës së Madhe. Kjo e fundit është e ndërtuar brenda viteve 30 deri 40 të shek. XVIII. Faza e tretë e saj e sipas mbishkrimit i përket vitit 1754, që gjendet në hajatin perëndimor. Sipas studimeve të pikturës murore, shtresa e dytë e saj në naos i takon autorëve të fazës së parë, ndërkohë që mbishkrimi dhe data e saj janë lënë të dukshme mbi hyrjen.[13]) Ikona e vitit 1731[14]), përmendja në vitin 1715 nga dokumentet kishtare[15]) dhe ikona e murgut Simon të këtij manastiri, e shekullit të XVII, e shtyn në kohë ndërtimin e kishës së manastirit. Por për t'u shtyrë më tej nuk gjejmë ndonjë të dhënë përveç datës 1 Maj 1477 dhe rrënojave të kapelës së vjetër të Shën Triadhës.

Kapela e Shën Triadhës është më e hershme se tërë strukturat e tjera, shumë më e vjetër nga stera ngjitur, e cila i takon gjysmës së parë të shek. XVIII. Këtë e tregon përdorimi i gurëve të sterës së prishur në hajatin jugor të Kishës së Madhe. Terreni ku u ndërtua kjo e fundit përdorej si varrezë e kapelës. Varreza është bashkëkohëse e kapelës, sepse themelet nuk kanë dhunuar ndonjë varr, siç ka ndodhur me sterën. Është gjithashtu e kuptueshme se stera nuk mund të ndërtohej mbi varre të rinj. Përkundrazi, këta duhet të kenë qenë kaq të vjetër, sa të ishin harruar ose të paktën të mos dalloheshin në kohën kur u vendos të ndërtohej stera. Për një kohë të hershme tregon edhe analiza e materialit ndërtimor. Përveç strukturës së mureve tullat i përmbahen një standarti të njëjtë me atë të kishës së Ristozit,[16]) të shek. XIII-XIV. Ky element nuk është aq i fuqishëm sa të fiksojë datën e themelimit të kishës. Por duke marrë parasysh datimin e varrezës në pragun e mesjetës së mesme, sipas analizës antropologjike, do të anonim më tepër për një datim në shek. XIII--XIV, në këtë drejtim, ndonëse Ristozi ndodhet larg. Marrëdhëniet ekonomike midis krahinës së Korçës dhe Myzeqesë njihen si tradicionale[17]). Në këto marrëdhënje të ngushta ekonomike pa tjetër është ndërthurur edhe jeta e këtij manastiri. Shprehja e traditës së këtyre raporteve duhet të jenë edhe kontaktet e gjera, të veçanta, me Voskopojën në shek. XVII-XVIII. Nuk përjashtohet mundësia që përveç kapelës, të ketë pasur edhe ndonjë kishë tjetër më të madhe, të cilën tani për tani nuk e vërtetojmë dot.

Për shekujt XIII-XIV rrethanat historike qenë të favorshme si në pikëpamje politike, ashtu edhe në ato ekonomike. Pellgu i Muzeqesë përfshihej kryesisht nga dy zotërime të mëdha të ndara mes dy familjeve feudale të dëgjuara për atë kohë, siç qenë Muzakajt dhe Matarangët.

Duke u nisur nga të dhënat që kemi, mendojmë se manastiri i Ardenicës e filloi jetën në shek. XIII--XIV. Data e mbishkrimit të hyrjes 1477 është e pazakontë, pasi në këtë periudhë nisur nga rrethanat historike, ndërtimet e reja janë minimale, për të mos

9) S. Mihalçka, **vep.cit,**

10) Th. Popa, **Materialet epigrafike kishtare të vendit si burime për historinë e kulturës së popullit tonë,** Kumtesë në Konferencën I-rë të Studimeve Albanologjike 1962, f. 570.

11) Dh. Dhamo: Studia Albanica 1/1986 f. 152, **Murg Simoni i manastirit të Ardenicës paraqitet me disa ikona të shek. XVII.**

12) A. Lorenzoni, Firenze, 1940, f. 12.

13) S. Mihalçka, **vep.cit,** f. 86.

Sipas këtij autori dora e dytë e pikturës së naosit është realizuar brenda v. 1744, vit i cili është i përbashkët edhe për dorën e parë, duke mos lënë vende për futjen e pikturës së narteksit si fazë e ndërmjetme. Shkëputja në kohë e dy duarve pikturore të naosit është evidentuar kur e lidh atë me arkitekturën, ndryshimet e së cilës janë të detyrueshme edhe për afreskun.

14) Th. Popa, **vep.cit,**

15) I. Snjegarov, **vep.cit,**

15) P. Thomo, **Arkitektura e kishës së Ristozit në Mborje të Korçës,** Studime Historike 2/1967, f. 157.

17) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien, 19 ...

thënë se u ndërprenë. Shekujt e mëvonshëm nuk kanë ndonjë refleks në arkitekturë, deri në ndërtimet e fillimit të shek. XVIII. Kjo kohë është për manastirin periudha kur arrihet fuqia më e madhe ekonomike. Ndërtimet shtrihen në sipërfaqen më të madhe. Kisha kthehet në një model për shumicën e kishave të Myzeqesë të ndërtuara në këtë kohë, ndërsa manastiri bëhet një nga më të frekuentuarit e zonës përrreth. Në këtë kohë ai shtoj marrëdhëniet ekonomike me zona të tjera, madje edhe të largëta.

TEKNIKAT E NDËRTIMIT

Teknika e ndërtimit e përdorur në kompleksin është e thjeshtë. Zgjidhjet konstruktive janë të njohura edhe në arkitekturën e banesës popullore. Në strukturat mbuluese është përdorur harku dhe qemeri. Ka shumë mundësi që stera-rrënojë të këtë qenë e mbuluar me kupolë. Harqet në shumicën e tyre janë realizuar me gurë gëlqeror. Skema e vendosjes është mjaft e efektshme, pasi jep mundësi të shfrytëzohen gurë me profile jo shumë të mëdha, duke realizuar në të njëjtën kohë një lidhje të qëndrueshme zinxhir (Tab. XIII, fig. 4), me vendosje në formën e gërmës T që përsëritet. I njëjti parim me përjashtim të vendosjes zinxhir ndiqet edhe në ballet e qemerit të hyrjes (Tab. XIII, fig. 3). Bëjnë përjashtim, si përsa i përket llojit të gurit, ashtu edhe skemës së vendosjes, harqet e mjedisit të mullirit dhe ato në katin përdhe të segmentit jugperëndimor (fig. 27), ku vendosja e gurëve shtuforë në seksion është e thjeshtë dhe në faqen e brendshme të harkut fugat vertikale janë të alternuara. Harqet e arkadave kanë në konturin e sipërm një shirit me tulla (përjashtuar harqet në brendësi të narteksit, mullirit dhe ato të katit përdhe të krahut jugperëndimor). Harqet mbështeten gjithnjë në gurë të plotë të profiluar, të cilët dalin nga planet e faqeve të harkut. Në rastin e harkadave me kolona cilindrike mbështetja bëhet në kapitele të thjeshta. Formues i harqeve është gjithnjë gjysmërrethi, përjashtuar këtu qemerin e hyrjes kryesore, që është më i shtrirë. Në asnjë rast nuk theksohet çelësi i harkut.

Gurët gëlqerorë, përdoren në pjesët që kërkojnë përpunim të veçantë, si harqet, qoshet e mureve, shpatullat dhe arkitrarët e dritareve, absidën e kishës, me tërë elementet e saj. Ky lloj guri preferohet për gdhendjen e lehtë, por ndërkohë përdoret



Figura 27

me ekonomi, pasi kavot e tij janë larg, kurse guri i shtufit gjendet pranë, në vetë kodrën e Ardenicës. Tullat përdoren si elemente konstruktive në qemeret, si elemente dekorative në harqet, si shtresë dyshemeje, në kornizat dhe zonën e sipërme të dritareve të kishës së madhe. Mbulimi i mjediseve të kateve të sipërme është me konstruksione druri. Ndarjet e mjediseve janë me çatma.

Themelet janë vazhdim i murit pa ndonjë zgjerim. Nga pikëpamja e konsistencës për cilësi më të mirë dallojnë pjesët më të vjetra, si rrënojat në qoshen perëndimore të konakëve. Në Kishën e Madhe ndodh e kundërta.

KONSIDERATA PËR ARKITEKTURËN

Kisha «Fjetja e Shën Mërisë»

Në kishat pasbizantine të vendit tonë vihet re tendenca e zmadhimit të tyre dhe pëlqimi gjithnjë e më tepër i tipit bazilikal.[18]) Ky tip siguron pjesëmarrjen e një numri më të madh besimtarësh, pasi përmasat e saj nuk krijojnë probleme të komplikuara konstruktive.

Në kuadrin e kishave pasbizantine, kisha e ma-

18) A. Meksi, P. Thomo, **Arkitektura pasbizantine në Shqipëri, (Bazilikat)** Monumentet 3/1981, f. 99.

DO NOT COPY

nastirit të Ardenicës, shquhet në pellgun e Myzeqesë për madhësinë, trajtimin arkitektonik dhe skemën funksionale. Trajtimi i fasadave të saj është bërë me një kujdes më të madh se në kishat e tjera të këtij grupi. Dritaret, harkada dhe shumë elemente të tjera tregojnë se kemi të bëjmë me një kishë nga më të spikaturat e këtij pellgu.

Për tërë kishat e Myzeqesë të kësaj periudhe, tipar i përbashkët është ndërtimi në tri anë, përveç anës lindore, i mjediseve në formë hajati të mbyllur. Në kishën e këtij manastiri është aplikuar hajati i hapur, i zhvilluar në formë harkade në anën jugore e perëndimore. Në krahun verior ai nuk ekziston. Narteksi i zhvilluar në dy kate e i zgjatur më tepër se fasada perëndimore e naosit, përafron me kishën e Shën Mërisë në kalanë e Beratit dhe kishat e Voskopojës. Piktura dhe punimi në dru i përgjigjen mirë rëndësisë që kishte fituar manastiri në atë kohë. Kisha pikturohet tri herë në një periudhë fare të shkurtër, nga piktorët më të shquar të asaj kohe. Ka shumë gjasë, që edhe faza e dytë, piktura e narteksit, të jetë realizuar nga e njëjta dorë që ka realizuar dy pikturat brenda naosit.

Konakët

Skema funksionale e manastirit në periudhën bizantine arriti modelin më të plotë, që si i tillë u trashëgua edhe më vonë (Tab. XIV, fig. 3,4). Pikat e saj kryesore qenë: një mur rrethues, një portë e punuar me kujdes dhe e pajisur jashtë saj me ndenjëse për kalimtarët, oborri qendror, kisha në qendër. Rreth saj zhvilloheshin ndërtimet e tjera, konakët me dy ose më shumë kate me një korridor të hapur përpara, si dhe shtëpia e miqve, trapezeria dhe pranë saj kuzhina e çesma dhe së fundi kambanarja[19]). Këto karakteristika të manastireve bizantine, i gjejmë të kristalizuara edhe në manastirin e Ardenicës. Skema funksionale i qëndron pothuajse besnike të vjetrës, duke përjashtuar tipin e kishës (Tab. XIV, fig. 1,2). Kjo e fundit bëhet e madhe dhe e përdorshme nga një shumicë njerëzish dhe jo vetëm të një seksi. Kjo ka qenë rrjedhojë e rolit të manastirit si pikë pelegrinazhi për tërë territorin fushor përreth, me ditë të shënuar 8 shtatorin. Përsa i përket pjesës tjetër të kompleksit, këtu gjejmë portalin e hyrjes, i cili paraqitet funksionalisht i njëjtë me skemën e vjetër. Rolin e murit rrethues e luan vetë mënyra e vendosjes së godinave. Një pjesë e manastireve, nisur nga kushtet dhe pozicioni, një kujdes të veçantë i kushtonin aspektit mbrojtës që përfaqësohet nga muri mbrojtës, kullat, frëngjitë etj. (Mesopotamit,[20]) Demës, Krorës, Kakome[21]) etj.) Në rastin tonë nuk ka elemente të tilla treguese për një mbrojtje të mirëfilltë. Mbrojtjen pasive në këtë drejtim e siguronte mbyllja e kompleksit, qenia e katit përdhe pa shumë dritare dhe organizimi me kujdes i hyrjes. Përveç murit rrethues nga skema klasike mungon trapezeria. Për të ka të dhëna se ajo ekzistonte deri në fillimet e këtij shekulli,[22]) e me sa duket vinte në një radhë me kuzhinën dhe furrën, pjesa e manastirit më e aksidentuar dhe me transformime të thella.

Që nga fillimet e tyre manastiret ortodokse kanë pasur kriter bazë shtjellimin rreth një qendre kryesore kompozicionale që përkon me kishën. Kisha ngelet gjithnjë në qendër të vëmendje, dhe asaj i kushtohet kujdesi dhe respekti më i madh. Mendojmë se ky rregull, i trashëguar nga e kaluara, është refleks i strukturës kishtare bizantine, e cila kishte natyrë të theksuar centraliste.

Konakët e manastirit janë një rast i veçantë i zhvillimit të banesës në përgjithësi, të cilët kanë tipare dhe elemente të përbashkëta. Ndërkohë, ato dallohen mjaft prej njëra-tjetrës. Banesa e manastirit (konakët) influencohen shumë nga banesa popullore e zonës ku ndodhen. Por këto janë lidhje të planeve të dyta, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me funksionet pjesore të godinës dhe me elementet e detajet arkitektonike. Në planin e kompozimit të përgjithshëm banesa e manastirit përafron me një gjini tjetër ndërtimore të karakterit shoqëror siç janë hanet. Por edhe ato dallojnë në funksion. Të parat konceptohen si banesë e përhershme e një grupi njerëzish, të cilët kryejnë tërë aktivitetin jetësor brenda territorit të manastirit, kurse funksioni i bujtjes radhitet në plan të dytë. Në të kundrët, në hanet, bujtja zë rolin kryesor. Ky ndryshim reflektohet detyrimisht në situatën arkitektonike.

Nisur nga raporti i banesës së manastirit me banesën popullore vihet re se ndërsa në të dytat bërthamën e kompozimit, siç mund të qe dhoma e zja-

19) C. Mango: Architettura Bizantina 1978, f. 109-110.
20) A. Meksi, **Arkitektura e Kishës së Mesopotamit,** Monumentet, 3, 1972, f. 47.
21) Gj. Karaiskaj, **«5000 vjet fortifikime në Shqipëri,** 19,
22) C. Patsch, **vep.cit,**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 28

rrit, matka, salloni apo çardaku[23]) e gjejmë brenda volumit të saj, në manastirin e Ardenicës si edhe tek të tjerat, qendra e gravitetit shpërngulet dhe del jashtë saj. Në mënyrë figurative do të thoshim se ka një lloj shpërthimi. Linja e vendosjes së dhomave është e lirë në pamje të parë, porse në të vërtetë, siç e pamë më sipër kjo kushtëzohet nga kisha (Tab. III).

Për vetë faktin se ndodhet pranë njërës prej qendrave qytetare më të fuqishme të periudhës mesjetare, siç është Berati, ndërkohë që këtej ka pasur edhe ndërvarjen kishtare, manastiri i Ardenicës ka shumë elemente arkitektonike të përafërta me ato të banesës së këtij qyteti, por që nuk arrijnë atë kombinim dhe ngjeshje organike mes tyre. Kështu çardaku në bllokun e hyrjes, nuk e zë atë vend që ka në banesën popullore (fig. 28), ku ky element trajtohet si i dorës së parë, si përsa i përket anës formale, ashtu edhe funksionit. Në rastin tonë çardaku ka dy porta në qoshet anësore, gjë e rrallë për çardaqet e banesave. Në këtë mënyrë ky element qëndron në mes çardakut dhe korridorit të hapur. Funksioni ndërlidhës, për mjediset ngjitur tij, në këtë rast është i zbehtë. Në banesën popullore funksioni ndërlidhës i çardakut arrin kulmin, paralelisht me atë të ndenjes, aq sa bëhet edhe elementi përcaktues i tipit. Ndryshe ndodh me hajatin dhe korridorin e hapur në tërë gjatësinë e dhomave. Për banesën popullore në përgjithësi, hajati, është një zonë pararendëse e brendësisë, pa pasur peshë për ndërlidhjen e mjediseve të tjera.[24]) Në manastirin e Ardenicës zotëron korridori i hapur, i cili ka funksion ndërlidhës të dorës së parë, si funksional ashtu edhe formal. Ai dominon plotësisht fasadat duke i dhënë atyre transparencë dhe duke krijuar një sfond të këndshëm e qetësues për oborrin. Ritmi i kolonadës e gjen refleksin e tij në pjesën qëndrore të kompleksit, në hajatet e kishës. Së fundi, ai dallon nga korridoret e manastireve të tjerë, pasi ka një thellësi më të madhe.

Një pikë e ngjashme midis dy llojeve të banesave është edhe ndarja funksionale në lartësi. Funksionet e dorës së dytë kryhen në katin përdhe dhe banimi në të sipërmin. Zhvillimi në dy kate përbën një karakteristikë tjetër për këtë manastir. Në këtë mënyrë, ai i përafrohet grupit të banesës me kompozim horizontal.[26])

23) K. Zheku, **Banesa Tiranase,** Monumentet 2, 1971, f. 118.
V. Shtylla, **Të dhëna arkitektonike mbi banesën e vjetër fshatare të rrethit të Lushnjës,** Monumentet.
L. Lazimi, **Çardaku në banesën Beratase,** Monumentet 11, 1976, f. 173.
24) E. Riza, **Banesa popullore në qytetin muze të Beratit,** Monumentet 5-6, 1973, f. 101.
25) **Po aty** 5-6, 1973, f. 101.
26) E. Riza, **Tipare të krijimtarisë popullore në banesën qytetare shqiptare,** Monumentet 2/1982, f. 7-10.



Figura 31

Mjediset për miqtë gjenden edhe këtu, sikurse në banesën popullore, porse vendosja e tyre në raport me të tërën ndryshon gjithnjë, duke të kujtuar më tepër banesën gjirokastrite[27]). Përsa i takon elementeve e detajeve të tjera arkitektonike, si: strehët, harqet, kolona, kapitele, dritare etj, këtu çdo gjë të kujton banesën popullore, vetëm me një dallim se këtu ndihet një thjeshtësi më e madhe. Ato nuk arrijnë asnjëherë të bëhen aq elegante dhe të pasura si në banesat. Në mënyrë më të qartë kjo duket në elementet prej druri të interiereve. Fryma e thjeshtësisë zotëron tërë kompleksin, aq sa mund ta quanim këtë një tipar të veçantë të tij. Ndërkohë, shtrirja e madhe e ndërtimit të kishës dhe hedhja në vertikalitet e kullës së kambanores krijon edhe ndjenjën e madhështisë, duke ruajtur në të njëjtën kohë raporte të drejta të arkitekturës me njeriun.

27) E. Riza, **Tipare** f. 7.

DO NOT COPY

TAB. I



DOKUMENT COPY

DO NOT COPY







TAB. III



1



2

DO NOT COPY

TAB. IV



DO NOT COPY



PRERIA A-A *Faka e patë*





PRERJA A-A *Faka e dytë*



DO NOT COPY

TAB. VI













DO NOT COPY

TAB. VII.



DO NOT COPY

TAB. VIII



DO NOT COPY

DO NOT COPY

PLANIMETRIA



PRERIA B-B



PLANIMETRIA



PRERIA B-B



TAB. X







DO NOT COPY

3

TAB. XI













DO NOT COPY

TAB. XII













DO NOT COPY

TAB. XIII



1



2



3



4



5

DO NOT COPY

TAB. XIV

DO NOT COPY

KATI I PARE



1

SKEMA FUNKSIONALE E MANASTIRIT TE ARDENICES

KATI PERDHE



2

SKEMA FUNKSIONALE E MANASTIRIT BIZANTIN



3

KATI . PERDHE



4

KATI I PARE

shpjegues

HYRJET

DHOMA E PORTARIT

DEPO

TRAPEZERI

DHOMA E PJETJEJE

DEPO UJI

PORTIKE, HAJATE

BIBLIOTEKA

TAB. XV









DO NOT COPY

Reshat GEGA

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE ET LA RESTAURATION DU MONASTERE «LA DORMITION DE LA VIERGE» A ARDENICE

Le monastère «La Dormition de la Vierge» à Ardenice (la région de Lushjna) représente l'un des plus importants monuments de la période médiévale de notre pays. Il s'érige sur un terrain bien élevé, prédominant les alentours, sur l'une des collines de la chaine côtière qui prend naissance à Kavaja. A son ouest, passait l'une des principales artères routières de l'Antiquité et du Moyen Age.

Le bassin de Myzeqe, au centre duquel s'élève ce monastère, traditionnellement a été occupé de centres habités de différentes potentialité, depuis les plus développés tels Durrah, Apolloni, Antipatrea, Bylis, Dimal etc jusqu'aux plus petits tels Babunje, Mbolan, Pirg, Bashtove, Stan Karbunar et l'habitat le plus proche du monastère, Çuka e Bregut të Madh, à l'extrémité méridionale de la colline.

De pair aux centres ruraux et urbains, à Myzeqe on remarque des constructions de culte telles les monastères et les églises. Il y a eu quelques anciens monastère dont on ne conserve que des ruines ou quelques données orales comme p.ex. le manastère de Saint Sava à l'ouest de la ville de Lushnja, de la période avant l'invasion turque, le monastère de Saint Nicolas au village Karbunar, de la période avant l'invasion turque, la Grande église ou l'église Rouge sur la plus haute partie de la colline de Lushnje. D'après la tradition orale le monastère de Saint Vendredi près du village Mërtirë remonte à la période avant l'invasion turque, le monastère de Saint Georges au village Shëngjergj au XVIIe-XVIIIe sc, celui de Saint Theodor à Kadi Pasha, au XVIIIe sc, celui de Notre Dame à Kolkandas au début du XVIIIe sc (il fut reconstruit au début du XIXe sc par Ali Pasha) et le monastère de Sainte Varvara près du village Barbullinj, au XIIe-XIIIe sc.

Les chercheurs et les voyageurs n'ont donné qu'une simple déscription sur le monastère d'Ardenica. Quant à l'église de la fondation, on s'est référé aux traditions orales sans entreprendre des travaux concrets sur l'objet en question. Les travaux de restauration, effectués pendant ces quatre dernières années contribuèrent à l'estimation de ce complexe sous tous ses aspects, architectoniques et artistiques. Ils mirent en évidence les phases de construction et dans une certaine mesure, la période de la fondation.

Le monastère d'Ardenica fait partie du type byzantin dont la principale particularité fut le développement de la planimétrie en s'appuyant sur un axe central, un rôle qui appartint toujours à d'église.

Le terrain sur lequel s'élève le complexe, à conditionné jusqu'à une certaine mesure la forme de la planimétrie des pièces qui prennent la forme d'un triangle irrégulier. C'est une construction à un etage. Au rez-de-chaussée se trouvent les communs et au premier étage les chambres et les salles de bain. La plus grande partie des façades de la cour se présente par des galeries ouvertes en arcade au premier étage et en colonnade au rez-de-chaussée.

L'entree principale se trouve à l'est alors que près du coin nord-est il y a une petite porte pour le betail. Le bloc est traversé de la galerie d'entrée couverte de voûte cylindrique peu courbée. Au coté septentrional se trouve la pièce du moulin et au cote oppose celle du portier, toutes les deux couvertes de voûtes cylindriques en briques. Deux arcs en pierre qui renforcent la voute, divisent en trois parties la piece du moulin. Le premier étage de ce bloc est utilise comme pièce de séjour. Au-dessus de la galerie d'entrée s'élève la chambre de séjour alors que des deux côtés se trouvent les chambres à coucher.

La chaine des pièces s'interrompt deux fois par les endommagements que le monuments à subi au cours de ce siècle.

Au centre de ce complexe se situe la grande eglise «La Dormition de Sainte Marie», la petite église de «Sainte Trinite», et le réservoir-puit. Ils sont entourés d'une cour à de différents niveaux, selon le terrain.

L'entrée à la chapelle de «Sainte Trinté» est assuree par une porte percee sur sa face occidentale. L'abside, le diaconiçon et la prothese se developpent à l'interieur de la section du mur. Deux fenetres ouvertes sur la face meridionale eclairent l'interieur. Un reservoir d'eau, dont la principale façade donne sur l'est, est joint au côté oriental.

La grande église représente le type de la basilique couverte de toit en bois. Deux rangées de colonnes en bois divisent le naos en trois. On y accède au moyen de deux portes latérales, alors qu'une troisième porte à l'ouest assure la communication entre le naos et le narthex. Celui-ci se développe à la hauteur de deux étages et se divise en trois nefs par deux rangées d'arcades en pierre. Sur la face occidentale il y a une porte qui donne accès au porche de ce côté tandis qu'au côté méridional se situent le baptistère et le clocher. La façade méridionale de l'église se présente par l'arcade du porche de ce côté. Le passage de la cour ou porche, se réalise

par un escalier en pierre. Devant le porche occidental s'étend la plateforme, au coin de laquelle s'élève l'arcade du réservoir en forme de puit. Tous les arcs des portes et des arcades sont en plein cintre, réalisés en pierres.

Le plan de la restauration prévit, dès le début, de s'arrêter sur quelques questions. Ainsi, on organisa l'état statique de toutes les structures et entre temps on entamma des sondages afin de préciser les formes originales. On examina l'état physique-chimique des matériaux et des éléments utilisés, on répara toutes les structures des couvertures et on mit en lumière des formes architectoniques dissimulées par des interventions ultérieures. Les arcs, les voûtes, les murs et quelques fois les fondations furent réparés et consolidés. On chercha les pavés des anciennes cours et on mit en évidence les niveaux originaux du terrain, tant à l'intérieur qu'à l'extérieur. Les interventions touchèrent tout le complexe, les pièces et les églises. Tout le processus de restauration s'appuya sur les sondages effectués qui servirent d'une part à vérifier l'état technique de toutes les structures, ce qui rendit plus facile la définition de l'intervention convenable, d'autre port créa une vue réelle du processus des constructions que le complexe subit dans le temps et l'espace.

En général, les interventions furent simples, du point de vue technique. On utilisa les tirants méthaliques au niveau des planchers et des plafonds, afin d'éliminer les mouvements circulaires du mur extérieur des pièces au sud-ouest et du mur septentrional du naos de l'église. On répara le mur de refend qui divisait le naos du narthex, et au premier étage on procéda à la méthode de la réfection après avoir enlevé une partie de l'afresque. La partie supérieure du mur fut attachée sur toute sa longueur d'une chaine de beton-armé invisible. Elle sert en même temps à répartir uniformément les charges des deux toits.

Les fondations d'un des contreforts qui avait perdu sa capacité de soutènement et risquait de s'écrouler, furent refaites de beton et de pierres et attachées d'anneaux métaliques.

Au sud, on mit en évidence les ruines des pièces perdues et on consolida leur partie supérieure.

Les sondages effectués, mirent au jour beaucoup d'autres éléments. Ainsi au coin occidental, vers le nord jusqu'au moulin à huile, furent découvertes des ruines de murs. Elles démontrent la forme planimétrique des phases précédentes du monastère. A l'extremité occidental on précisa l'entrée qui y donnait accès. Des ruines furent mis au jour même au sud-est et au nord-ouest de l'église, en face du naos.

Toutes les ruines et les traces conservées aux pièces du rez-de-chaussée, aidèrent à mieux saisir l'évolution de la construction du monastère. La mise en évidence et la récupération des niveaux originaux par l'enlèvement des remblais ultérieurs, apporta un image de l'ensemble des pièces, des rapports initiaux des volumes en leur hauteur.

Dans ce but on procéda à la reconstruction du balcon de la façade orientale de l'entrée, à la reconstruction de l'escalier près du tchardak de l'entrée et enfin au complètement de la couverture de la fontaine du résevoir méridional, près de la grande église. Ces complètements se basèrent sur des traces sûres, qui furent assez suffisantes pour ne pas donner lieu à des hypothèses sur les formes originales. Leur construction ne cache et n'altère aucun élément.

Les sondages effectués à la petite église touchèrent toute la surface du plancher. En creusant par couche jusqu'au plus ancien niveau de la construction, on mit au jour quatre phases de construction. De la planimétrie de la première phase qui est plus petite que celle actuelle, il ne reste qui trois murs, celui oriental, méridional et occidental. Le plancher est pavé de briques cuites aux dimensions régulières et conserve les traces de la traverse inférieure de l'inconostase en bois.

Le terrain du côté oriental a servi de cimetière Selon des données accessoires, telles les briques du plancher, l'analyse des squelettes de la cimetière, etc cette phase remonte au XIIIe XIVe sc.

Pendant la deuxième moitié du XVIIIe sc, à l'est, fut construit un réservoir d'eau. Plus tard, après avoir subi un endommagement, la chapelle fut reconstruite sur une plus longue planimétrie, occupant même le réservoir. La reconstruction de ce siècle représente la deuxième phase.

Après les fouilles effectuées, afin d'être lisible la chapelle fut conservée telle quelle.

Les sondages effectués aux fondations de la grande église «La Dormition de la Vierge», mirent au jour trois phases de construction. Pendant la première phase on réalisa le naos et ses affesques et au sud on construisit un réservoir en forme de puit à planimétrie circulaire. Au cours de la déuxième phase, à la façade occidentale du naos, fut ajouté un porche en bois peint. La fresque bouche les deux fenêtres de la façade, sans rien toucher à la porte. La troisième phase apporta à l'église de grandes transformations. On construisit depuis les fondations les murs septentrionnal, oriental et méridional du naos, conservant seulement son mur occidental et sa fresque. Les anciens matériaux furent réutilisés à la reconstruction du naos et à la construction du porche méridional. Celui-ci qui fut élevé sur les ruines du réservoir, est contemporain au narthex et au porche occidental. L'intérieur du naos fut repeint par le même peintre. Au mur occidental on perça quatre fenêtres qui furent disposées deux par deux au rez-de-chaussée et au premier étage du narthex qui s'harmonisèrent bien avec la nouvelle peinture du naos. La fresque extérieure fut altérée par les nouvelles fenêtres qui diminuèrent aussi la hauteur de la porte du rez-de-chaussée du narthex.

En général, l'ensemble demeura à cet état, à l'exception de quelques modifications effectueés au cours de ce siècle telles: la construction du baptistère, du clocher, le percement d'une porte à l'extrémité nord du narthex etc.

Le commencement de la construction appartient aux années 30-40 du XVIIIe sc, alors que les peintures des Zograf re

DO NOT COPY

DO NOT COPY

SHPRESA PRIFTI

BANESA E KRAHINËS SË KELMENDIT*)

Në kuadrin e gjurmimit dhe vënies në mbrojtje të ndërtimeve fshatare, nga Instituti i Monumenteve të Kulturës u kryen dy ekspedita në krahinën e Kelmendit, deri sot e pashkelur, për qëllime studimi të banesës së kësaj krahine[1]).

Materiali i mbledhur në fshatrat Niksh, Vukël, Tamarë, Selcë, Gropa, Lepushë e Vermosh me paraqitjen e banesave më karakteristike të këtyre fshatrave, do të na japë mundësi të parashtrojmë tiparet e përgjithshme të tyre, evolucionin, përhapjen, si dhe anët e përbashkëta e dalluese ndërmjet tyre.



Figura 1

Zona e Kelmendit, në qendër të Alpeve Shqiptare, është krahinë etnografike e Malësisë së Madhe, në anën veriperëndimore të saj. Historikisht ajo përfshin trevën ndërmjet brigjeve të dy lumenjve, lumit të Nikshit dhe lumit të Vuklit. Vendbanimet e krahinës së Kelmendit për vetë karakterin tepër të thyer të rajonit janë të shpërndara, dhe sipas truallit ku ngrihen, vendosen në rrafshe malore si Vukli, në luginat rrëzë maleve Nikshi (fig. 1). Lepusha (fig. 2), apo në luginat e lumenjtë si Tamara e Vermoshi (fig. 3). Këto kushte të truallit, klima tepër e ashpër malore bënë që në të kaluarën të mbizotëronte ekonomia blegtorale. Dimërimi i bagëtive bëhej në ultësirat pjellore buzë detit dhe rreth liqenit të Shkodrës, ndërsa shkëmbimi i produkteve blegtorale dhe bujqësore të ekonomisë fshatare bëhej në pazaret e zonave të afërta siç ishin ato të Gucisë e të Plavës.

*) Rilevimet janë të S. Terezit e H. Gjinit, vizatimet të S. Terezit ndërsa fotografitë të autorit dhe P. Sulit.

1) Gjatë ekspeditës së parë të kryer më 1978 u gjurmuan fshatrat Niksh, Vukël, Tamarë, Selcë e Vermosh, ndërsa gjatë ekspeditës së dytë të kryer në v. 1987 u rigjurmua fshati Vermosh dhe u gjurmuan fshatrat Gropa, Lepushë.

DO NOT COPY



Figura 2



Figura 3

Disa të dhëna burimore në pragun e pushtimit turk na lejojnë që të krijojmë një ide mbi popullimin e krahinës së Kelmendit. Sipas defterit të regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485[2]), zona e Kelmendit kishte pesë fshatra. Njëra prej qendrave të banuara që përmendet në këtë regjistër, Selçishta (mundet Selca) del se në atë kohë numëronte 40 shtëpi. Sipas një të dhëne të vitit 1638[3]) del se zona e Kelmendit ka pasur afro 250 shtëpi dhe 2900 frymë. Pushtimi osman me forma të reja të shfrytëzimit ekonomik i vuri kelmendasit përballë presionit gjithnjë e më të madh. Të detyruar për të mbrojtur autonominë e tyre të brendshme, ato u vetëizoluan në zonat e thella malore. Taksat, të cilat i varfëronin shumë[4]), të vendosura mbi truallin, banesën apo bagëtinë preknin dhe kullotat. Kjo i detyroi malësorët t'i dimëronin bagëtitë e tyre tashmë në luginat rrëzë maleve, apo lumenjve, relativisht më të varfëra me kullota, duke vazhduar për një kohë të gjatë vendosjen e tyre në dy vendbanime në mal dhe në fushë. Deri në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XIX zonat Tamarë, Lepushë, e Vermosh, të pasura me kullota, kanë shërbyer si stane për dimërimin e bagëtive të vendbanimeve Selcë, Niksh e Vukël. Ky fakt shpjegon dhe zhvillimin e paktë dhe relativisht të ri të këtyre fshatrave të vendosura në luginat rrëzë maleve e lumenjve, në ndryshim nga ato të zonave të thella malore, për të cilat kemi të dhëna burimore si dhe gjurmë të banesave të vjetra. Të dhënat gojore hedhin dritë mbi ndërtimet e staneve, të cilat ishin ngrehina të thjeshta, provizore të ndërtuara me dërrasa e materiale të tjera rrethanore. Shpesh këto vendqëndrime shfrytëzonin terrenet e pjerrëta duke prerë shpatin malor në formë drejtkëndëshi dhe duke trajtuar hyrjen me materiale rrethanore.

Banesa përbën njësinë kryesore ndërtimore të kësaj krahine. Përgjithësisht ato janë të vendosura larg njëra-tjetrës, me një orientim pak a shumë të detyruar, duke shfrytëzuar me mjeshtëri truallin. Kjo vendosje e tyre ka krijuar një rrjet të çrregullt rrugor, i cili ndjek vijat e niveleve me zikzake, për t'u lidhur me rrugët kryesore, të krijuara në, përgjithësi, nga vetë trualli i ngjeshur pjesërisht shkëmbor. Banesat janë me oborre të krijuara nga rrethimi i truallit pranë banesës me gardhe. Këtu shpesh gjejmë ndërtime ndihmëse të ekonomisë familjare (fig. 4) si për mbajtjen e barit apo të ushqimeve; si koçeku i misrit (fig. 5) ose ndonjë çaranik prej druri. Vetë banesa, me truallin rreth saj e ndërtimet përreth, është një ekonomi ndihmëse e shëndoshë për jetesën e familjes. Kjo zonë, e cila strehonte kryesisht popullësi blegtorale, pasqyronte në vetvete një program relativisht të varfër kërkesash jetësore duke kushtëzuar një banesë përgjithësisht të thjeshtë, që mbeti deri vonë

2) Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 fq. 2 «Nahija e Kelmendit ka pesë fshatra...».

3) Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII, vëll. II.

4) Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës, të vitit 1495 «Është urdhëruar që të krishterët e fshatrave të sipërpërmendura (Selçishtë etj.) të paguajnë sanxhakbeun në formë qesimi 1000 akçe haraç dhe po kështu në formë qesimi 1000 akçe ispenxhe».

DO NOT COPY



Figura 4

në stade të ulëta zhvillimi. Duke u nisur nga shtrirja e saj kohore, dhe shfaqja e disa koncepteve të reja në kompozimin e banesës apo në trajtimin e elementeve të ndryshme të saj në fillimet e shek. XX, banesën e krahinës së Kelmendit do ta ndajmë në dy njësi: në banesën e ndërtuar prej gjysmës së dytë të shek. XIX, deri në fundin e shek. XIX dhe në banesën e periudhës prej fillimeve të shek. XX deri në mesin e shek. XX. Në njësinë e parë materialin bazë e japin banesat rrënojë të cilat do të jepen ashtu siç janë gjetur, si dhe fillimet e lindjes së tipit të ri të banesës të kësaj krahine, evolucioni dhe përhapja e së cilës do të trajtohet në njësinë e dytë.

Përpara se të kalojmë në parashtrimin e materialit faktik po ndalemi tek përcaktimi i mjediseve formuese të banesës dhe pikërisht te shtëpia e zjarrit, mjedisi i fjetjes dhe ahuri.

Shtëpia e zjarrit është mjedisi kryesor i banesës, pjesë përbërëse e saj në çdo kohë, me një trajtim mjaft të thjeshtë. Në variantet e thjeshta, kur banesa ishte një kthinëshe ajo ka funksione të plota e të mbingarkuara, si qëndrimi, gatimi, fjetjeje dhe mikpritjeje njëherazi. Në variantet e zhvilluara ajo humbet pjesërisht apo plotësisht funksionet e fjetjes, duke ruajtur gjithnjë atë të mikpritjes. Elementi kryesor i saj është vendi i zjarrit – vatra.

Mjedisi tjetër, ai i fjetjes, përfaqëson një kthinë me funksione qëndrimi e fjetjeje. Karakteristik për të është mungesa e vatrës.

Ahuri është një mjedis i zakonshëm i banesës në të gjithë variantet e saj. Ai është vendi ku mbahen bagëtitë dhe kafshët e trasha. Me nxjerrjen e tyre jashtë, ahuri bëhet i banuar duke ndërtuar përgjithësisht në të shtëpinë e zjarrit. Mbi bazën e kriterit tipologjik dhe kronologjik, aq sa na lejojnë të dhënat, po kalojmë në analizën e banesave të kësaj krahine.

Banesa e gjysmës së dytë të shek. XIX. Një ndihmesë të veçantë për studimin e banesës së kësaj krahine na japin gjurmët e banesave të vjetra të ruajtura deri sot në formë rrënojash. Këto rrënoja, tri në numër, i gjetëm në fshatin Nish. Numri relativisht i vogël i tyre e bën të vështirë studimin dhe përcaktimin e banesës së përhapur në atë periudhë. Gjurmët e rrënojave, veçanërisht të njërës, e cila ruan në lartësi të plotë muraturën, hedhin dritë mbi zhvillimin e banesës me kat, duke lejuar ndjekjen e formës planimetrike të saj me përmasa të zgjatura në plan (Tab. I, fig. 6). Banesës i mungon çatia si dhe të gjitha ndarjet e pajisjet e mundshme që mund të ketë pasur. Kati përdhe që në gjendjen e sotme formohet nga një mjedis, ka një hyrje të vetme (fig. 7), që është mbuluar me hark guri, ndërsa



Figura 5

shpatullat e saj përkufizohen nga dy masive guri. Dera është njëflegërshe, me dërrasa të afruara, pajisur me një prag të plotë guri. Ky mjedis ndriçohet nga dy dritare përkufizuar me blloqe guri. Trajtimi i brendshëm i muraturës së katit të banuar, volumi i bollshëm i saj, të lënë të mendosh për një ndarje të lehtë, e cila duket se kishte krijuar dy kthina banimi, respektivisht e krahut të djathtë, shtëpia e zjarrit dhe ajo e krahut të majtë, mjedis banimi. Në faqen e ngushtë shtëpia e zjarrit ka vatrën karakteristike, si dhe dy kamare pranë saj. Të dy mjediset kanë kamare të vendosura asimetrikisht dhe me përmasa të ndryshme. Ato ndriçohen nga dritare të përkufizuara me blloqe guri. Banesa, në katin e banuar, në pamjen e pasme, ka një hyrje me një trajtim mjaft interesant të muraturës që e qarkon[5]) (fig. 8). Vendndodhja e saj të bind për lidhjen me shtëpinë e zjarrit, e cila del se ka patur dalje të drejtpërdrejtë në mjedisin e jashtëm. Banesa duhet të ketë patur shkallë të brendshme druri. Teknika e murit të gurit me llaç gëlqereje pa breza druri është realizuar me gurë relativisht të mëdhenj, punuar trashë dhe të vendosur në formë të çrregullt. Zgjatja e dy mureve anësore tregon se banesa ka patur çati dy ujëse, pjerrësia jo e madhe e të cilave na ndihmon



Figura 6



Figura 7

të mendojmë se si mbulesë ka patur rrasa guri. Gjithë banesa, me sipërfaqe të plota e të rrafshta muresh, çati me rrasa guri e trajtim të varfër arkitektonik ka trajta të mbyllura, të cilat i japin asaj karakter mbrojtës. Të vetmet elemente ku ndjehet përkujdesja dekorative janë gdhendjet e qosheve, harqet e paturat e dyerve e dritareve. Në rrënojën tjetër ruhet mjaft mirë gjurma e vatrës karakteristike, si dhe kamaret bri saj (fig. 9). Nga ana teknike muratura është ndërtuar gjithashtu me gurë të punuar trashë, lidhur me llaç gëlqereje, duke përdorur gjerësisht dhe gurët e vegjël. Dhe për të dy rrënojat e tjera (fig. 10, fig. 11), pavarësisht se përcak-

5) Ajo qarkohet nga tri radhë harqesh, ku harku i parë i rregullt, vazhdohet nga i dyti i cili mbështetet tek guri i shpatullës duke u zgjeruar drejt kyçit të harkut dhe përfundon me harkun e tretë me dimensione të çrregullta gurësh, i cili arrin deri te niveli i çatisë. Shpatullat e derës përbëhen nga katër masivë guri ku ata poshtë harkut (52 x 64 cm) janë skalitur me forma të rregullta gjeometrike (fig. 12).

DO NOT COPY



Figura 8



Figura 9

timi i përmasave të tyre në plan është i pamundur për mungesë gjurmësh të sigurta, volumet e tyre tregojnë se kanë qenë banesa me kat, dukuri e cila ka paralele dhe me krahinat e tjera të Shqipërisë Veriperëndimore[6]). Të dhënat gojore, karakteristikat e tyre, teknika e ndërtimit në ngjasim me banesat e zonave fqinje, të datuara rreth gjysmës së dytë të shek. XIX, na shtyjnë t'i datojmë dhe këto si të kësaj periudhe.

Banesat e mëvonshme, të fundit të shek. XIX, të cilat përbëjnë dhe objektin kryesor të këtij studimi, duke u cilësuar si banesa karakteristike të krahinës, ndonëse ruajnë një skemë të ngjashme planimetrike dhe funksionale të thjeshtë, të ngjashme me ato të rrënojave të gjetura në fshatin Niksh, fitojnë elemente të reja arkitektonike e konstruktive duke pasuruar e gjallëruar mjaft trajtimin e përgjithshëm arkitektonik të tyre. Zgjidhja kompozicionale mbetet ajo me kat, ndërsa si elemente të reja kemi ballkonin prej druri i cili vendoset gjatë gjithë gjatësisë së faqes (i ashtuquajtur nga vendasit «shameshin») dhe ajo që është më karakteristike dhe e reja thelbësore, çatia e lartë e tipit alpin me pjerrësi të madhe e mbuluar me dërrasa, e cila e dallon qartazi këtë banesë nga banesat e krahinave të tjera, duke gjetur paralele vetëm me atë të krahinës së Dukagjinit. Përfitimet e kësaj çatije ishin të dukshme. Ajo ishte mjaft e përshtatshme për largimin e dëborës, duke lehtësuar kështu dhe ndërtimin e saj. Hapësira e bollshme e krijuar nën çati pati një përdorim të gjerë, në variantet e thjeshta



Figura 10

6) P. Thomo, **Banesa fshatare e Shqipërisë veriore,** Tiranë 1981.

DO NOT COPY

për depo dhe në ato më të zhvilluarat për banim, duke kushtëzuar kështu banesën dykatëshe. Këto karakteristika dalluese të shkrira dhe me elemente të tjera të banesës, dhanë mundësinë e krijimit të zgjidhjeve të shumëllojta e të arritura arkitektonikisht me një karakter të veçantë dallues të banesës së krahinës së Kelmendit. Megjithatë, arsyeja e përhapjes së kësaj çatije në një masë kaq të kufizuar nuk shpjegohet dot me kushtet ekonomiko-shoqërore dhe natyrore të këtyre krahinave, të cilat i gjejmë dhe në krahina të tjera të vendit. I rëndësishëm, e që vlen të dallohet për këtë çati, është fakti se ne e takuam atë në një formë të plotë zhvillimi pa gjetur faza të ndërmjetme ndërtimi, gjë që na ndihmoi të hedhim mendimin se ndoshta ajo është e ardhur në këtë zonë. Lidhur me fillimet e ndërtimit të kësaj çatije jemi të mendimit se i takon fundit të shek. XIX, ndërsa shfrytëzimi për banim i hapësirës nën çati fillon aty nga çereku i dytë i shek. XX. Këto probleme thelbësore, që lidhen me krijimin e një tipi të caktuar banese, mbeten hipotetike duke pritur gjurmime më të thelluara në të ardhmen.

Këtë tip banese, sipas rastit, e takojmë me një, dy apo me shumë mjedise banimi që përbëjnë dhe variantet e saj. Llojin më të thjeshtë të saj me një mjedis të vetëm e gjetëm në fshatin Niksh. Banesa Nr. 2 (Tab. I) fig. 13, sot është e ndryshuar në katin e banuar, por gjendja fillestare e saj arrihet duke patur parasysh gjurmët origjinale si dhe dëshmitë gojore. Ajo formohet nga mjedisi përdhes i pabanuar dhe mjedisi i sipërm i banuar. Kati përdhe, një mjedis i vetëm i quajtur nga vendasit ahuri, shërben për të strehuar bagëtinë dhe për të depozituar ushqimin e saj. Shtëpia e zjarrit, në murin anësor në qendër, ka të ndërtuar vatrën, përmasat relativisht të mëdha të së cilës kanë justifikuar funksionin që ajo ka patur në fazën fillestare, si një kthinë e vetme banimi. Vendi i zjarrit është i pajisur me kanal tymi i cili del lart në çati me një oxhak guri. Shtëpia e zjarrit ndriçohej nga një hapësirë e vogël drite, e cila ruhet e murosur në pamjen ballore. Ngjitja në kat bëhet me shkallë të jashtme druri, të cilat lidhen me shameshiun karakteristik që vendoset gjatë gjithë gjatësisë së faqes. Ai del jashtë konturit të banesës i mbuluar nga dalja tepër e madhe e çatisë në këtë faqe.

Shembujt me kat me dy kthina banimi janë më të përhapur në këtë krahinë. Ato i përgjigjeshin më mirë nevojave jetësore të banesave. Banesa Nr. 3 (Tab. II), në fshatin Vukël, paraqet një zgjidhje disi të veçantë planimetrike. Ajo ruhet në gjendje



Figura 11



Figura 12

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 13



Figura 14

të mirë, por ka pësuar ndryshime me zmadhimin e dritareve dhe hapjen e dritareve e dyerve të reja. Ajo ka një kompozim të shtrirë me dy mjedise banimi të cilat sipër, korrespondojnë me dy mjediset e poshtme E veçanta në këtë banesë është se të katër mjediset kanë hyrje të drejtpërdrejta nga jashtë, pa ndërlidhje të brendshme. Mendojmë se komunikimi i brendshëm i dy mjediseve të katit do të jetë mbyllur në kohë, ndërsa hapja e dyerve të reja shpjegon një fazë të ndërmjetme punimi. Ndërlidhja me katin bëhet nga shkallë dy rampëshe druri e ndërlidhur nga shameshini, i cili në gjerësinë e tij ka të ndërtuar një çaranik prej thuprash, që është një pajisje ndihmëse për familjen dhe shërben për ruajtjen e mbajtjen freskët të ushqimeve. Mjedisi i krahut të djathtë, ai i fjetjes, i ruan elementet origjinal, portën si dhe dy hapësirat për ndriçim. Shtëpia e zjarrit me vatrën në faqen e ngushtë bri saj ka patur një ndërtim të dalë, funksioni i të cilit mbetet i paqartë. Ndërsa pamja ballore e banesës pasurohet dhe lehtësohet mjaft me dyert e harkuara si dhe kompleksin e shameshiut me shkallët, faqja anësore e pandryshuar trajtohet në kontrast me të, mjaft e mbyllur dhe e varfër, vetëm me një hapësirë minimale ndriçimi. (fig. 14).

Një zgjidhje më të përparuar të banesës me dy kthina banimi, që përbën njëherazi shembullin tipik të banesës së krahinës, paraqet banesa në fshatin Selcë. Banesa Nr. 4 (Tab. II, fq. 15) ka një kompozim të shtrirë, duke patur një mjedis të vetëm në katin përdhes dhe dy mjedise banimi në kat, të lidhura me mjedisin e jashtëm nga një portë e vetme me ndërlidhje nga brenda. Këto mjedise kanë pësuar ndryshime veçanërisht me zmadhimin e hapjen e dritareve të reja. Shtëpia e zjarrit ka një organizim të veçantë të faqes ku ndodhet vatra. Ajo i largohet skemës klasike të mjediseve me vatër zjarri në mes, në rastin tonë e zhvendosur pothuaj në skaj të faqes. Perdja ndarëse e dy mjediseve ka një zgjidhje interesante si rezultat i futjes së disa pajisjeve të reja, siç janë dollapet e murit, e kushtëzuar kjo edhe nga prirja për një komoditet më të mirë të banimit. Në gjysmën e gjatësisë së saj ajo vjen më e futur në volumin e shtëpisë së zjarrit, duke u trajtuar në formën e një dollapi muri (fig. 16), i cili shërben për të vendosur rrobat e familjes. Tani dhoma merr një përkujdesje më të madhe. Ajo ka tavan me dërrasa të punuar dhe muratura e saj qarkohet me një fashaturë të thjeshtë në nivelin e dritareve. Një pajisje të thjeshtë në formën e një dollapi me sergji, që shërben për të vendosur enët e kuzhinës (fig. 17), e shohim edhe në shtëpinë e zjarrit. Të dy mjediseve të katit u janë murosur dritaret origjinale. Gjithë trajtimi i jashtëm i banesës ka një përkujdesje më të madhe. Dritaret me hapësirë të plotë drite përkufizohen me fashatura dërrase, muratura prej guri punohet më pastër, veçanërisht ajo e ballit të katit të sipërm fugatohet me llaçin e gëlqeres, duke spikatur nën strehën e dalë të kompleksit shameshiu — shkallë që është vendosur gjatë gjithë gjatësisë së saj. Në mjedisin e saj rrethues banesa ka një ndërtim ndihmës, koçekun e misrit, i cili ka for-

DO NOT COPY



Figura 15

më prizmatike me bazë drejtkëndëshi prej druri, mbuluar nga një çati me dërrasa e ngritur paksa nga trualli.

Banesa e fillimit shek. XX deri në mesin e shek. XX

Kushtet e reja ekonomiko-shoqërore të shek. XX, të lidhura ngushtësisht me kërkesat e kohës, sollën shfaqjen e disa koncepteve të reja si në kompozimin e banesës, ashtu dhe në trajtimin e ndryshëm të



Figura 16

elementeve arkitektonike. Shkaqet duhen kërkuar veçanërisht në mënyrën e jetesës me kërkesa për një komoditet më të madh në banesë, që fillon e shkëputet nga koncepti i volumit drejtkëndor me ndërlidhje të brendshme duke fituar forma të reja në plan. E rëndësishme, madje thelbësore, për këtë banesë është kthimi i katit përdhe në të banuar, duke larguar prej saj funksionin e strehimit të bagëtive. Mjediset ndërlidhen me anë të korridorit qendror duke



Figura 17

ruajtur tradicionalisht shkallët e jashtme si dhe shameshiun prej druri. Banesa e re dallohet për një trajtim më të kujdesshëm arkitektonik. Dritaret në formë frëngjie të katit përdhe, si dhe ato shumë të vogla të katit, zëvendësohen me dritare të mëdha, kornizuar me fashatura dërrase. Muratura e banesës fugatohet ngjeshur, shpesh balli i katit të sipërm edhe suvatohet. Krahas trajtimit të jashtëm, banesa pëson një përkujdesje dhe në brendinë e saj.

DO NOT COPY



Figura 18



Figura 19

Mjediset plot dritë tavanosen e suvatohen pastër. Përpunime pësojnë të gjithë elementet e drurit, si tavanet (fig. 18), dollapët e murit (fig. 19), dyert e shkalla (fig. 20), duke arritur në mjaft raste përpunime artistike me vlera.

Banesa Nr. 5 (Tab. III fig. 21). e ngritur në fshatin Vermosh, datuar në vitin 1919, është shembull me interes i një zgjidhje të re si në kompozimin planimetriko-volumor, ashtu dhe në atë të trajtimit të elementeve të ndryshme arkitektonike. Ajo është e vendosur në një truall të sheshtë me një volum të thjeshtë prizmatik me kat, me shkallë të jashtme guri. Ajo paraqet interes veçanërisht në trajtimin arkitektoniko-dekorativ të pamjes së saj ballore dhe perëndimore, të cilat trajtohen simetrikisht. E veçanta qëndron tek ndërtimi dhe formulimi i ri i elementeve dekorative të harqeve (fig. 22) shpatullave të derës e dritareve (fig. 23), teknikës së punimit të tyre si dhe materialit të përdorur për to. Po ashtu, rol estetik luan edhe teknika e muraturës me fuga të përpunuara, duke kombinuar me shije përdorimin e gurit të bardhë me atë me ngjyrë të errët. Në ndryshim nga trajtimi i jashtëm arkitektonik që formon një unitet të lidhur organikisht dhe simetrikisht, kompozimi i brendshëm është mjaft kontradiktor me të duke dhënë një zgjidhje jashtë tipologjisë. Kati përdhe formohet nga tri mjedise me ndërlidhje të brendshme me njëri-tjetrin. Kati i sipërm, në gjendje të papërfunduar, ka katër mjedise banimi si dhe dy korridore ndërlidhëse, nga të cilët mjedisi fundor i krahut të djathtë është shtëpia e zjarrit. Karakteristike



Figura 20

DO NOT COPY



Figura 21

për këtë banesë është pjerrësia tepër e madhe e çatisë katër ujëse e shfrytëzuar thjesht për depo, e cila me volumin e saj prizmatik harmonizohet bukur me mjedisin e thepisur shkëmbor të zonës, duke krijuar kështu një pamje mjaft piktoreske.

Zhvillim më të madh banesa e krahinës së Kelmendit, ashtu si ajo e krahinave veriperëndimore në



Figura 22



Figura 23

përgjithësi, e arriti me banesat dykatëshe[7]), si pasojë e rindërtimit të banesave të vjetra, si dhe të ndërtimit të banesave të reja. Banesa nr. 6 (Tab. V) (fig. 24), e ngritur në fshatin Vermosh paraqet një rast të riprekjes së një banese të vjetër. Në fazën e parë ajo ka qenë banesë me kat me dy mjedise banimi. Në një kohë më të vonë asaj i rritet muratura duke u mbuluar nga një çati katër ujëse në ndryshim nga ajo e fazës së parë dy ujëse. Hapësirës së bollëshme të krijuar në çati i hapet në muraturën anësore një dritare duke përligjur plotësisht krijimin e një kati të dytë, i cili u përdor si depo për mbajtjen e produkteve bujqësore si dhe të pajisjeve të tjera të familjes. (fig. 25). Në banesa të tjera, sipas rastit, ky kat përdoret dhe për banim. Kompozimi i ri që pëson tashmë kati i ndërmjetëm paraqet në vetvete

7) P. Thomo, **Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore**, Tiranë 1981,



Figura 24

një zgjidhje të përparuar në krahasim me banesën me kat. E reja këtu është krijimi i një korridori qëndror ndërlidhës në mes të dy mjediseve të katit, respektivisht, majtas shtëpia e zjarrit dhe djathtas mjedisi i banimit dhe futja e nyjes sanitare brenda banesës. Hyrja në katin përdhe, që është një mjedis i vetëm i pabanuar, ndryshe nga banesat e tjera, ndodhet në faqen e pasme. Ajo mbulohet me arkitra guri dhe ka një trajtim e përpunim të veçantë të shpatullave të saj (fig. 26). Korridori lidhet me mjedisin e jashtëm me një portë, mbuluar me arkitra guri. Shtëpia e zjarrit ka vatrën, të ndodhur në faqen e ngushtë, pajisur me kanal tymi, e cila merr dritë nga tri hapësira të vogla drite, qarkuar me blloqe guri. Mjedisi tjetër i banimit në faqen ballore ka një dollap muri me kapak të punuar. Ngjitja për në katin e dytë të banesës bëhet nga shkallë të lëvizshme druri që ndodhen në shtëpinë e zjarrit. Banesës nuk i mungon shameshiu me shkallët prej druri, i cili në pjesën fundore ka të ndërtuar çaranikun. Po ashtu banesa brenda territorit të saj ka dhe një ndërtim ndihmës, koçekun e misrit. E rëndësishme për këtë banesë, e që lidhet me fazën fillestare të saj, është ekzistenca e frëngjive, dy në katin e poshtëm dhe dy në katin e sipërm, të hapura nga një në çdo dhomë, dëshmi e karakterit mbrojtës të banesës së kësaj zone. Bashkëjetesa e dy fazave, megjithë ritrajtimin që pësoi banesa, e ka shpjegimin te forca tradicionale e ndërtimit, e kushtëzuar kjo nga mënyra e vjetër e jetesës si dhe nga karakteri i njëjtë i ekonomisë, që kanë kushtëzuar një program të thjeshtë ndërtimi e banimi. Këtë detaj e takojmë dhe në një



Figura 25



Figura 26

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Figura 27



Figura 28

banesë në fshatin Gropë të Selcës, sot mjaft e ndryshuar (fig. 27).

Banesa në Vermosh (fig. 28) paraqet një kompozim me interes në drejtimin volumor të saj me zhvillim në një krah, duke iu larguar banesës karakteristike të zonës me kat. Ndërsa blloku i dalë e ka të formuar plotësisht katin e sipërm, blloku më i futur e ka të krijuar atë si rrjedhim i përdorimit të hapësirës së bollshme nën çati. Karakteristikë e çative tek blloku i futur është streha tepër e dalë, gjerësia e së cilës respekton daljen e muraturës. Banesa ka shkallë të brendshme druri, në kompozimin planimetrik (sot është një ndërtim i papërfunduar) ka korridorin qendror dhe rreth e qark tij mjedise banimi, të cilat korrespondojnë me ato të katit të sipërm.

Banesa në fshatin Lepushë (fig. 29) paraqet një rast të ripjekjes së banesës së vjetër, si pasojë e ndërtimit në krah të saj të një ndërtimi të ri banimi, datuar në vitin 1944. Banesa e re e përftuar me



Figura 29



Figura 30

një zhvillim planimetrik pothuaj barabrinjës të shkronjës L, fiton vlera të reja në drejtim të trajtimit të jashtëm arkitektonik.

Banesa në fshatin Vermosh (fig. 30) paraqet një shembull të arritur të tipit të ri të banesës. Ndërtuar rreth viteve 50, ajo ka një kompozim pothuaj simetrik, duke patur në qendër të kompozimit dy mjedise ndërlidhëse, nga një për çdo kat, si dhe shtatë mjedise banimi, respektivisht, katër në katin e sipërm dhe tre në katin e poshtëm. Hapësirën e bollshme nën çati e ka të përdorur, dy mjedise për banim dhe pjesën tjetër për depo. Në korridorin e katit të sipërm janë shkallët për në katin e II. Pamja kryesore e banesës dallohet për një punim të kujdesshëm, ku spikat vargu ritmik i dritareve dhe derës, qarkuar me fashatura dërrase, si dhe shameshiun që përfshin gjithë ballin e banesës.

Veç banesave të reja me zgjidhje të veçanta, në këtë krahinë takojmë dhe komplekse ndërtimore të cilat ndeshen rrallë. Një kompleks të tillë gjetëm në fshatin Vermosh, (fig. 31) të vendosur në një vend mjaft piktoresk rrëzë shpatit të gjelbëruar malor. Kompleksi përfaqëson në kompozim bashkimin e tre ndërtimeve, ku ai qëndrori është dy katësh, ai i krahut të djathtë me kat dhe ai i krahut të majtë përdhes. Dy ndërtimet me kat kanë funksione banimi, ndërsa ai përdhes ka funksion ndihmës për familjen. Kompleksi, krahas vlerave kompozicionale, përfaqëson një zhvillim të mëtejshëm me vlerë të formave dhe elementeve arkitektonike të banesës së asaj krahine, me volumin dhe pamjen e saj ajo shkrihet e tëra organikisht në natyrën e bukur alpine të asaj zone.



Figura 31

Teknika e ndërtimit dhe elementet arkitektonike

Në përgjithësi, teknika e ndërtimit si dhe e elementeve arkitektonike të krahinës së Kelmendit janë në unitet me pjesën tjetër të krahinës Veriperëndimore e veçanërisht me krahinën e Dukagjinit.

Muratura, e ndërtuar që prej themeleve me mur guri, lidhet me llaç gëlqereje. Përgjithësisht, ajo ndërtohet me gurë kave apo përroi, me punim të ashpër, me një fugatim të trashë. Në të mungojnë brezat e drurit, trashësia e saj luhatet brenda 60 – 70 cm. Përpunim kanë vetëm qoshet, si dhe paturat e dyerve e dritareve. Harqet janë një element mjaft i përhapur në këtë krahinë. Ato zakonisht kurorëzojnë faqen e jashtme të dyerve e dritareve, duke u punuar me një kujdes të veçantë. Për qoshe dhe harqe përdorej guri i fortë, i ashtuquajtur nga vendasit «i gjallë», ndërsa për muraturë e brendi përdorej gurë i butë shtufor.

Çatia ndërtohet gjithnjë me konstruksion druri. Ajo vjen me strehë të mbyllura, e zgjatet nga muratura 40 – 50 cm. (Muratura ndër çati, hatllat, nga vendasit quhet «nastjer»). Sipas rastit, ajo është dyujëse apo katërujëse. Kur çatia është dyujëse, muret e ngushta anësore ngrihen në formë kallkani. Skema e ndërtimit të saj në këtë rast është mjaft e thjeshtë, e ndërtuar me mahi të kryqëzuara në kulme. Me lindjen e tipit të ri të banesës, kemi formimin e një çatije të re, të tipit alpin. Karakteristikë e saj është pjerrësia e madhe, llogaritja e së cilës bëhet ndaj raportit gjerësi, lartësi me masën 70 – 75%. Lënda e drurit që përdorej për mbulesën e çative është bredh, pishë dhe shelg pishe.

Formimi i çative të tipit alpin solli krijimin nën të të një hapësire të bollshme për shfrytëzim, e cila në variantet e thjeshta u përdor për depo dhe në ato më të zhvilluarat për banim. Kur hapësira nën çati është e shfrytëzueshme kemi tipin e çatisë së

DO NOT COPY

DO NOT COPY

quajtur nga vendasit «tipi me llastaricë», dhe, kur ajo është e pashfrytëzuar kemi tipin «pa llastaricë». Karakteristikë e tipit «me llastaricë» është çatia më e shkurtuar në dy faqet anësore të saj.

Ahuret janë gjithmonë përdhese, të shtruara me dhe të ngjeshura ndërsa shtresa e katit është prej druri. Karakteristikë e pozicionit të vatrës në shtëpinë e zjarrit është vendosja e saj në murin nga lindja. Pjesa e dalë në formë tamburi quhet nga vendasit «forum». Në banesat me kat, për të mënjanuar rrezikun e zjarrit nga dyshemeja e dërrasës, vendi i vatrës izolohet nga një shtresë balte e zgjedhur, e cila vendoset mbi binarë të puthitur mirë, që mbështeten pjerrëtas mbi dy gurët e dalë, të cilët ndodhen poshtë vatrës. Shtëpia e zjarrit asnjëherë nuk tavanoset, ndërsa ajo në krah pajiset me tavan përgjithësisht të thjeshtë e gjithmonë prej druri. Me lindjen e tipit të ri të banesës, të gjitha mjediset, si dhe shtëpia e zjarrit tavanosen, elementet e drurit pësojnë një përkujdesje të veçantë. Rozetat e trekëndëshat karakteristike të tavanit, dukuri të banesës qytetare, arrijnë realizime me vlerë.

Dritaret e banesës, veçanërisht ato të katit përdhe në formë frëngjie, si dhe ato të katit të banuar tepër të vogla, përkufizohen me blloqe të plota guri. Me tipin e ri të banesës futen dritaret e mëdha kornizuar me fashatura dërrase.

Portat përgjithësisht mbulohen me hark gjysmë rrethor, por nuk mungojnë dhe mbulesat me arkitra, që bëhen të zakonshme në banesën e re.

Ballkoni ose shameshiu, një element i ri i banesës së zonës, që lindi me zhvillimin e banesës me kat, vendoset gjithmonë nën strehën gjatë gjithë gjatësisë së faqes së banesës, duke dalë jashtë saj rreth 1.50 — 1.60 m. Ai është i ndërtuar i gjithi prej druri, i mbështetur mbi trarët e dalë konsol nga muratura. Balli i tij ndërpritet nga shtyllat e drurit, të cilat shërbejnë për mbajtjen e strehës së dalë, duke u përkufizuar me parmak të thjeshtë druri. Brenda gjerësisë së tij ndodhen shkallët e drurit.

Nyja sanitare e banesës, përgjithësisht, del jashtë konturit të banesës. Ajo vendoset nën strehë, paksa (fig. 32) e mbështetur mbi dy trarët konsol, qarkuar me dërrasë të afruara. Nuk përjashtohen dhe rastet kur ajo ndërtohet gjithnjë prej dërrase në mjedisin rrethues.

Mjeshtrit ndërtues në krahinën e Kelmendit kanë qenë përgjithësisht vendas, të cilët e kanë pasur traditë si punimin e gurit, ashtu edhe atë të drurit, pikërisht këto dy materiale bazë për banesën, të cilat gjendeshin me shumicë në atë krahinë. Por krahas tyre nuk kanë munguar edhe dibranët, aktiviteti i të cilëve është mjaft i njohur në mbarë Shqipërinë Veriore.



Figura 32

* * *

Në karakterin dhe tipologjinë e banesës së krahinës së Kelmendit si në mbarë morfologjinë e banesës, faktor me rëndësi janë kushtet ekonomiko shoqërore. Banesa me kat ka qenë dukuria më përhapur në këtë krahinë. Kjo banesë u parapëlqye nga shtresat e fshatarësisë, sepse ajo i plotësonte më së miri kërkesat jetësore të familjes. Bagëtitë si dhe kafshët e punës mbaheshin në mjedisin përdhes të banesës, ndërsa sipër jetonte familja me kërkesa minimale.

Banesa e krahinës së Kelmendit, e tipit të ri, përgjithësisht ka një karakter të mbyllur, i cili vërehet nga volumet e ngushta të muraturës me sipërfaqe

minimale të ndriçimit, Në karakterin mbrojtës të saj ka ndikuar ekonomia bazë e familjes, klima mjaft e ashpër dhe njëherazi synimi për mbrojtje i kushtëzuar nga kushtet shoqërore të kohës. Veçanërisht në banesat e kësaj krahine, ku ato vendosen mjaft të izoluara për shkak të rajonit tepër të thyer malor, në ndryshim me ato të krahinave të Shqipërisë së Jugut, ku banesat janë të grupuara, tipari mbrojtës ishte i kuptueshëm. Por, ky karakter fortifikues nuk duhet të mbivlerësohet e të bëhet tipar dalluës i tyre, ashtu siç ndodh në banesën e Malësisë së Gjakovës[8]). Futja e elementeve të reja konstruktive dhe arkitektonike prej druri, si shkallët, shameshiu e, veçanërisht, çatia e lartë me mbulesa druri, e zbusin mjaft karakterin mbrojtës të banesës së kësaj krahine, duke i dhënë tani asaj një trajtim të lirshëm dhe karakter shpesh herë piktoresk.

Konceptet e reja të shek. XX, të kushtëzuara për një komoditet më të madh në banesë, sollën nevojën e një organizimi të ri në banesë. Heqja e funksionit të ruajtjes së bagëtive nga kati përdhe, krijimi i një korridori qendror për ndërlidhjen e mjediseve, kërkesa për brendësi më të ndriçuara e të trajtuara më me kujdes, si dhe fillimi i futjes së orendive, formuluan banesën e re e cila bashkëjeton harmonishëm me të vjetrën, duke fituar vlera të reja në drejtim të trajtimit të elementeve arkitektonik, si dhe të kompozimit planimetriko-volumor.

Afritë më të dalluara të banesës së krahinës së Kelmentit i përkasin asaj të Dukagjinit, e cila bën pjesë po në grupin e krahinave veriperëndimore e pikërisht në fshatin më të skajmë të saj në Theth, ku ajo banesë pati një zhvillim e përhapje të gjerë.

Banesa e krahinës së Kelmendit, me tipare të qarta dalluese në drejtim të trajtimit të elementeve arkitektoniko-konstruktive, paraqet, në kuadrin e banesës fshatare, një tip të ri, që mund ta emërtojmë alpine, me një përhapje mjaft të gjerë deri në ditët tona, duke u cilësuar si banesa karakteristike e krahinës së Kelmendit.

DO NOT COPY

8) P. Thomo, **Banesa fshatare në Shqipërinë Veriore,** Tiranë 1981;

DO NOT COPY

TAB I

BANESA 1



KATI I

KATI II

0 2 4m



PAMIE KRYESORE

BANESA 2



PAMJE KRYESORE



KATI I



KATI II

0 2 4m

DO NOT COPY

TAB II

BANESA 3



KATI I



KATI II

0 2 4m



PAMIE KRYESORE

BANESA 4



PAMIE KRYESORE



KATI I



KATI II

0 2 4m

DO NOT COPY

TAB. III

BANESA 5



KATI I



KATI II



PAMIE KRYESORE

BANESA 6



KATI I



KATI II



PAMIA KRYESORE

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

L'HABITATION DE LA REGION DE KELMEND

Dans le cadre de la recherche et de la mise sous protection des constructions rurales, l'Institut des Monuments Culturels effectua deux expéditions dans la région de Kelmend, dont les habitations étaient inexplorées du point de vue de leur construction. Le matériel représentant les habitations villageoises recueili dans les villages Niksh, Vukël, Tamarë, Selcë, Gropa Lepush et Vermosh, nous permettra à mettre en évidence leurs caractéristiques principales.

La zone de Kelmend est une région ethnographique de Malësi e Madhe. Elle se situe à son nord-ouest, au centre des Alpes albanais. Historiquement elle englobe la contrée entre les rives des deux rivières notamment Nukësh et Vukël. A cause du terrain accidenté les villages de Kelmend sont dispersés et s'élèvent les uns sur des roches comme Niksh et Vukël, les autres sur des plateaux montagneux comme Selca, dans des bouches entre les montagnes comme Lepusha ou dans les vallées des rivières, comme Tamara et Vermoshi. Le terrain et le rude climat de la montagne influèrent à créer une économie penchée sur l'élevage.

Quelques sources écrites à la veille de l'occupation ottomane, nous donnent une idée sur le développement de cette région. D'après le cadastre du Sandjak de Shkodra de l'année 1485, la zone de Kelmend comprenait cinq villages, dont l'un, mentionné par le nom Selçishta (peut-être Selca) disposait de 40 habitations. D'après une autre donnée de l'année 1638, Kelmend comptait environ 250 habitations et 29500 habitants. L'occupation ottomane avec ses nouvelles formes de l'exploitation économique, mit les habitants de cette région face à des pressions toujours croissantes. Afin de défendre leur autonomie intérieure, ils s'isolèrent dans les zones montagneuses reculées. Les impôts sur le terrain, l'habitation ou le bétail, frappait aussi le pâturage donc les montagnards s'obligèrent à garder le bétail même en hiver dans les bouches des montagnes ou les vallées des rivières. Jusqu'au dernier décennie du XIXe sc, les zones Tamare, Lepushë et Vermosh, riches en pâturages, ont servi de parc pour l'hivernage du bétail des villages Selcë, Niksh, Vukël. Ce fait explique même le développement ultérieur de ces villages situés dans les vallées au pied des montagnes ou à la rive des rivières, à la différence de celui des zones montagneuse reculées dont nous disposons des données et des traces sur les anciennes habitations.

L'habitation à un étage, qui satisfaisait bien les besoins de la famille, fut le type le plus répandu de l'habitation de cette région. Le bétail et les bêtes de somme étaient abrités au rez-de-chaussée, alors que la famille habitait le premier étage.

L'évolution compositionnelle de l'habitation de cette région, le traitement des différents éléments architectoniques ainsi que son étendue dans le temps rendirent indispensable son étude.

Selon l'époque de leur construction et les nouvelles conceptions apparues au début du XXe sc, les habitations seront groupées en: habitations datant du milieu du XIXe sc jusqu'à la fin du XIXe sc (les ruines trouvées au village Nikël) et celles représentant les premiers traits du nouveau type d'habitation, et habitations datant du début du XXe sc jusqu'au milieu du XXe sc et leur évolution.

Leurs traits distinctifs apparaissent essentiellement à leur forme architectonique extérieure par l'introduction des éléments nouveaux.

L'habitation de la deuxième moitié du XIXe sc.

Les ruines des trois anciennes habitations, conservées sur terre au village Niksh, donnent une contribution particulière aux recherches de ce domaine. Le rez-de-chaussée où l'on accède au moyen d'une seule porte, est éclairé par deux fenêtres.

La composition intérieure de la maçonnerie de l'étage habité et son large volume nous induisent à penser qu'il y a eu autrefois une légère cloison qui le divisait en deux pièces. On pense qu'un escalier intérieur en bois conduisait au premier étage. Le mur est réalisé par un appareil irrégulier en pierres de taille calcaires liées avec du mortier, sans chaines de bois. L'allongement des deux murs latéraux démontre que l'habitation a été couverte d'un toit à deux pentes. Les coins, les arcs et les embrasures des fenêtres réalisés avec des pierres de taille, représentent les seuls éléments témoignant un traitement plus élaboré. A la différence des ruines conservées au village Niksh, l'habitation à un étage de la fin du XIXe sc, gagne de nouveaux éléments architectoniques et constructifs. Ainsi c'est à cette époque qu'aparait le balcon en bois et le haut toit à forte pente couvert de planches. L'habitation à un étage se compose d'une, de deux ou de plusieurs pièces. La plus simple variante, à une seule pièce, se rencontre au village Niksh. Elle est formée par le rez-de-chaussée inhabité et la pièce du premier étage, modifiée. Au centre du mur latéral de la maison du feu se trouve la cheminée dont les grandes dimensions justifient sa fonction originale pour une seule grande pièce. Au premier étage on monte au moyen d'un escalier en bois ame-

nant au balcon caractéristique situé sur toute la longueur du mur. Couvert de l'avant-toit, il fait saillie au mur. Le toit, assez haut, à quatre fortes pentes, est couvert de planches.

Dans cette région, on rencontre plus souvent des habitations à un étage avec deux pièces habitées, qui satisfait mieux les besoins des habitants. Un exemple typique en est une habitation du village Selcë (tab. V) d'une composition étendue avec une seule pièce au rez-de-chaussée et deux pièces habitées au premier étage. La communication se réalise par un escalier intérieur. La cheminée de la maison du feu se trouve déplacée au coin du mur et la cloison de la pièce à côté, après l'aménagement des placards, représente une solution intéressante.

L'habitation de cette région connut sa meilleure évolution avec sa variante à deux étages, réalisée par la reconstruction compositionnelle et architectonique de l'habitation à un étage. Le nouvel espace créé au-dessous du toit, quelques fois est utilisé comme dépôt, quelques fois comme pièce habitée.

L'habitation du début jusqu'au milieux du XXe sc

Les nouvelles conditions économiques sociales, liées aux nouvelles exigences pour un meilleur mode de vie, apportèrent la création d'une nouvelle habitation des années 50, qui se distingue de celles déjà mentionnées, par la fonction, la composition et le traitement des éléments architectoniques. Au point de vue de la composition, elle s'éloigne du volume quadrangulaire en gagnant de nouvelles formes. Il est à souligner la transformation du rez-de-chaussée en pièce habitée, éloignant ainsi le bétail de l'habitation. Les pièces communiquant par un couloir central, conservent toujours l'escalier extérieur en bois et le balcon caractéristique. Dans la façade de la nouvelle habitation on remarque que le traitement architectonique est plus soigné et la partie frontale de l'étage supérieur est souvent couvert d'enduit. De pair au traitement extérieur, on prêta attention aux éléments intérieurs en bois, comme les plafonds, les placards, les escaliers etc. Les complexes de constructions qu'on rencontre dans cette région à part les valeurs compositionnelles, représentent une évolution ultérieure des éléments architectoniques de l'habitation de cette zone.

L'habitation de la région de Kelmend de la fin du XIXe sc jusqu'au deuxième quart du XXe sc apparait comme une nouvelle construction avec de nouvelles valeurs quant au traitement des éléments architectoniques constructifs, en se présentant dans le cadre de l'habitation rurale comme un nouveau type d'habitation que conventionnellement on peut nommer habitation alpine. Elle se propagea largement dans cette région jusqu'à nos jours.

Le fait que cette habitation s'étendit seulement dans cette région ainsi que l'évolution complète de son toit, sans phases intermédiaires, nous font penser que l'origine de ce type d'habitation se trouve ailleurs.

DO NOT COPY

Faik ALIMEHMETI

MBI ECURINË URBANE TË FSHATRAVE TË TIRANËS

Rrethi i Tiranës ka një konfiguracion tokësor të larmishëm. Ai mund të ndahet në tri zona gjeografike të mëdha. Sipërfaqen më të madhe e ze **zona malore,** e cila mbulon krejt pjesën lindore të trevës dhe përbëhet nga malësia e Bendës me qendër Shëngjergjin, malësia e Tamadhesë me qendër Shupalin dhe malësia e Kërrabës me qendër Kërrabën. Në krahun perëndimor shtrihet **zona kodrinore,** e cila përbëhet nga krahina e Pezës, Vorës dhe Prezës. Në qendër të trevës shtrihet **zona fushore,** e cila mban emrin fusha e Tiranës. Relievi malor e kodrinor e rrethon atë në trajtën e një patkoi.

Me toka buke tepër të pakta, banorët e zonës malore kanë qenë të detyruar të merreshin më tepër me blegtori se me bujqësi. Në ekonomitë fshatare të zonës kodrinore kishte një ekuilibër midis veprimtarisë bujqësore dhe blegtorale. Në zonën fushore, ekonomitë agrare merreshin kryesisht me bujqësi, kurse blegtorinë e kishin si ekonomi ndihmëse. Si pasojë e këtyre kushteve gjeografiko-natyrore, malësia merrte nga e dyta prodhimet bujqësore që i mungonin, kryesisht drithin, kurse fusha siguronte nga e para prodhimet blegtorale që i kishte të pamjaftueshme, sidomos leshin dhe lëkurën. Gjithashtu, fusha plotësonte nevojat që kishte malësia për kullotat e saj dimërore, kurse malësia furnizonte fushën me krahët e saj të tepërta të punës. Konfiguracioni tokësor dhe baza ekonomike kanë ndikuar padyshim në tiparet urbanistike të qendrave të banuara rurale në trevën fshatare të Tiranës, madje edhe në vetë tipologjinë e banesës së saj, deri edhe në materialet e ndërtimit, në përbërjen e anekseve të saj etj.

Që në kohët më të lashta, në fushën e Tiranës kryqëzoheshin rrugë të rëndësishme që lidhnin, nga njëra anë bregdetin Adriatik të Durrësit me viset e brendshme malore, nga ana tjetër, krahinat verilindore të Shqipërisë me trojet e saj juglindore, deri në thellësi të Maqedonisë. Kështu, nga Durrësi nisej rruga antike dhe mesjetare, e cila pasi përshkonte fushën e Tiranës dhe Shkallën e Tujanit, kalonte në Guribardhë, Klos, Bulqizë dhe arrinte në Dibër.[1]) Nëpër fushën e Tiranës kalonte, gjithashtu, rruga antike e mesjetare, e cila nisej nga Shkodra apo nga Lezha, kalonte nëpër Milot e Prezë dhe vijonte në Qafën e Krrabës, deri sa arrinte në luginën e Shkumbinit (pranë Elbasanit), ku lidhej me rrugën Egnatia. Veç këtyre, nëpër fushën e Tiranës kanë funksionuar në periudha të ndryshme edhe trase të tjera, siç ka qenë rruga Kavajë-Tiranë, e cila kalonte lumin e Erzenit mbi urën e Beshirit e ndërtuar në shek. XIX[2]), me një degëzim që lidhte Arbanën me Petrelën e në vazhdim takohej me rrugën e Qafë Krrabës, si dhe rruga malore që nisej nga Kruja dhe pasi kalonte rrëzë malit të Kërcunit, më tej urën e Brrarit[3]), zbriste në fushën e Tiranës.

Rrjeti rrugor që ka përshkuar kryq e tërthor fushën e Tiranës ka ndikuar në zhvillimin e hershëm urban të kësaj treve. Këtë e dëshmojnë gjurmët e vendbanimeve më të hershme të zbuluara deri sot nga gërmimet arkeologjike, të paktën qysh në fillimet e antikitetit. Këto përfaqësohen nga mbetjet e qendrave të dikurshme të fortifikuara, të ndërtuara për nevoja të vetëmbrojtjes, në pika të rëndësishme strategjike, të cilat përmbanin brenda mureve të tyre

1) J. Adami, **Historia e rrugëve të Shqipërisë,** I, Rrugët e Shqipërisë në kohën antike, në «Buletin në Shkencat Shoqërore nr. 1, 1953 f. 62-63., J. Adami, **Historia e rrugëve të Shqipërisë,** II, Rrugët e Shqipërisë në kohën e mesme, në «Buletin në shkencat shoqërore», nr. 2, 1953. f.

2) K. Frashëri, **Historia e Tiranës (dorëshkrim)**

3) K. Frashëri, **Fillimet e historisë së Tiranës,** në Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, nr. 4, 1955, f. 126-147, K. Frashëri, **Vështrim mbi zhvillimin kulturor e arsimor të Tiranës gjatë shek. XVIII dhe gjysmës së parë të shek. XIX,** në Arsimi Popullor, nr. 4, 1964, V. Shtylla, **Në gjurmë të rrugës së vjetër Durrës-Fushë e Tiranës-Dibër,** Pasuri e trashëguar në shekuj, f. 155.

DO NOT COPY

një sistem të tërë banesash ku strehoheshin banorët e tyre. Gjurmë të tilla, qendrash urbane, të zbuluara deri sot, në trevën e Tiranës, ruhen pjesërisht. Madje ato ende nuk janë evidentuar sa duhet dhe aq më pak studiuar në thellësi. Qendra urbane të lashtësisë të pafortifikuara, deri më sot, nuk kanë dalë në dritë. Kjo kuptohet po të kemi parasysh se në lashtësi, si pasojë e kushteve historike, popullsia e trevës ilire, e kishte të vështirë si kudo edhe këtu, të jetonte e të punonte pa një qendër të fortifikuar, ose të paktën larg mureve të tyre rerthuese.

Kalatë më të hershme të zbuluara në trevën e Tiranës kanë patur përmasa modeste, si p.sh. kalaja e Dorëzit,[4]) në luginën e Erzenit me sipërfaqe banimi 1,8 ha. Vinë pastaj për nga lashtësia kalaja e Shëngjinit (shek. V – VI)[5]) me sipërfaqe të përafërt 100 x x 40 m, kalaja e Dajtit (shek. V – VI)[6]) me 0,40 ha në krahinën e Bendës, kalaja e Tujanit (shek. IV p.e.r)[7]) me sipërfaqe 160 x 190 m në krahinën e Tamadhesë, kalaja e Lalmit (shek. V-VI)[8]) me formën e një elipsi me gjatësi 100 m dhe gjerësi 50 m në zonën e Vorës, kalaja e Ndroqit (shek. IV)[9]) me sipërfaqe 300 x 150 m në zonën e Ndroqit, kalaja e Vilës (Persqopit, shek. IV-III p.e.s)[10]) me 14 ha në trevën e Krrabës dhe dy kalatë e rëndësishme të kësaj treve, ajo e Petrelës[11]) dhe e Prezës[12]), që së bashku me atë të Ndroqit kanë qenë banuar pa ndërprerje që nga kohët e lashta dhe deri në ditët tona.

Duhet theksuar se jo të gjitha fortifikimet e zbuluara në trevën e Tiranës kanë qenë qendra rurale. Dy prej tyre, dihet historikisht se kanë qenë qendra urbane – me siguri seli administrative dhe pika ushtarake. E tillë ka qenë Petrela, e cila përmendet nën emrin Petrela qysh në shek. XI nga Ana Komnena[13]).Po ashtu edhe Preza[14]), në ekstremin VP të trevës së Tiranës. Qendër urbane, ç'ka shihet nga gjurmët në terren, duhet të ketë qenë edhe kalaja e Vilës (Persqopit) një kilometër larg kështjellës së Petrelës, e cila për nga përmasat e sipërfaqes së banueshme renditet ndër kalatë më të mëdha të kohës antike në vendin tonë. Gjithashtu edhe kalaja e Ndroqit, e cila përveç sipërfaqes së justifikueshme ka edhe gjurmë të një qendre urbane. Megjithatë këto qendra urbane nuk hyjnë në rrethin e studimit tonë.

Varfëria e theksuar e burimeve dokumentare të shkruara nga njëra anë dhe e gjurmëve të dala në dritë në terren nga ana tjetër, nuk na lejojnë të flasim konkretisht për ecurinë urbane të fshatit, në trevën e Tiranës përpara shek. XV. Prandaj, në këtë punim, atë do ta trajtojmë që nga shek. XV, kur nisin të flasin regjistrat osmanë e deri në fillimet e shek. XX, madje pa pretenduar për një shtjellim të hollësishëm të këtij problemi të rëndësishëm. Edhe brenda kësaj periudhe, do të përpiqemi të japim një kuadër më tepër të përgjithshëm të ecurisë urbane të fshatrave të Tiranës, të mbështetura kryesisht në të dhënat demografike, gjeografiko-ekonomike dhe të artit të të ndërtuarit.[15])

Për të shqyrtuar zhvillimin demografik të qen-

4) Gj. Karaiskaj, dhe A. Baçe, **Kalaja e Durrësit dhe sistemi i fortifikimit përreth në kohën antike të vonë,** Monumentet 9, 1975, f. 17.
5) **Po aty,** f. 19.
6) **Po aty,** f. 20.
7) **Po aty,** f. 20 – 21.
8) **Po aty,** f. 15 – 16.
9) Gj. Frashëri, **Kalaja e Ndroqit,** Monumentet 4, 1972,
10) A. Baçe, **Kalaja e Persqopit dhe e Petrelës,** në shtyp.
11) A. Baçe, Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** Monumentet 5 – 6, f. 139 – 157.
12) L. Papajani, **Kalaja e Prezës,** Monumentet 7-8, Tiranë 1974. f. 167 – 181.
13) A. Baçe Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës, vep.cit,** f. 140.
14) L. Papajani, **vep.cit,** f.
15) Për fshatin dhe banesën fshatare të Tianës kemi shfrytëzuar dhe studimet: K. Zheku, **Sntëpia e banimit në fshatin Mullet dhe zhvillimi i saj,** Etnografia shqiptare, Tiranë 1962, 1, f. 65 – 105, K. Zheku, **Tiparet karakteristike në arkitekturën e banesave të fshatit Linxë,** Etnografia shqiptare, Tiranë 1963, 2, f. 110-143, K. Zheku, **Disa shtëpi banimi karakteristike të fshatit Farkë e Lundër,** Etnografia shqiptare, Tiranë 1972, 4, f. 242 – 261, K. Zheku, **Banesë fshatare në fshatrat kodrinore përreth qytetit të Tiranës,** Monumentet 15-16, 1978, f. 163-184, A. Muka, **Arkitektura popullore e Shqipërisë së Mesme,** Monumentet 11, 1976 f. 199-222. A. Muka, **Banesa fshatare në malësinë e Tiranës gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX,** Etnografia shqiptare, Tiranë 1978, 9, f. 208 – 312, A. Muka, **Banesa e një familjeje të madhe në, malësinë e Tiranës,** Kultura Popullore, Tiranë 1981, 2, f. 119-130, A. Muka, **Një kompleks banimi në fshatin Brar,** Etnografia shqiptare, Tiranë 1982, 12, f. 191-219, E. Riza, **Banesa popullore dhe disa qendra qytetare të Shqipërisë së Mesme,** Monumentet 5-6, f. 101-120, E. Riza, dhe P. Thomo, **Karakteri dhe tiparet e veçanimeve të banesave fshatare shqiptare të shek. XIV-XVIII,** Kultura popullore, Tiranë 1983, 2, f. 125 – 150.

DOKTORO PY

drave të banuara fshatare, të cilat sot përfshihen brenda caqeve administrative në rrethin e Tiranës, jemi mbështetur në të dhënat që na japin tre regjistrime: dy të parat në regjistrimin mufasal të vitit 1431-32 dhe atë të vitit 1583, të bëra nga osmanët dhe të fundit në regjistrin e vitit 1927, të bërë pak kohë pas shpalljes së Tiranës kryeqytet.

Sipas regjistrit të vitit 1431 – 32 rezulton se brenda caqeve administrative të trevës së Tiranës të përcaktuar më sipër, ka patur rreth 60 qendra banimi, me rreth 1.000 shtëpi dhe me një popullsi rreth 7.300[16]) banorë (duke llogaritur 7 – 8 pjestarë për familjen e kësaj periudhe). Qendrat me popullsi më të madhe banimi rezultojnë të jenë Kusi me 55 shtëpi, Priska me 48 shtëpi, Përpunja me 45, Lalmi 41, Pineti 36, Bargjini (sot i zhdukur)[17]) me 31, Domje 28, Pre-



Fig. 1.

16) H. Inalçik, **Hicri 835 tarihli suret-i defter-i sincak-i Arvanid,** Ankara 1954,

17) Fshati Bargjin ndodhej në këndin verior të truallit ku shtrihet sot qyteti i Tiranës, në afërsi të fakultetit Mjekësor dhe jo larg lumit Tigllatë (lumi i Tiranës). Në të vërtetë, fshati Burgjin nuk u zhduk, por u integrua nga fshati fqi i Tiranës, i cili ndodhej në pikën ku kryqëzoheshin rrugët kryesore që kalonin nëpër fushën e Tiranës dhe si rrjedhim u kthye në qytet në fillim të shek. XVII. Nga fshati Bargjin është Sulejman Pasha, të cilin tradita gojore e paraqet si themeluesin e qytetit të Tiranës.

DO NOT COPY

za 27, Bërzhita 25. Ndërsa qendrat e tjera më të vogla (nga 2 deri 10 shtëpi) janë gjithsej 22 fshatra, si Meniku, Kamza, Pinari, Tujani, Tufina, Farka, Bathore, Pashkashesh, etj. Mbi këto të dhëna kemi ndërtuar hartën më të hershme që kemi deri sot për shpërndarjen e qendrave të banuara brenda caqeve të rrethit të Tiranës.

Sipas saj, qendrat rurale paraqiten më të koncentruara kryesisht në zonat fushore, në territorin që shtrihet nga kodrat e Saukut e deri tek kodrat e Prezës (si rrethinat e Saukut, Bërzhitës, Kasharit, Vares, Vaqarit, Kamzës e Prezës) dhe në zonat kodrinore (në rrethinat e Vorës, Ndroqit, Zall Herrit, Baldushkut, Petrelës), ndërsa hapësira me qendra më të rralla është zona malore (rrethinat e Priskës, Kllojkës, Shëngjergjit, Zall Bastarit, Zall Dajtit etj). Këtu në një rast muna të mendohet se në vitet 1431-32, ende në zonat e thella të malësisë të Tiranës nuk ishte shtrirë sistemi i timareve, prandaj duhet nënkuptuar ekzistenca e vendbanimeve të tjera fshatare në këto rajone të paregjistruara. Për regjistrimi i disa qendrave të banuara të kësaj natyre si Zall Bastar, Shengjergj, etj, për mendimin tone tregon se mundësia e një numri vendbanimesh dhe të banorëve të tyre të paregjistruara në zonat e thella malore duhet të ketë qenë shumë i vogël në krahasim me të dhënat që na ofron regjistrimi i vitit 1431-32. Madje, mungesa e regjistrimit në këtë defter e vendbanimeve si Shënkoll, Dorëz, etj, të cilat do t'i shohim në regjistrat e mëvonshëm, duhen parë më tepër si të braktisura nga banorët në dhjetevjeçarët e parë të shek« XV, ashtu si fshatrat e Bargjin e Bodinak, nuk do t'i takojmë më në defterët e mëvonshëm.

Të dhënat statistikore të regjistrimeve të vitit 1583 na tregojnë për 111 qendra të banuara rurale në të njëjtën hapësirë, me rreth 2900 shtëpi dhe 20.000 banorë[18]). Prej tyre, po qe se do t'i konsiderojmë të identifikuara fshatrat Tamjan, (Damjan), Rait (Dajt) Urshkez (Yrshek), Brisavish (Kozaverë) (Brazb Babru), Doreshts (Dorëz), Bravesh (Fravesh), Breshkop (Persqop), nuk kemi mundur të identifikojmë 23 qendra të banuara (Krvaçish, Pjeç, Kutreq, Bruç, Peksh; dhe Lonic, Rodesh, Dubit, Bakvaç, Kavas, Faran, Patiza, Sharblut, Shëndëlli, Manes, Cutina, Najmes, Cezma, Shenandre, Kalbesh, (të Gumës), Kroshav, Kahret, Minol). Ato nuk janë përfshirë në hartën përkatëse, dhe mbetet për t'u gjurmuar në të ardhmen (fig. 1).

Vlen të përmendim se në regjistrimin e vitit 1583 zbulohet për herë të parë Tirana si qendër e banuar, pas përmendjes së emërtimit të saj nga Barleti në fillim të shek. XVI.[19]) Në këtë kohë ajo përmbante 8 familje (1 të krishterë e 7 myslimanë) me 1300 akçe të kohës si detyrim për feudalin. Ky regjistrim tregon gjithashtu për copëtimin e disa fshatrave duke marrë emrat e feudalëve. Tipik për këtë është Lalmi, me shtatë emërtime apo mjedise të veçuara banimi — Germau Lalm, Irman Lalm, Mëzez Lalm, Geg Lalm, Filek Lalm, Zot Lalm, dhe Prush Lalm, të cilat më vonë u kthyen gradualisht në qendra të banuara të veçanta si vetë Lalmi, Mëzezi e Prushi. Po kështu Lana Bregasi, Lana Katunasi, dy Priskat, dy Shëngjinët etj.

Një pamje tjetër na japin të dhënat e marra nga regjistrimet e vitit 1927[20]), disa vite pas shpalljes së Tiranës kryeqytet. Të bie në sy rritja e konsiderueshme e qendrave të banuara në periferi të Tiranës si dhe dalja e ndonjë qendre të re të banuar si: Babruja (107 banorë), Farka (516), Kamza (406), Kashari (795), Mjull Bathore (179). Po kështu me zhvillim të madh popullativ dhe me funksione të plota urbane na dalin: Preza me 1972 banorë, Ndroqi me «treg» të zhvilluar dhe me lagjen e Pazarit me 860 banorë, Petrela me 596 banorë, Vora me 422 banorë, Sharra me 383 banorë, etj.

Nga ky regjistrim del dukshëm fenomeni i rritjes së popullsisë së zonave kodrinore e në veçanti në ato malore, si Selita e Malit e Zall Dajtit me 618 banorë, Shënmëria, Ura dhe Shëngjin i Madh të rrethinës së Shëngjergjit (sot Vërris) përkatësisht me 725,60? dhe 374 banorë, po kështu Vilëza me 442 banorë, Mneri me 575 banorë, etj. Rritet gjithashtu ndikimi ekonomiko-shoqëror i qendrave kryesore urbane ndaj fshatrave, p.sh. Preza, e kishte ndikimin e saj prej Bubqit në afërsi të Krujës deri në Manzë, në afërsi të Durrësit. Shëngjergji shtriu ndikimin e tij deri në zonën e Shkallës, ndërsa funksionet shoqërore të Petrelës arritën deri në Gurrëz, Bërzhitë, Krrabë e deri në afërsi të Shëngjergjit.

Regjistrimi i vitit 1927, përmban 124 qendra të banuara në rrethin e Tiranës me 41.098 banorë, prej të cilave Tirana kishte si qytet 12.453 banorë. Është me interes të shihet se në krahasim me regjistrimet e bëra në vitin 1979, rreth gjysmë shekulli më vonë, qyteti i Tiranës si pasojë e zhvillimit socialist rezulton 17 herë më i rritur për nga numri i popullsisë, ndërsa rrethinat e tij rezultojnë të rritura 4 herë.

Prej këtij vështrimi të përgjithshëm mund të nxi-

18) **Regjistri osman i vitit 1583,** (Arkivi i Institutit të Historisë, A.E. dok. 437/5, fq. 29, 87, 98, 105, 106; 109-119, 175, 212, 252 dhe A.E. dok. 421/8 f. 29 — 75.

19) M. Barleti, **Historia e Skënderbeut.**

20) **Shqipëria më 1927,** Tiranë 1928, f. 496 — 558.

DOKUMENTI

rren disa përfundime mbi ecurinë urbane të trevës në shqyrtim. Të dhënat e regjistrave tregojnë për një shtim të vazhdueshëm në kohë të numrit të vendbanimeve të reja në hapësirën e trevës së Tiranës, madje edhe për një rritje të vazhdueshme të numrit të popullsisë së saj. Përsa i përket strukturës urbane, duke parë numrin e vogël të banesave të disa qendrave të banuara, mund të themi se në zonë kodrinore e në veçanti në atë malore, karakteristikë e përgjithshme ka qenë shtrirja e tyre e madhe dhe me dendësi të rrallë, për të cilën duhet të ketë ndikuar terreni i thyer malor dhe tokat e pakta të bukës. Duke kaluar nga regjistrimi i parë (1431 – 32) në atë të dytin (1583) shihet se një pjesë e mirë e fshatrave të zonës kodrinore e malore paraqiten në dy ose në tri zona banimi, të vendosura sipas emërtimeve në Zall (ose Vërri), në Katund dhe në Mal. Prej këtyre zonave, për të njëjtën qendër banimi, Mali ka patur si karakteristikë shtrirjen më të madhe, por më të rrallë të ndërtesave, ndërsa dendësitë më të mëdha me ndërtime i ka patur Katundi e Zalli. Në këtë periudhë, megjithëse struktura urbane e mjediseve të banuara në viset kodrinore e malore ka qenë më e coptuar, ajo ka qenë më e ngjeshur me popullsi se ajo e fushës. Është me interes të shihet gjithashtu se zhvendosja e zonave të banimit ka ndodhur kryesisht nga Katundi në Mal, dhe jo e kundërta, proces që duket se është frenuar pas shek. XVI.

Mësojmë, gjithashtu, se në fillim në Mal kanë qenë «stanet e gjasë» pas të cilave gradualisht u ngujuan familje me banim të përhershëm, të detyruara nga rrethanat historike të periudhës së parë të sundimit osman (shek. XV – XVI). Banesa në Mal erdhi kështu, nga kasollja e ndërtuar me gardh e baltë (apo guri) të mbuluara me dërrasa sopate (furde) ose me rrasa guri, në ndërtimin më vonë (gjatë shek. XVI – XIX) të banesave të kompletuara për banim (me kate). Ndërsa Zalli e veçanërisht Katundi kanë qenë zona banimi më të vjetra të fshatit dhe më të pëlqyerat për banim në kohët relativisht të qeta. Zalli për shembull, vendosja e të cilit shkon deri 500 m mbi nivelin e detit, ka qenë më pranë tokave pjellore, por më i pasigurt në kohëra luftrash. Nga kjo pikëpamje, katundi, si zonë banimi e mesme, mund të konsiderohet në strukturën urbane të fshatit mesjetar të trevës së Tiranës, si bërthama më e vjetër dhe më e preferuar. Në këtë aspekt, Zalli dhe Mali kanë qenë lagje të Katundit. Provë për këtë është fakti se në Katund ndodhen të ndërtuara objektet e kultit, në fillim kishat e më vonë xhamitë. Gjatë shek. XVI – XIX, shohim se Zalli e Mali kthehen në vendbanime të përhershme duke patur epërsi, njëra në shfrytëzimin e tokave të reja, tjetra në atë të kullotave të bagëtisë. Gjatë kohës pajisen me emra të veçantë, duke i ruajtur lidhjet me Katundin. Shembuj të tillë mund të jenë fshati Bastar i përbërë nga Zallë Bastari, Bastar i Mesëm (Katundi) dhe Bastar Mëriza ose Mal Bastar, fshatra të tjerë që kanë Zallin e Katundin siç janë Domja e Malit, Fagu, Kllojka, fshati Shupal që përbëhet nga Kodër Shupal (Katundi) dhe Zall Dajti (Zalli), Shëngjergji me Vërrin (Katundi), Urën dhe Kasollen, fshati Vilëz me Zall Vilzën, Vilëzën e Mesme (Katundin) dhe Mal Vilzën, fshati Mner me Zall Mnerin, Mënerin (Zguri ose Katundi) dhe Mner i Epërm ose Mal Mneri.

Struktura urbane e mjediseve të banuara në zonën fushore paraqitet me fizionomi tjetër, e lidhur pa dyshim me karakterin e theksuar bujqësor të tyre. Në përgjithësi këto vendbanime paraqiteshin të shtrira në një hapësirë më të madhe. Fshatrat në zonën fushore përbëheshin nga dy lagje, të cilat ishin vendosur njera në zonën kodrinore (Katundi), ndërsa tjetra në atë fushore, brenda të cilave dalloheshin edhe «mëhallat».

Nga pikëpamja e strukturës shoqërore në rrethin e Tiranës gjatë shek. XVI – XIX viheshin re tre kategori fshatrash – ato me fshatarë pronarë (të vegjël, të mesëm e të pasur), ato me fshatarë pa pronë, pra me çifçinj, të cilët punonin e jetonin në sistemin e çiflikut dhe fshatra me fshatarë të dy kategorive, që jetonin pranë me njëri-tjetrin. në të njëjtin territor, pra me fshatarë pronarë, fshatarë çifçinj dhe me fshatarë paraqendarë (fshatarë që kishin pak prona dhe që në të njëjtën kohë merrnin me qira tokë nga pronarët e ndryshëm, domethënë fshatarë pjesërisht pronarë, pjesërisht çifligarë). Ky dallim ekonomiko-shoqëror pasqyrohet edhe në strukturën urbanistike dhe arkitektonike të fshatit. Kështu p.sh., fshatrat e kategorisë së parë, të cilat ndodheshin kryesisht në hapësirën malore, janë ndërtuar përgjithësisht prej guri (shtëpitë), pasi fshatarët pronarë kanë qenë banorë të përhershëm në fshatin e tyre. Këto ndërtesa kanë patur pamjen e tipit «kullë». Nga pikëpamja urbane këto fshatra kanë qenë sipas rastit herë të përqendruara, siç është p.sh. fshati Shëngjergj dhe herë të përhapura domethënë kur fshatarët i ndërtonin banesat e tyre pranë tokave, siç është rasti i fshatit Bastar.

Fshati Çiflik, i përbërë kryesisht me çifçinj, fizionomia e të cilit na del më e qartë në shekujt e fundit, ka patur një karakter krejt të ndryshëm, i cili shtrihej në zonën fushore. Fshatari çifçi nuk ishte pronar i tokës, rrjedhimisht as i shtëpisë ku banonte. Sipas normave të marrëdhënieve çifligare pronari ndërtonte për bujkun edhe banesën e tij. Natyrisht kjo banesë ishte mjaft modeste, zakonisht prej qer-

BOTIMET



Fig. 2

Fig. 2 (marrë nga A. Muka, Banesa në Malësinë e Tiranës, Etnografia shqiptare IX, f. 289)

DO NOT COPY

piçi dhe më keq akoma me gardhesh me baltë. Nga ana tjetër këto fshatra shtriheshin nga pikëpamja urbanistike në dy mënyra, «të përhapura» dhe «tepër të përhapura», për arsye se çifçiu duhej të banonte kurdoherë pranë tokës me të cilën ishte i lidhur.

Ndërsa në fshatin me fshatarë pronarë kishte shtëpi me dy kate, në atë me fshatarë çifçinj shtëpitë ishin rregullisht përdhese. Të tilla fshatra ndodheshin sidomos në zonën e Kamzës.

Në kategorinë e tretë, gjendja shoqërore kom-



SKEMA E ZGJERIMIT DISA HERE TE NJE BANESE

Fig. 3 (marrë nga A. Muka, **po aty** f. 295.)

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4 (marrë nga A. Muka, **po aty,** f. 292)

plekse fshatare (mikse) pasqyrohej edhe në strukturën urbanistiko-arkitektonike të fshatit, me ndryshim se këtu fshatarët pa tokë nuk ishin gjë tjetër veçse fshatarë pronarë që kishin humbur tokën dhe që vazhdonin të punonin në fshatin e tyre, pra fshatarë që kishin humbur tokën, por jo banesën. Në këtë rast, një pjesë e fshatarëve çfiçinj bananin në të njëjtat shtëpi (prej guri) si të fshatarëve pronarë, pa përjashtuar edhe rastet kur çifçinjtë bananin në kasolle prej balte. Të tilla fshatra i ndeshim në zonën kodrinore. Si shembull mund të sjellim këtu fshatin Sharrë.

Në kuadrin e studimit të banesës popullore të Shqipërisë së Mesme edhe banesa e rrethit të Tiranës sot na paraqitet e studiuar nga një numër au-

torësh.[21]) Këto gjurmime kanë treguar se bërthamën e kompozimit të banesës së kësaj treve e përbënte shtëpia e zjarrit e me ballë hajati e çardaku, të cilat vazhduan të ruheshin me gjithë zhvillimin e saj në kohë në planin horizontal e atë vertikal. Madje këto shtesa nuk e prekën bërthamën qendrore të saj. Procesi i zgjerimit të vazhdueshëm të banesës së rrethit të Tiranës është për mendimin tonë një objekt gjurmimi e studimi, rezultatet e së cilës duhet të hyjnë më gjerë e më konkretisht në punën projektuese të banesave të qendrave rurale.

Në fig. 2 është paraqitur një zgjerim banese në zonën malore të Tiranës. Këto shtesa në anën jugore i kanë dhënë banesës një orientim L – P, duke bërë ruajtjen e formës këndrejtë.

Në fig. 3 është paraqitur një mënyrë tjetër zgjerimi të banesës së zonës kodrinore e malore të Tiranës, e cila është shtuar dy herë radhazi, në drejtimin perëndimor, duke ruajtur përsëri formën këndrejtë të saj në planimetri, me pamje të hapura nga lindja e veçanërisht nga jugu. Shtëpia e zjarrit ruhet e paprekur dhe qëndron në lartësinë e dy kateve të saj.

Në fig. 4 është paraqitur një rikonstruksion banese, e cila del jashtë kuadrit të një ndërtese të veçantë dhe paraqet një kompleks banimi, një pikë kulmore që mori zhvillimi i kësaj banese. Ajo ka formë katrore me përmasa 15 x 15 m dhe i përkiste një familjeje të madhe. Në këtë kompleks rritja numerike e familjes është përballuar me shtesën e banesës ekzistuese (shtëpisë së zjarrit), duke mos vënë dorë në «shtëpinë e madhe» dhe ruhet «Oda e miqve» e përbashkët për të gjithë kompleksin e ri. Në këtë ide ka gjetur rrugë zgjerimi nëpërmjet ndërtimit dykatësh, poshtë hajat për bagëti, sipër mjedise për fjetje, që lidhen midis tyre me anën e një ballkoni të hapur, më tej, brenda oborrit, është ndërtuar «kulla e bereqetit», e cila poshtë përsëri ka hajat për bagëtinë e sipër shërben pjesërisht për fjetje e pjesërisht për bereqetin, së fundi «kulla e sanës», përsëri me dy kate, sipër për depozitë bari, ndërsa poshtë për bagëti. Një kompleks i tillë banimi përballonte nevojat e një familjeje të madhe me rreth 60 banorë.

Mendojmë se faktorët e ekonomisë urbane, të ekonomisë së truallit të peizazhit urban të gjetura nga populli në ecurinë kohore, duhen të bëhen më tepër objekt studimi dhe kërkojnë nga projektuesit urbanistë një përkujdesje më të madhe e një disiplinim më të organizuar të ecurisë urbane të zonave rurale (fig. 5).

MONUMENTET E KULTURËS NË FSHATRAT E RRETHIT TË TIRANËS

1. Kalaja e Dorzës në fshatin Pezë e Madhe
2. Kalaja e Varoshit në fshatin Ndroq
3. Kalaja e Lalmit në fshatin Vaqar
4. Kalaja e Petrelës në fshatin Petrelë
5. Kalaja e Tujanit në fshatin Priskë-Shish-Tufinë
6. Kalaja e Prezës në fshatin Prezë
7. Kalaja e Dajtit në rrëzë malit të Dajtit
8. Ura e Brarit në fshatin Brar
9. Ura Kanal në fshatin Zall-Herr
10. Muret antike dhe varri përsqopit në fshatin Petrelë
11. Tyrbja e nuses në fshatin Mullet
12. Rrënojat e kishës së Shënmërisë në fshatin Linxë-Surrel
13. Rrënojat e kishës në fshatin Brrar
14. Banesa e Sulejman Metës (Bajram Ukës) sot shtetërore në fshatin Brar
15. Banesa e Sinan Bonacës në fshatin Priskë e Madhe
16. Banesa e Qamil Culhaj në fshatin Surrel Priskë
17. Banesa e Adem Danit në fshatin Herr Pinar
18. Banesa e Ish Bajram Lamit në fshatin Zall Bastar
19. Banesa e Riza Lilës në fshatin Zall-Mner
20. Banesa e Ahmet Cunit në fshatin Murrizë-Zall-Bastar
21. Banesa muze e Haxhi Qamilit në fshatin Sharrë
22. Shtëpi muze e xha Dyrit në fshatin Pezë
23. Shtëpia ku u mbajt konferenca e Pezës në fshatin Pezë
24. Shtëpia e Dalip Karait në fshatin Alltat Baldushk
25. Çezma monumentale Prezë.

21) Theksojmë edhe një herë, se për këtë çështje, materiali bazë që kemi shfrytëzuar janë punimet shkencore të përmendura të K. Zhekut dhe të A. Mukës.

DO NOT COPY

DO NOT COPY


Rrethi i Krujës
Rrethi i Matit
Rrethi i Durrësit
Rrethi i Librazhdit
Zall Mënar
Preze
Zall Bastar
Zall Herr
Pinar
Brar
Dajt
Tujan
TIRANA
Shkallë
Surel
Laim
Vagar
Sharrë
Peske e Madhe
Nitroq
Peze Helmes
Allajate
Mullet
Kllojkë
Petrelë
Bertalë
Dorëz
Peze e Madhe
Baldushk
15 KM
10 KM
20 KM
Banesë
Monument Historik
Kështjellë
Urë
Portë e Qeme monumentale
Kishë
Qytetë Antike
MONUMENTET KULTURORE DHE HISTORIKE NE RRETHIN E TIRANES

Faik ALIMEHMETI

DO NOT COPY

SUR L'EVOLUTION URBAINE DES VILLAGES DE TIRANA

RESUME

La région de Tirana est formée de trois zones géographiques bien distinctes par la configuration naturelle. A l'est la région montagneuse et à l'ouest celle des collines qui cernent la plaine en forme de fer à cheval. Située au carrefour des voies reliant les régions, la plaine de Tirana, depuis l'antiquité était un endroit important qui reliait les régions du nord du pays et celles du sud. Le système routier, témoigné par les fouilles archéologiques a influé à sa formation urbaine. Le long de ces voies, à des points stratégiques s'élevaient des centres habités fortifiés. Ceux-ci étaient des groupes d'habitations à l'intérieur d'une enceinte. Cette sorte d'habitat fortifié représente le premier exemple du centre urbain dans la contrée de Tirana. On en a découvert d'autres qui ne sont pas encore étudiés mais qui diffèrent par leur grandeur, leur époque de construction, l'importance qu'ils ont connue, devenant ou pas des centres ruraux.

Cet article traitera l'évolution dans le temps des villages de Tirana du XVe au XXe sc, s'appuyant sur les régistres ottomans et sur les données démographiques, géographiques-économiques de l'art de construction de cette contrée. Selon l'enregistrement de l'année 1431-32, la contrée de Tirana comptait environ 60 centres habités avec presque 1000 habitations et 7300 habitants. En 1583, d'après les données statistiques du régistre, il y avait 112 centres habités avec environ 2900 habitations et 20.000 habitants. Se basant sur les données de ces régistres, on a dréssé la cartographie de la dispersion des centres habités d'où il résulte que les centres ruraux se sont concentrés dans la plaine, depuis les collines de Sauk jusqu'à celles de Preza, et dans les collines à Vorë, Zallher, Baldushk, Petrele. Dans la région montagneuse, les centres ruraux étaient moins denses.

La cartographie fut enrichie particulièrement par l'enregistrement de l'année 1927 (peu après la proclamation de Tirana capitale de l'Albanie). Au cours des XVIe-XXe sc les environs de la ville se soumettent à de grandes modifications avec l'épanouissement des nouveaux centres au voisinnage de la ville, l'élargissement considérable de quelques villages qui possèdent des constructions sociales et des marchés, la croissance du nombre des habitants surtout de ceux des villages situés sur les collines. L'enregistrement de l'année 1927 mentionne 124 centres habités dans la région de Tirana avec 41098 habitants dont 12.453 habitaient la ville. Il faut noter qu'en comparant l'enregistrement de l'année 1979 avec celui de l'année 1927, il résulte que la population de la région se présente 4 fois multipliée et celle de la ville 17 fois.

En général, le dynamisme de la région de Tirana se caractérise par une croissance continuelle de la population. En ce qui concerne la structure urbaine, d'après l'enregistrement de l'année 1431-32, on constate un élargissement des villages et très rarement une croissance de la densité des habitations; plus tard, en 1583, les villages des zones montagneuses et de celles de collines se présentent par deux ou trois groupements, d'habitations nommés Zall, Katund, Mal. Dans ce groupement Katund et Zall comprennent un plus grand nombre d'habitations que Mal dont les habitations sont assez rares. Au cours de cette période, la zone de la plaine était moins peuplée que les deux autres et le flux des habitants se dirigeait vers la montagne. Après le XVIe sc ce processus changea de direction. Du XVI^ë au XIXe sc on remarque que Zall et Mal deviennent des habitations permanentes qui se diférencient par les nouveaux impôts, l'un sur les produits agricoles et l'autre sur le pâturages et le bétail (Bastari). Au début, en montagne, l'habitation se présente par un long parc dont l'origine fut la chaumière en haie et en pisé, quelquefois en pierres, couverte de dalles, puis aux XVI-XIX sc apparait l'habitation à étages.

Dans la région de la plaine, la physionomie urbaine se présente autrement. On y rencontre des centres habités d'une large étendue et d'un caractère agricole bien marqué. Généralement, le village de la plaine est formé de deux quartiers, l'un sur la colline (katundi) l'autre sur la plaine et on y distingue le «mëhalla» (petit quartier). Du point de vue de la structure sociale, dans la région de Tirana au cours des XVIe-XIXe sc, on remarque trois catégories de villages-ceux avec des propriétaires fonciers (petits, moyens, riches) ceux sans propriétaires (çifçinj) et ceux avec les deux catégories des habitants. Cette différence économique sociale se reflète même à l'aspect urbanistique et architectonique du village.

Les villages de la première catégorie se situent essentiellement sur le flanc de la montagne, leurs habitations sont en pierres puisque les villageois y étaient des habitants permanents. En général elles sont du type «Kulla», groupées (Shëngjergj) ou dispersées auprès des terres cultivabels (Bistor).

Les villages de la deuxième catégorie s'étendaient dans la

plaine. Leurs habitants, les çifçinj, logeaient dans les habitations du propriétaire qui leur louait aussi la terre. C'était en des habitations assez modestes, généralement en pisé. Le village des propriétaires avait des habitations à un étage alors que celui des çifçinj des habitations à simple rez-de-chausée. Dans la troisième catégorie se reflète la structure économique respectable. Puisque ceux qui y travaillaient comme çifçinj étaient des villageois qui avaient perdu leur terre, les habitations de ces villages étaient en pierres. On trouvait aussi des chaumières pour les çifçinj venus d'un autre village. Enfin, par les études, effectuées sur la typologie de ces habitations, il résulte que le noyau de sa composition est constitué par «la maison du feu» précédée d'un tchardak, qui se conserve même plus tard sur le plan horizontal et vertical. Dans ce sens, ce processus de l'étendue des habitations de la contrée de Tirana dans le temps, demeure encore un objet d'études et de recherches importantes. Nous pensons que les valeurs architectoniques de cette habitation doivent être pris en considération par les urbanistes de nos jours afin d'améliorer l'évolution urbaine des régions rurales en l'avenir.

DO NOT COPY

Nr. 1 1988

monumentet

Resul LLOGO

DISA GJURMË ANTIKE NË LUGINËN E DRINOS

Lugina e Drinos, që fillon nga Kakavia dhe mbaron në afërsi të Tepelenës, e njohur për vendbanime të shumta antike dhe mesjetare, përshkohet nga një rrugë që lidh Shqipërinë e Mesme me Greqinë, e cila funksiononte qysh në kohët e lashta. Kjo luginë nga të dyja anët rrethohet nga vargmale të larta. Por ato lejojnë lidhjen ndërmjet tyre të zonave të Zagorisë dhe Pogonit, malësinë e Kurveleshit dhe fushën e Delvinës. Kjo lidhje kryhet me anë të tri rrugëve, në grykat e Suhës, Qafën e Muzinës dhe grykën e Kardhiqit. Praninë e këtyre rrugëve, krahas qëndrave të fortifikuara, e dëshmojnë edhe gjetjet e ndryshme arkeologjike. Gjatë vrojtimeve në terren, krahas qendrave të njohura kemi zbuluar një sërë pikash të panjohura të cilat po i rendisim më poshtë:

1) Dyqind metra në lindje të shkollës së mesme në Urën e Kardhiqit, gjatë punimeve bujqësore, u hapën disa varre me orientim nga lindja. Ato formohen prej rrasash shtufore të vendosura në formë arke. Përmasat e tyre janë 1,80 x 0,80 x 1 m. Materiali qeramik përbëhet prej fragmentesh vorbash të punuara pa kujdes të veçantë dhe dy lotore. Varri duhet t'i përkasë shekujve të parë të erës sonë.

2) Gjatë punimeve bonifikuese në luginën e Kardhiqit, në kodrën përballë pasarelës, u zbuluan disa varre. Ata mbulohen me një çati dy ujëse prej tjegullash. Varret kanë përmasa të vogla, deri në 1,5 m, të orientuar nga verilindja. Qeramika e gjetur e tipit «pseudorrasigilata» i daton ata në shekujt II-III e.s.

3) Rreth 200 m në lindje të këtyre varreve, tek Bregu i Fiqve, u zbulua një mur me gjerësi 0,8 m. Muri është ndërtuar me gurë të vegjël dhe tjegulla të lidhura me llaç. Afër tij, në 1 m thellësi, u zbulua një fragment skulpture. Prej saj ruhet qafa dhe gjoksi i një personi të veshur me togë. Skulptura prej guri të fortë gëlqeror duket se është punim lokal. Punimi i saj është me cilësi të larta artistike. Duke u nisur nga profili i gërshetit në trajtë vile rrushi mendojmë se kemi të bëjmë me portretin e Dionisit. Punimi i palave me trapano e daton skulpturën në shekujt II-III e.s.

4) Në fshatin Kakodhiq, në mes të një arre, nga fundi i fshatit, ndodhet një burim uji. Këtu u gjetën mure me gurë të lidhur me llaç, si dhe kolloneta me tulla të rrumbullakta me diametër 20 cm dhe trashësi 5 cm. Prania e burimeve të shumta të ujit na shtyn të mendojmë se kemi të bëjmë me kolona të hipokaustit të një terme, ndoshta të një stacioni rrugor.

Pas Kakodhiqit rruga shmangej nga rruga e sotme, duke e lënë qafën e Tarominës dhe duke ndjekur luginën e Piksit, deri sa dilte në Qafën e Skorficës, 812 m mbi nivelin e detit, për të zbritur pastaj në pellgun e Delvinës. Këtë rrugë e shoqërojnë fortifikime të tjera, si ai i Dragasit dhe Vilës, afër fshatit Tatzat.

DO NOT COPY

Resul LLOGO

QUELQUES TRACES DE L'ANTIQUITE DANS LA VALLEE DE DRINO

RESUME

La vallée de Drino, qui s'allonge de Kakavi jusqu'au voisinage de Tepelena, connue pour ses nombreuses agglomérations antiques et médiévales, est parcourue d'une voie antique qui relie l'Albanie centrale et la Grèce. A part les centres fortifiés la présence de cette voie est témoignée par les diverses trouvailles archéologiques.

1) 200 m à l'est de l'école de Ura e Kardhiqit, au cours des travaux agricoles furent découvertes quelques tombes orientées vers l'est. C'étaient des dalles de ponce disposées en forme de caisse, dont l'une avait les dimensions: 1,80mx0,80mx1m. Les fouilles livrèrent des tessons de céramique et deux vases lacrymales.

2) Les travaux de bonification dans la vallée de Kardhiq, sur la colline en face de la passerelle, mirent au jour quelques autres tombes. Elles étaient formées de deux plaques latérales appuyées sur terre couvertes d'un toit de tuiles à deux pentes. La céramique découverte, remonte au IIe-IIIe sc.

3) 2000 m à l'est de ces tombes fut découvert un mur d'une largeur de 0,8 m, construit avec des pierres et des tuiles liées au mortier. Tout près, à 1m de profondeur on trouva le torse d'une sculpture en pierre calcaire assez dure. C'est un travail de haute qualité artistique qui par le profil de la tresse en forme de grappe de raisin, nous induit à penser au portrait de Dionis. La réalisation des plis au moyen d'une perceuse date la sculpture aux IIe-IIIe sc.

4) A côté du village Kakodhiq, au milieu d'un champ se trouve une fontaine. On y trouva des fragments de mur de pierres liées au mortier et des colonnettes en briques arrondies d'un diamètre de 20cm et d'une épaisseur de 5 cm. La présence des nombreuses fontaines nous pousse à penser que ce sont les colonnettes de l'hypocauste d'une station routière (mutatio).

Après Kakodhiq, la voie dévie de la voie actuelle laisse le col de Taromine suit la vallée de Piks, le point le plus délicat du passage, atteint le col de Scrifice 812 m au-dessus du niveau de la mer, pour descendre au bassin de Delvina où d'autres fortifications comme celui de Dragas ou la ville près de Tatgat, la protègent.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

NJË BOTIM NË FRANCË PËR MONUMENTET E KËRKIMET ARKEOLOGJIKE NË SHQIPËRI

Një numër i veçantë i revistës «Dossiers histoire et archéologie», që u botua kohët e fundit në Francë, i kushtohet tërësisht monumenteve, kërkimeve e rezultateve të studimeve arkeologjike në Shqipëri. Botimi është realizuar me bashkëpunimin e punonjësve të Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike dhe të Institutit të Monumenteve e Kulturës, nën kujdesin e studiuesit francez Alain Mahuzier.

Që në faqen e parë, vihet në dukje se Shqipëria e vendosur në kryqëzim të rrugëve të mëdha antike, që lidhin Lindjen me Perëndimin, duke pasur fqinjë Greqinë dhe Italinë, ka qenë e lidhur drejtpërdrejt me ngjarjet e mëdha historike, kulturore që janë zhvilluar në Evropën Qendrore e në pellgun mesdhetar. Ilirët që zinin territorin e Shqipërisë së lashtë, numërohen ndër popujt më të mëdhenj të lashtësisë.

Para Çlirimit në Shqipëri janë bërë kërkime të karakterit të pjesshëm nga dijetarë të huaj, por Qendra e Kërkimeve Arkeologjike e krijuar në Tiranë mbas Luftës së Dytë Botërore, rigrupoi studiuesit shqiptarë të disiplinave të ndryshme historike, duke ndërmarrë kërkime në shkallë të gjera, në tërë terrenin shqiptar.

Prehistoria shqiptare dhe raportet e saj me Ballkanin dhe Egjeun, kultura ilire që i dha hov qytetërimit mesjetar të arbërve të hershëm, lidhja e tyre me shqiptarët modernë, janë argumentuar me zbulime të reja që i janë bërë të mirënjohura edhe publikut të huaj shkencor. Qëllimi i këtij numri të veçantë të revistës, përfundon shënimi i redaksisë, është t'i bëjë të njohura studimet mbi arkeologjinë shqiptare. Revista ka ilustrime të shumta për zbulimet e bëra vitet e fundit në vendin tonë.

Revista nis me artikullin «Zbulime të arkeologjisë shqiptare», të M. Korkutit, ku jepet një pasqyrë e shkurtër e kërkimeve të shumanshme të periudhave të ndryshme, duke theksuar vijimësinë etnike e kulturore.

Në rubrikën «Prehistoria protohistoria ilire» publikohet cikli i studimeve «Mbi gjurmët e prehistorisë shqiptare», «Qytetërimi ilir», «Stoli ilire të periudhës së hekurit», «Tumat e Kukësit, trashëgim dardan» (B. Jubani), «Iliria në ciklet e legjendat greke» (A. Mahuzier), «Shqipëria dhe bota egjeane» (F. Prendi).

Në studimet bëhen të njohura rezultatet e kërkimeve të zanafillës dhe të shkaqeve të krijimit e formimit të qytetërimit ilir, të lidhjeve më të hershme me kulturat e tjera të lashta mesdhetare, të para jo vetëm në aspektin e objekteve materiale, por dhe të botës mitike shpirtërore. Për këtë merr rëndësi të veçantë si skicimi dhe paraqitja e kulteve prehistorike e të mëvonshme ilire, ashtu dhe ndërfutja në mitet greke, gjë që e vë në dukje studimi i A. Mahuzier.

Rubrika e dytë e titulluar «Qytetërimi urban në Iliri» përfshin shkrimet: «Ilirët e grekët në Dyrrahium» (S. Anamali), «Apollonia e Ilirisë» (A. Mahuzier), «Monedhat antike të Ilirisë së Jugut» (Sh. Gjongecaj), «Butrinti – minierë e mbishkrimeve të lashta» (F. Drini), «Mozaikët paleokristianë» (Dh. Dhamo), «Mbi gjurmët e një legjende» (N. Ceka), Antigonea – qytet i fuqishëm epirot» (Dh. Budina), «Shoqëria e institucionet në Shqipërinë antike» (P. Caban), «Fortifikimet në antikitetin e vonë» (A. Baçe).

Në këtë rubrikë, përgjithësimet shkencore kanë rëndësi të veçantë për dukuritë e qytetërimit urban ilir, për raportet e kolonive greke të Durrësit, Apollonisë etj. me qytetin ilir. Në të trajtohet dhe procesi i ilirizimit të kolonive të mësipërme në shek. IV-II p.e. sonë, lidhjet e qytetit ilir dhe atij epirot, etj.

N. Ceka jep të dhëna për një tempull në natyrë të hapur në liqenin e Belshit, ku praktikohej riti i hedhjes në ujë i terakotave të një hyjneshe ilire. Terakota me rëndësi për historikun e artit të lashtë,

Dh. Dhamo merr në konsideratë gjetjet e mozaikëve të antikitetit të vonë duke bërë identifikimin e figurave antropomorfe dhe jep shpjegimin e kuptimeve simbolike të skenave, duke vlerësuar cilësitë artistike të artit muziv në Shqipëri.

A. Baçe analizon monumentet fortifikuese të antikitetit të vonë, për të argumentuar vijimësinë qytetare në prag të procesit të rëndësishëm të formimit historik të popullit shqiptar në mesjetë A. Mahuzier, në përshkrimin e Apolonisë, ndalet te disa skulptura të shkollës apoloniane, duke vënë në dukje vlerat artistike, kurse P. Caban, F. Drini e Dh. Budina theksojnë karakterin ilir të mënyrës së jetesës në qytetet epiriote dhe institucionet e tyre. Këto të dhëna plotësojnë në mënyrë të kënaqshme tablonë e qytetit ilir në antikitet.

Rubrika e tretë «Arbërit e mesjetës» përfaqësohet nga studimet: «Kultura arbërore e Komanit» (D. Komata), «Arbërit e Jugut» (N. Bodinaku), «Zbukurime e stoli arbërore» (H. Spahiu), «Kështjellat e mesjetës» (Gj. Karaiskaj). Kjo rubrikë, që pasqyron të dhënat arkeologjike për mesjetën shqiptare e monumentet e saj, thekson origjinalitetin e kulturës së hershme shqiptare, objektet më përfaqësuese të «Kulturës së Komanit» si dhe të zbulimeve të objekteve të së njëjtës periudhë, në luginën e Vjosës, duke i plotësuar me veçori lokale (N. Bodinaku), Gj. Karaiskaj vë në pah jo vetëm karakterin arkitektonik të kështjellave e fortifikimeve mesjetare në Shqipëri, por dhe domosdoshmërinë e tyre historike, lidhjen e tyre me jetën e qytetit mesjetar dhe me formacionet shtetërore të shqiptarëve në mesjetë.

Të tri rubrikat, me 18 studime të specialistëve shqiptarë e 3 studime të dy specialistëve francezë, përbëjnë një tërësi të konceptuar kronologjikisht, për të dhënë një sintezë të arritjeve shkencore të arkeologjisë shqiptare dhe të punës me monumentet antike e mesjetare në Shqipëri. Shkrimet shoqërohen me 145 fotografi, skica, harta etj. të monumenteve e objekteve të ndryshme. Pjesa më e madhe e N. Babës, ndërsa të tjerat janë të studiuesit francez A. Mahuzier. Mbylljen e rubrikave e pason një bibliografi e studimeve të dijetarëve shqiptarë e të huaj, mbi kërkimet për monumentet arkeologjike në Shqipëri, si dhe një tabelë kronologjike.

Botimi i një numri të veçantë të revistës franceze «Dossiers histoire et archéologie» është një informacion i çmuar për publikun e huaj, që jep një pasqyrë të gjerë të sukseseve të arritura në fushën e studimeve të trashëgimisë shekullore kulturore në vendin tonë.

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

DO NOT COPY

UNE EDITION EN FRANCE SUR LES MONUMENTS ET LES RECHERCHES ARCHEOLOGIQUES EN ALBANIE

Un numéro spécial de la revue «Dossiers histoire et archéologie» publié dernièrement en France est dédié aux monuments culturels et aux recherches archéologiques en Albanie. C'est une édition réalisée par la collaboration du Centre de Recherches Archéologiques avec l'Institut des Monuments Culturels sous le patronage du chercheur français Alain Mahuzier.

A la première page on souligne que l'Albanie, située au carrefour des pays balkaniques de la Grèce et de l'Italie, a toujours été directement concernée par les grands événements historiques et culturels qui se sont déroulés en Europe centrale et dans le Bassin méditerranéen. Les Illyriens qui occupaient le territoire de l'Albanie ancienne, comptent parmi les grands peuples de l'Antiquité.

Avant la libération, en Albanie, furent effectuées des recherches partielles par des savants étrangers mais le centre de Recherches Archéologiques créé à Tirana après la Deuxième Guerre Mondiale et qui regroupe les chercheurs albanais des différentes disciplines, a entrepris de vastes travaux sur le territoire albanais.

La préhistoire albanaise et ses rapports avec celle des Balkans ou de l'Egée, la culture illyrienne qui a donné naissance à la civilisation médiévale des Arbers, et à celle des Albanais modernes, se sont enrichies de nouvelles découvertes et sont désormais mieux connues. Ce numéro de la revue «Dossiers Histoire et Archéologie, termine l'annotation de la rédaction, a pour but de faire connaitre les recherches sur l'archéologie albanaise. La revue est abondamment illustrée par les découvertes faites dans notre pays au cours des dernières années.

La revue s'ouvre par l'article de M. Korkuti «Découvrir l'archéologie albanaise» qui traite brièvement les multiples recherches des diverses périodes, mettant l'accent sur la continuité ethnique et culturelle.

A la rubrique «Préhistoire et protohistoire illyriennes» on publie le cycle «Sur les traces de la préhistoire albanaise (F. Prendi), «La civilisation illyrienne», (M. Korkuti), «Parures illyriennes de l'âge du fer», (Zh. Andrea). «Les tumulus de Kukës: l'héritage dardanien», (B. Jubani), «Illyrie dans les cycles héroïques des légendes grecques» (A. Mahuzier) «L'Albanie et le monde égéen» (F. Prendi).

Ces études font connaitre les résultats de l'origine des recherches et des motifs qui donnèrent naissance à la ville illyrienne, des anciens rapports avec les autres cultures anciennes médiévales, vus non seulement sous l'aspect des objets matériels, mais aussi sous celui du monde mythique et spirituel. A cet égard, une importance particulière revêtent tant la présentation des cultes préhistoriques et ceux ultérieurs illyriens que l'introduction aux mythes grecs, ce qui est mis en évidence par l'étude de A. Mahuzier.

La deuxième rubrique intitulée «La civilisation urbaine en Illyrie du sud» comprend ces études; «Illyriens et hellènes à Dyrrachion» (S. Anamali), «Apollonia d'Illyrie» (A. Mahuzier), «Monnaies antiques d'Illyrie du sud» (Sh. Gjongecaj), «Bouthrotos, mine d'inscription antiques» (F. Drini), «Les mosaïques paléochrétiennes (Dh. Dhamo), «Sur les traces d'une légende» (N. Ceka), «Face à Apollonia; la ville de Byllis» (Dh. Budina), «Antigonea, puissante cité épiriote» (Dh. Budina), «Société et institutions d'Albanie antique» (P. Cabanes) «Fortifications de la basse antiquité» (A. Baçe).

Dans cette rubrique, les synthèses scientifiques représentent une particulière importance quant aux phénomènes de la civilisation urbaine illyrienne, des rapports que les colonies grecques Durrachium, Apollonia etc, entretenaient avec la ville illyrienne. Elle traite aussi du processus de l'illyrisation des colonies déjà mentionnées du IVe-IIIe sc. av. n.è, des rapports de la ville illyrienne avec celle de l'Epire etc.

N. Ceka avance des données sur un temple en pleine nature, au lac de Belsh, où l'on lançait des terres cuites représentant une divinité illyrienne. Dh. Dhamo prend en considération la découverte des mosaïques de la basse antiquité en identifiant les figures anthropomorphes, en expliquant le sens symbolique des scènes et en apprécient les réalisations artistiques de l'art de la mosaïque en Albanie.

A. Baçe, analyse les fortifications de la basse antiquité afin d'argumenter la continuité urbaine à la veille du processus important de la formation historique du peuple albanais au Moyen-Age. A. Mahuzier, dans sa description d'Apollonie, s'arrête à quelques sculptures de l'école apolioniate, mettant en évidence les valeurs artistiques alors que P. Cabanes, F. Drini et Dh. Budina mettent l'accent sur le caractère illyrien du mode de vie dans les villes épiriotes et leurs institutions. Ces données complètent de façon satisfaisante le tableau de la ville illyrienne au cours de l'antiquité.

La troisième rubrique «Les arbres du Haut Moyen Age» est représentée par les études: «La culture arbere de Koman, (D. Komata), «Les arbres du Sud» (N. Bodinaku), «Parures et

DO NOT COPY

bijoux albers» (H. Spahiu), «Les citadelles du Moyen Age» Gj. Karaiskaj).

Cette rubrique reflète les données archéologiques du moyen âge albanais et ses monuments, met l'accent sur l'originalité de l'ancienne culture albanaise, sur les objets les plus représentatifs de la «Culture de Koman» et sur la découverte des citadelles et des fortifications médiévales mais aussi sur leur indispensabilité historique, sur leurs relations avec la vie de la ville médiévale et les formations d'État des albanais, au moyen âge.

Les trois rubriques, avec les 18 études des spécialistes albanais et les trois études des deux spécialistes français, constituent un ensembel conçu chronologiquemont, afin de donner une synthèse des réalisations scientifiques de l'archéologie albanaise et du travail sur les monuments antiques et médiévaux en Albanie. Les textes sont accampagnés de 145 photos, plans, cartes etc. des monuments et des divers objets. La revue se termine par une bibliographie des études des chercheurs albanais et étrangers sur les recherches des monuments archéologiques en Albanie.

L'édition d'un numéro spécial de la revue française «Dossiers histoire et archéologie» représente une information spéciale pour le public étranger, il donne un large tabelau des réussites dans le domaine des études sur l'ancien héritage culturel de notre pays.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë